Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

http://kk.rks-gov.net/istog/
Tel: 038/200 438 14

00 Numër: 90/2025
Data:21.05.2025

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

Për: Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës-Istog

Në bazë të nenit 43 neni 45 dhe neni 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe nenit 48.3 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, neni 5 i Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve te Kuvendit te Komunës.

T H Ë R R A S

Mbledhjen e **38-të** të rregullt të Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës.
Mbledhja do të mbahet më: **30.05.2025, e Premte,** në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati III, duke filluar me punë **në ora 10:00.**

R E N D D I T E:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Njoftimi me Qarkoren Buxhetore nr.1 të Ministrisë së Financave për kufijtë preliminar të përgatitjes së Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për Destinimin e parcelës për varreza në fshatin Zhakovë,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për pesë komunat e rajonit të Dukagjinit, Pejë, Klinë,Istog, Deçan dhe Junik 2025-2035,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së projekteve kapitale në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2025,
8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova
E.Rugova

Vërejtje :
Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në mbledhje,
t'i referoheni dispozitës së nenit 39 paragrafi 39.8 të LVL.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

http://kk.rks-gov.net/istog/ Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e tridhjetë e shtatë e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **30.04.2025,** në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00.**

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

1. Enver Rugova, LDK;
2. Hajrush Shoshi, LDK;
3. Faruk Kabashi, LDK;
4. Haki Podrimaj, LDK;
5. Veton Kurti, LDK;
6. Faik Alushaj, LDK;
7. Arta Balaj, LDK;
8. Liridona Lajçi, LDK;
9. Valbona Demaj, LDK;
10. Ruzhdi Metaj, LDK;
11. Arianit Selmanaj LDK;
12. Agron Gashi, AAK;
13. Ajshe Metaj, AAK;
14. Ardita Idrizaj, AAK;
15. Fjolla Ukaj, AAK;
16. Negjdet Ramaj, AAK;
17. Nexhmedin Balaj AAK;
18. Niman Beqiraj, VV
19. Florin Dreshaj,VV;
20. Floriana Maxharraj, VV;
21. Lavdije Bujupaj, VV;
22. Arian Shatri VV;
23. Andi Xhuraj PDK ;
24. Visar Haxhijaj, PDK;
25. Era Visoqi, PDK;
26. Djula Karisik,GIBI;

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm Kryetari i komunës Ilir Ferati,NënKryetari i Komunës Ali Nimanaj Drejtorët e Drejtorive, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV – Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: ”shembulli 1”)
(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-te e xhirimit gjenden në dosje: “shembulli 2”).
(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në https://www.youtube.com/watch?v=P3uHqKA2F5I “shembulli 3”).

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit– përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.
Hap punimet për mbledhjen e tridhjetë e shtatë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës në sallë, prezentë janë 26 të anëtarë të Kuvendit.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R e n d d i t e

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e parë (Janar -Mars) të vitit 2025,
4. Bartja e mjeteve të pa shpenzuara buxhetore të hyrave të bartura nga viti fiskal 2024 dhe të hyrat e tejkaluara në vitin 2025.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Transparencë Komunale,
6. Shpallja në diskutim publik e Rregullores për Subvencione,
7. Shpallja në diskutim publik e Rregullores për Tregun tërë ditor në Istog,
8. Shpallja në diskutim publik e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale,
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për destinimin e lokacionit për varreza në fshatin Rakosh,
10. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit- njoftoi se pas mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) më 22.04.2025, janë marrë vlerësimet për katër prona nga Agjencia për Vlerësimin e Pronave. KPF-ja rekomandoi që këto pika të shtohen në rendin e ditës për mbledhjen e Kuvendit të datës 19.05.2025. Gjithashtu, ai sqaroi një gabim në njoftimin për komisionin e ankesave ndaj ndarjes së bursave, ku kishte përmendur tre anëtarë të Kuvendit, ndërsa ishin dy. Ai kërkoi falje për këtë lëshim dhe pyeti Kuvendin dhe ekzekutivin nëse kishin ndonjë sugjerim apo vërejtje lidhur me rendin e ditës. Fjalën e mori Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- mbledhjen e kaluar ekzekutivi e ka bërë një zotim që do të vjen me një draft Rregullore për emërimin e objekteve komunale, desha ta di se çfarë po ndodhë?

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës- një prej pikave përpos pikave shtesë që i kemi në planifikim me i listuar në këtë rend dite ka qenë edhe njoftimi për themelimin e grupit punues për hartimin e projekt Rregullores për emërtimin e institucioneve kulturore,sportive, arsimore, shëndetësore dhe institucioneve tjera që ka të bëj me emërtim të cilin e diskutove edhe ti. Personalisht jam kryesuesi i atij grupi punues, janë pothuajse të gjithë drejtorët e ekzekutivit, ka përfaqësues prej sportit, të organizatës së familjes së dëshmorëve,të burgosurve politikë, prej OVL UÇK, prej Zyrës së Informimit, pothuajse të gjithë sektorët e jetës që e përbëjnë komunën e Istogut dhe që ky grup punues ka me e hartuar Rregulloren për emërtimin e institucioneve, parqeve, shesheve, shkollave çka do që ne e kemi në planifikim dhe ato që na vijnë përmes kërkesave që janë dorëzuar e para mos gaboj ka qenë prej anëtares së Kuvendit znj.Floriana Maxharraj edhe tutje tjerat, edhe debatet që i kemi pasur lidhur me emërtimet e institucioneve. Besoj shumë që bashkë me grupin në mbledhjen e ardhshme kemi me ardhur me një draft të Rregullores të cilën kemi me e shpallë në diskutim publik e pastaj me i vazhduar procedurat e tjera. Faleminderit që e ngrite si çështje! Tani po vazhdoj me dy pika jashtë rendit të ditës që i propozoj të hyn në rend dite për sot, e para është Shfuqizimi i Rregullores për Kategorizimin e Klubeve Sportive dhe pjesa e dytë, diskutimi që e kemi pasur edhe me ju edhe me sindikatën dhe me një pjesë dërrmuese të zyrtarëve është me e vazhduar propozimin për kompensimin për shujtat për zyrtarët publikë. Llogaritë që janë bërë, del që nëse vazhdojmë me të njëjtën shifër që ka qenë e aprovuar herën e kaluar po prej këtij Kuvendi me 3.50 euro (tri euro e pesëdhjetë cent) në shumë ditore e që i bie prej 647-728 ditë pune për vitet 2022-2024, 196 punëtorë në total 2264.50 euro për punëtor janë 443.000 e 800 sosh në të cilat ne hymë në obligim po e ceku në momentin e parë që krijohen kushtet financiare për kompensim. Pse po e them këtë, në muajin janar jemi dëmtuar prej përmbaruesit për kompensim të shujtave për kontratën kolektive diku rreth 700.000 euro, vitin e kaluar e ka prek shifrën 3.000.000 euro gjatë tërë vitit. Mirëpo edhe me mirëkuptimin e zyrtarëve edhe sindikatës dhe të anëtarëve të Kuvendit që kanë pasur diskutime me plotë të drejtë, kisha kërkuar që kjo pikë të bëhet pjesë e rendit të ditës dhe të kaloj shuma prej 3.50 euro (tri euro e pesëdhjetë cent) me e cek që në momentin e parë të krijimit të kushteve financiare ne me e vazhduar me ju përgjigj si obligim zyrtarëve publik për shujtat ditore të ushqimit.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Kryetari! Fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- unë e pata një vërejtje te krejt diçka tjetër por po lidhem te kjo çka e tha kryetari, po më vjen mirë që e keni sjellë për shfuqizim Rregulloren për Kategorizimin e Klubeve Sportive sepse ka qenë tmerr. Dhe vërejtjet e mia këtu kanë qenë se drejtoresha në dëgjim publik i ka përmendur ekspertët, kush janë ata që kanë punuar në atë Rregullore që bie ndesh me ligjet në fuqi për sportin. Dhe Lëvizja Vetëvendosje e përkrah për me e fut në rend dite. Edhe një vërejtje e pata kryesues, shumica e materialit na ka ardhur dje në ora 18:00 dhe kjo po përsëritet disa herë pastaj nuk po kemi mundësi as me e lexuar me e ditë si po votojmë pastaj po na fut në lajthitje këtu kur po votojmë shkel e shko. Vota është koxha obligim, se përfaqësojmë votën e qytetarit, dhe po të lus që më mos të ndodhë. Pastaj mbledhja e sotme që e keni mbajtur e Komitetit për Politikë dhe Financa, ato pika janë shumë të rëndësishme se qytetarëve ju ka marrë prona më shumë se dy vite dhe i keni maltretuar qytetarët duke ardhur në komunë e duke shikuar se a është përfunduar e sot e mbani mbledhjen, mua po më duket që ka qenë vetëm për mëditje. Keni mundur me i propozuar këtu ashtu siç ka ndodhur shpesh e kishim votuar se nuk jemi për me u dëmtuar qytetarët, por jemi për mënyrën se si po i procesoni gjërat dhe si po punoni. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës- në propozimin tim asnjëherë nuk e ceka që Rregullorja është e jashtëligjshme, drejtoresha me plotë të drejtë ka thënë që ka qenë pjesë e grupit të hartimit ekspertë, përfaqësues të klubeve sportive që janë pjesë edhe e aplikacioneve në secilën thirrje që ka të bëj me subvencionim të sporteve. E kemi diskutuar edhe në Kuvend, një pjesë e propozimeve më kujtohet të Agronit janë bërë pjesë e Rregullores, përndryshme përgjysmë me ekzekutivin përgjegjësinë e kanë edhe klubet sportive se janë me ekspert se unë e se ju. Arsyeja pse e thashë është edhe politike edhe qytetare për shkak se po konsideroj që në mënyrë të pa barabartë në raport me arritjet që ata i kanë, edhe një lloj diskriminimi i lehtë te vlerësimi i të arriturave qofshin ato kolektive personale varësisht prej orientimit të klubit. Sa i përket çështjes së mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, vlerësimet prej Ministrisë së Financave kanë ardhur pas mbajtjes së KPF-së që mbahet në orarin e rregullt, ligji e thotë që te çështja e këmbimit të pronës nuk mund të vijnë në rend dite pa kaluar në KPF, pse me e lëshuar ne një mbledhje të Kuvendit për shkak të një mbledhje të KPF-së dhe me proceduar me këmbim që njerëzit me i marrë kompensimet e veta vetëm për një vonesë që e ka pasur organi që merret me vlerësimin e pronave. Nuk ka qenë neglizhencë as për një mëditje, por ka qenë vonesa që ata e kanë bërë.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Kryetari! Fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- pikërisht ato pikat që i ka propozuar Agroni janë ato që bien ndesh me Rregulloren për Sportin me ligjet në fuqi, ato që është dashur me i përmirësuar edhe ka ra ndesh edhe me ligjin. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- Fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- grupi jonë e përkrah shfuqizimin e kësaj Rregullore siç e potencoi edhe kryetari ka qenë diskriminuese dhe besoj që ka me ardhur një Rregullore e re që ja u jep meritat të gjithë sportistëve. Si dhe për pikën dy, ne e kemi një vërejtje sa i përket thirrjes së mbledhjes së KPF-së ku një orë përpara u mbajt, pa marrë parasysh se cilat janë pikat ne duhet me i pas materialet dhe me ditë se çfarë po votojmë. Çdo seancë thirret 7 ditë pas mbledhjes së Komitetit e jo një orë pas me na ardhur ato. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- desha vetëm një sqarim se u tha që mbledhja e KPF-së është mbajtur vetëm për mëditje dhe dua të informoj se mëditje nuk merret, merret vetëm një mëditje brenda muajit. Mos të dezinformohet opinioni, prandaj nuk ka mëditje. E kemi kryer një procedurë e pamë edhe në material që me datë 25 është bërë vlerësimi i ministrisë, është mirë që këto prona të japen sepse është këmbim.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka edhe dikush diçka rreth rendit të ditës? Pasi që nuk ka, fillojmë pra me këto katër propozimet që i bëra unë : Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Istogut me pronën e paluajtshme të personit fizik z. Ardi Maraj. Kush është që kjo pikë të hyn në rend dite për sot?

Konstatojmë që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 22 vota pro 0 kundër dhe 3 abstenim kjo pikë hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

Vazhdojmë me propozimin e dytë, Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Istogut me pronën e paluajtshme të personit fizik z. Avdullah Bytyçi. E ftoj drejtorin këtu që ta na jep një sqarim.

Agon Dreshaj- jep sqarim lidhur me këtë pikë të propozuar.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- po i bie që ne jemi kundër këtyre pronave, nëse votojmë për nuk po e di për çka po votojmë se nuk kemi asnjë material, me votuar kundër munden qytetarët me thënë këta janë kundër këmbimit të pronave, kishte me

qenë mirë me e shtyer për seancën tjetër nuk kemi asnjë lloj materiali. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- unë kisha kërkuar që drejtori me na zgjeruar pak më mirë cili është interesi apo qëllimi i komunës që po bëhet ky këmbim dhe saktësisht ku janë pronat, materiali është duke u shpërndarë tani, unë e kam këtë informacion por shumica nuk e kanë, vetëm me na sqaruar pak më mirë.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Agon Dreshaj.

Agon Dreshaj- unë vetëm e lashë që kur të vjen radha e këtyre pikave pasi të futen në rend dite me jep sqarim dhe me i prezentuar, por pasi po më kërkohet tani, po vazhdoj. Drejtori prezanton dhe jep sqarimet për pikat e propozuar.

Kryesuesi i Kuvendit- po votojmë, kush është që kjo pikë të procedohet në mbledhjen e sotme?

Konstatojmë që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 21 vota pro 0 kundër dhe 4 abstenim kjo pikë hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e tretë të propozuar Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Istogut me pronën e paluajtshme të personit fizik z. Brahim Sejdaj,

Agon Dreshaj- prezanton dhe jep sqarimet e nevojshme për këtë pikë.

Kryesuesi i Kuvendit- po votojmë, kush është që kjo pikë të procedohet në mbledhjen e sotme?

Konstatojmë që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 22 vota pro 0 kundër dhe 2 abstenim kjo pikë hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e katërt të propozuar Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Istogut me pronën e paluajtshme të personave fizikë z. Avdullah Bytyçi, Ibrahim Bytyçi, Shkumbin Bytyçi, Haxhi Bytyçi

Drejtori Agon Dreshaj- prezanton dhe jep sqarimet e nevojshme për këtë pikë.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin, fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- desha vetëm një pyetje a është pjesa ku po ndërtohet një restaurant te ajo pjesa lartë?

Kryetari i Komunës- pjesa ku po mendon ti Negjdet është pjesë e Agjencionit të Pyjeve ku po ndërtohet restauranti.

Drejtori Genc Ademaj- jep sqarime shtesë lidhur me këtë pikë.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Lavdije Bujupaj.

Lavdije Bujupaj- ne si Lëvizje Vetëvendosje e përkrahim këtë këmbim, nuk e di sa ju kujtohet ka qenë edhe kërkesë e jona më herët që të punohet diçka në këtë drejtim në rregullimin e Bollovanit për interes të përgjithshëm komunal. Shpresoj shumë që të punohet në atë drejtim dhe mos të mbetet vetëm ndërrimi i pronës, por të punohet që mos të ketë vërshime.

Kryesuesi i Kuvendit- po votojmë, kush është që kjo pikë të procedohet në mbledhjen e sotme?

Konstatojmë që nga 22 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 19 vota pro 0 kundër dhe 3 abstenim kjo pikë hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

Vazhdojmë me radhë e kemi propozimin e ekzekutivit për Shfuqizimin e Rregullores për Kategorizimin e Klubeve Sportive. Po votojmë, kush është që kjo pikë të procedohet në mbledhjen e sotme?

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim kjo pikë hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

Vazhdojmë me pikën tjetër të propozuar nga ekzekutivi, Kompensimi i shujtave për zyrtarët publikë, kush është kjo pikë të procedohet në mbledhjen e sotme?

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim kjo pikë hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

Hedh në votim rendin e ditës për sot me propozimet e dhëna në tërësi, kush është të miratohet?

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet rendi ditës për mbledhjen e sotme.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- Në mbledhje mungon Njomza Demaj që për shkaqe shëndetësore ende nuk mund të marrë pjesë.

Të pranishëm në mbledhje janë 20 anëtarë të Kuvendit (disa prej tyre kanë lëshuar mbledhjen, disa të tjerë kanë dalë dhe kanë hyrë prapë).

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin në lidhje me procesverbalin nga mbledhja e kaluar? A ka dikush vërejtje apo sugjerime? Pasi që nuk ka diçka tjetër e hedh në votim kush është që të miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar?

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Drejtori Genc Ademaj- prezanton Raportin financiar për tre mujorin e parë (Janar -Mars) të vitit 2025.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Floriana Maxharraj.

Floriana Maxharraj- Raporti për tremujorin e parë (TM1) të vitit 2025 tregon një mospërputhje të dukshme mes planifikimeve dhe të ardhurave të mbledhura. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, të hyrat kanë rënë në 77,224€, ose 24.64%, ndërsa planifikimi për 2025 është përmbushur vetëm në masën 16.4%. Në vitin 2024, Komuna e Istogut planifikoi të mbledhë 22,305€ nga bujqësia, por mblodhi vetëm 8,174.5€, ose 36.64% e objektivit. Pavarësisht kësaj performance të dobët, planifikimi për 2025 u rrit me 39.71%, duke arritur në 37,000€. Megjithatë, në TM1 2025, të hyrat nga bujqësia ishin vetëm 2€, që përfaqëson 0.0054% të planifikimit. Planifikimi dhe të hyrat në bujqësi janë si vijon: Licencat për afarizëm: Planifikimi 5,000€, të ardhura 0.00€. Ndërrimi dhe destinimi i tokës bujqësore: Planifikimi 20,000€, të ardhura 0.00€. Qiraja për toka bujqësore komunale: Planifikimi 12,000€, të ardhura 0.00€. I vetmi burim i të hyrave në TM1 2025 ishin taksat administrative, ishte shuma prej 2.00€. Për vitin 2025, komuna planifikoi të mbledhë 333,000€ nga planifikimi hapësinor dhe rregullativ, por mblodhi vetëm 34,002.5€, ose 10.21% e objektivit. Krahasuar me TM1 2024, ky sektor shënon një rënie të ndjeshme, sidomos në dy kategori kryesore, taksa komunale për leje ndërtimi dhe taksa për legalizimin e objekteve, pyetja ime është, cilat janë shkaqet e të ardhurave kaq të ulëta nga taksa për leje ndërtimi? A ka pasur vonesa administrative, rënie të kërkesës për ndërtime në Istog, apo çfarë, si dhe pse u rrit planifikimi me 50% për taksat e legalizimit të objekteve, kur në 2024 u përmbush vetëm 79.3% e objektivit? Te buxheti qiratë e objekteve publike në vitin 2024, komuna planifikoi të mbledhë 4,000€ nga qiratë

e objekteve publike, por nuk mblodhi asnjë të ardhur.Pavarësisht kësaj, planifikimi për 2025 u rrit me 25% (në 4,500€). Fatkeqësisht, në TM1 2025, të ardhurat mbeten zero, ashtu si në çdo tremujor të 2024.Tatimi në tokë dhe mbledhja e borxheve, planifikimi i të hyrave për këtë vit është thuajse i njëjtë me atë të vitit të kaluar, siç është edhe realizimi i të hyrave. Në vitin 2024 ishin planifikuar të hyra në vlerë 116,411€ ndërsa realizimi ishte 0.00 €, ndërsa planifikimi është bërë njejtë edhe për këtë vit. Kam një pyetje: Çfarë hapash politik ka ndërmarrë qeverisja lokale që të ndryshohet gjendja në tërren dhe ky planifikim të jetë i arsyeshëm e rrjedhimisht të kemi mbledhje të borxheve. Raporti i të hyrave vetanake për këtë TM1 i komunës së Istogut zbulon një mospërputhje të madhe mes planifikimit dh të ardhurave të mbledhura në një rënie prej 24.64% krahasuar me TM1 2024 dhe në përmbushje vetëm 16.4% prej tyre.

Drejtori Genc Ademaj- e kam një përgjigje të shkurtër. Nëse i keni shikuar mirë, që po del që nuk e keni shikuar mirë Raportin e tre mujorit të fundit të vitit të kaluar TM4 komuna e Istogut ka tejkalim, nëse kishte qenë ajo performance kaq e dobët siç e prezantove ti, po të them që kemi tejkalim të planit të të hyrave vetanake për vitin 2024. Si mundemi ne me e pasur një planifikim të dobët ku kemi tejkalim prej 734.000€. Tani kemi me i bartë bashkë me juve nëpër projekte të reja në pikën tjetër të rendit të ditës. Zërat që ti ju referove, edhe në bujqësi e din që këtu e kemi shfuqizuar në Rregullore për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba vitin e kaluar taksën prej 5.00€ që është i vetmi burim te drejtoria e Bujqësisë. Te pjesa e Urbanizmit te Rregullorja për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba e kemi vendosur çështjen e ndryshimit të destinimit të tokave për shkak që me pasur një kordinim më të mire mes planifikimit urban dhe mjedisit me lejet ndërtimore dhe kërkesat e qytetarëve. Vazhdon sqarimin dhe përgjigjen.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Floriana Maxharraj.

Floriana Maxharraj- unë u mundova me i dhënë sugjerimet dhe kritikat e mia. Për kategoritë e njejta edhe në vitin 2024 i kam jap sugjerimet dhe kritikat e njejta dhe përgjigjia jote ka qenë se ne e ndjekim trendin e njejtë ndër vite dhe duke u nisur nga ajo nuk e di a është dashur me pas ngritje a jo. Të paktën planifikimi është dashur të jetë më real. Faleminderit!

Drejtori Genc Ademaj- përgjigjet dhe jep sqarime shtesë.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor, po më doket që ekzaminimi ishte komplet. Fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- desha vetëm një sqarim për shprërndarjen e faturave të tatimit në pronë sepse ka pasur ankesa prej qytetarëve se janë shpërndarë me vonesë, dihet që data 30 prill është afati i fundit, desha ta di a ngarkohen me kamatë pasi

që dihet që vonesat janë bërë prej ekzekutivit deri sa e keni caktuar bazën tatimore. Pra janë ankuar që faturat kanë ardhur me 28-29 prill.

Drejtori Genc Ademaj- faturat me 28-29 prill nuk kanë ardhur, dhe ekzekutivi nuk e ka pasur dhe nuk e ka asnjë përgjegjësi te pjesa e shpërndarjes, është marrëveshje që e bëjmë me pjesën e postës, se obligohemi t'i mbulojmë shpenzimet e shpërndarjes por ne as nuk i shtypim e as nuk kalkulojmë faturat. Faturat kalkulohen nga programi në formë automatike që është në kuadër të ministrisë së Financave. Ne e bëjmë vetëm pagesën e shërbimit postar. Masa ndëshkuese nuk është ngarkesë e madhe.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- unë e pata një kërkesë për drejtorin, kur përgjigjet ju lutem mo ofendoni. Ja fillove me ju përgjigjur Florianës me ti nuk e ki kuptuar, Floriana nuk është rastësisht asambleiste dhe nuk është rastësisht prej grave më të votuara në Kuvend dhe pikërisht fakultetin e ka kryer për këtë analizë që e bëri. Dhe ju ka referuar numrave drejtor. Nuk është e ndershme me ju referuar me nuk din ti. Faleminderit!

Drejtori Genc Ademaj- unë nuk e di që i thashë nuk e di, por i thashë që ka mundesi që nuk e ki kuptuar e që nuk është ofenduese por nëse nuk e ka kuptuar unë jam këtu për sqarime. Ne shkollën mundemi me e përfunduar të gjithë por kur ballafaqohesh me planifikim, me analizë e ki nganjëherë informata më shumë se një zyrtar që ballafaqohet me ato. Floriana tha që komuna e Istogut ka pas një realizim të dobët të të hyrave vetanake të planifikuara dhe nuk mundem ta mbroj atë kur ke tejkalim 1 milionë euro. Këtë nuk mundem ta pranoj. Edhe ju nganjëherë nuk duhet të jeni të ngutshëm. Ka mospërputhje të inkasimit këtë e pranoj dhe ajo nuk ndodhë për shkak të gabimeve tona. Nëse dikush ndonjëherë e ndjen vetën të ofenduar nga ana ime, unë ju kërkoj falje edhe publikisht.

Kryesuesi i Kuvendit- nuk më tingëlloj si ofendim. Sepse nese kishte ndodhur kisha reaguar unë. A ka edhe dikush diçka pasi që jo dhe ky ishte njoftim, atëherë vazhdojmë me pikën tjetër.

Shqyrtimi i pikën 4.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Drejtori Genc Ademaj- prezanton pikën e rendit të ditës. Bartja e mjeteve të pa shpenzuara buxhetore të hyrave të bartura nga viti fiskal 2024 dhe të hyrat e tejkaluara në vitin 2025.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- isha ndalur te pika te bartja e buxhetit, e para është stacioni i autobusëve që po barten 15.000 euro edhe pse kemi pasur diskutime edhe më herët për këtë, kisha kërkuar nga drejtori me na sqaruar pak se pse shkojnë këto mjete për stacionin e autobusëve. E dimë që para vitit të kaluar i kemi dërguar 50.000 euro dhe MAPL-ja na ka kthyer që ato nuk kanë qenë në rregull, dhe kanë qenë për paga e që gjoja ne e kemi rifunksionalizuar atë, e tani prapë vjen për rifunksionalizim, e dimë raportin e Auditorit, është thënë se ato mjete nuk kanë shkuar për subvencionin e caktuar, d.m.th janë keq menaxhuar. Është një kompani që po e shoh që nuk po ec. Edhe kur i kemi dërguar ato mjete më herët, e kam thënë se ai nuk ka as plan biznesi se çfarë kanë me bërë. Kështu që nuk jam i pajtimit që me u derdhur mjete kështu pa asnjë plan. Dhe pika dytë ishte renovimi i palestrës , në kuadër të kësaj thirrje atëherë ka qenë që ministria ka me e financuar një pjesë të vet prej 300.000 euro ndërsa komuna 200.000 euro vetëm për kulmin. Tani janë dy pika që nuk na tregove, njëra 140.000 euro dhe tjetra është projekt i ri. Pak nëse mundesh me na shpjeguar. Faleminderit!

Drejtori Abedin Kabashi- Unë jam në kontakt me komunat tjera si ne, po e llogariti edhe komunën e Klinës, Deçanit, Skenderajit të gjitha stacionet e autobusëve subvencionohen prej komunës. Shpresoj që sa më shpejt e funksionalizojmë, se pa e subvencionuar do të jetë problem për të mbijetuar.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Floriana Maxharraj.

Floriana Maxharraj- edhe unë desha të ndalem te pika e njejtë. E dimë që gjatë këtij mandati janë ndarë 50.000 euro për stacionin e Autobusëve, ku 30.000 euro kanë qenë paga për punëtorët dhe pagesa të tatimeve. Shumicën e përgjigjeve unë i mora. Se edhe unë e pata pyetjen si duam ta rifunksionalizojmë stacionin me 15.000 euro ku e dimë që me 50.000 euro nuk kemi mundur.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës- një gjë duhet me e pas parasysh është kosto ma e vogël me e mbajtur një ndërmarrje nën mbijetesë se sa me e lënë me falimentuar me u shuar dhe në momentin që na paraqitet neve si nevojë me e krijuar të re. Kjo është ajo çka po ndodhë deri në funksionalizimin e stacionit. Tregu i ri është ndërtuar afër stacionit, jemi duke tentuar me e gjetur bazën ligjore te inkasimi që bëhet prej shfrytëzimit të tregut prej tregtarëve me hy dhe me u inkasuar në arkën e stacionit të Autobusëve në mënyrë që me garantuar stabilitet financiar përtej kësaj momentin që fillojnë gravitimet e autobusëve brenda stacionit bashkë me taksën që e paguajnë në baza ditore ose me linja si e kanë, mendoj që krijohet një stabilitet. Përndryshe 350.00 euro është rrogë minimale sot, njerëzit që udhëheqin borde janë njerëz që duhet me pas një ekspertizë dhe një përvojë të madhe dhe kur hap konkurs për njerëz me kritere të tilla me një page 350.00 euro mundësa me i rekrutuar është minimale. Edhe përveç diskutimeve interne kërkoj edhe para Kuvendit nga drejtori i drejtorisë së Shërbimeve Publike që me hapa sa

më shpejt të ec drejtë funksionalizimit edhe marrëveshjeve që duhet me i bërë me inspektoriatin qendror bashkë me atë komunal dhe policinë e Kosovës që me i obliguar operatorët ekonomikë me u bë pjesë dhe me na u heq barra financiare neve dhe qytetarët me pasur shërbimin më të mirë.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- desha të ndërlidhem me kryetarin. Kryetar në qoftë se nuk janë aktiv inspektorët edhe policia ka me vazhduar ashtu siç ka qenë tani. Ata duhet me i detyruar kur te paguajnë taksën në Pejë e në Prishtinë me paguar edhe në Istog. Desha të ndërlidhem pak me kanalet e ujitjes, drejtori e përmendi që ka me u ba mirëmbajtja e kanaleve por nuk e kuptova tamam, a vetëm kanalet me ujë të Drinit apo kanë me u mirëmbajtur edhe kanalet e tjera të ujitjes. Edhe i përmendi që kanë me u ndërtuar edhe kanale të tjera të ujitjes edhe këtu kemi një shqetësim se si vend rural po shkatërrohen të mbjellat për shkak të mungesës së ujitjes e disa që janë ndërtuar është ujitja më e dobët se sa kur ka qenë pa kanale për shkak të punëve të këqija që janë bërë. Kisha pasur qejf një sqarim për këto.

Drejtori Genc Ademaj- ne ndajmë buxhet bashkë me Kuvendin për me i betonuar kanalet e ujitjes për me ja lehtësuar procesin e ujitjes bujqëve të komunës së Istogut edhe pse pastaj ato janë asete të ndërmarrjes publike "Drini i Bardhë" se në mungesë të mjeteve të tyre nuk munden me e realizuar ose ma trego një kanal që ata deri sot e kanë ndërtuar. Aty ka keq menaxhim por realisht të hyrat e tyre të vogla ja u kanë pamundësuar atyre. Mirëmbajtja realisht ka filluar, ata e kanë një projekt që kanalet e mbyllura kanë me i trajtuar dhe me i hap ato të betonuara realisht. A ka pasur keq realizim nga ana e operatorëve, po e them edhe unë që ka pasur. Vazhdon sqarimin.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- një lloj praktike e zakonshme që ne vend që të trajtohet si problem e të shfrytëzohen me kohë këto vetëm barten. Kjo formë e menaxhimit me buxhetin më shumë tregon që buxhetimi nuk po bëhet mirë. Pra ka mungesa të subvencioneve në sport, në bujqësi, mungesë investimesh kapitale e gjitha kjo duke humbur kohë që pastaj këto të barten deri në vitin e fundit zgjedhor që muajt e fundit me u dukur që po punohet. Me e pas të vetmin kriter me e dhënë ndonjë subvencion, me kritere të shfrytëzimit të mëvonshëm politik. Ne kemi kështu si vërejtje që këto të shfrytëzohen me kohë dhe mos të barten vitin e fundit zgjedhor.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Genc Ademaj.

Drejtori Genc Ademaj- të hyrat që po i kërkojmë për bartje d.m.th tejkalim i kemi 734.000 euro që janë jashtë planifikimit që nuk kemi mundur ta zëmë afatin për bartje brenda vitit fiskal 2024 për shkak të afateve ligjore që nuk na lejohen.

Për bartje i kemi kërkuar 215.000 euro që nuk janë shpenzuar vitin e kaluar. Vazhdon **përgjigjen dhe sqarimet.**

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- sot jemi duke e bërë bartjen e mjeteve mirëpo a rrezikohet ndonjë projekt që janë marrë mjetet nga përmbaruesve. Konkretisht desha të pyes për një projekt në Banjë parkun e Banjës është anuluar edhe vitin e kaluar e mos ka ndodhë edhe këtë vit e po mbetem pa projekt.

Drejtori Genc Ademaj- ne e kemi nisur procedurën mjetet janë në dispozicion, projekti është dëmtuar vitin e kaluar, këtë vit janë dëmtuar disa por edhe për ato e kemi filluar procedurat sepse e kemi një mundësi te Qarkorja e parë buxhetore.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Andi Xhuraj.

Andi Xhuraj- drejtor te tabela sportive nuk na sqarove se sa tabela sportive kanë me u blerë dhe ku kanë me u vendosur. Ashtu siç e di unë I kemi dy tabela sportive. Edhe një pyetje e kam pse nuk po vazhdohet me implementimin e projektit në Rakosh që quhet parku dhe këndi i lojërave se unë e di që aty keni intervenuar bashkë me KFOR-in për pastrimin e atij terreni por nuk besoj që është ndonjë kosto e madhe me u realizuar ky projekt.

Drejtori Genc Ademaj- te pjesa e tabelave, Andi, në Vrellë ku do të funksionalizohet salla e sportit, realisht mungojnë rekuizitat. Më herët pata një debat me Arianin se Ministria e Kulturës ka të planifikuara 1 milion euro për rekuizita sportive. Këtë çështje e kemi diskutuar edhe me drejtoreshën dhe kemi disa pajisje përcjellëse për palestrën në Istog, të cilat i kemi shqyrtuar bashkë me Farukun. Mungojnë disa pajisje për tabelat që i kemi funksionalizuar para dy vitesh. Nuk jam profesionist, por kjo është çfarë më është thënë.Sa i përket Rakoshit, projekti ka qenë i planifikuar, por oferta ka ardhur më e lartë se tenderi. Megjithatë, ai projekt do të fillojë këtë vit.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- desha të flas për bartjen e mjeteve për dy çështje. E para ka të bëjë me rrugët në Mojstir, veçanërisht një rrugë drejt varrezave që shpesh ka qenë në projekt, por nuk është realizuar kurrë asfaltimi i saj. Do të doja të di statusin e saj. Çështja tjetër është funksionalizimi i Stacionit të Autobusëve. Është e vërtetë që nuk ka pasur përparim dhe kjo është përmendur edhe nga kolegët. Shpresojmë që bordi i ri që do të zgjidhet së shpejti, bashkë me inspektorin që kemi pritur gjatë të bashkëpunojë me policinë dhe të sjellë ndryshim. Prapë po e them që shpresoj se do te bëhet diçka në këtë drejtim.

Drejtori Genc Ademaj- sa i përket rrugës në Mojstir, të gjitha projektet për rrugë janë pezulluar sepse fshati nuk e ka pasur të ndërtuar kanalizimin e ujërave të zeza. Këtë vit planifikohet faza e tretë e kanalizimit, dhe më pas do të fillojmë me asfaltimin e të gjitha rrugëve në Mojstir.Për Stacionin e Autobusëve, mendoj se do të funksionalizohet. Nëse dështon edhe këtë herë, atëherë do të mbyllet përfundimisht.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Lavdije Bujupaj.

Lavdije Bujupaj pashë që në projekt nuk ishte përfshirë rruga "Liridona" në fshatin Dubravë, e cila ende nuk është asfaltuar. Sa janë gjasat që të realizohet asfaltimi i saj?

Drejtori Genc Ademaj- **-**dje isha te rruga në fshatin Dubravë. E kemi matur – është 1340 metra e gjatë dhe ka nevojë për ndërtimin e një ure për shkak të vërshimeve, sipas kërkesës së banorëve. Ka pasur një pengesë pronësore, por tani është zgjidhur. Projekti është buxhetuar vitin e kaluar dhe punimet pritet të nisin brenda dy muajve.

Kryesuesi i Kuvendit- pasi nuk ka diskutime të tjera, kalojmë në votim.

Konstatojmë që nga 21 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 21 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit kjo Rregullore është sjellë nga ministria dhe duhet ta miratojmë siç është. Rregullorja e mëparshme është shfuqizuar. Hapet debati.

Ajshe Metaj -një Rregullore nuk mund të shfuqizohet pa një të re. A e dimë arsyen e shfuqizimit dhe çfarë përmban e reja?

Kryesuesi i Kuvendit- ligjet ndryshojnë dhe rregulloret plotësohen dhe ndryshohen në përputhje.Po votojm. pra, kush është të miratohet kjo Rregullore?

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 6

Kryesuesi i Kuvenditn -Rregullorja për Subvencione ka ndryshuar për shkak të ndryshimeve ligjore dhe duhet të kalojë në diskutim publik.

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit- te kjo Rregullore për tregun ditor jemi ndër të paret në Kosovë që e shqyrtojmë. I uroj punë të mbarë komisionit që e ka hartuar, që të mos kemi probleme në funksionim.

Liridona Lajçi Avdijaj- dua të ndërlidhem me një pikë të Rregullores – në rast se një tregtar përdor dhunë verbale apo fizike ndaj drejtorit të tregut, ti ndalohet përkohësisht apo krejtesisht shitja. Propozoj që ndalimi të jetë i përhershëm, sepse masa e përkohshme nuk mjafton për të parandaluar incidente.

Drejtori Genc Ademaj- kjo është Rregullorja e parë e këtij lloji, prandaj nuk ka ende një bazë të qartë funksionale. Ftoj qytetarët me përvojë në tregje të marrin pjesë në diskutimin publik. Edhe propozimi i Liridonës për ndëshkim më të ashpër ndaj sjelljeve jo etike është i qëlluar. Rregullorja mund të ndryshohet e plotësohet më vonë sipas nevojës.

Andi Xhuraj -sa i përket asaj qe u diskutua, te Rregullorja është mirë e shkruar dhe përmban dënime të qarta, nuk ka nevojë për ndryshime.

Agron Gashi -ka shumë paqartësi – nuk dihet çfarë produktesh lejohen, kush e menaxhon tregun, si vendosen çmimet, kush siguron pastërtinë. Kam rreth 70 pika që duhen shtuar.

Ajshe Metaj -Rregullorja është pozitive, në Prishtinë funksionon tregu për çdo ditë. Por shqetësimi është kontrolli sanitar – si do të sigurohet një inspektor sanitar për të garantuar sigurinë ushqimore?

Drejtori Genc Ademaj- tregu qe ka me u funksionalizuar, per ju eshte e panjohur se çfarë do te shitet aty, në Rregullore do të përfshihet, është treg i produkteve të gjelbërta i bylmetit, ndërsa pjesa tjeter e tregut të plaçkave, ne jemi të interesuar të funksionalizojmë ish tregun e kafshëve. Fatmirësisht e kemi inspektorin e tregut,është z. Hysen Mehmetaj dhe është personi përgjegjës dhe kompetent për menaxhimin e tregut, ndërsa sa i përket pjesës sanitare është rajonale, por sa i p.rket produkteve që shiten është përgjegjës inspektori komunal e atë e kemi.

Andi Xhuraj -Rregullorja do të kthehet për miratim pas diskutimit publik, kështu që mund të shtojmë propozime më vonë. Të kalojmë në votim.

Kryesuesi i Kuvendit -Kush është për kalimin e Rregullores në diskutim publik?

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 8.

Kryesuesi i Kuvendit- hapet debati. Pasi Rregullorja do të shkojë në diskutim publik, kalojmë në votim.

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 9.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Drejtori Genc Ademaj- prezanton pikën e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin, pasi nuk ka diskutime e hedh ne votim kush eshte te miratohet kjo pike e rendit te dites?

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 10.

Kryesuesi i Kuvendit- nei eksploruam këto pika pa hyrë në rend dite kur u propozuan të hynë, kështu që vetëm po i votojm.? Kush është të miratohet kjo pikë e rendit të ditës?

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro, 0 kundër dhe 2 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 11.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin rreth kësaj pike? Nuk ka diskutime e hedh ne votim?

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota pro, 1 kundër dhe 2 abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 12.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin rreth kësaj pike? Nuk ka diskutime e hedh në votim?

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 13.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin rreth kësaj pike? Nuk ka diskutime e hedh në votim?

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro, 0 kundër dhe 2 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 14.

Kryesuesi i Kuvendit- kush është te shfuqizohet kjo Rregullore?

Konstatojmë që nga 17 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim shfuqizohet Rregullorja per Kategorizimin e Klubeve Sportive.

Shqyrtimi i pikës 15.

Kryesuesi i Kuvendit- Duhet të informoj se vitin e kaluar sindikata ka kërkuar një informacion në lidhje me shujtat për zyrtarët publikë. Kërkesa është dërguar te kryetari, dhe ekzekutivi ka rënë dakord me çmimin prej 3.50 euro për shujta. Tani hapim debatin, dhe fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- edhe atëherë kur janë ndarë shujtat për punëtorët e komunës dhe stafin civil kam qenë për atë për shkak se e kanë një orar të gjatë të punës. Mirëpo e kam edhe një pyetje tjetër këtu, ne disa obligime në shkollë po i realizojmë përmes kontratës kolektive, komuna ka thënë gjithmonë që nuk ka pasur obligime ndaj këtyre gjërave, unë jam për atë që komuna si komunë edhe pse nuk është ndjerë fajtore se nuk ka pasur obligim se është dëmtuar, por desha të them që nuk po flas për shujta por për disa shpenzime të udhëtimit dhe për disa gjëra të tjera a mundet me marrë obligim komuna siç merr vendime, me ja u paguar shujtat bile neve se paku udhëtimin, se te ne nuk po merren parasysh, njësoj po trajtohet si ai që e ka shtepinë në derë të shkollës si ai qe udhëton me kilometra. Është e padrejtë, desha ta di kontekstin edhe pse pak a shumë e di përgjigjen desha një ri konfirmim.

Drejtori Genc Ademaj- E ligjshme nuk është. Kuvendi mund të marrë një vendim, por ligjshmëria do të konfirmohet nga MAPL-ja. Çështja e shujtave mund të procesohen për punëtorët teknikë dhe administrativë të komunës. Në arsim, kjo nuk është e mundur. Shujtat janë për punë, jo për shërbime që krijohen për të shkuar në punë.

Andi Xhuraj- Ne mbështesim këtë propozim dhe jemi të gatshëm të përkrahim edhe rritje në të ardhmen.

Haki Podrimaj- Mbështes marrëveshjen me sindikatën dhe propozoj që në të ardhmen të përfshihen edhe sektori i arsimit dhe shëndetësisë.

Lavdije Bujupaj - e përkrahu ndarjen e shujtave, por theksoj që për shkak të inflacionit, shuma prej 3.50 euro është e pamjaftueshme dhe kërkoi rritje të saj.

Agron Gashi - Mbështes këtë vendim dhe propozim.

Drejtori Genc Ademaj - a bën një propozim kryesues? Po me vjen mirë për vullnetin politik qe e ka Kuvendi i Komunës, ne e kemi bërë një analizë edhe me vullnetin e kryetarit por edhe të juajin po e shoh , kërkesa e sindikatës ka qenë 3.50 euro, po tentojmë me i siguruar mjetet për 4.50 euro e që shuma totale është 570.654 euro për të gjithë punëtorët e administratës nëse ju jeni për. D.m.th kjo është maksimumi pa tatime përcjellëse. Nëse ne e marrim këtë vendim e po dakordohem që pjesa e Kuvendit me e përkrah me shumën 4.50 euro atëherë konfirmimi i ligjshmërisë na vjen neve pozitiv, atëherë unë në mbledhjen tjeter e marrë përsiper me e hedh në votim ndryshimin e kategorisë që mos me pas keq klasifikim nga ana e përmbaruesve, dakordohem që cilat projekte ose te cilat kategori ekonomike bashkërisht i prekim dhe i transferojmë në kategorinë paga dhe mëditje që me ligj është e përkcaktuar lëvizja, pastaj ajo shkon te ministria e Financave, bazuar në vendimin e Kuvendit, ministria e gëzon të drejtën shtesë a na aprovon arsyetimin çfare e kemi, kjo është procedura që mos me na u hakmarrë në performancën, sepse pastaj duke tentuar të bëjmë mirë mundemi me e humb grantin e përformancës për shkak të keq klasifikimit. Duhet ta kemi parasysh që ky akt nuk duhet të shkoj në asnjë mënyrë përmes gjykatës ose me shkuar përmes procedurës përmbarimore. Kështu që unë kryesues kërkoj, te pjesa e vendimit të Kuvendit, para hartimit të vendimit të Kuvendit sindikata me e lëshuar një njoftim që akti i Kuvendit mos të përcillet te organet e tjera përpos organit të Kuvendit dhe të ministrisë së Financave. Mendoj që është fer mos me na dëmtuar pastaj me procedura tjera sepse nuk e besoj që një shërbyes civil e ka vullnetin me i marrë 2.000-3.000 euro e me ja humb komunës 1.000.000 euro. Ne duam të tentojmë në formën ligjore.

Kryesuesi i Kuvendit- drejtor dhe ju anëtarë të Kuvendit, prej pervoje herën e kaluar, është metoda edhe prej komunave tjera që e kanë aplikuar jo vetëm te shujtat, por edhe te këto të arsimit me kontratë kolektive. Me marrëveshje gjyqësore që mos me u fut në obligime me përmbarues. Sindikata duhet me e marrë këtë zotim, që këtë vit nuk ka shanca se janë edhe ato të arsimit, kështu që këto me i lënë për vitin e ardhshëm. Unë drejtor propozoj kështu.

Drejtori Genc Ademaj- po e lëmë të përgjithshme, brenda mundësive buxhetore që komuna e Istogut i gëzon për vitet fiskale në vijim.

Kryesuesi i Kuvendit- Ministria e Financave e kthen përmes MAPL-së. Nuk e kthen negativ, por e kthen sa te holla i ke për subvencionim siç e ka kthyer herën e kaluar.

Drejtori Genc Ademaj- një informacion që me erdh, ligji e parasheh që përfaqësuesi i sindikatës dhe komuna me u dakorduar për procedurat e realizimit, d.m.th kjo qenka e mirë, që pjesë e vendimit me qenë edhe neni i ndërmjetësimit mes sindikatës dhe komunës qe mos me na prodhuar pastaj obligime tjera financiare jashtë vullnetit që e ka Kuvendi.

Kryesuesi i Kuvendit- drejtor mua më duhet të drejtohem para Kuvendi se duhet të votohet me çmim.

Drejtori Genc Ademaj- unë jam për çmimin 4.50 (katër euro e pesëdhjetë cent) pra për 130.000 euro më shumë se sa ka qenë kërkesa e sindikatës me 3.50 (tri euro e pesëdhjetë cent) dhe besoj që nuk është ndonjë dëm i madh për komunën. Dhe është një pagesë me e arsyeshme për punëtorët.

Kryesuesi i Kuvendit- unë të falendëroj në emër të të gjithë punëtorëve të komunës, të zjarrëfiksëve, shtëpisë së Kulturës.

Drejtori Genc Ademaj- kryesues ata le ta falenderojnë kryetarin.

Kryesuesi i Kuvendit- po e falenderojmë kryetarin për bashkëpunimin qe e ka pasur me sindikatën e këtu po të falenderoj ty për këtë një euro. Fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- desha ta jap një propozim mos po e ndihmon procesin, që pjesa e pagesës mund të ndahet me këste. Në shume komuna tjera parashihet që të jetë. Nëse kemi një pjesë të mjeteve në fund të vitit, me i dhënë ato, vitin tjetër pjesën tjetër d.m.th mos ta mbyllim me njëherë.

Kryesuesi i Kuvendit- ashtu e kuptova edhe drejtorin kur të ka mjete me i dhënë. Na duhet me e bërë me specifikim.

Drejtori Genc Ademaj- nje sqarim, realisht me ligjin e ri te pagave, nëse e dini kur e kemi bërë planifikimin e buxhetit, edhe anëtarët e Kuvendit janë pjesë e listës së rregullt të pagave ju takon ajo shtesë. Për një vit ju takon. Nëse ata i marrin 3.000 euro juve ju takojnë 1.000 euro.

Kryesuesi i Kuvendit- ju lutem vëmendje, se duhet me e specifikuar votimin se për çfarë po votojmë. Propozohet, që shujta të jetë 4.50 euro (katër euro e pesëdhjetë cent) dhe pagesa të bëhet me marrëveshje ndërmjet zyrtarit ligjor të sindikatës dhe përfaqësuesit të komunës kryetarit. Pagesa të jetë me negocim.

Drejtori Genc Ademaj- une mendoj që titulli i vendimit të jetë, ndarja e shumës buxhetore prej 4.50 euro (katër euro e pesëdhjetë cent) për të gjithë punëtorët e administratës.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalen e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- e pata kerkesën me ja bërë kryetarit të sindikatës që në të njejtën mënyrë edhe neve pagesen, ne nuk po kërkojmë 4.50 euro po mjafton 3.50 euro.

Drejtori Genc Ademaj- a ka mundesi ne me përfunduar kontraten kolektive.

Kryesuesi i Kuvendit- po votojme pra. Sindikata është pajtuar me 3.50 euro, (tri euro e pesëdhjetë cent) për këtë po e falenderojmë kryetarin që është 4.50 euro (katër euro e pesëdhjetë cent) dhe po votojmë me 4.50 euro (katër euro e pesëdhjetë cent) dhe me modalitetet që do ti bëjnë zyrtarët ligjore të të dy palëve. Kush është për?

Konstatojmë që nga 18 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 16.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- është kërkuar që rruga "Shaban Hajzeraj" të rregullohet për vite, vetëm dua të di nëse është në procedurë. Po ashtu, kam një pyetje për drejtorin e Shëndetësisë për ambulantën në Uçë – çka po ndodhë me të? A do të funksionalizohet apo ka ndonjë plan tjetër? Gjithashtu, banorët kërkojnë një teknik medicinal, dhe kam propozuar që një teknik e licencuar, bashkëshortja ime, mund të shërbejë pa pagesë dy herë në javë. Për kryetarin, kisha një vërejtje për mos praninë e tij në disa aktivitete për dëshmorët, por nuk është këtu, kështu që mund ta diskutojmë një ditë tjetër.

Drejtori Genc Ademaj- për rrugën "Shaban Hajzeraj", këtë vit është ndarë buxheti dhe do të realizohet. Për ambulantën, kemi diskutuar me kryetarin dhe do të dërgojmë një teknik medicinal për shërbime bazike, dhe ajo do të funksionalizohet brenda dy muajve. Sa i përket mos-pranisë së kryetarit, është e vërtetë që ai nuk ka marrë ftesa për disa aktivitete, që janë organizuar ad-hoc për dëshmorët, dhe nuk është informuar për to. Kjo është e pandershme, pasi mund të bëjmë një agjendë të përbashkët për ditën e dëshmorëve. Kemi një memorial për dëshmorët ku janë investuar mbi 1 milion euro, dhe ky është vendi më dinjitoz për t'i nderuar. Organizimet ad-hoc kanë krijuar ndasi, dhe është e papranueshme të bëhen pa njoftuar kryetarin, duke tentuar të krijohet ndarje politike, veçanërisht tani në vit zgjedhor.

Negjdet Ramaj- në lidhje me përvjetorin e Dëshmorëve të Vrellës, është e vërtetë se ka pasur organizim publik ku ka pas fjalë rasti edhe kryetari i komunës së Istogut, së bashku me z. Xhavit Jashari. Megjithatë unë edhe për ngjarjet e tjera, si ato në bjeshkët e Uçës, e ftoj kryetarin dhe kryetari nuk merr pjesë, edhe pse është ftuar personalisht. Ish-kryetari Rugova, përkundrazi, ka marrë pjesë në këto përvjetore sa herë është ftuar.

Drejtori Genc Ademaj- nuk mundem të flas deri në këtë nivel në emër të kryetarit por prej bisedave që i kemi pasur po ta them me përgjegjësi që ka vullnet më shumë se gjithësecili këtu me marrë pjesë. Vazhdon sqarimin.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalen e ka Floriana Maxharraj.

Floriana Maxharraj- Pata me e marrë një Informacion nga ekzekutivi deri me 28 prill 2025 ka qenë afati i fundit për aplikim për të përfituar nga nisma Wi-Fi për Ballkanin Perëndimor e cila ofronte hotspote Wi-Fi falas deri në 500 komuna në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Pikat e Wi-Fi-se do të instalohen në hapësirat publike si sheshe, parqe, bibloteka, muze dhe shkolla. Desha ta di a keni aplikuar në këtë nismë?

Drejtori Genc Ademaj- jemi komuna e parë që kemi aplikuar në vitin e parë kur është hapur thirrja publike, fatmirësisht ka qene aty edhe një familjar i Liridonës që na ka asistuar në aplikim. Ne si komunë e kemi parë të arsyeshme pjesën e parkut, kanë me u vendosur 6 hotspote, pjesa e komunës dhe e parkut kanë me përfituar prej atij furnizimi, është një projekt i mirë deri tani nëse nuk gaboj vetëm 7 komuna kane aplikuar, e ne jemi e para në ditën e parë që kemi aplikuar. Uroj të jemi fitues.

Kryesuesi i Kuvendit- Andi Xhuraj e ka fjalën.

Andi Xhuraj- mendova se po zgjatet shumë ajo tema te respektimi i familjarëve të dëshmorëve e këto. Negjdeti e tha shume mirë. E te pjesa a ka qenë kryeministri i pari, e kush po vjen më shumë e kush më pak nuk po e shoh të arsyeshme në atë temë të ndjeshme me u përdor ky lloj komunikimi.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalen e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- edhe unë nuk desha me i debatuar vizitat te përmendoret, është një ditë e dëshmorëve, por familjarët kërkojnë me e pasur njëorganizim të veçantë. E kisha pasur dëshirë të them që ata që janë martir e dëshmorë nuk kanë rënë për të pasur grupacione politike faktikisht kisha dashur që të gjithë të trajtohen njësoj. Rastësisht në Kamenicë te familja Lipaj pashë një organizim shumë të mirë. Nuk është pak me pas një vizitë se edhe ata kanë rënë që ne të jemi të lirë. E nuk duhet me e kursyer as kohën as asgjë. Pajtohem plotësisht me Andin në atë

se çfarë e tha. Nuk ka me fituar poena politik mbi diçka që nuk duhet me qenë. Prandaj sugjeroj ose të bëhet një ditë për të gjithë ose të shkohet në të gjitha vendet ku organizohen këto e mos të bëhet padrejtësi.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Ajshe. A ka edhe dikush pyetje. Jo atëherë,

Kryesuesi i Kuvendit- e shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.
Falënderon të gjithë për durimin qe patën, dhe kontributin e dhënë,
E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.
Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 13:10

Procesmbajtëse,
Flora Bujupaj

Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva • Arhiva • Archive
Njësia Org. 04/4/40 Nr. Prot. 1508/2025
Org. Jedin. Br. Prot.
Org. Unit Prot. No.
Nr. i faqeve 4 Data 15.05.2025
Broj stranica Datum
No. pages Date
Dalësë PRISHTINË/A

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria–Vlada-Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve / Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfere / Ministry of Finance, Labour and Transfers

Zyra e Ministrit / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister

DATË/A:	15.05.2025
PËR/ZA/TO:	Ministrat, Kryetarët e Komunave, Kryeshefat e Agjensioneve, Udhëheqësit e Organizatave buxhetore, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zyrtarët Kryesor Financiar,
NGA/OD/FROM:	Hekuran Murati, Ministër në Ministrinë e Financave, Punë dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja Buxhetore 2026/01

Të nderuar,

Me lejoni t'ju shpreh falënderimin tim për kontributin tuaj të çmuar në hartimin e projeksioneve buxhetore për periudhën 2026–2028, të cilat përbëjnë bazën për përgatitjen e buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2026.

Në vijim, ju përcjellim Qarkoren Buxhetore 2026/01, e cila përmban kufijtë fillestarë buxhetorë për secilën Organizatë Buxhetore në nivel qendror, si dhe kufijtë buxhetorë për nivelin komunal për periudhën 2026–2028.

Duke marrë parasysh se procesi i regjistrimit të popullsisë ka përfunduar, ju njoftojmë se kufijtë buxhetorë të përcaktuar në këtë qarkore janë bazuar në të dhënat zyrtare të regjistrimit të popullsisë, të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në vitin 2024, dhe të aprovuara me Vendimin e Qeverisë Nr. 08/251, datë 12.03.2025.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve mbetet në dispozicionin tuaj për të ofruar mbështetjen e nevojshme gjatë procesit të hartimit të Projektligjit për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin.

Me respekt!

Hekuran Murati
Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve

Për:

Qarkorja Buxhetore 2026/01

1. Qëllimi

Në përputhje me nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ministri për Financa, Punë dhe Transfere është i autorizuar dhe përgjegjës të lëshojë qarkore buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore, me qëllim të ofrimit të udhëzimeve për përgatitjen e Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Në mbështetje të kësaj dispozite ligjore, Ministri lëshon Qarkoren Buxhetore 2026/01, e cila përmban udhëzimet e para për hartimin e buxhetit për vitin 2026, si dhe vlerësimet për vitet 2027 dhe 2028. Kjo qarkore përfshin gjithashtu kalendarin kohor indikativ për procesin buxhetor dhe kufijtë fillestarë buxhetorë për vitin 2026, përkatësisht vlerësimet për vitet 2027-2028 për secilën organizatë buxhetore.
Në rast nevoje, pas kësaj qarkoreje do të lëshohen edhe qarkore të tjera plotësuese deri në finalizimin e plotë të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2026 dhe vlerësimeve për vitet pasuese.

2. Konteksti për përgatitjen e buxhetit për 2026-2028

Planifikimi i buxhetit për vitin 2026 mbështet në Deklaratën e Prioriteteve të Qeverisë 2026-2028 dhe kornizën makro-fiskale për të njëjtën periudhë. Qeveria është e përkushtuar që duke ruajtur stabilitetin fiskal të përkrah kërkesat e organizatave buxhetore, në përputhje me orientimit sektorial buxhetor dhe prioritetet e përcaktuara në Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë.

Objektivat strategjike të Qeverisë janë përcaktuar përmes Programit të Qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, dhe strategjive sektoriale, si dhe nëpërmjet dokumenteve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian, si Programi për Reforma në Ekonomi 2025-2027 dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Prioritetet e Qeverisë për periudhën trevjeçare të ardhshme përqendrohen në ri-orientimin e ekonomisë drejt prodhimit dhe eksportit, rritjen e punësimit, dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, që mbrojnë mjedisin dhe sigurojnë ruajtjen e tij për brezat e ardhshëm. Po ashtu, një tjetër prioritet është orientimi drejt transformimit digjital.

Projeksionet fiskale kanë përcaktuar burimet e mundshme të financimit që Qeveria mund të disponojë për shpenzime në vitin 2026, si dhe vlerësimet për vitet 2027-2028. Çdo tejkalim i kufijve të shpenzimeve të përcaktuara në këtë qarkore do të bëjë të detyrueshëm ndryshimin e burimeve të financimit, përfshirë mundësinë e rritjes së burimeve të financimit dhe/ose ndryshimin e politikave tatimore për të siguruar të hyra shtesë.

Gjatë procesit të hartimit të buxhetit, duhet të merren parasysh zotimet tona ndaj institucioneve financiare ndërkombëtare. Në këtë kuadër, Qarkorja Buxhetore 2026/01 është hartuar në përputhje me obligimet e deritanishme nga marrëveshjet financiare ekzistuese dhe ato në proces negociate, duke pasqyruar përkushtimet për politikën fiskale në përputhje me kërkesat e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

3. Parashikimet për implementimin e buxhetit 2026

Para paraqitjes së kërkesave buxhetore për vitin 2026, organizatat buxhetore duhet të paraqesin në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve një parashikim të realizimit të buxhetit për vitin 2025, deri në fund të tij, në nivelin e programeve, nën-programeve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve individuale. Gjithashtu, organizatat buxhetore janë të obliguara të identifikojnë dhe të informojnë Ministrinë për nënshpenzimet eventuale në buxhetin aktual, si dhe për pritshmëritë për mbi-shpenzimet para se të paraqesin kërkesat buxhetore për vitin 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028.

4. Kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit për 2026-2028

Procesi buxhetor për vitet 2026-2028 ka për qëllim të lidhi planet dhe politikat buxhetore me prioritetet e Qeverisë. Në nivel sektorial, kjo është realizuar duke prioritizuar sektorët buxhetorë sipas projeksioneve për periudhën 2026-2028. Përmes kësaj qarkoreje, kërkohet që organizatat buxhetore të konkretizojnë kërkesat e paraqitura, duke detajuar përgatitjen e buxhetit në nivelin e programeve, nën-programeve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve specifike.

Kërkesat për shpenzime të reja duhet të paraqiten vetëm nëse ka hapësirë fiskale të lirë dhe nëse ato janë përfshirë në projeksionet për periudhën 2026-2028. Gjatë procesit buxhetor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet të sigurohet që totali i shpenzimeve për të gjitha organizatat brenda një sektori të mos e kalojë shumën e parashikuar në projeksionet për sektorin për vitet 2026-2028.

Organizatat buxhetore duhet të kenë parasysh që gjatë përgatitjes së kërkesave të tyre, t'u japin prioritet:

- Projekteve që kontribuojnë në realizimin e prioriteteve të Qeverisë dhe dokumenteve strategjike.
- Projekteve që janë në vazhdimësi nga vitet e kaluar dhe kanë obligime kontraktuale, përfshirë edhe ato të shpronësimit të lidhura me këto projekte.
- Zotimeve të Qeverisë për Planin e Veprimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe për programin Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA).
- Legjislacionit të ri ose ndryshimit dhe plotësimit të legjislacionit ekzistues.
- Obligimeve për financim të jashtëm për projekte individuale, të cilat duhet të përfshihen brenda ndarjeve buxhetore.
- Aktivitet të cilat kanë të bëjnë me Agjendën e reformave ne kuadër të Planit te rritjes.

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës;
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale;
- Prezantimi në formë të tabelës mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve për vitin 2026 dhe projeksionet për vitet 2027-2028 dhe

- Gjatë procesit buxhetor vëmendje e shtuar duhet t'i jepet nga OB-të në nivel qendror dhe lokal zbatimit të çështjeve si në vijim:
    - OB-të të mos propozojnë aktivitete apo projekte të reja pa i dhënë prioritet buxhetimit të obligimeve për aktivitetet/projektet kapitale. Në përputhje me rekomandimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, OB-të të dërgojnë në MFPT informatë lidhur me paditë e ngritura së bashku me një vlerësim nga zyrat ligjore për mundësinë e materializimit/shndërrimit të tyre në obligime;
    - OB-të janë të obliguara të plotësojnë të dhënat që kërkohen në sistemet buxhetore SZHMB dhe PIP si dhe duhet të parandalojnë keq klasifikimin e shpenzimeve buxhetore. Nëse me rastin e dorëzimit të propozim buxhetit nga OB qendrore apo lokale analisti buxhetor do të identifikojë keq klasifikimet, Departamenti i Buxhetit të njëjtat do t'i largoje nga buxheti, duke përfshirë jo vetëm keq klasifikimet për projektet e reja por edhe ato që janë në vazhdimësi nga viti i kaluar;
    - Projektet e propozuara kapitale të jenë projekte në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse. Projektet të cilat nuk zbatojnë standardet dhe kriteret e parapara ligjore nuk do të lejohen të bëhen pjesë e buxhetit.
    - Me rastin e propozimit të projekteve të reja kapitale, OB-të të dorëzojnë në MFPT arsyeshmërinë për secilin projekt sipas rregullave të sistemit PIP dhe udhëzimeve administrative përkatëse.;
    - Nga OB-të kërkohet që të bëhet regjistrimi i zotimeve shumëvjeçare në sistemin PIP;Ministritë duhet të ndajnë mjete buxhetore brenda hapësirës fiskale vetëm për realizimin e atyre projekteve kapitale për të cilat në bazë marrëveshjeve të mirëkuptimit me komunat kanë krijuar obligime në të kaluarën;
    - Buxhetimi i projekteve kapitale të bëhet në përputhje me rregullat në fuqi, ku pjesë e kostos së projektit të jenë edhe *shpenzimet e shpronësimit.* Organizatat buxhetore qendrore dhe lokale, pas një analize paraprake, duhet të planifikojnë shpenzimet e shpronësimit për çdo projekt individual në kuadër të kostos totale të projektit, e jo të planifikojnë linjë të veçantë për shpronësim.
    - <u>Për projektet e reja kapitale të natyrës teknologjisë informative Organizatat Buxhetore para se të aplikojnë për mjete buxhetore duhet të marrin miratim paraprak nga Agjencia e Shërbimit te Informacionit- ASHI (MPB) se një projekt të tillë nuk mund të zbatohet nga ASHI-ja.</u>

Qeveria mund të ndryshojë strukturën e shpenzimeve me qëllim arritjen e prioriteteve të saj, si brenda programeve të një organizate buxhetore, ashtu edhe duke zhvendosur buxhetin nga një organizatë në tjetrën të nivelit qendror, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kërkesat buxhetore duhet të mbështesin politikat prioritare të Qeverisë dhe të fokusohen në fushat e politikave sektoriale, në përputhje me Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë 2026-2028.

Shpenzimet rrjedhëse: Organizatat buxhetore duhet të paraqesin kërkesat e tyre brenda kufizimeve buxhetore të caktuara. Është thelbësore që të gjitha organizatat buxhetore të respektojnë kufijtë e përcaktuar në Shtojcat e bashkangjitura.

Punësimi: Pozitat e reja do të lejohen vetëm brenda numrit të aprovuar të pozitave dhe buxhetit për pozitat e paplotësuara sipas udhëzimeve të dhëna me qarkore.

Pagat dhe shtesat: Për kalkulimin e pagave për vitin 2026 për pozitat aktuale është marrë për bazë për përllogaritje muaji mars 2025 duke përfshirë rritjen e planifikuar të koeficientit për 0.5 sipas Ligjit

mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025. Ndërsa për punëtorët e papunësuar është përllogaritur paga mesatare dhe është buxhetuar vetëm deri 40%, brenda kufizimeve buxhetore.

Mallra dhe shërbime: Organizatave buxhetore do t'i mundësohet financimi në fushat e rëndësishme dhe të domosdoshme. Organizatat buxhetore duhet të identifikojnë burimet brenda skenarëve bazë të tyre nga ato fusha me performancë jo të mirë, ose që nuk janë në përputhje të mjaftueshme me prioritetet e nivelit të lartë të Qeverisë.

Shpenzimet komunale: priten të ketë pjesëmarrje përafërsisht të njëjtë krahasuar me vitin 2025.

Subvencionet dhe transferet: Në kuadër të kësaj kategorie do të vazhdohet me ndarjen e mjeteve për zbatimin e skemave sociale dhe pensionale përfshirë këtu edhe rritjen natyrale të skemave pensionale, subvencionimet në bujqësi si dhe politikat e reja tani më të aprovuara në Qeveri.

Investimet kapitale: përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme dhe, në periudhën afatmesme, pritet të përfaqësojnë rreth 26% të shpenzimeve totale. Gjatë kësaj periudhe, pritet të realizohen projekte kapitale të bazuara në një listë prioritetesh, që përfshijnë iniciativa me ndikim në përmirësimin e rrjetit të transportit, përmirësimin e rrjetit të energjisë elektrike, si dhe përmirësimin e kushteve në sektorët e arsimit, shëndetësisë, sistemit social, mbrojtjes dhe sigurisë, etj. Pjesa më e madhe e investimeve kapitale gjatë periudhës afatmesme pritet të financohet nga buxheti i rregullt, ndërkohë që një numër i madh i projekteve në sektorë të ndryshëm planifikohen të financohen përmes huazimit të jashtëm, duke përdorur klauzolën e investimeve.

Përparësi në financim do të kenë projektet që janë në fazën e realizimit, si dhe ato që janë plotësisht në përputhje me prioritetet e Qeverisë. Kufijtë buxhetorë për investimet kapitale nëpër organizatat buxhetore janë indikativë, dhe Qeveria mban të drejtën t'i rregullojë ata në përputhje me arsyeshmërinë e projekteve që propozohen nga organizatat buxhetore.

Për organizatat buxhetore që konkurrojnë për fonde huamarrjeje (nga deficiti buxhetor prej 2%, përmes fondit 04) dhe nga klauzola e investimeve – përmes fondit 06 (ku aplikimi për fonde nga klauzola mund të bëhet vetëm për projekte kapitale), është e domosdoshme që projektet të përmbushin kriteret e përmendura më parë. Kjo përfshin gjithashtu analizën e shpenzimeve rrjedhëse para, gjatë dhe pas përfundimit të projektit, të cilat duhet të jenë të përshtatshme dhe të përfshira në projeksionet financiare të organizatës buxhetore.

5. Programi për investime publike (PIP)

Planifikimi i buxhetit për investime kapitale realizohet nëpërmjet rregullave dhe sistemit të Programit për Investime Publike (PIP). Prioritetet strategjike të Qeverisë, të përcaktuara në "Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë 2026–2028", përbëjnë bazën për përgatitjen e kërkesave buxhetore dhe për identifikimin e projekteve kapitale.

6. Indikatorët e performancës

Organizatat buxhetore, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë komunal, janë të obliguara të prezantojnë indikatorët e performancës të përmbledhur sipas objektivave dhe aktiviteteve përkatëse në nivelin e tyre organizativ, në përputhje me nenin 21 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Çdo organizatë buxhetore duhet të paraqesë nga 1 deri në 5

objektiva, të cilat lidhen drejtpërdrejt me strategjitë përkatëse dhe mbulojnë programet më të rëndësishme të saj. Udhëzimi parashikon që, aty ku është e aplikueshme, të paktën një nga objektivat e paraqitura të synojë promovimin e barazisë gjinore, i shoqëruar me indikatorë të performancës dhe aktivitetet konkrete për realizimin e tij. Gjithashtu, çdo kërkesë për fonde shtesë duhet të shoqërohet me një arsyetim të qartë se si ajo ndihmon në arritjen e objektivave të organizatës. Organizatat buxhetore duhet të rishqyrtojnë aktivitetet e tyre në funksion të arritjes së këtyre objektivave, ndërsa indikatorët për matjen e performancës së aktiviteteve duhet të jenë të qartë, të matshëm dhe konkretë për secilin aktivitet.

Forma e ofrimit të këtyre informatave dhe një shembull konkret janë dhënë në Aneksin 2. Për secilën organizatë buxhetore duhet të ofrohen informacionet e mëposhtme:

- **Objektivat e outputit**: Këto përshkruajnë rezultatet e pritshme nga ofrimi i shërbimeve, të cilat janë nën kontrollin e organizatës buxhetore.
- **Treguesit e outputit**: Këta tregues matnin aktivitetin e institucionit, si p.sh. sasinë apo cilësinë e shërbimit ose produktit të ofruar.
  a) Indikatori treguesi bazë
  b) Indikatori treguesi i synuar
- **Aktivitetet**: Këto përshkruajnë veprimet që do të ndërmerren për arritjen e objektivave të deklaruara.

7. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ)

Duke vepruar në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020 (2015), institucionet e Kosovës kanë përgjegjësinë për "përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i domosdoshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve" (Neni 5.1.5.). Për këtë arsye, organizatat buxhetore duhet të pasqyrojnë ndikimin e shpenzimeve publike në barazinë gjinore në buxhetin vjetor për vitin 2026. Kjo do të kontribuon gjithashtu në rritjen e efektivitetit dhe transparencës në menaxhimin e financave publike.
Komunat duhet të marrin parasysh këto udhëzime gjatë hartimit të qarkores së brendshme buxhetore komunale, e cila do të shërbejë si dokument bazë për planifikimin e buxhetit komunal për periudhën 2026-2028. Në rast të paqartësive, organizatat buxhetore mund të kërkojnë ndihmë nga analistët përkatës në kuadër të Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave. Forma e ofrimit të këtyre informacionave është dhënë në Aneksin 1. Po ashtu, organizatat buxhetore duhet të publikojnë këto të dhëna.

8. Kufijtë buxhetor për organizatat buxhetore të nivelit qendror për 2026-2028

Organizatat buxhetore të nivelit qendror duhet të marrin parasysh kufijtë buxhetorë të dhënë në tabelën e mëposhtme gjatë përgatitjes së buxhetit të tyre për vitin 2026 dhe për dy vitet në vijim.
Ju lutemi të keni parasysh se këta kufij buxhetorë mund të ndryshojnë në varësi të lëvizjeve fiskale apo vendimeve të Qeverisë, të cilat do të pasqyrohen përmes Qarkoreve Buxhetore pasuese, si dhe në varësi të kualitetit të kërkesave buxhetore.

Më poshtë në Tabelën 1 janë kufijtë buxhetor për organizatat buxhetore qendrore për 2026-2028.

Shtojca 1. Vlersimet per vitet 2026-2028

Kodi org.	Ministritë/Institucionet	Vlersimet për vitin 2026								Vlerësimet për vitin 2027			Vlerësimet për vitin 2028		
		Numri Aprovuar	Paga dhe Shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzimet Komunale	Subvencione dhe Transfere	Investimet Kapitale	Rezerva	Total 2026	Shpenzime Operative	Shpenzime Kapitale	Total 2027	Shpenzime Operative	Shpenzime Kapitale	Total 2028
101	Kuvendi i Kosovës	528	8,098,353	1,558,000	200,000	70,000	200,000		**10,126,353**	10,671,763	200,000	**10,871,763**	11,141,670	200,000	**11,341,670**
102	Zyra e Presidentit	113	1,621,527	2,246,421	6,700	419,305	15,000	-	**4,308,953**	4,383,137	15,000	**4,398,137**	4,477,226	15,000	**4,492,226**
104	Zyra e Kryeministrit	609	5,551,518	7,047,500	88,226	7,505,687	1,000,000	-	**21,192,931**	17,521,912	1,500,000	**19,021,912**	17,994,038	1,500,000	**19,494,038**
201	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	2,693	29,251,955	15,910,661	897,576	1,074,860,661	24,850,000	-	**1,145,770,853**	1,171,440,122	48,350,000	**1,219,790,122**	1,284,415,749	85,000,000	**1,369,415,749**
203	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	937	8,245,496	6,000,000	264,783	77,630,000	3,544,000	-	**95,684,279**	93,143,781	5,544,000	**98,687,781**	93,622,226	5,544,000	**99,166,226**
204	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	331	3,014,452	5,500,000	158,280	8,246,000	10,320,000	-	**27,238,732**	21,084,526	14,320,000	**35,404,526**	21,259,440	14,320,000	**35,579,440**
205	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	636	6,132,762	37,605,515	481,490	1,643,814	264,977,687	-	**310,841,268**	52,087,781	271,038,265	**323,126,046**	48,943,634	261,538,625	**310,482,259**
206	Ministria e Shëndetësisë	1,482	18,873,544	38,097,600	281,848	2,813,805	36,341,050	-	**96,407,847**	56,379,842	33,010,750	**89,390,592**	63,137,879	28,980,750	**92,118,629**
220	Sherbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosoves	7,538	101,490,732	69,600,000	4,139,016		22,449,500	-	**197,679,248**	180,911,738	22,449,500	**203,361,238**	187,100,738	23,000,000	**210,100,738**
207	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	831	8,550,336	5,550,000	383,908	17,116,550	66,440,000	-	**98,040,794**	32,071,063	96,440,000	**128,511,063**	32,567,196	96,440,000	**129,007,196**
208	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	2,282	25,954,911	14,350,000	1,590,459	25,305,360	42,862,054	-	**110,062,784**	69,678,250	49,862,054	**119,540,304**	71,047,371	49,862,054	**120,909,425**
211	Ministria për Komunitete dhe Kthim	121	1,102,753	375,000	17,000	2,100,000	2,000,000	-	**5,594,753**	3,655,405	2,000,000	**5,655,405**	3,719,392	2,000,000	**5,719,392**
212	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	129	1,247,573	335,000	7,000	1,000,000	4,050,000	-	**6,639,573**	2,758,189	4,050,000	**6,808,189**	2,830,580	4,050,000	**6,880,580**
213	Ministria e Ekonomisë	204	1,849,894	5,800,000	23,130	24,352,870	46,931,926		**78,957,820**	31,974,545	48,052,196	**80,026,741**	28,939,015	21,600,000	**50,539,015**
214	Ministria e Punëve të Brendshme	11,901	136,800,926	44,270,623	4,450,400	2,171,367	60,189,023	-	**247,882,339**	193,005,617	62,218,773	**255,224,390**	200,543,490	62,218,773	**262,762,263**
215	Ministria e Drejtësisë	2,169	21,660,702	12,500,000	1,088,769	11,898,000	9,800,000	-	**56,947,471**	46,067,810	7,000,000	**53,067,810**	47,324,672	7,000,000	**54,324,672**
216	Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diaspores	389	8,842,498	23,935,000	839,551	2,000,000	16,395,000	-	**52,012,049**	36,074,386	16,395,000	**52,469,386**	36,588,472	16,395,000	**52,983,472**
217	Ministria e Mbrojtjes	5,479	53,381,701	45,905,600	1,169,000		115,641,260	-	**216,097,561**	109,862,295	112,441,260	**222,303,555**	112,959,768	112,441,260	**225,401,028**
221	Ministria e Zhvillimit Rajonal	60	733,939	335,000	1,360	2,000,000	2,000,000	-	**5,070,299**	3,120,666	2,000,000	**5,120,666**	3,159,381	2,000,000	**5,159,381**
230	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	42	512,805	310,000	5,000		100,000	-	**927,805**	856,009	100,000	**956,009**	885,765	100,000	**985,765**
231	Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës	20	288,878	930,000	5,000	790,159		-	**2,014,037**	2,029,925	-	**2,029,925**	2,046,688	-	**2,046,688**
235	Autoriteti i Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	42	572,220	785,000	18,200		600,000	-	**1,975,420**	1,406,892	600,000	**2,006,892**	1,440,096	600,000	**2,040,096**
236	Agjencioni për parandalim e korrupcionit	58	831,165	140,000	8,500		-	-	**979,665**	1,030,379	-	**1,030,379**	1,078,607	-	**1,078,607**
238	Zyra Rregullatorit për Energji	41	588,672	270,000	22,000		80,800	-	**961,472**	913,049	80,800	**993,849**	947,207	80,800	**1,028,007**
240	Organi Shqyrtues i Prokurimit	35	391,824	160,000	5,100				**556,924**	578,475	-	**578,475**	601,210	-	**601,210**
242	Univerziteti i Prishtinës	2,081	23,562,238	4,200,000	1,020,000	1,744,000	5,400,000	-	**35,926,238**	32,322,161	5,400,000	**37,722,161**	33,939,360	5,400,000	**39,339,360**
243	Gjykata Kushtetuese e Kosoves	72	1,446,766	705,000	10,800	165,080	110,000	-	**2,437,646**	2,407,218	110,000	**2,517,218**	2,491,166	110,000	**2,601,166**
244	Autoriteti Kosovar i Konkurencës	30	393,188	77,000	2,000			-	**472,188**	496,813	-	**496,813**	521,628	-	**521,628**
245	Agjencioni Kosovar i Intelegjencës	190	8,215,730	4,000,000	45,000	700,000	4,270,000	-	**17,230,730**	13,412,595	4,270,000	**17,682,595**	14,039,313	4,500,000	**18,539,313**
246	Këshilli i Kosovës për Trashigimi Kulturore	18	275,445	107,000	2,550			-	**384,995**	400,144	-	**400,144**	416,127	-	**416,127**
247	Paneli Zgjedhor per Ankesa dhe Parashtesa	21	311,805	58,000	7,820			-	**377,625**	396,775	-	**396,775**	414,867	-	**414,867**
249	Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Sherbimin Civil të Kosovës	38	502,628	160,000	3,825			-	**666,453**	694,098	-	**694,098**	743,263	-	**743,263**
250	Keshilli Prokurororial i Kosoves	969	13,837,463	3,450,000	199,630		2,134,500	-	**19,621,593**	18,248,153	2,134,500	**20,382,653**	19,051,072	2,134,500	**21,185,572**
302	Zyra Kombetare e Auditimit	185	2,666,915	826,100	40,000		-	-	**3,533,015**	3,679,695	-	**3,679,695**	3,834,443	-	**3,834,443**
313	Autoriteti Rregullativ i Sherbimeve të Ujit	21	260,678	143,000	6,503		-	-	**410,181**	424,518	-	**424,518**	439,644	-	**439,644**
314	Autoriteti Regullativ i Hekurudhave	29	303,789	127,000	6,400		10,000	-	**447,189**	453,898	-	**453,898**	471,525	-	**471,525**
317	Autoriteti i Aviacionit Civil	31	717,138	150,000	3,738			-	**870,876**	910,319	-	**910,319**	948,148	-	**948,148**
318	Komsioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve	77	964,054	409,281	20,600		200,000	-	**1,593,935**	1,446,958	200,000	**1,646,958**	1,502,897	200,000	**1,702,897**
319	Komisioni i Pavarur i Mediave	44	556,650	409,883	28,000		400,000	-	**1,394,533**	1,025,149	-	**1,025,149**	1,057,449	-	**1,057,449**
320	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	93	1,267,441	700,000	28,100	4,800,000	-	-	**6,795,541**	6,865,250	-	**6,865,250**	6,958,793	-	**6,958,793**
321	Institucioni i Avokatit të Popullit	78	1,066,535	355,000	8,000		60,000	-	**1,489,535**	1,489,194	60,000	**1,549,194**	1,551,080	60,000	**1,611,080**
322	Akademia e Drejtesisë	32	336,504	535,000	16,500		-	-	**888,004**	906,511	-	**906,511**	926,037	-	**926,037**
328	Këshilli Gjygjësor i Kosovës	2,321	28,251,055	5,193,000	650,000	500,000	3,920,000	-	**38,514,055**	36,147,863	3,920,000	**40,067,863**	37,787,131	3,920,000	**41,707,131**
329	Agjencia Kosovare për krahasim dhe Verifikim të Pronës	200	1,845,875	851,090	48,523		431,500	-	**3,176,988**	2,847,011	431,500	**3,278,511**	2,954,118	431,500	**3,385,618**
251	Agjensioni per Informim dhe Privatesi	34	388,748	144,000	2,450				**535,198**	556,580	-	**556,580**	579,137	-	**579,137**
232	Shpenzimet e Paparashikuara						1,930,000	4,800,000	**6,730,000**	4,800,000	1,930,000	**6,730,000**	4,800,000	1,930,000	**6,730,000**
248	Radio Televizioni i Kosovës					8,960,000		-	**8,960,000**	8,960,000	-	**8,960,000**	8,960,000	-	**8,960,000**
224	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore	52	509,992	300,000	25,000	10,000,000		-	**10,834,992**	10,963,042	-	**10,963,042**	11,042,634	-	**11,042,634**
255	Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifik uar	25	416,362	280,000	10,000		200,000		**906,362**	736,262	150,000	**886,262**	760,422	150,000	**910,422**
	Totali	45,311	533,688,136	362,697,274	18,337,735	1,288,792,658	749,853,300	4,800,000	**2,958,169,103**	2,293,297,765	816,273,598	**3,109,571,363**	2,434,961,765	813,722,262	**3,248,684,027**
239	Agjencioni Kosovar i Privatizimit	242	3,665,947	1,025,000	110,000	2,000	30,000	-	**4,832,947**	5,004,574	20,000	**5,024,574**	5,217,291	20,000	**5,237,291**
	Totali i përgjithshëm me AKP	45,553	537,354,083	363,722,274	18,447,735	1,288,794,658	749,883,300	4,800,000	**2,963,002,050**	2,298,302,339	816,293,598	**3,114,595,937**	2,440,179,055	813,742,262	**3,253,921,317**

9. Fazat e procesit buxhetor për vitin 2026 për nivelin qendror

Pjesa në vijim prezanton kalendarin kohor të buxhetit, hapat dhe veprimet gjatë procesit buxhetor për vitin 2026.

• **15 Maj** - Lëshimi i Qarkores së parë buxhetore 2026/01. Kjo qarkore përmban udhëzimet për procesin buxhetor, kufijtë buxhetor dhe kalendarin buxhetor.
• **26 Qershor** - Organizatat buxhetore duhet të dorëzojnë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) kërkesat buxhetore sipas dokumentacionit përkatës, duke i përshkruar programet dhe kategoritë e shpenzimeve. Kërkesat duhet të jenë të plotësuara dhe të arsyetuara përmes përdorimit të sistemit të SZHMB-së dhe PIP-it.
• **27 Qershor** - Departamenti i Makroekonomisë paraqet kornizën e re makro-fiskale, e cila përcakton parametrat e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin buxhetor 2026.
• **11 Korrik** - Lëshimi i Qarkores së dytë buxhetore 2026/02, e cila do të adresojë çështjet specifike të reja që kanë dalë pas lëshimit të Qarkores së parë buxhetore.
• **25 Korrik** - Nëse kërkohen informata shtesë sipas Qarkores së dytë buxhetore, ato duhet të dorëzohen nga organizatat buxhetore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamentin e Buxhetit deri në këtë datë.
• **21 Gusht – 29 Gusht** - Dëgjimet buxhetore. Pas pranimit të materialeve nga organizatat buxhetore, do të zhvillohen dëgjime me pjesëmarrës nga organizatat buxhetore, stafi i MFPT, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, dhe përfaqësues të Komisionit Parlamentar për Buxhet, Punë dhe Transfere. Orari i dëgjimeve do t'i bashkëngjitet Qarkores buxhetore 2026/02. Mundësia e arritjes së marrëveshjes për shumat totale të buxhetit të organizatës për vitin 2026 mund të shqyrtohet gjatë këtyre dëgjimeve.
• **12 Shtator** - Departamenti i Makroekonomisë paraqet vlerësimet e fundit për indikatorët makro-ekonomik, sidomos ata që lidhen me procesin buxhetor 2026-2028.
• **17 Shtator – 22 Shtator** - Konsultime në Qeveri për caktimin e kufijve final buxhetor. Gjatë kësaj periudhe, do të diskutohet dhe përcaktohen kufijtë përfundimtarë të buxhetit.
• **26 Shtator** - Lëshimi i Qarkores së tretë buxhetore, e cila do të përmbajë kufijtë final buxhetor. Këta kufij mund të ndryshojnë nga ato të përcaktuara në Qarkoren e parë dhe të dytë.
• **30 Shtator – 3 Tetor** - Ankesat nga Organizatat Buxhetore. Organizatat do të mund të parashtrojnë ankesat e tyre në lidhje me kufijtë buxhetor të caktuar.
• **7 Tetor – 10 Tetor** - Takimet e Qeverisë për të shqyrtuar ankesat e organizatave buxhetore dhe për të vendosur mbi çështjet që kanë lindur gjatë procesit të shqyrtimit.
• **17 Tetor** - Drafti i parë i buxhetit për vitin 2026 do të paraqitet në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe do të dërgohet në Qeveri për shqyrtim.
• **20 Tetor – 24 Tetor** - Miratimi final i Draft Buxhetit në Qeveri. Pas shqyrtimit të tij, Qeveria do të miratojë buxhetin përfundimtar për vitin 2026.
• **29 Tetor** - Dorëzimi i Draft Buxhetit 2026 në Kuvendin e Republikës së Kosovës për miratimin e tij.

Kërkesa për buxhet nga organizata buxhetore të nivelit qendror duhet të përfshijë:

- Një tabelë me parashikimet deri në fund vit të implementimit të buxhetit 2025, në nivel programi dhe nën-programi, si dhe komentet përcjellëse për nën-ekzekutimin apo mbi-ekzekutim nga ndarjet e buxhetit 2025;
- Tabelat 3.1, 3.1 A, 3.1 B si dhe Formularët e PCF-ve të shtypura nga sistemi i SZHMB-së;
- Tabelat 3.2, 3.2 B dhe Formularët e shtypur nga Sistemi PIP;
- Tabelat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor;
- Tabela e Buxhetimit në bazë të performancës;

- Kërkesa buxhetore duhet të jetë e konsoliduar në nivel të organizatës buxhetore, duke përfshirë gjithashtu agjencitë ekzekutive;
- Shkresa kërkesë (shkresa përcjellëse) e nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm ose Kryeshefi i agjencisë, e cila shoqëron të gjitha materialet buxhetore;
- Përshkrimi i kërkesës në formë narrative duhet të paraqitet me këto të dhëna:
    - Arritjet e deritanishme, me fokus të veçantë në realizimin e objektivave të caktuara në dokumentet strategjike.
    - Çfarë është parashikuar të arrihet me ndarjet buxhetore për vitin 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028?
    - Organizatat buxhetore duhet të informojnë Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve nëse kërkesa buxhetore përfshin vazhdimin e politikave ekzistuese, ose parashikon përfundimin e aktiviteteve aktuale dhe nisjen e aktiviteteve të reja.

Për aktivitetet e reja, organizatat buxhetore duhet të specifikojnë bazën ligjore (si koncept dokumenti, udhëzim administrativ, projektligj, etj.) dhe të informojnë nëse është kryer Vlerësimi i Ndikimit Buxhetor për këtë bazë ligjore, në përputhje me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 03/2015, lidhur me Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor për Nismat e Reja Qeveritare.

Niveli Komunal

1. Hyrje

Me qarkoren buxhetore janë përcaktuar grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2026 dhe orientimet për vitet 2027-2028, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, qarkorja përcakton edhe nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2026 si dhe parashikimin afatmesëm 2027-2028.

Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2026, bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Me rastin e regjistrimit të popullsisë, të dhënat të cilat janë publikuar zyrtarisht nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në vitin 2024, Qeveria e Republikës se Kosovës me datë 12.03.2025 ka aprovuar shtojcën 1 me të dhënat e reja nga regjistrimi i Popullsisë, në përputhje me nenin 35, paragrafi 2 të Ligjit N.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, të dhëna të cilat kanë shërbyer për përgatitjen e buxhetit komunal për vitin 2026-2028.

Procesi i buxhetit komunal merr parasysh këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël,
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës,
- Zbatimi i konceptit shumë vjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe
- Përcaktimi i strukturës së shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve.

Projektet kapitale shumë vjeçare duhet të raportohen në sistemin e Projekteve të Investimeve Publike (PIP) bazuar në performancë. Si rrjedhojë, nga komunat kërkohet të hartojnë strategjinë kornizë bazuar në synimet dhe objektivat të orientuara në rezultate.

2. Burimet e Financimit Komunal për vitin 2026-2028

2.1. Granti i Përgjithshëm

Bazuar në Tabelën 1, të paraqitur në vijim, të përgatitur nga Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në përputhje me LFPL, Granti i Përgjithshëm për komuna për vitin 2026 është në shumë prej 345 milion euro, në të cilën është përfshirë edhe kostoja nga regjistrimi i popullsisë në shumë prej 6.5 milion euro, për të mbuluar ndikimin negativ në disa komuna, bazuar në nenin 35.3 të LFPL.

Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL. Sipas këtij neni, 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore ju ndahen komunave, duke përjashtuar: mbështetjen buxhetore dhe grantet, grantet e përcaktuara të donatorëve, të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga interesi si dhe taksat, ngarkesat dhe të tjera nga qeveria lokale.

Siç paraqitet në tabelën në vijim, bazuar në vlerësimet të Departamentit të Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar, të hyrat e përgjithshme qeveritare për vitin 2026 pritet të jenë 3,544.3 mil. euro. Nga kjo shumë, zbriten ato të hyra siç specifikohet në nenin 24 të LFPL dhe vijmë tek baza për ndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna, i cili grant për vitin 2026 është në shumë prej 338.53 milion euro.

Tabela 1: Përcaktimi i vlerës së Grantit të Përgjithshëm për komuna 2026-2028 (mil. Euro)

Përshkrimi	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
A. Të hyrat e përgjithshme të Qeverisë	**2,676.30**	**2,985.32**	**3,227.19**	**3,544.30**	**3,812.40**	**4,094.30**
Zbriten:						
Mbeshtetja buxhetore dhe grante	(10.5)	(18.0)	(22.5)	(22.5)	(22.5)	(22.5)
Tatimi në pronë	(44.6)	(49.3)	(45.0)	(50.0)	(55.0)	(55.5)
Grantet e percaktuara të donatorëve	(12.0)	(12.0)	(12.0)	0.0	0.0	0.0
Taksa ngarkesa dhe të tjera nga Qeveria Lokale	(54.0)	(56.2)	(70.0)	(73.5)	(77.2)	(77.2)
Të hyrat nga interesi	(3.1)	(3.0)	(2.8)	(13.0)	(12.7)	(2.7)
B. Baza për llogaritjen e grantit të përgjithshëm për komunal	**2,552.11**	**2,846.80**	**3,074.89**	**3,385.26**	**3,645.06**	**3,936.46**
C. Granti i përgjithshëm për komuna (10%)	**255.21**	**284.68**	**307.49**	**338.53**	**364.51**	**393.65**

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (i) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (iii) numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%); (iv) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%).

Tabela 2: Struktura e Grantit të Përgjithshëm për 2025-2027 sipas LFPL (mil. Euro)

Faktorët	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
Granti i përgjithshëm	255.21	284.68	307.49	345.02	364.5	393.6
Diferenca 2026/2025 e ndikuar negativisht (kostoja pas regjistrimit të popullsisë)				6.5	0.0	0.0
Shuma Fikse	3.6	3.6	3.6	3.8	3.8	3.8
Popullsia (banorë)	1,780,021	1,780,021	1,780,021	1,602,515	1,602,515	1,602,515
Buxheti: 89% e shumës agregate	223.9	250.1	270.4	297.9	321.0	347.0
Zona komunale (km2)	10,901	10,901	10,901	10,905	10,905	10,905
Buxheti: 6% e shumës agregate	15.1	16.9	18.2	20.1	21.6	23.4
Komunitetet pakicë në komunë	107,926	107,926	107,926	115	115	115
Buxheti: 3% e shumës agregate	7.5	8.4	9.1	10.0	10.8	11.7
Popullsia e komunave pakicë	62,031	62,031	62,031	45,756	45,756	45,756
Buxheti: 2% e shumës agregate	5.0	5.6	6.1	6.7	7.2	7.8

Tabela 3 në vijim paraqet shpërndarjen e Grantit të Përgjithshëm nëpër komuna sipas formulës të paraparë në LFPL.

Tabela 3: Shpërndarja e Grantit të Përgjithshëm në komuna për vitet 2026-2028

	Komunat	Kriteret për ndarjen e Grantit të Përgjithshëm (sipas LFPL)								Shuma Fikse (140,000-1€)	Shuma për Popullsi (89%)	Shuma për madhësi gjeografike (6%)	Shuma për popullsi pakicë në komuna (3%)	Shuma për Komunat me popullsi pakicë (2%)	Diferenca 2026/2025 e ndikuar negativisht (kostoja pas regjistrimit të popullsisë)	Granti i përgjithshëm për vitin 2026	Granti i përgjithshëm për vitin 2027	Granti i përgjithshëm për vitin 2028
		Popullsia		Madhësia gjeografike		Popullsia Pakicë		Komunat me popullsi pakicë										
		Popullsia	89%	Madhësia gjeografike	6%	Popullsia Pakicë në Komuna	3%	Komunat me popullsi pakicë	2%									
1	Deçan	27,775	1.73%	293.97	2.70%	509	0.44%		0.00%	112,225	5,163,176	541,369	44,447	-	861,916	**6,723,133**	**6,307,427**	**6,807,946**
2	Dragash	28,896	1.80%	433.85	3.98%	11,342	9.86%		0.00%	111,104	5,371,561	798,969	990,409	-		**7,272,043**	**7,827,842**	**8,451,289**
3	Ferizaj	109,255	6.82%	344.61	3.16%	4,230	3.68%		0.00%	30,745	20,309,730	634,627	369,373	-		**21,344,474**	**22,998,747**	**24,854,366**
4	Fushë Kosovë	63,949	3.99%	84.09	0.77%	5,548	4.82%		0.00%	76,051	11,887,666	154,858	484,464	-		**12,603,039**	**13,575,325**	**14,665,952**
5	Gjakovë	78,699	4.91%	586.64	5.38%	6,603	5.74%		0.00%	61,301	14,629,586	1,080,344	576,589	-		**16,347,820**	**17,611,903**	**19,029,843**
6	Gjilan	82,980	5.18%	391.84	3.59%	2,338	2.03%		0.00%	57,020	15,425,394	721,605	204,159	-		**16,408,177**	**17,677,278**	**19,100,845**
7	Gllogoc	48,079	3.00%	275.63	2.53%	43	0.04%		0.00%	91,921	8,937,545	507,595	3,755	-		**9,540,816**	**10,274,195**	**11,096,836**
8	Hani i Elezit	8,533	0.53%	83.13	0.76%	16	0.01%		0.00%	131,467	1,586,224	153,091	1,397	-		**1,872,179**	**2,007,285**	**2,158,835**
9	Istog	33,008	2.06%	454.36	4.17%	3,116	2.71%		0.00%	106,992	6,135,953	836,740	272,096	-		**7,351,781**	**7,914,088**	**8,544,835**
10	Junik	3,943	0.25%	77.76	0.71%	5	0.00%		0.00%	136,057	732,976	143,201	437	-	169,873	**1,182,544**	**1,080,709**	**1,157,029**
11	Kaçanik	27,716	1.73%	211.27	1.94%	31	0.03%		0.00%	112,284	5,152,208	389,071	2,707	-		**5,656,269**	**6,086,568**	**6,569,239**
12	Kamenicë	22,868	1.43%	416.61	3.82%	2,310	2.01%		0.00%	117,132	4,250,999	767,220	201,714	-	1,115,830	**6,452,896**	**5,742,213**	**6,196,672**
13	Klinë	30,503	1.90%	309.02	2.83%	1,352	1.18%		0.00%	109,497	5,670,291	569,085	118,060	-	104,886	**6,571,819**	**6,960,367**	**7,513,860**
14	Leposaviq	9,485	0.59%	539.05	4.94%	837	0.73%	9,485	20.73%	130,515	1,763,194	992,704	73,089	1,387,696	149,768	**4,496,965**	**4,674,476**	**5,041,590**
15	Lipjan	55,044	3.43%	338.41	3.10%	3,183	2.77%		0.00%	84,956	10,232,289	623,209	277,947	-		**11,218,401**	**12,082,527**	**13,051,829**
16	Malishevë	43,888	2.74%	306.44	2.81%	71	0.06%		0.00%	96,112	8,158,468	564,334	6,200	-	73,880	**8,898,994**	**9,502,618**	**10,262,584**
17	Mamushë	5,607	0.35%	10.94	0.10%	387	0.34%	5,607	12.25%	134,393	1,042,302	20,147	33,794	820,328		**2,050,963**	**2,199,718**	**2,366,579**
18	Mitrovicë	64,742	4.04%	330.72	3.03%	2,049	1.78%		0.00%	75,258	12,035,079	609,047	178,923	-		**12,898,307**	**13,893,572**	**15,009,975**
19	Novo Bërdë	4,493	0.28%	203.98	1.87%	692	0.60%		0.00%	135,507	835,217	375,645	60,427	-	360,625	**1,767,421**	**1,505,468**	**1,616,149**
20	Obiliq	22,815	1.42%	104.84	0.96%	3,573	3.11%		0.00%	117,185	4,241,147	193,071	312,002	-		**4,863,405**	**5,231,785**	**5,645,001**
21	Pejë	82,745	5.16%	602.58	5.53%	7,266	6.32%		0.00%	57,255	15,381,709	1,109,699	634,483	-		**17,183,146**	**18,512,378**	**20,003,395**
22	Podujevë	70,975	4.43%	632.59	5.80%	904	0.79%		0.00%	69,025	13,193,749	1,164,965	78,939	-	120,590	**14,627,269**	**15,627,262**	**16,884,235**
23	Prishtinë	227,466	14.19%	523.14	4.80%	4,568	3.97%		0.00%		42,284,316	963,404	398,888	-		**43,646,608**	**47,034,254**	**50,834,223**
24	Prizren	147,246	9.19%	626.86	5.75%	32,762	28.49%		0.00%		27,371,987	1,154,413	2,860,851	-		**31,387,250**	**33,823,382**	**36,556,025**
25	Rahovec	41,799	2.61%	275.90	2.53%	1,308	1.14%		0.00%	98,201	7,770,138	508,092	114,217	-	677,411	**9,168,059**	**9,142,031**	**9,872,695**
26	Shtërpcë	10,771	0.67%	247.70	2.27%	2,691	2.34%	10,771	23.54%	129,229	2,002,253	456,159	234,984	1,575,843		**4,398,468**	**4,729,826**	**5,101,515**
27	Shtime	24,308	1.52%	134.42	1.23%	775	0.67%		0.00%	115,692	4,518,685	247,545	67,675	-		**4,949,597**	**5,324,782**	**5,745,632**
28	Skenderaj	40,664	2.54%	374.37	3.43%	275	0.24%		0.00%	99,336	7,559,149	689,432	24,014	-	78,717	**8,450,648**	**9,014,011**	**9,734,241**
29	Suharekë	45,749	2.85%	361.04	3.31%	561	0.49%		0.00%	94,251	8,504,415	664,884	48,988	-	493,520	**9,806,058**	**10,028,018**	**10,830,582**
30	Viti	35,566	2.22%	269.69	2.47%	243	0.21%		0.00%	104,434	6,611,467	496,656	21,219	-	471,289	**7,705,065**	**7,787,122**	**8,407,818**
31	Vushtrri	61,528	3.84%	344.85	3.16%	681	0.59%		0.00%	78,472	11,437,619	635,069	59,466	-		**12,210,626**	**13,152,267**	**14,208,519**
32	Zubin Potok	3,385	0.21%	334.38	3.07%	683	0.59%	3,385	7.40%	136,615	629,247	615,789	59,641	495,240	491,335	**2,427,867**	**2,076,234**	**2,232,939**
33	Zveçan	2,867	0.18%	123.01	1.13%	362	0.31%	2,867	6.27%	137,133	532,955	226,533	31,611	419,454	892,814	**2,240,499**	**1,441,643**	**1,547,036**
34	Gracanicë	18,486	1.15%	122.42	1.12%	9,863	8.58%		0.00%	121,514	3,436,416	225,446	861,259	-		**4,644,636**	**4,995,699**	**5,389,492**
35	Kllokot	3,041	0.19%	23.39	0.21%	1,339	1.16%		0.00%	136,959	565,300	43,075	116,924	-		**862,258**	**918,553**	**981,699**
36	Mitrovica veriore	7,920	0.49%	5.46	0.05%	2,326	2.02%	7,920	17.31%	132,080	1,472,272	10,055	203,111	1,158,729	313,406	**3,289,654**	**3,196,999**	**3,444,618**
37	Partesh	3,240	0.20%	28.67	0.26%	19	0.02%	3,240	7.08%	136,760	602,293	52,798	1,659	474,026		**1,267,536**	**1,355,301**	**1,453,749**
38	Ranillug	2,481	0.15%	77.62	0.71%	132	0.11%	2,481	5.42%	137,519	461,200	142,943	11,527	362,981	115,856	**1,232,026**	**1,192,128**	**1,277,332**
	Gjithsej	**1,602,515**	**100%**	**10,905.25**	**100%**	**114,993**	**100%**	**45,756**	**100%**	**3,812,197**	**297,896,175**	**20,082,888**	**10,041,444**	**6,694,296**	**6,491,715**	**345,018,715**	**364,506,000**	**393,647,000**

Financimi i shërbimeve sociale si kompetencë e transferuar nga MPMS në komuna përfshihet në kuadër të grantit të përgjithshëm të komunës.

Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Arsim para universitar dhe Shëndetësi primare financohen nga granti i përgjithshëm në komuna.
Po ashtu, nga granti i përgjithshëm do të plotësohen edhe grantet specifike për arsim dhe shëndetësi kur është e nevojshme.

2.2. Granti shtesë për financimin e Kryeqytetit

Bazuar në Ligjin Nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën, neni 19 Kryeqyteti i Republikës së Kosovës Prishtina përfiton një grant shtesë nga niveli qendror, në lartësi jo më pak se 6% e grantit të përgjithshëm.
Për vitin 2026 Kryeqyteti, Prishtina përfiton grant shtesë prej 20,311,620 euro, ndërsa për vitin 2027 përfiton 21,870,360 euro dhe për vitin 2028 përfiton 23,618,820 euro.

Tabela 4: Shpërndarja e Grantit shtesë për financimin e Kryeqytetit 2026-2028

Përshkrimi	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
Granti i përgjithshëm për komuna	193.53	255.21	284.68	307.49	338.50	364.50	393.60
Granti shtesë për financimin e Kryeqytetit (6%)	11.61	15.31	17.08	18.45	20.31	21.87	23.62

2.3. Granti specifik për Arsim parauniversitar

Granti Specifik për Arsim para universitar sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit para universitar të MASHTI për vitin 2026-2028.

Grantin specifik për arsim para universitar për vitin 2026 është në shumë prej 270.46 milion euro, si vijon:

1. Granti bazë në shumë prej 265.9 milion euro si vijon:
    - Paga dhe shtesa në shumë prej 247.4 milion euro,
    - Mallra dhe shërbime në shumë prej 16.75 milion euro,
    - Shpenzime kapitale në shumë prej 2.1 milion euro.

2. Politikat e reja të aprovuara janë si në vijim:

    a) Transporti i nxënësve nga klasa 0-9, me kosto prej 3,48 milion euro,
    b) Numri i personelit ndihmës për çerdhet e reja, rritje të stafit prej 138 dhe kosto për paga dhe shtesa prej 0.9 milion euro.

Formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kritere:

a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2024/2025;
b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 22/2013 të MASHTI-it);
c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
f) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
g) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;
h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin parafillor dhe fillor;
i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm
j) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje);
k) Kalkulimi i pagave dhe shtesave është bazuar në Ligjin për Paga në sektorin Publik;
l) Shërbimi profesional Pedagogjik/Psikologjik;
m) Koordinatorët e cilësisë;
n) Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafillore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);
o) Kapitalet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës;

Sipas MASHTI-të është raportuar numri për 12,961 nxënës më pak në arsim para universitar krahasuar me vitin paraprak.

Tabela 5: Të dhënat statistikore dhe shpërndarja e grantit specifik për arsimin parauniversitar për vitet 2026-2028

U ovoj projekciji, u pogledu poreskih prihoda, uzeti su u obzir prihodi od poreza na nepokretnu imovinu, dok je za neporeske prihode uzeto prosečno ostvarenje neporeskih prihoda u poslednje tri godine i prognoze opština na trend rasta neporeskih prihoda.

Tabela 9: Projekcije sopstvenih opštinskih prihoda za 2026-2028

Br.	Opstine	Porez na imovinu 2026	Porez na zemlju 2026	Porez na imovinu 2027	Poraz za zemlju 2027	Porez na imovinu 2028	Porez na zemlju 2028	Neporeski prihodi 2026	Neporeski prihodi 2027	Neporeski prihodi 2028	Projekcije za 2026 godinu	Projekscije za 2027 godinu	Pojekcije za 2028 godinu
1	Decane	480,541	116,634	515,380	141,127	520,534	141,833	371,104	389,659	389,659	968,279	1,046,167	1,052,026
2	Dragas	272,299	66,129	292,041	80,016	294,961	80,416	251,300	263,865	263,865	589,728	635,922	639,242
3	Urosevac	2,617,577	656,963	2,807,351	794,925	2,835,425	798,900	4,385,729	4,605,015	4,605,015	7,660,269	8,207,292	8,239,340
4	Kosovo Polje	1,144,460	269,231	1,227,434	325,769	1,239,708	327,398	3,010,060	3,160,563	3,160,563	4,423,751	4,713,766	4,727,669
5	Djakovica	2,538,964	645,090	2,723,039	780,559	2,750,269	784,461	3,636,069	3,817,872	3,817,872	6,820,123	7,321,470	7,352,603
6	Gnjilane	2,504,879	573,396	2,686,482	693,809	2,713,347	697,278	2,742,927	2,880,074	2,880,074	5,821,202	6,260,365	6,290,699
7	Glogovac	761,072	189,794	816,250	229,650	824,412	230,798	1,318,333	1,384,250	1,384,250	2,269,199	2,430,150	2,439,461
8	Elez Han	149,145	37,392	159,958	45,245	161,558	45,471	170,183	178,692	178,692	356,720	383,895	385,721
9	Istok	529,267	135,753	567,639	164,261	573,315	165,082	935,254	982,017	1,192,017	1,600,274	1,713,916	1,930,414
10	Junik	102,727	26,724	110,175	32,336	111,277	32,498	65,850	69,143	69,143	195,301	211,654	212,917
11	Kacanik	384,577	93,925	412,458	113,649	416,583	114,218	586,631	615,963	615,963	1,065,133	1,142,071	1,146,763
12	Kamenica	481,693	120,667	516,615	146,007	521,782	146,737	621,557	652,635	652,635	1,223,917	1,315,257	1,321,154
13	Klina	530,059	133,825	568,488	161,928	574,173	162,737	887,900	932,295	932,295	1,551,784	1,662,711	1,669,206
14	Leposavic	1,600	400	2,500	700	3,500	1,000	105,756	111,044	111,044	107,756	114,244	115,544
15	Lipjan	1,271,058	335,347	1,363,210	405,769	1,376,842	407,798	1,761,735	1,849,822	1,849,822	3,368,140	3,618,802	3,634,463
16	Malisevo	367,005	88,543	393,613	107,137	397,549	107,673	1,488,400	1,562,820	1,562,820	1,943,948	2,063,570	2,068,042
17	Mamusa	32,970	8,223	35,361	9,950	35,714	9,999	58,600	61,530	61,530	99,793	106,840	107,244
18	Mitrovica	1,016,041	218,731	1,089,704	264,665	1,100,601	265,988	2,465,228	2,588,489	2,588,489	3,700,000	3,942,858	3,955,079
19	Novobrdo	94,497	24,268	101,348	29,364	102,361	29,511	347,193	364,553	364,553	465,957	495,264	496,424
20	Obilic	608,358	155,247	652,464	187,848	658,988	188,788	634,710	666,446	666,446	1,398,314	1,506,758	1,514,221
21	Pec	2,635,918	666,897	2,827,022	806,945	2,855,292	810,980	2,880,736	3,024,773	3,024,773	6,183,550	6,658,739	6,691,044
22	Podujevo	692,704	167,622	742,925	202,822	750,354	203,836	1,498,000	1,572,900	1,572,900	2,358,325	2,518,647	2,527,090
23	Pristina	12,060,238	3,063,554	12,934,605	3,706,901	13,063,951	3,725,435	26,120,980	27,427,029	27,322,029	41,244,772	44,068,534	44,111,415
24	Prizren	3,395,361	864,684	3,641,525	1,046,268	3,677,940	1,051,500	7,105,822	7,461,113	7,461,113	11,365,867	12,148,906	12,190,553
25	Orahovac	622,731	156,701	667,879	189,608	674,558	190,556	1,471,982	1,545,581	1,440,581	2,251,414	2,403,069	2,305,695
26	Strpce	241,163	60,751	258,648	73,509	261,234	73,876	108,611	114,042	114,042	410,525	446,198	449,152
27	Stimlje	254,407	62,957	272,852	76,178	275,580	76,559	542,132	569,239	569,239	859,497	918,269	921,378
28	Skenderaj	306,125	77,197	328,319	93,409	331,602	93,876	1,357,590	1,425,470	1,425,470	1,740,912	1,847,197	1,850,947
29	Suva Reka	1,070,014	272,872	1,147,590	330,176	1,159,066	331,827	1,305,705	1,370,990	1,370,990	2,648,591	2,848,756	2,861,882
30	Vitina	503,696	125,464	540,214	151,812	545,616	152,571	665,500	698,775	698,775	1,294,660	1,390,801	1,396,962
31	Vucitrn	1,070,296	284,351	1,147,892	344,065	1,159,371	345,785	2,473,000	2,596,650	2,596,650	3,827,647	4,088,607	4,101,806
32	Zubin Potok	700	300	1,000	500	700	1,500	81,400	85,470	85,470	82,400	86,970	87,670
33	Zvecan	1,500	600	2,000	1,000	2,300	1,200	74,500	78,225	78,225	76,600	81,225	81,725
34	Gracanica	1,102,138	262,218	1,182,043	317,283	1,193,863	318,870	1,471,185	1,544,744	1,544,744	2,835,540	3,044,070	3,057,477
35	Klokot	89,275	20,249	95,748	24,502	96,705	24,624	98,582	103,511	103,511	208,107	223,761	224,841
36	Severna Mitrovica	4,500	1,200	4,800	1,400	5,000	1,700	130,000	136,500	136,500	135,700	142,700	143,200
37	Partes	34,731	10,060	37,249	12,173	37,621	12,234	206,946	217,293	217,293	251,737	266,715	267,148
38	Ranilug	34,015	8,542	36,481	10,336	36,845	10,387	69,793	73,282	73,282	112,349	120,098	120,515
Ukupno		40,008,300	10,002,500	42,910,300	12,103,600	43,340,500	12,165,900	73,506,983	77,182,332	77,182,332	123,517,783	132,196,232	132,688,732

2.11. Finansiranje zaduživanja

Za 2026. godinu, putem zaduživanja, projekti za energetsku efikasnost u javnim zgradama biće finansirani u Javnim Zgradama u opštini Priština i opštini Prizren kao u sledećoj tabeli.

Tabela 10: Finansiranje zaduživanja 2026-2028

Projekt	2026.god.			2027 god.			2028 god.		
	Fond 04	Fond 06	Ukupno	Operativni	Kapitalni	Ukupno	Operativni	Kapitalni	Ukupno
Projekat energetske efikasnosti u javnim zgradama u opštini Priština	46,900	1,953,100	2,000,000			-			-
Projekat energetske efikasnosti u javnim zgradama u opštini Prizren		1,400,000	1,400,000		1,300,000	1,300,000		1,050,000	1,050,000
Ukupno	46,900	3,353,100	3,400,000	-	1,300,000	1,300,000	-	1,050,000	1,050,000

2.12. Rezime opštinskog finansiranja za 2026-2028

Za dodelu vladinih grantova po opštinama za 2026. godinu primenjeni su osnovni kriterijumi i formule definisani Zakonom o finansijama lokalne samouprave i drugim relevantnim zakonima, kao i na osnovu makrofiskalnih projekcija i podataka resornih ministarstava:

Tabela 11: Rezime opštinskog finansiranja za 2026-2028 (mil. evra)

Opis	Budžet 2022	Budžet 2023	Budžet 2024	Budžet 2025	Prognoziranje za 2026	Prognoziranje za 2027	Prognoziranje za 2028
1. Vladini grantovi	**457.6**	**526.9**	**605.2**	**639.6**	**703.0**	**733.2**	**773.4**
1.1 Opšti grant	**193.5**	**255.2**	**284.7**	**307.5**	**345.0**	**364.5**	**393.6**
Opšti grant	193.5	255.2	284.7	307.5	345.0	364.5	393.6
1.2 Specifični grant za zdravstvo	**62.6**	**70.5**	**82.0**	**83.0**	**87.5**	**90.1**	**92.9**
Osnovni grant	62.6	62.6	82.0	83.0	85.8	90.1	92.9
Tekuće i nove politike		7.9			1.8		
1.3 Specifični grant za obrazovanje	**201.5**	**201.2**	**238.5**	**249.1**	**270.5**	**278.6**	**286.9**
Osnovni grant	195.0	194.4	238.5	249.1	266.0	278.6	286.9
Tekuće i nove politike	6.5	6.8			4.5		
2. Finansiranje za sekundarno zakonodavstvo	**2.6**	**2.6**	**2.6**	**2.6**	**2.9**	**2.9**	**2.9**
3. Stambene usluge	**2.3**	**4.2**	**3.5**	**3.6**	**7.8**	**9.0**	**10.0**
4. Finansiranje za QHP, QKHFZ i KHM	**0.1**	**0.1**	**0.1**	**0.1**	**0.1**	**0.1**	**0.1**
5. Grant za glavni grad - Prištinu	**11.6**	**15.3**	**17.1**	**18.4**	**20.3**	**21.9**	**23.6**
6. Finansiranje za Obilić	**5.0**	**5.0**	**5.0**	**4.8**	**4.6**	**4.6**	**4.6**
7. Sopstveni opštinski prihodi	**87.4**	**98.5**	**105.5**	**115.0**	**123.5**	**132.2**	**132.7**
8. Finansiranje za pozorišta	**0.9**	**0.9**	**1.6**	**1.7**	**2.0**	**2.1**	**2.3**
9. Finansiranja od zaduživanja	**-**	**6.0**	**2.0**	**2.5**	**3.4**	**1.3**	**1.1**
Ukupno opštinsko finansiranje	**567.5**	**659.5**	**742.6**	**788.3**	**867.6**	**907.3**	**950.6**

Departament Budzeta organizovace forume sa opstinskim autoritetima povodom razvoja budzetskog procesa opstina za 2026-2028 godinu.
Takodje, odrzace se konsultativni sastanci sa finansijskim sluzbenicima opstina za odredjivanje strukture prema kategorijama potrosnje i prema potrebama pruzicemo upustva sa specifikacijama oko procesa i kriterijumima za sastav budzeta za 2026 godinu i projekcije za 2027-2028 godinu.

Tabela 12: Finansijski izvori i struktura troskova za 2026-2028

Budjet Opstinskog nivoa	2024 godina Potrosnja	2025 Godina Budzet	2026 Godina Planiranje	2027 Godina Ocenjivanje	2028 godina Ocenjeno
Total	**724,677,425**	**788,294,719**	**867,648,415**	**907,323,563**	**950,634,497**
Broj radnika	45,444	45,385			
Plata I dodatci	380,228,847	373,312,363	424,975,295	431,349,924	437,820,173
Robe I usluge	117,112,354	132,538,342	137,200,000	140,000,000	144,000,000
Komunalne potrosnje	13,810,287	15,807,292	17,000,000	18,500,000	19,000,000
Subvencije I transferi	29,729,841	35,306,640	40,485,825	42,000,000	45,000,000
Kapitalne investicije	183,796,096	231,214,833	247,987,295	275,473,638	304,814,324
Rezerva		115,249			
Izvori finansiranja	**724,677,425**	**788,294,719**	**867,648,415**	**907,323,563**	**950,634,497**
Grantovi vlade	617,153,848	670,794,719	740,730,633	773,827,331	816,895,765
Sopstveni prihodi	105,523,577	115,000,000	123,517,783	132,196,232	132,688,732
Finansiranje od zaduzivanja - 04		250,000	3,400,000	1,300,000	1,050,000
Finansiranje iz Investicione Klauzole-06	2,000,000	2,250,000			

2.13. Vremenski kalendar za opštinski nivo

Budžetske organizacije na lokalnom nivou moraju se pridržavati ovog vremenskog kalendara u pripremi predloga budžeta:

- 30 jun: Usvajanje srednjoročnog opštinskog budžetskog okvira,
- 30. septembar: usvajanje predloga opštinskog budžeta za 2026-2028. godinu od strane Skupštine opštine,
- 30. septembar: nakon usvajanja predloga budžeta od strane Skupštine opštine, opštine su dužne da Ministarstvu finansija, rada i transfera dostave sledeća dokumenta:
  - Propratno pismo na osnovu usvajanja predloga budžeta od strane Skupštine opštine (potpisano od strane predsednika opštine).
  - Odluka Skupštine opštine o usvajanju predloga budžeta opštine za 2026-2028. godinu, uključujući višegodišnje kapitalne projekte.
  - Tabele opštinskog budžeta (BDMS i PIP):
    - Tabela 4.1 - plan budžetske raspodele troškova za 2026-2028 godinu (štampani
    - primerak iz BDMS-a, pečat i potpisan od strane predsednika opštine i finansijskog direktora),
    - Tabela 4.1.B – plan budžetske raspodele troškova kroz klauzulu ulaganja i zaduživanja
    - Tabela 4.2 – finansiranje kapitalnih projekata za 2026. godinu i višegodišnji kapitalni za 2027-2028 godinu (iz sistema PIP-a, overeno i potpisano od strane Gradonacelnika Opstine i Glavni finansijski sluzbenik
    - Tabela 4.2.B - finansiranje kapitalnih projekata putem klauzule o ulaganju i Zaduživanju
    - Tabela 4.3- Srednjorocni plan i ukupni prihodi budzeta opstine iz Vladinih grantova i sopstvenih prihoda (iz sistema BDMS-ja, overeno i potpisano od strane gradonacelnika opstine i glavnog finansijskog sluzbenika)
    - Tabela budzeta za ucinak

Primer:

Aneks 1:

Rodno odgovorno budžetiranje

Tabela 1: Broj zaposlenih u relevantnoj budžetskoj organizaciji
Naziv institucije/ministarstva/opštine

Godina	Ukupan broj osoblja	Broj žena	Broj muškaraca	Plate i dnevnice za žene	Plate i dnevnice za muškarce
2025					
2026					
2027					
Plan za 2028					

Tabela 2. Planiranje za 2026 – Nivoi plata u budžetskoj organizaciji
Naziv institucije/ministarstva/opštine

Nivo plata	Ukupan broj zaposlenih na tom nivo	Broj muškaraca	Iznos potrošen za muškarce	Broj žena	Iznos potrošen za žene
201-400					
401-600					
600+					

Tabela 3: Broj korisnika subvencija ili usluga koje pruža budžetska organizacija
(Naziv institucije/ministarstva/opštine: Naziv usluge/subvencije).

Godina	Ukupan budžet za datu uslugu/subvenciju	Ukupan broj korisnika	Broj žena korisnica	Broj muškaraca korisnika	Budžet za žene	Budžet za muškarce
2025						
2026						
2027						
Plan za 2028						

Aneks 2:

INDIKATORI PERFORMANSI BUDŽETSKIH PROGRAMA

Tabela 5: Ključni indikatori performansi koji opisuju očekivane rezultate budžetske organizacije za period 2026–2028

Prioritet Vlade 1 – Smanjenje neformalne ekonomije za 20% u periodu 2026–2028 i unapređenje poslovnog okruženja						
Br.	**Naziv indikatora i jedinica mere**	**Izvori finansiranja**	**2025 (N) (očekivano)**	**2026 (N+1) (planirano)**	**2027 (N+2) (planirano)**	**2028 (N+3) (planirano)**
1	**2**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**
	2,750 inspekcija	**Vladin grant**	**600 inspekcija**	**650 inspekcija**	**700 inspekcija**	**800 inspekcija**
	1,200 Kampanja za podizanje svesti	**Vladin grant**	**300 kampanja**	**300 kampanja**	**300 kampanja**	**300 kampanja**
Rezultat: Povećanje uključenosti dece uzrasta 0–6 godina u rani predškolski obrazovni sistem za 30% u periodu 2026–2027						
Br.	**Naziv indikatora i jedinica mere**	**Izvori finansiranja**	**2025 (N) (očekivano)**	**2026 (N+1) (planirano)**	**2027 (N+2) (planirano)**	**2028 (N+3) (planiorano)**
1	**2**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**
	30 vrtića za decu predškolskog uzrasta	**Vladini grantovi**	**6 vrtića za decu predškolskog uzrasta**	**7 vrtića za decu predškolskog uzrasta**	**8 vrtića za decu predškolskog uzrasta**	**9 vrtića za decu predškolskog uzrasta**
	8 vrtića za decu predškolskog uzrasta	**IPA/EU**	**2 vrtića za decu predškolskog uzrasta**	**2 vrtića za decu predškolskog uzrasta**	**2 vrtića za decu predškolskog uzrasta**	**2 vrtića za decu predškolskog uzrastav**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Komuna e Istogut
Opshtina Istok
Municipality of Istog

00 Numër: /2025
Data: 2025

http://kk.rks-gov.net/istog/

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË ADMINISTRATËN KOMUNALE

MAJ 2025

Në mbështetje të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2, pika c) dhe nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 33 paragrafi 33.1 pika 1 e Statutit të Komunës 01-Nr.62/10 datë 30.11.2010, nenit 2 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura si dhe Rregullores (QRK) numër nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Kuvendi i Komunës në seancën e mbajtur më datë 00.05.2025, miraton këtë:

RREGULLORE NR. XX/2025 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË ADMINISTRATËN KOMUNALE

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohet organizimi i brendshëm, përgjegjësit e njësive organizative si dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale, përfshirë administratën e shërbimit publik.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet në administratën komunale, përfshirë administratën e shërbimit publik në Komunën e Istogut.

Neni 3
Përkufizimet

Për qëllim të kësaj Rregulloreje , termat dhe shprehjet e përdorura kanë kuptimin e përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin për Zyrtarët Publik, Rregulloren

Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura si dhe Rregulloren Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Neni 4
Përgjegjësitë e administratës komunale

Përgjegjësitë, kompetencat vetanake dhe të deleguara të administratës komunale janë të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, legjislacionin e veçantë sektorial si dhe me këtë Rregullore.

Neni 5
Misioni i administratës komunale

Misioni i administratës komunale është menaxhimi efikas i shërbimeve publike dhe burimeve, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës së banorëve. Kjo përfshin zhvillimin e infrastrukturës, sigurinë publike, arsimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale dhe planifikimin urban si dhe promovimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes dhe ruajtjen e trashëgimisë lokale, duke u përqendruar në nevojat specifike të komunitetit të Komunës.

KAPITULLI II
ORGANIZIMI I BRENDSHËM

Neni 6
Struktura organizative e administratës komunale

1. Administrata komunale drejtohet nga Kryetari i Komunës dhe përbëhet nga strukturat si në vijim:

1.1 Kabineti i Kryetarit;

1.2 Drejtoritë, dhe

1.3 Sektorët *(njësitë apo zyrat*).

2. Njësia apo zyra si në paragrafin 1.3 të këtij neni, sa i përket organizimit dhe klasifikimit janë ekuivalente dhe kanë nivel të njëjtë hierarkik me sektorët.

3. Si rregull, i gjithë stafi i administratës komunale, varësisht nga detyrat dhe përgjegjësit, në mënyrë hierarkike duhet të jetë i sistemuar në njërën nga strukturat e administratës komunale.

4. Përjashtimisht nga paragrafi 3 i këtij neni, nëpunësi civil që ushtron funksionin e zyrtarit certifikues, dhe nëpunësi që kryen në mënyrë individuale njërin prej funksioneve të brendshme mbështetëse, ose funksioneve tjera, kur nuk janë plotësuar kushtet për formimin e një sektori, zyre apo njësie, do të veprojë jashtë strukturave organizative dhe do të mbikëqyret drejtpërdrejt nga Kryetari i Komunës.
5. Numri i të punësuarve në administratën komunale, është njëqindetetëdhjetë (180).

Neni 7
Kabineti i Kryetarit

1. Kabineti i Kryetarit përbëhet, si në vijim:

1.1 Kryetari i Komunës ;

1.2 Nënkryetari;

1.3 Shefi i Kabinetit të Kryetarit;

1.4 Personeli mbështetës.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryetarit përcaktohen me legjislacionin e vetëqeverisjes lokale, legjislacionin tjetër përkatës në fuqi, Statutin e Komunës dhe këtë Rregullore.

3. Pozitat tjera që i përgjigjen drejtpërdrejt Kryetarit të Komunës, janë:

3.1 Zyrtar i Lartë Certifikues;

3.2 Zyrtari i Lartë për Integrime Evropiane

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e pozitave nën varësi të Kryetarit përcaktohen sipas legjislacionit përkatës për zyrtarë publikë.

5. Numri i të punësuarve në Zyrën e Kryetarit, është 7 (Shtatë).

Neni 8
Drejtoritë dhe sektorët (*njësitë apo zyrat*)

1. Drejtoritë dhe sektorët *(njësitë apo zyrat)* e administratës komunale, janë:

1.1 Drejtoria për Administratë dhe Shërbime të Përbashkëta:

1.1.1 Sektori për Shërbime të Përbashkëta;

1.1.2 Sektori për Gjendje Civile;

1.1.3 Sektori për Shërbime për Qytetar;

1.1.4 Sektori për Teknologji Informative dhe Arkiv;

1.1.5 Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.

1.2 Drejtoria për Buxhet dhe Financa:

1.2.1 Sektori për Buxhet;

1.2.2 Sektori për Financa;

1.2.3 Sektori për Tatimin në Pronë.

1.3 Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm:

1.3.1 Sektori për Zhvillim Ekonomik;

1.3.2 Sektori për Zhvillim të Turizmit.

1.4 Drejtoria për Arsim:

1.4.1 Sektori për Arsim Parashkollor dhe Fillor;

1.4.2 Sektori për Arsim të Mesëm të Ulët dhe të Lartë.

1.5 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport:

1.5.1 Sektori për Kulturë;

1.5.2 Sektori për Rini dhe Sport.

1.6 Drejtoria për Shëndetësi:

1.6.1 Sektori për Shëndetësi.

1.7 Drejtoria për Mirëqenie Sociale:

1.7.1 Sektori për Mirëqenie Sociale;

1.7.2 Sektori për Shërbime Sociale;

1.7.3 Sektori për Ndihmë Sociale.

1.8 Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis:

1.8.1 Sektori për Planifikim dhe Zhvillim Urban;

1.8.2 Sektori për Mbrojtje të Mjedisit.

1.9 Drejtoria për Shërbimeve Publike:

1.9.1 Sektori për Shërbime Publike;
1.9.2 Sektori për Menaxhim të Mbeturinave.

1.10 Drejtoria për Emergjenca, Mbrojtje dhe Shpëtim:

1.10.1 Sektori për Siguri dhe Emergjenca.

1.11 Drejtoria për Bujqësi, dhe Zhvillim Rural:

1.11.1 Sektori për Bujqësi, dhe Zhvillim Rural.

1.12 Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Prona:

1.12.1 Sektori për Kadastër dhe Gjeodezi;

1.12.2 Sektori për Prona të Paluajtshme.

1.13 Drejtoria për Inspektime:

1.13.1 Sektori për Inspektime të Ndërtimit;

1.13.2 Sektori për Inspektime të Shërbimeve Publike dhe Tregut.

1.14 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;

1.15 Zyra për Komunikim me Publikun;

1.16 Sektori për cështje Ligjor;

1.17 Zyra për Komunitete dhe Kthim;

1.18 Sektori për Prokurim Publik;

1.19 Njësia për Auditim të Brendshëm;

Neni 9
Drejtoria për Administratë dhe Shërbime të Përbashkëta

1. Misioni i Drejtorisë për Administratë dhe Shërbime të Përbashkëta është menaxhimi dhe koordinimi çështjet administrative dhe operacionale në mënyrë efikase dhe efektive duke ofruar mbështetje dhe shërbime për administratën komunale dhe qytetarët, në mënyrë që të sigurojë ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme dhe cilësore për komunitetin.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Administratë dhe Shërbime të Përbashkëta, janë:

2.1 Ofrimi i shërbimeve mbështetëse administrative dhe logjistike për kabinetin e kryetarit, kuvendin komunal, drejtoritë e administratës komunale, dhe trupat tjerë të komunës;

2.2 Sigurimi i zbatimit të legjislacionit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut të grupeve të ndjeshme, duke përfshirë fëmijët, personat me aftësi të kufizuara si dhe mbrojtjen dhe promovimin e barazisë gjinore në nivelin komunal;

2.3 Mbështetja në formulimin dhe zbatimin e procedurave komunale dhe bashkëpunimi me drejtoritë për përmirësimin e tyre;

2.4 Menaxhimi i të dhënave, dokumenteve dhe arkivave të komunës, korrespondencës zyrtare, dokumenteve dhe të dhënave të tjera të rëndësishme administrative;

2.5 Mbikëqyrja e mirëmbajtjes, riparimit dhe shfrytëzimit të objekteve, dhe aseteve komunale, përfshirë sigurimin që objektet dhe asetet komunale të mirëmbahen sipas procedurave të përcaktuara;

2.6 Ofrimi dhe menaxhimi i infrastrukturës dhe shërbimeve të teknologjisë informative për komunën përfshirë mirëmbajtjen e sistemeve kompjuterike, rrjeteve, aplikacioneve softuerike dhe masave të sigurisë kibernetike;

2.7 Bashkëpunimi me banorët, organizatat e komunitetit dhe palët e interesuara për të mbledhur të dhëna lidhur me shërbimet dhe për të adresuar shqetësimet e tyre;

2.8 Ofrimin e shërbimeve të gjendjes civile si regjistrimin e lindjeve, martesave dhe vdekjeve, lëshimin e certifikatave të statusit civil si dhe shpërndarjen e dokumenteve personale të qytetareve;

2.9 Sigurimi i zbatimit të procedurave për menaxhim e automjetet, mirëmbajtjen dhe servisimin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

2.10 Ofrimi i të gjitha formave të shërbimeve dhe të ndihmës juridike për qytetarët, përfshirë regjistrimin e kërkesave dhe parashtresave të tyre dhe raportimi për kryerjen e lëndëve administrative në përputhje me afatet ligjore;

2.11 Zhvillimi dhe mirëmbajta e ueb faqes së internetit të komunës, si dhe aplikacioneve për qytetarët që të kenë qasje në shërbime dhe të marrin informacion e duhur.

3. Drejtoria për Administratë dhe Shërbime të Përbashkëta udhëhiqet nga Drejtori, i cili raporton Kryetarit të Komunës.

4. Në kuadër të kësaj Drejtorie, bëjnë pjesë:

4.1 Sektori për Shërbime të Përbashkëta;
4.2 Sektori për Gjendje Civile;

4.3 Sektori për Shërbime për Qytetar;

4.4 Sektori për Teknologji Informative dhe Arkiv;

4.5 Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.

5. Numri i të punësuarve në Drejtorinë Administratë dhe Shërbime të Përbashkëta, është dyzetedy (42).

Neni 10
Sektori për Shërbime të Përbashkëta

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Shërbime të Përbashkëta, janë:

1.1 Ofrimi i shërbimeve mbështetëse administrative dhe logjistike për kabinetin e kryetarit, kuvendin komunal, drejtoritë e administratës komunale, dhe trupave tjerë të komunës;

1.2 Mbështetja në formulimin dhe zbatimin e procedurave komunale dhe bashkëpunimi me drejtoritë për përmirësimin e tyre;

1.3 Mbështetja në organizimi e mbledhjeve të kuvendit komunal dhe takimeve të komiteteve dhe komisioneve duke njoftuar pjesëmarrësit dhe dërgimin e materialeve si dhe siguruar logjistikën e nevojshme për mbajtjen e tyre;

1.4 Përgatitja e materiale të detajuara për çështjet që diskutohen në mbledhjet e kuvendit komunal, duke siguruar që anëtarët e Kuvendit kanë informacionin e nevojshëm për të marrë vendime të informuara;

1.5 Sigurimi i shpërndarjes me kohë dhe në mënyrë të plotë të draft-rregulloreve komunale, vendimeve dhe materialeve të tjera përkatëse te secili anëtar i Kuvendit Komunal;

1.6 Menaxhimi i të dhënave, dokumenteve dhe korrespondencës zyrtare, dokumenteve dhe të dhënave të tjera të rëndësishme administrative;

1.7 Sigurimi i zbatimit të procedurave për menaxhim e automjetet, mirëmbajtjen dhe servisimin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

1.8 Menaxhimi i depos dhe furnizimi me materiale, inventar dhe sigurimi i pajisjeve të nevojshme për administratën komunale si dhe mbikëqyrja e stokut;

1.9 Mbikëqyrja e mirëmbajtjes, riparimit dhe shfrytëzimit të objekteve, dhe aseteve komunale, përfshirë sigurimin që objektet dhe asetet komunale të mirëmbahen sipas procedurave të përcaktuara.

2. Sektori për Shërbime të Përbashkëta udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Administratë dhe Shërbime të Përbashkëta .

3. Numri i të punësuarve në Sektorin për Shërbime të Përbashkëta, është tetëmbëdhjetë (18).

Neni 11
Sektori për Gjendje Civile

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Gjendje Civile, janë:

1.1 Regjistrimi dhe dokumentimi i saktë i ngjarjeve të gjendjes civile, të lindjes, martesës dhe vdekjes në regjistrat e tyre përkatës dhe mbajtja e duhur e këtyre të dhënave;

1.2 Ofrimi i shërbimeve të kërkuara për qytetarët për marrjen e certifikatave për lindjen, vdekjen dhe martesën si dhe informimi i publikut për rëndësinë e regjistrimit të saktë të ngjarjeve të gjendjes civile;

1.3 Lëshimi i vërtetimeve të ndryshme për statusin martesor, që personi është në jetë dhe gjendjen familjare si dhe vërtetimeve tjera sipas kërkesave të palëve;

1.4 Hartimi dhe ndihma në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm kur kërkohen dëshmitarë për regjistrime të ndryshme të gjendjes civile;

1.5 Mirëmbajtja dhe ruajtja e regjistrave dhe librave që përmbajnë të dhënat e gjendjes civile duke siguruar që informacionet personale të ndjeshme nga të dhënat e gjendjes civile të mbahen konfidenciale;

1.6 Verifikimi dhe vërtetimi i dokumenteve dhe informacioneve të paraqitura për ngjarjet e gjendjes civile dhe sigurimi që të gjitha aktivitetet e statusit civil t'u përmbahen ligjeve, rregulloreve dhe standardeve etike përkatëse;

1.7 Përditësimi i të dhënave ekzistuese për të pasqyruar ndryshimet në gjendjen civile, si ndryshimet e emrit, birësimet, ndryshimet gjinore dhe divorcet, ndër të tjera;

1.8 Bashkëpunimi me Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe institucionet tjera për të siguruar të dhëna të sakta dhe të qëndrueshme në sisteme të ndryshme administrative.

2. Sektori për gjendjen civile udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Administratë dhe Shërbime të Përbashkëta.

3. Numri i të punësuarve në Sektorin për Gjendje Civile, është nëntë (9).

Neni 12
Sektori për Shërbime për Qytetar

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Shërbime për Qytetar, janë:

1.1 Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet qeverisë komunale dhe vendbanimeve, përfshirë organizimin e takimeve, dëgjimit të shqetësimeve dhe sugjerimeve të qytetarëve;

1.2 Përfaqësimin e interesave të vendbanimeve në organet qeverisëse të komunës, duke u siguruar që zëri i tyre të dëgjohet në vendimmarrje;

1.3 Mbështetja e qytetareve në marrjen e shërbimeve të ndryshme që ofrohen nga administrata komunale dhe informimi për procedurat administrative për marrjen e këtyre shërbimeve;

1.4 Organizimi dhe menaxhimi i projekteve dhe aktiviteteve që kanë për qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës në vendbanime;

1.5 Nxitja dhe mbështetja e iniciativave dhe projekteve të zhvilluara nga vendbanimeve për të përmirësuar kushtet e tyre të jetesës dhe të punës;

1.6 Sigurimi që qytetarët janë të informuar rreth aktiviteteve, shërbimeve dhe vendimeve të komunës, përmes kanaleve të ndryshme komunikimi;

1.7 Pranimi dhe trajtimi i ankesave dhe sugjerimeve nga qytetarët për të përmirësuar shërbimet dhe funksionimin e qeverisjes lokale;

1.8 Inkurajimi i qytetarëve të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse, përmes konsultimeve publike dhe platformave të ndryshme si dhe pjesëmarrjen në takime të kuvendit komunal.

2. Sektori për Shërbime për Qytetar, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Administratë Shërbime të Përbashkëta.

3. Numri i të punësuarve në Sektorin për Shërbime për Qytetar, është gjashtë (6).

Neni 13
Sektori për Teknologji Informative dhe Arkiv

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Teknologji Informative dhe Arkiv, janë:

1.1 Mirëmbajta dhe menaxhimi i infrastrukturës së teknologjisë informative në komunë, përfshirë rrjetet, serverët, kompjuterët dhe komponentët e tjerë harduerikë si dhe ofrimi i mbështetje për punonjësit dhe zyrtarët komunalë;

1.2 Menaxhimi i sistemeve dhe shërbimeve të komunikimit brenda komunës, duke përfshirë telefonat, video-konferencat dhe lidhjen në internet duke përfshirë telefonat VOIP dhe të gjitha pajisjet e Teknologjisë Informative;

1.3 Administrimi i ueb faqes zyrtare të komunës, si dhe administrimi dhe menaxhimi i aplikacioneve zyrtare që ofrojnë shërbime për zyrtarë dhe qytetarë;

1.4 Menaxhimi dhe ruajtja e dokumenteve zyrtare, të cilat përfshijnë regjistrat, vendimet, korrespondencat zyrtare dhe dokumente të tjera të rëndësishme të qytetit si dhe lehtësimi në qasjen e tyre;

1.5 Ofrimi i ndihmës dhe mbështetjes për stafin Komunal në përdorimin e Sistemeve të Informacionit dhe Komunikimit me rëndësi shtetërore për nivelin lokal;

1.6 Sigurimi që të gjitha dokumentet e rëndësishme arkivohen në mënyrë sistematike dhe të qasshme, duke përdorur metodat e duhura të arkivimit si digjitalizimi, kategorizimi dhe etiketimi;

1.7 Mbrojtja e dokumenteve nga dëmtimi, humbja apo keqpërdorimi, duke përfshirë masat e sigurisë fizike dhe kibernetike për të ruajtur integritetin dhe privatësinë e informacioneve;

1.8 Ofrimi i qasjes publike në dokumente, në përputhje me ligjet dhe rregulloret, përfshirë përgjigjen ndaj kërkesave për informacion dhe sigurimin që dokumentet janë të lehta për t'u gjetur dhe përdorur;

1.9 Kujdesi dhe restaurimi i dokumenteve të vjetra apo të dëmtuara, duke përdorur teknika profesionale për të siguruar që ato të ruhen për breza të ardhshëm;

1.10 Ofrimi i ndihmës dhe këshillimit teknik për drejtorit e komunës lidhur me menaxhimin e dokumenteve dhe çështje të arkivimit;

1.11 Përditësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i proceseve dhe sistemeve të teknologjisë informative, duke përdorur teknologji të reja për të përmirësuar efikasitetin e shërbimeve komunale për qytetarë.

2. Sektori për Teknologji Informative dhe Arkiv, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Administratë dhe Shërbime të Përbashkëta .

3. Numri i të punësuarve në Sektorin për Teknologji Informative dhe Arkiv, është pesë (5).

Neni 14
Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore , janë:

1.1 Monitorimi i respektimit të të drejtave të njeriut në komunë dhe promovimi i ndërgjegjësimit për këto të drejta, duke përfshirë identifikimin dhe trajtimin e çështjeve të diskriminimit dhe mbështetjen e barazisë gjinore;

1.2 Mbështetja në mbrojtjen e të drejtave të grupimeve të ndjeshme, duke përfshirë fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe promovimin e barazisë gjinore në nivelin komunal;

1.3 Këshillimi dhe ndihma ligjore për individët që përballen me shkelje të të drejtave të tyre, duke mbështetur veçanërisht rastet e diskriminimit dhe abuzimeve;

1.4 Sigurimi i zbatimit të politikave dhe rregulloreve që promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut, dhe ofrimi i kontributit në përmirësimin e politikave në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare;

1.5 Bashkëpunimi me OJQ-të, grupet e komunitetit, agjencitë qeveritare dhe aktorët e tjerë për të adresuar çështjet e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore;

1.6 Pjesëmarrja në hartimin dhe shqyrtimin e akteve normative të komunës, duke siguruar që ato janë në përputhje me parimet e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore;

1.7 Organizimi i trajnimeve që kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe aftësive për avancimin e barazisë gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në komunë;

1.8 Përgatitja e raporteve periodike mbi gjendjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut në komunë, duke përfshirë vlerësimin e progresit dhe sfidave të hasura.

2. Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Administratë dhe Shërbime të Përbashkëta .

3. Numri i të punësuarve në Sektorin për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, është tre (3).

Neni 15
Drejtoria për Buxhet dhe Financa

1. Misioni i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa është planifikimi dhe ekzekutimi në mënyrë efektive i buxhetit të komunës, menaxhimi i të hyrave dhe tatimit në pronë, në përputhje të plotë me legjislacionin aktual, procedurat e vendosura dhe standardet e njohura si dhe mbajtja e të dhënave të sakta dhe transparente të kontabilitetit financiar, duke siguruar menaxhimin e përgjegjshëm të burimeve financiare të komunës.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa janë:

2.1 Planifikimi dhe përgatitja e buxhetit përfshirë përgatitjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) , duke pasqyruar në mënyrë të drejtë kërkesat dhe në përputhje me dokumentet planifikuese;

2.2 Menaxhimi i shpenzimit të buxhetit dhe rregullimi i ndarjeve buxhetore në përputhje me legjislacionin mbi menaxhimin e financave publike;

2.3 Përgatitja e planit rrjedhjes të parasë në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e përcaktuara si dhe sigurimi që zotimet dhe shpenzimet janë bërë në përputhje me rregullat financiare;

2.4 Përgatitja e pasqyrave financiare së bashku me njësitë buxhetore në kuadër të administratës komunale dhe sigurimi i kontrollit të brendshëm financiar bazuar në parimet e llogaridhënies;

2.5 Evidentimi, menaxhimi, barazimi dhe raportimi i të gjitha të hyrave financiare të komunës, përfshirë tatimin në pronë;

2.6 Regjistrimi i kërkesave buxhetore në sistemin e BDMS-së dhe PIP sipas planifikimeve të njësive buxhetore dhe sigurimi i mbajtjes së kontabilitetit sipas standardeve;

2.7 Përgatitja e vlerësimit të ndikimit buxhetor për projektet komunale, projekt aktet, dhe projekt dokumentet strategjike nga fushëveprimi i komunës;

2.8 Analizimi dhe vlerësimi i propozimeve buxhetore, duke shqyrtuar korrektësinë, saktësinë dhe tërësinë e tyre, dhe rekomandimi i ndryshimeve të përshtatshme në buxhet, kur është e nevojshme;

2.9 Ndarja apo zotimi i mjeteve nga kategoria e caktuar për realizimin e pagesave për projekte/aktivitete të parapara në buxhet te komunës;

2.10 Përgatitja e raporteve periodike dhe sipas kërkesë për shpenzimet buxhetore, bazuar në ligjin përkatës për menaxhimin e financave publike dhe legjislacionin tjetër në fuqi;

2.11 Regjistrimi i pasurisë së komunës në sistemet financiare, përfshirë regjistrimin e të gjitha ndryshimeve në gjendjen e pasurisë dhe menaxhimi i pasurisë në mënyrë të duhur.

3. Drejtoria për Buxhet dhe Financa udhëhiqet nga Drejtori i cili i raporton Kryetarit të Komunës.

4. Në kuadër të kësaj Drejtorie, bëjnë pjesë:

4.1 Sektori për Buxhet;

4.2 Sektori për Financa;

4.3 Sektori për Tatimin në Pronë.

5. Numri i të punësuarve në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa është njëzet (20).

Neni 16
Sektori për Buxhet

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Buxhet, janë:

1.1 Planifikimi i buxhetit të komunës në koordinim me njësitë përkatëse në kuadër të administratës komunale;

1.2 Përgatitja e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), në harmoni me kërkesat e paraqitura nga njësitë buxhetore që veprojnë në kuadër të administratës komunale;

1.3 Krijimi i programeve/nën-programeve në bazë të kërkesave të njësive buxhetore në bashkëpunim me Departamentin e Buxhetit (Ministria e Financave);

1.4 Bashkërendimi me drejtoritë komunale, ministrinë e financave dhe institucionet tjera lidhur me buxhetin komunës;

1.5 Analizimi dhe vlerësimi i propozimeve buxhetore, duke shqyrtuar korrektësinë, saktësinë dhe tërësinë e tyre, dhe rekomandimi i ndryshimeve të përshtatshme në buxhet, kur është e nevojshme;

1.6 Mbështetja e njësive buxhetore në zbatimin e buxhetit gjatë vitit fiskal, përmes propozimit të masave për përmirësim dhe përgatitjes së raporteve periodike për realizimin e buxhetit;

1.7 Sigurimi i bashkëpunimit dhe koordinimit të duhur me auditorët e brendshëm dhe të jashtëm gjatë kryerjes së auditimeve financiare dhe buxhetore;

1.8 Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të buxhetit, duke identifikuar devijimet nga planet fillestare dhe duke propozuar masa korrigjuese për të siguruar përmbushjen e objektivave buxhetore.

2. Sektori për Buxhet, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa .

3. Numri i të punësuarve në Sektorin për Buxhet, është gjashtë (6).

Neni 17
Sektori për Financa

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Financa, janë:

1.1 Realizimi i shpenzimit të buxhetit në përputhje me planifikimet dhe në pajtim me rregullat e përcaktuar me legjislacionin e financave publike;

1.2 Përgatitja e planit rrjedhjes të parasë në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e përcaktuara si dhe sigurimi që zotimet dhe shpenzimet janë bërë në përputhje me rregullat financiare;

1.3 Përgatitja e pasqyrave financiare së bashku me njësitë buxhetore në kuadër të administratës komunale dhe sigurimi i kontrollit të brendshëm financiar bazuar në parimet e llogaridhënies;

1.4 Krijimi sistemi për monitorimin e shpenzimeve nga inicimi deri te pagesa e faturave, duke koordinuar kalimin e urdhrave dhe dokumenteve ndërmjet zyrtarit autorizues, prokurimit, certifikimit dhe Departamentit të Thesarit;

1.5 Përgatitja e vlerësimit të ndikimit buxhetor për projektet komunale, projekt aktet, dhe projekt dokumentet strategjike nga fushëveprimi i komunës;

1.6 Ndarja apo zotimi i mjeteve nga kategoria e caktuar për realizimin e pagesave për projekte/aktivitete të parapara në buxhet te komunës;

1.7 Menaxhimi i lidhshmërisë së mjeteve të alokuara, atyre të shpenzuara dhe të zotuara gjatë vitit fiskal;

1.8 Menaxhimi i sistemit të kontrollit të brendshëm financiar për të siguruar që buxheti i komunës shfrytëzohet në përputhje me objektivat dhe projektet e miratuara;

1.9 Përgatitja e analizave financiare si dhe raporteve periodike dhe sipas kërkesës mbi shpenzimin e buxhetit;

1.10 Regjistrimi i pasurisë së komunës në sistemet financiare, përfshirë regjistrimin e të gjitha ndryshimeve në gjendjen e pasurisë dhe menaxhimi i pasurisë në mënyrë të duhur.

4. Sektori për Financa, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili njëkohësisht ushtron funksionet dhe përgjegjësitë e Zyrtarit Kryesor Financiar të përcaktuara me ligjin përkatës për menaxhimin e financave publike, dhe i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

5. Numri i të punësuarve në Sektorin për Financa, është tetë (8).

Neni 18
Sektori për Tatimin në Pronë

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Tatimin në Pronë, janë:

1.1 Menaxhimi dhe administrimi i tatimit në pronë në mënyre efektive si dhe mbështetja në formulimin dhe rishikimin e politikave dhe rregulloreve komunale lidhur me tatimin në pronë;

1.2 Asistimi i vlerësimit të pronave përfshirë përcaktimin e vlerës së tregut të tokës, ndërtesave dhe strukturave të tjera me qëllim që taksat , tatimet të vendosen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë;

1.3 Klasifikimi i pronave duke i kategorizuar në klasa të ndryshme në bazë të përdorimit të tyre (si banesore, tregtare, industriale, etj.) dhe vendosja e normave të tatimit në pronë bazuar në vlerat e vlerësuara të pronës;

1.4 Sigurimi i zbatimit të standardeve të unifikuara të vlerësimit dhe administrimit të tatimit në pronë dhe monitoron zbatimin e tyre;

1.5 Ofrimi i këshillave, sugjerimeve dhe rekomandime për qytetaret dhe bizneset lidhur me procedurat dhe proceset e tatimit në pronë;

1.6 Koordinimi me Departamentin e tatimit në pronë të Ministrisë së Financave lidhur me procedurat dhe standardet për caktimin dhe mbledhjen e tatimit në pronë;

1.7 Zhvillimi dhe sigurimi i zbatimit të sistemit për menaxhimin e administrimit të tatimit në pronë dhe vlerësimit të pronës sipas kritereve dhe standardeve të caktuara me legjislacionin në fuqi.

2. Sektori për Tatimin në Pronë, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa .

3. Numri i të punësuarve në Sektorin për Tatimin në Pronë, është pesë (5).

Neni 19
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm

1. Misioni i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm është të nxisë rritjen ekonomike dhe të promovojë turizmin nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës, mbështetjes së bizneseve, përmirësimit të shërbimeve si dhe ndërtimit dhe ruajtjes së marrëdhënieve me bizneset, investitorët dhe partnerët e tjerë, duke synuar krijimin e një mjedisi të favorshëm për rritjen ekonomike dhe punësim.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm , janë:

2.1 Promovimi dhe stimulimi i rritjes ekonomike dhe turizmit brenda komunës përmes hartimit dhe zbatimit të politikave, strategjive dhe iniciativave për të tërhequr biznese të reja dhe krijuar mjedis të favorshëm për investime, dhe për të krijuar mundësi punësimi;

2.2 Mbështetja e bizneseve të vogla dhe të mesme lokale duke siguruar burime financiare (grante, kredi dhe burime të tjera financimi) për mbështetje dhe trajnime për të ndihmuar bizneset e vogla të zhvillohen dhe të kontribuojnë në ekonominë dhe turizmin lokal;

2.3 Bashkëpunimi me drejtoritë tjera komunale dhe institucionet përkatëse për të siguruar që infrastruktura e nevojshme (transporti, shërbimet komunale, etj.) është në disponim për të mbështetur zhvillimin ekonomik, rritjen e biznesit dhe promovimin e turizmit;

2.4 Bashkëpunimi me institucionet arsimore dhe qendrat e trajnimit për të siguruar që fuqia punëtore lokale të ketë aftësitë e nevojshme për bizneset përfshirë krijimin e programeve të trajnimit, praktikave dhe shërbimeve të punësimit;

2.5 Zhvillimi dhe promovimi i turizmit, organizimi i ngjarjeve dhe rritjen e atraksioneve lokale për të nxitur ekonominë përmes shpenzimeve të vizitorëve;

2.6 Mbledhja dhe analizimi i të dhënave ekonomike për të marrë vendime adekuate, për të ndjekur progresin dhe për të identifikuar fushat për përmirësim si dhe avokimi për politika që mbështesin rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës dhe investimet;

2.7 Regjistrimi i bizneseve të reja që operojnë brenda komunës si dhe lehtësimi i partneriteteve ndërmjet sektorit publik dhe privat për të punuar në bashkëpunim në projekte dhe iniciativa të zhvillimit ekonomik;

2.8 Krijimi i lidhjeve me organizatat rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare për të tërhequr investime, për të shkëmbyer praktikat më të mira dhe për të mësuar nga modelet e tjera të suksesshme të zhvillimit ekonomik;

2.9 Inkurajimi dhe mbështetja e investimeve në infrastrukturën dhe atraksionet turistike, për të përmirësuar shërbimet dhe ofertat turistike, përfshirë ruajtjen dhe

menaxhimin e burimeve natyrore dhe kulturore, duke siguruar një zhvillim turistik të qëndrueshëm.

3. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm udhëhiqet nga Drejtori i cili i raporton Kryetarit të Komunës.

4. Në kuadër të kësaj Drejtorie, bëjnë pjesë:

4.1 Sektori për Zhvillim Ekonomik;

4.2 Sektori për Zhvillim të Turizmit.

5. Numri i të punësuarve në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm tetë (8).

Neni 20
Sektori për Zhvillim Ekonomik

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Zhvillim Ekonomi, janë:

1.1 Promovimi dhe stimulimi i rritjes ekonomike brenda komunës përmes hartimit dhe zbatimit të politikave, strategjive dhe iniciativave që kontribuojnë në ekonominë lokale;

1.2 Bashkëpunimi me drejtoritë tjera komunale dhe institucionet përkatëse për të siguruar që infrastruktura e nevojshme (transporti, shërbimet komunale, etj.) është në disponim për të mbështetur zhvillimin ekonomik;

1.3 Bashkëpunimi me institucionet arsimore dhe qendrat e trajnimit për të siguruar që fuqia punëtore lokale të ketë aftësitë e nevojshme për bizneset përfshirë krijimin e programeve të trajnimit, praktikave dhe shërbimeve të punësimit.

1.4 Regjistrimi i bizneseve të reja që operojnë brenda komunës si dhe lehtësimi i partneriteteve ndërmjet sektorit publik dhe privat për të punuar në bashkëpunim në projekte dhe iniciativa të zhvillimit ekonomik;

1.5 Mbledhja dhe analizimi i të dhënave ekonomike për të marrë vendime adekuate, për të ndjekur progresin dhe për të identifikuar fushat për përmirësim si dhe avokimi për politika që mbështesin rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës dhe investimet;

1.6 Lehtësimi i partneriteteve ndërmjet sektorit publik dhe privat për të punuar në bashkëpunim në projekte dhe iniciativa të zhvillimit ekonomik;

1.7 Krijimi i lidhjeve me organizatat rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare për të tërhequr investime, për të shkëmbyer praktikat më të mira dhe për të mësuar nga modelet e tjera të suksesshme të zhvillimit ekonomik;

1.8 Angazhimi me komunitetin lokal për të kuptuar nevojat dhe shqetësimet e tyre dhe përfshirja e tyre në procesin e zhvillimit ekonomik.

1. Sektori për Zhvillim Ekonomik, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm.

2. Numri i të punësuarve në Sektorin për Zhvillim Ekonomik, është katër (4).

Neni 21
Sektori për Zhvillim të Turizmit

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Zhvillim të Turizmit, janë:

1.1 Hartimi dhe zbatimi i strategjive dhe planeve për zhvillimin e turizmit në komunë, duke përfshirë identifikimin e mundësive të reja turistike;

1.2 Krijimi dhe menaxhimi i fushatave të marketingut dhe promovimit për të rritur ndërgjegjësimin dhe tërheqjen e turistëve, duke përdorur mjete si reklama, ueb faqe, rrjete sociale dhe ngjarje speciale;

1.3 Inkurajimi dhe mbështetja e bizneseve dhe projekteve që kontribuojnë në përmirësimin e infrastrukturës turistike, si rrugët, transporti, vendpushimet dhe atraksionet;

1.4 Organizimi dhe mbështetja e ngjarjeve kulturore, historike dhe turistike që rrisin vizibilitetin dhe tërheqjen e komunës si destinacion turistik;

1.5 Ndërtimi dhe ruajtja e marrëdhënieve me bizneset e turizmit, si hotelet, restorantet dhe operatorët e turizmit, për të promovuar një ofertë të gjithanshme turistike;

1.6 Sigurimi që atraksionet kulturore dhe natyrore janë të mbrojtura dhe të qasshme për turistët, duke ruajtur njëkohësisht qëndrueshmërinë dhe identitetin lokal dhe vlerat kulturore;

1.7 Planifikimi dhe mbështetja e aktiviteteve dhe ngjarjeve që tërheqin turistë, si festivale, panaire, dhe aktivitete kulturore dhe sportive;

1.8 Vlerësimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së nevojshme për turizmin, si rrugët, transportin publik, dhe shërbimet e tjera.

2. Sektori për Zhvillim të Turizmit, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm.

3. Numri i të punësuarve në Sektorin për Zhvillim të Turizmit, është tre (3).

Neni 22

Drejtori për Arsim

1. Misioni i Drejtorisë për Arsim është të ofrojë arsim cilësor për të gjithë banorët duke siguruar qasje të barabartë në arsim, krijimi i infrastrukturës së mjaftueshme arsimore, përfshirjen aktive të prindërve dhe komunitetit dhe mbështetjen e përkushtuar për nxënësit me nevoja të veçanta.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Arsim janë:

2.1 Sigurimi i zbatimit të legjislacionit, politikave dhe strategjive arsimore të gjitha niveleve para universitare ë përputhje me udhëzimet dhe standardet e përcaktuara nga Ministria e Arsimit;

2.2 Planifikimi afatshkurtër dhe afatgjatë për arsimin e të gjitha niveleve para universitare, duke marrë parasysh faktorët si rritja e popullsisë, trendët arsimore dhe zhvillimi i infrastrukturës;

2.3 Mbikëqyrja e zbatimit të Kornizës së Kurrikulumit të Kosovës dhe kurrikulumit bazë si dhe sigurimi që institucionet arsimore të zbatojnë kurrikulumin në përputhje me udhëzimet e Ministrisë;

2.4 Monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së arsimit në institucionet arsimore, duke siguruar që përmbushen standardet kombëtare të cilësisë dhe ofrohet arsimi gjithëpërfshirës dhe jo-diskriminues;

2.5 Planifikimi dhe mbikëqyrja e ndërtimit, mirëmbajtjes dhe renovimit të objekteve arsimore, duke siguruar që ambientet shkollore janë të sigurta dhe të përshtatshme për nxënësit dhe personelin, sipas udhëzimeve të Ministrisë;

2.6 Promovimi i pjesëmarrjen aktive të prindërve dhe komunitetit në procesin arsimor përmes këshillave të prindërve dhe institucioneve të tjera këshillimore;

2.7 Sigurimi që të gjithë nxënësit e moshës së shkollimit të detyruar janë të regjistruar dhe të ndjekin shkollimin, duke marrë masa për të parandaluar braktisjen e shkollës dhe për të siguruar disiplinën e nevojshme;

2.8 Sigurimi i përfshirjes së nxënësve nga grupet e ndjeshme, përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta arsimore dhe ata që janë pjesë e komuniteteve jo-shumicë, duke u siguruar që ata të kenë qasje të barabartë në arsimim;

2.9 Zhvillimi dhe zbatimi i programeve për mbështetje psikologjike dhe sociale, duke siguruar shërbime këshillimore për nxënësit dhe stafin, me fokus në përmirësimin e mirëqenies së tyre;

2.10 Në bashkëpunim me Ministrinë e arsimit, mbikëqyr trajnimin dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve, duke siguruar që ata të jenë të licencuar sipas kritereve të përcaktuara me ligj;

2.11 Sigurimi i transportit dhe shërbime mbështetëse për nxënësit që jetojnë larg shkollave, si dhe për ata me aftësi të kufizuara;

2.12 Bashkëpunimi me inspektorët e arsimit për të monitoruar respektimin e ligjit, rregullave dhe standardeve arsimore në institucionet arsimore brenda komunës, dhe ndërmerr masa për përmirësimin e cilësisë arsimore;

2.13 Sigurimi i pajisjes së shkollave me teknologji moderne dhe platforma digjitale, si dhe trajnimi i stafit për përdorimin e tyre, për të përmirësuar procesin mësimor

3. Drejtoria për Arsim udhëhiqet nga Drejtori i cili i raporton Kryetarit të Komunës.

4. Në kuadër të kësaj Drejtorie, bëjnë pjesë:

4.1 Sektori për Arsim Parashkollor dhe Fillor;

4.2 Sektori për Arsim të Mesëm të Ulët dhe të Lartë.

5. Numri i të punësuarve në Drejtorinë për Arsim, është shtatë (7)

Neni 23
Sektori për Arsim Parashkollor dhe Fillor

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Arsim Parashkollor dhe Fillor, janë:

1.1 Sigurimi i zbatimit të legjislacionit, politikave dhe strategjive për arsim parashkollor dhe fillor në përputhje me udhëzimet dhe standardet e përcaktuara nga ministria e arsimit;

1.2 Mbikëqyrja e zbatimit të Kornizës së Kurrikulumit të Kosovës, programeve dhe kurrikulumit bazë në përputhje me udhëzimet e ministrisë së arsimit;

1.3 Monitorimi dhe sigurimi i funksionimit të shkollave fillore dhe institucioneve parashkollore, çerdheve për fëmijë dhe sigurimi që të ketë hapësira dhe pajisje të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një mjedis të favorshëm mësimi dhe edukimi;

1.4 Menaxhimi i procesit të regjistrimit të nxënësve, fëmijëve në shkollat fillore dhe institucioneve parashkollore, duke siguruar qasjes të barabartë dhe duke marrë masa për të parandaluar braktisjen e shkollës;

1.5 Mbikëqyrja e menaxhimit të infrastrukturës së institucioneve parashkollore, duke përfshirë sigurinë, higjienën dhe pajisjen me materiale të përshtatshme edukative

1.6 Planifikimi afatshkurtër dhe afatgjatë për arsimin parashkollor dhe fillor, duke marrë parasysh faktorët si rritja e popullsisë, trendët arsimore dhe zhvillimi i infrastrukturës;

1.7 Organizimi i programeve të trajnimit, seminareve për zhvillim profesional dhe për të përmirësuar aftësitë e mësimdhënies, dhe edukimit të fëmijëve;

1.8 Monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së arsimit dhe edukimit në shkolla fillore dhe institucione parashkollore, dhe përgatitja e raporteve përkatëse për autoritetet komunale;

1.9 Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet shkollave, prindërve dhe komunitetit lokal për të përmirësuar cilësinë në arsim dhe për të mbështetur zhvillimin e nxënësve;

1.10 Mbledhja dhe analizimi i të dhënave mbi performancën e nxënësve dhe regjistrimin e tyre, pjesëmarrjen dhe efektivitetin e mësuesve, për të mbështetur vendimmarrjen dhe përmirësimin e procesit arsimor.

1.11 Sigurimi i përfshirjes dhe mbështetja e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin parashkollor dhe fillor, duke garantuar që ata të kenë qasje të barabartë në edukim;

4. Sektori për Arsim Parashkollor dhe Fillor, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Arsim.

5. Numri i të punësuarve në Sektorin për Arsim Parashkollor dhe Fillor është tre (3)

Neni 24
Sektori për Arsim të Mesëm të Ulët dhe të Lartë

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Arsim të Mesëm të Ulët dhe të Lartë, janë:

1.1 Sigurimi i zbatimit të legjislacionit, politikave dhe strategjive për arsim të mesëm të ulët dhe të lartë në përputhje me udhëzimet dhe standardet e përcaktuara nga Ministria e Arsimit;

1.2 Mbikëqyrja e zbatimit të Kornizës së Kurrikulumit të Kosovës, programeve dhe kurrikulumit bazë në përputhje me udhëzimet e ministrisë së arsimit;

1.3 Mbikëqyrja e menaxhimit të shkollave të mesme të ulëta dhe të larta dhe sigurimi që shkollat të kenë hapësira dhe pajisje të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një mjedis të favorshëm mësimi;

1.4 Menaxhimi i procesit të regjistrimit të nxënësve në shkollat e mesme të ulëta dhe të larta duke siguruar qasjes të barabartë në arsim dhe duke marrë masa për të parandaluar braktisjen e shkollës;

1.5 Planifikimi afatshkurtër dhe afatgjatë për arsim të mesëm të ulët dhe të lartë, duke marrë parasysh faktorët si rritja e popullsisë, trendët arsimore dhe zhvillimi i infrastrukturës;

1.6 Organizimi i programeve të trajnimit, seminareve për zhvillim profesional dhe për të përmirësuar aftësitë e mësimdhënies dhe për t'i mbajtur të përditësuar me metodologjitë më të fundit të mësimdhënies;

1.7 Monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së arsimit në shkolla të mesme të ulëta dhe të larta, si dhe kryerja e vlerësimeve dhe zbatimi i strategjive për përmirësimin e rezultateve;

1.8 Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet shkollave, prindërve dhe komunitetit lokal për të përmirësuar cilësinë në arsim dhe për të mbështetur zhvillimin e nxënësve;

1.9 Mbledhja dhe analizimi i të dhënave mbi performancën e nxënësve dhe regjistrimin e tyre, pjesëmarrjen dhe efektivitetin e mësuesve, për të mbështetur vendimmarrjen dhe përmirësimin e procesit arsimor;

1.10 Bashkëpunimi me institucionet tjera qeveritare, organizatat joqeveritare dhe palët e interesuara për të krijuar një mjedis arsimor gjithëpërfshirës dhe mbështetës.

2. Sektori për Arsim të Mesëm të Ulët dhe të Lartë, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Arsim.

3. Numri i të punësuarve në Sektorin për Arsim të Mesëm të Ulët dhe të Lartë është, tre (3)

Neni 25
Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport

1. Misioni i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport është të përmirësojë dhe pasurojë jetën e komunitetit duke promovuar kulturën lokale, duke angazhuar të rinjtë dhe duke mbështetur aktivitetet sportive, me synim që të bashkojë njerëzit përmes ngjarjeve kulturore, të fuqizojë të rinjtë përmes programeve dhe të inkurajojë stile jetese aktive përmes iniciativave sportive.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, janë:

2.1 Zhvillimi i politikave dhe strategjive për promovimin e kulturës, angazhimin e të rinjve dhe zhvillimin e sportit;

2.2 Zhvillimi dhe zbatimi i programeve, ngjarjeve dhe iniciativave kulturore për promovimin e arteve, trashëgimisë dhe traditave lokale si dhe mbështetja e artistëve, artizanëve dhe organizatave kulturore lokale;

2.3 Menaxhimi dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore, muzeve, galerive, objekteve sportive dhe vendeve historike;

2.4 Planifikimi dhe organizimi i ngjarjeve kulturore, rinore dhe sportive dhe lehtësimi i përfshirjes së komunitetit në aktivitete kulturore, rinore dhe sportive si dhe komunikimi i informacionit për ngjarjet për publikun;

2.5 Zhvillimi dhe zbatimi i programeve dhe iniciativave për angazhimin e të rinjve në aktivitete rekreative, sigurimi i platformave për pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje si dhe mbështetja e klubeve dhe organizatave rinore;

2.6 Administrimi i granteve dhe fondeve për të mbështetur iniciativat kulturore, rinore dhe sportive si dhe vlerësimi dhe përzgjedhja e projekteve që përputhen me qëllimet e komunës;

2.7 Hartimi i politikave dhe strategjive për zhvillimin afatgjatë të bibliotekës dhe arkivit të qytetit, duke siguruar që ato të jenë në përputhje me nevojat e komunitetit dhe standardet e përcaktuara;

2.8 Bashkëpunim me organizata kulturore lokale dhe kombëtare, institucione arsimore, shoqata sportive, shkollat dhe grupet e komunitetit si dhe organizimi i festivaleve kulturore, ekspozitave, koncerteve dhe ngjarjeve sportive;

2.9 Sigurimi që programet kulturore, rinore dhe sportive të jenë të qasshme dhe mikpritëse për të gjithë anëtarët e komunitetit, pavarësisht nga prejardhja e tyre.

3. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, udhëhiqet nga Drejtori i cili i raporton Kryetarit të Komunës.

4. Në kuadër të kësaj Drejtorie, bëjnë pjesë:

4.1 Sektori për Kulturë;

4.2 Sektori për Rini dhe Sport.

5. Numri i të punësuarve në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, është shtatë (7).

Neni 26
Sektori për Kulturë

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Kulturë, janë:

1.1 Zhvillimi dhe zbatimi i politikave dhe strategjive kulturore për të udhëhequr zhvillimin kulturor të komunës, duke përfshirë nxitjen e një mjedisi kulturor të larmishëm dhe gjithëpërfshirës;

1.2 Planifikimi, organizimi dhe promovimi i ngjarjeve të ndryshme kulturore, ekspozitave, festivaleve, koncerteve, shfaqjeve teatrale, punëtorive dhe aktiviteteve të tjera artistike dhe kulturore për të angazhuar dhe pasuruar komunitetin;

1.3 Identifikimi, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të komunës, vendeve historike, monumenteve dhe traditave;

1.4 Sigurimi i burimeve, granteve dhe platformave për artistët, artizanët, interpretuesit, shkrimtarët dhe krijuesit vendas për të shfaqur punën e tyre;

1.5 Bashkëpunimi me organizatat kulturore lokale, grupet e komunitetit, institucionet arsimore dhe aktorë të tjerë për të rritur iniciativat kulturore dhe për të siguruar një qasje të koordinuar ndaj zhvillimit kulturor;

1.6 Menaxhimi i objekteve kulturore si muzetë, galeritë, qendrat kulturore, teatrot dhe bibliotekat, përfshirë mirëmbajtjen dhe sigurimin që këto hapësira të jenë të qasshme për publikun;

1.7 Hulumtimi mbi historinë, traditat dhe praktikat kulturore lokale dhe dokumentimi i tyre për brezat e ardhshëm;

1.8 Planifikimi dhe organizimi i ekspozitave të ndryshme në galeri, duke përfshirë punën e artistëve lokalë, kombëtarë dhe ndërkombëtar si dhe mirëmbajtja dhe zhvillimin e koleksionit të artit të galerisë;

1.9 Promovimi i ekspozitave dhe ngjarjeve të galerisë nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit, duke përfshirë mediat sociale, ueb faqen e komunës dhe galerisë.

2. Sektori për Kulturë, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

3. Numri i të punësuarve në Sektorin për Kulturë, është tre (3).

Neni 27
Sektori për Rini dhe Sport

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Rini dhe Sport, janë:

1.1 Zhvillimi dhe zbatimi i programeve dhe aktiviteteve që promovojnë sportin dhe aktivitetet fizike për rinin që përfshijnë të gjitha grupmoshat dhe nivelet e aftësive;

1.2 Krijimi i mundësive për angazhimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse brenda komunës, përfshirë themelimin e këshillave rinore ose grupeve këshillimore për çështjet që prekin të rinjtë;

1.3 Promovimi dhe organizimi i ngjarjeve dhe aktiviteteve sportive dhe rekreative për të inkurajuar aftësinë fizike, konkurrencën e shëndetshme e të rinjve;

1.4 Zhvillimi dhe zbatimi i iniciativave që adresojnë nevojat sociale dhe emocionale të të rinjve, duke përfshirë shërbimet e këshillimit, mbështetjen për të rinjtë në rrezik dhe programe që promovojnë shëndetin dhe mirëqenien mendore;

1.5 Bashkëpunim me institucionet arsimore dhe institucionet tjera për të ofruar mundësi arsimimi plotësues dhe formimit profesional për të rinjtë si dhe për të adresuar çështjet sociale që prekin të rinjtë, si shëndeti mendor, abuzimi me substancat dhe të pastrehët;

1.6 Ofrimi i trajnimeve, punëtorive dhe seminareve që pajisin të rinjtë me aftësi të rëndësishme për zhvillimin personal, avancimin në karrierë si dhe inkurajimi i përfshirjes së të rinjve në projekte vullnetare;

1.7 Mbështetja e klubeve dhe organizatave sportive lokale përfshirë mbështetjen financiare, për të nxitur zhvillimin e tyre dhe pjesëmarrjen e gjerë në aktivitete sportive;

1.8 Organizimi dhe menaxhimi i ngjarjeve sportive, si turne, kampionate, dhe aktivitete rekreative që inkurajojnë pjesëmarrjen e komunitetit;

1.9 Sigurimi dhe mirëmbajtja e objekteve dhe infrastrukturës sportive, si stadiume, palestra, fusha sportive, dhe pishina, për të garantuar qasjen dhe sigurinë për përdoruesit;

1.10 Promovimi i aktiviteteve sportive për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien e banorëve, duke u drejtuar të gjitha grupmoshave dhe niveleve të aftësisë;

1.11 Zhvillimi dhe ofrimi i programeve sportive që synojnë të angazhojnë të rinjtë dhe të inkurajojnë zhvillimin e tyre fizik, social dhe emocional;

1.12 Identifikimi dhe mbështetja e talenteve sportive përmes programeve të trajnimit dhe zhvillimit, duke ofruar mundësi për rritjen dhe zhvillimin e sportistëve të rinj.

2. Sektori për Rini dhe Sport, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

3. Numri i të punësuarve në Sektorin për Rini dhe Sport, është tre (3).

Neni 28
Drejtoria për Shëndetësi

1. Misioni i Drejtorisë për Shëndetësi është planifikimin, zbatimin dhe mbikëqyrja e programeve dhe shërbimeve për shëndetin publik, kujdesin shëndetësor parësor të banorëve të komunës.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Shëndetësi, janë:

2.1 Zbatimi i politikave lidhur me shëndetin publik duke siguruar udhëzime për praktikat e kujdesit shëndetësor parësor, dhe strategjitë e promovimit të shëndetit;

2.2 Monitorimi dhe përmirësimi i shëndetit të përgjithshëm publik të banorëve të komunës si dhe menaxhimi i situatave shëndetësore dhe epidemiologjike në nivelin e komunës;

2.3 Sigurimi që infrastruktura shëndetësore dhe burimet njerëzore plotësojnë standardet e vendosura për ofrimin e shërbimeve shëndetësore; si dhe ndërmarrja e veprimeve për të siguruar zhvillimin profesional të punonjësve shëndetësorë;

2.4 Sigurimi i shëndetit të nënave dhe fëmijëve duke ofruar programe për shëndetin e nënës, fushata të imunizimit të fëmijëve dhe mbështetje për zhvillimin e fëmijërisë së hershme;

2.5 Promovimi i ndërgjegjësimit për shëndetin dhe edukimin e publikut për mënyrat e shëndetshme të jetesës, parandalimin e sëmundjeve, përfshirë organizimin e fushatave shëndetësore dhe sesioneve informuese;

2.6 Vendosja e prioriteteve dhe objektivave shëndetësorë lokale në bazë të informacioneve të mbledhura dhe strategjive të kujdesit parësor shëndetësor si dhe identifikimi i nevojave shëndetësore të komunitetit;

2.7 Propozimi i buxhetit për shëndetësinë parësore dhe menaxhimi i bashkë pagesave për shërbimet shëndetësore, në përputhje me udhëzimet e ministrive përkatëse si dhe sigurimi i përdorimit efikas të burimeve financiare;

2.8 Menaxhimi i emergjencave dhe fatkeqësive të shëndetit publik, që përfshin zhvillimin e planeve, koordinimin e burimeve dhe bashkëpunimin me institucionet tjera për të siguruar një përgjigje të shpejtë dhe efektive;

2.9 Sigurimi i mbështetjes së plotë administrative dhe logjistike për institucionet shëndetësore në nivelin komunal.

2.10 Bashkëpunimi me institucionet tjera qeveritare, organizata joqeveritare dhe ofrues të kujdesit shëndetësor, për të përmirësuar shërbimet e shëndetit publik.

3. Drejtoria për Shëndetësi udhëhiqet nga Drejtori i cili i raporton Kryetarit të Komunës.

4. Në kuadër të kësaj Drejtorie, bënë pjesë:

4.1 Sektori për Shëndetësi.

5. Sektori për Shëndetësi, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësisë.

6. Detyrat dhe përgjegjësit e Drejtorisë, njëkohësisht janë edhe detyrat dhe përgjegjësit e Sektorit për Shëndetësi.

7. Numri i të punësuarve në Drejtorinë për Shëndetësi, është katër (4).

Neni 29
Drejtoria për Mirëqenie Sociale

1. Misioni i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale është të sigurojë mbrojtjen, mbështetjen dhe mirëqenien e të gjitha grupeve të cenueshme në komunë, duke ofruar shërbime dhe programe të ndihmës sociale, kujdesit rezidencial dhe rehabilitimit, si dhe duke promovuar integrimin dhe zhvillimin social.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, janë:

2.1 Zhvillimi dhe zbatimi i politikave dhe programeve për përmirësimin e mirëqenies sociale në komunë, duke siguruar mbështetje për grupet e ndjeshme, si të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe familjet me të ardhura të ulëta;

2.2 Menaxhimi dhe administrimi i skemës sociale në nivel komunal, përfshirë ndihmën sociale, shërbimet për personat në nevojë dhe mbështetjen për përfshirjen në ndihmë sociale;

2.3 Planifikimi dhe zbatimi i projekteve për strehimin dhe banimin, duke adresuar nevojat e qytetarëve për banim të përballueshëm, përfshirë ndërtimin dhe menaxhimin e banesave sociale;

2.4 Ofrimi i zgjidhjeve të përkohshme për strehim dhe ndihmë emergjente për individët dhe familjet që përballen me humbje të banimit për shkak të fatkeqësive natyrore, krizave financiare ose rrethanave të tjera emergjente;

2.5 Ofrimi i këshillimeve dhe informacioneve për qytetarët mbi mundësitë e strehimit dhe përfitimet sociale, duke i ndihmuar ata të kuptojnë dhe të përfitojnë nga shërbimet dhe programet e ofruara nga komuna;

2.6 Hartimi i programeve të kujdesit rezidencial për individët që kanë nevojë për ndihmë në aktivitetet e tyre të përditshme, duke bashkëpunuar me profesionistët shëndetësorë, banorët dhe familjarët për të siguruar plotësimin e nevojave fizike, emocionale dhe sociale;

2.7 Monitorimi i shëndetit të banorëve në strehimore në bashkëpunim me profesionistët e kujdesit shëndetësor për kontrolle dhe trajtime të rregullta, si dhe menaxhimi i situatave emergjente shëndetësore;

2.8 Organizimi dhe ofrimi i trajnimeve për stafin e kujdesit rezidencial mbi praktikat më të mira të kujdesit dhe reagimin në situata urgjente, si dhe lehtësimi i organizimit të aktiviteteve sociale, rekreative dhe edukative për banorët;

2.9 Sigurimi i mirëmbajtjes së hapësirave rezidenciale, duke respektuar protokollet e sigurisë, dhe përgatitja e raporteve mbi ndryshimet në gjendjen shëndetësore të banorëve, incidentet dhe shqetësimet;

2.10 Zhvillimi i programeve të mirëqenies sociale për të ndihmuar familjet me të ardhura të ulëta, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet e tjera të pa favorizuara, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve si kujdesi në shtëpi dhe transporti.

3. Drejtoria për Mirëqenie Sociale udhëhiqet nga Drejtori i cili i raporton Kryetarit të Komunës.

4. Në kuadër të kësaj Drejtorie, bëjnë pjesë:

4.3 Sektori per Mirëqenie Sociale;

4.4 Sektori për Shërbime Sociale;

4.5 Sektori për Ndihmë Sociale.

5. Numri i të punësuarve në Drejtorinë për Mirëqenie Sociale, është katërmbdhjet (14).

Neni 30
Sektori për Mirëqenie Sociale

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Mirëqenie Sociale, janë:

1.1 Zhvillimi dhe zbatimi i politikave dhe programeve për mirëqenie sociale për të ndihmuar familjet me të ardhura të ulëta, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet e tjera të pa favorizuara, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve si kujdesi në shtëpi dhe transporti;

1.2 Mbrojta ligjore e fëmijëve pa prindër duke i vendosur nën kujdestari dhe shtëpitë kalimtare përfshirë shërbimin e birësimit dhe bashkimi familjar duke respektuar kërkesat ligjore dhe urdhrat e gjykatës;

1.3 Menaxhimi dhe administrimi i skemës sociale në nivel komunal, përfshirë ndihmën sociale, shërbimet për personat në nevojë dhe mbështetjen për përfshirjen sociale;

1.4 Hartimi dhe zbatimi i programeve të banimit/strehimit të përballueshëm për qytetarët me të ardhura të ulëta dhe grupet e cenueshme, përfshirë menaxhimin e procesit të ndarje së banesave;

1.5 Përgatitja e programeve të kujdesit rezidencial për personat që kanë nevojë për ndihmë në aktivitetet e tyre, duke bashkëpunuar me profesionistët shëndetësorë, banorët dhe familjarët e tyre, për të siguruar adresimin e nevojave fizike, emocionale dhe sociale;

1.6 Ofrimi i zgjidhjeve të përkohshme për strehim dhe ndihmë emergjente për individët dhe familjet që përballen me humbje të banimit për shkak të fatkeqësive natyrore, krizave financiare ose rrethanave të tjera emergjente;

1.7 Sigurimi që hapësirat rezidenciale të mirëmbahen, duke respektuar protokollet e sigurisë, si dhe sigurimi i përgatitjes së raporteve lidhur me ndryshimet në gjendjen shëndetësore, incidentet dhe shqetësimet

1.8 Lehtësimi i caktimit të kujdestarëve për individët që nuk janë në gjendje të marrin vendime për shkak të paaftësisë ose problemeve të shëndetit mendor si dhe monitorimi për të siguruar që mirëqenia dhe të drejtat e tyre respektohen;

1.9 Mbështetja e viktimave të dhunës në familje, trafikimit dhe krimeve seksuale duke ofruar këshillime psiko-social, ndërgjegjësuese dhe edukative si dhe rehabilitimi dhe riintegrimi i tyre në familje dhe komunitete;

1.10 Këshillimi i familjeve për pajtim dhe bashkim familjar, përfshirë këshillimin gjatë divorcit dhe kujdesin për nevojat e veçanta të tyre si dhe ndërmjetësimi për të adresuar konfliktet dhe prishjet e komunikimit të tyre

1.11 Hartimi i programeve dhe skemave të ndihmës sociale për personat që kanë nevojë për ndihmë sociale për të siguruar plotësimin e nevojave të tyre sociale;

1.12 Ofrimi i programeve të formimit profesional dhe mbështetja për arsimim si dhe mbështetja në punësim;

1.13 Sigurimi i identifikimit të peronave dhe familjeve me të ardhura të ulëta, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet e tjera të pa favorizuara për t'iu ofruar ndihmën e nevojshme.

4. Sektori për Mirëqenie Sociale, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale.

5. Numri i të punësuarve në Sektorin për Mirëqenie Sociale, është katër (4).

Neni 31
Sektori për Shërbime Sociale

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për shërbime sociale, janë:

1.1 Mbrojta ligjore e fëmijëve pa prindër duke i vendosur nën kujdestari dhe shtëpitë kalimtare përfshirë shërbimin e birësimit dhe bashkimi familjar duke respektuar kërkesat ligjore dhe urdhrat e gjykatës;

1.2 Zhvillimi dhe zbatimi i planeve të kujdesit të individualizuar për fëmijët e dhunuar, neglizhuar dhe të pa mbrojtur, që adreson nevojat e tyre specifike përfshirë rehabilitimin dhe riintegrimi e tyre;

1.3 Monitorimi i rregullt i mirëqenies, përparimit dhe sigurisë së fëmijëve të vendosur nën kujdestari, përfshirë vizitat, komunikimin dhe bashkëpunimin me profesionistët përkatës;

1.4 Ofrimi i mbështetjes fizike, emocionale dhe arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara duke siguruar mirëqenien e tyre, qasjen në kujdesin mjekësor dhe mundësitë për zhvillim;

1.5 Këshillimi i familjeve për pajtim dhe bashkim familjar, përfshirë këshillimin gjatë divorcit dhe kujdesin për nevojat e veçanta të tyre si dhe ndërmjetësimi për të adresuar konfliktet dhe prishjet e komunikimit të tyre;

1.6 Mbështetja e viktimave të dhunës në familje, trafikimit dhe krimeve seksuale duke ofruar këshillime psiko-social, ndërgjegjësuese dhe edukative si dhe rehabilitimi dhe riintegrimi i tyre në familje dhe komunitete;

1.7 Lehtësimi i caktimit të kujdestarëve për individët që nuk janë në gjendje të marrin vendime për shkak të paaftësisë ose problemeve të shëndetit mendor si dhe monitorimi për të siguruar që mirëqenia dhe të drejtat e tyre respektohen;

1.8 Ofrimi i shërbimeve administrative, si udhëtimi për të mitur për fëmijët e prindërve të divorcuar, certifikatave për shtetësinë, vlerësimin e pavarësisë financiare, verifikimin e aftësisë për punësim dhe armë dhe çështjet tjera të përcaktuara me ligj;

1.9 Adresimi i nevojave të azilkërkuesve, refugjatëve dhe të riatdhesuarve si dhe ofrimi i ndihmës urgjente për ata që kanë nevoja urgjente.

2. Sektori për shërbime sociale, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale.

3. Numri i të punësuarve në Sektorin për shërbime sociale, është pesë (5)

Neni 32

Sektori për Ndihmë Sociale

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Ndihmë Sociale, janë:

1.1 Zbatimi i skemave dhe programeve të ndihmës sociale për të gjitha grupet e cenueshme dhe në nevojë të komunës;

1.2 Ofrimi i shërbimeve nga skema dhe programet e ndihmës sociale për të gjitha grupet e cenueshme dhe në nevojë të komunës, përfshirë verifikimin e varfërisë familjare dhe dhënia e përfitimeve;

1.3 Ofrimi i programeve të formimit profesional dhe mbështetja për arsimim si dhe mbështetja në punësim;

1.4 Monitorimi i skemave të ndihmës sociale, për të siguruar që ndihmat janë shpërndarë në mënyrë të drejtë dhe kanë ndikuar pozitivisht në përmirësimin e jetës së përfituesve;

1.5 Krijimi dhe mbajtja e një baze të dhënash të përfituesve dhe aplikuesve të ndihmës sociale, duke përfshirë verifikimin periodik të situatës së tyre;

1.6 Bashkëpunimi me organizata joqeveritare dhe agjenci të tjera, për të ndihmuar në identifikimin dhe mbështetjen e grupeve më të rrezikuara dhe në nevojë në komunë.

2. Sektori për Ndihmë Sociale, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale.

3. Numri i të punësuarve në Sektorin për Ndihmë Sociale, është katër (4).

Neni 33
Drejtori për Urbanizëm dhe Mjedis

1. Misioni i Drejtorisë për Urbanizëm është udhëheqja dhe menaxhimi i planifikimit dhe zhvillimit urban në mënyrë të qëndrueshme dhe të kontrolluar, përfshirë mbrojtjen e mjedisit përgatitjen e planeve të detajuara urbane dhe miratimin e projekteve të ndërtimit duke siguruar përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mjedis, janë:

2.1 Zhvillimi i planeve dhe rregulloreve urbane dhe mjedisore të detajuara, përfshirë përcaktimin e zonave të ndërtimit, infrastrukturës, dhe zonave të gjelbra si dhe sigurimi që këto plane janë në përputhje me standardet mjedisore dhe urbane;

2.2 Menaxhimi efikas dhe transparent i proceseve lejeve të ndërtimit dhe lejeve mjedisore përfshirë lëshimin e tyre si dhe mbikëqyrja e zbatimit të planeve të ndërtimit në përputhje me lejet e dhëna;

2.3 Analizimi dhe vlerësimi i projekteve dhe planeve zhvillimore për të siguruar përputhshmërinë me standardet dhe planet e urbanizmit ;

2.4 Mbikëqyrja e zhvillimit urban dhe raportimi i progresit dhe sfidave në zbatimin e planeve dhe politikave të urbanizmit;

2.5 Ruajtja dhe menaxhimi i parqeve, zonave të mbrojtura dhe burimeve natyrore, dhe zbatimi i masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës;

2.6 Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor për publikun dhe promovimi i praktikave të qëndrueshme mjedisore, si dhe organizimi i konsultimeve dhe dëgjimeve publike në lidhje me ndryshimet e planeve dhe zonave urbane;

2.7 Mbikëqyrja e zhvillimit urban dhe mjedisor dhe raportimi i progresit dhe sfidave në zbatimin e planeve dhe politikave të urbanizmit;

2.8 Planifikimi dhe zbatimi i masave për menaxhimin e rrezikut mjedisor dhe natyror, veçanërisht në rastet e emergjencave mjedisore ose katastrofave natyrore;

2.9 Planifikimi për infrastrukturën thelbësore si rrugët, shërbimet komunale, parqet dhe objektet publike për të akomoduar nevojat e popullsisë dhe bizneseve në rritje;

2.10 Planifikimi për infrastrukturën si rrugët, shërbimet komunale, parqet dhe objektet publike për të akomoduar nevojat e popullsisë dhe bizneseve në rritje;

2.11 Shqyrtimi dhe miratimi i planeve të ndërtimit për të siguruar që ato janë në përputhje me legjislacionin, rregulloret dhe standardet e planifikimit urban;

2.12 Sigurimi që të gjitha aktivitetet e ndërtimit janë në përputhje me ligjet dhe rregulloret, janë të sigurta, të qëndrueshme dhe respektojnë standardet e vendosura;

2.13 Ofrimi i përgjigjeve dhe këshillimeve të nevojshme për ndërtuesit, arkitektët dhe të tjerët që janë të përfshirë në procesin e ndërtimit.

1. Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis, udhëhiqet nga Drejtori i cili i raporton Kryetarit të Komunës.

2. Në kuadër të kësaj Drejtorie, bëjnë pjesë:

4.1 Sektori për Planifikim dhe Zhvillim Urban;

4.2 Sektori për Mbrojtje të Mjedisit.

3. Numri i të punësuarve në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mjedis, është tetë (8).

Neni 34
Sektori për Planifikim dhe Zhvillim Urban

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Planifikim dhe Zhvillim Urban, janë:

1.1 Zhvillimi i planeve dhe rregulloreve urbane të detajuara, përfshirë përcaktimin e zonave të ndërtimit dhe infrastrukturës, dhe sigurimi që këto plane janë në përputhje me standardet urbane;

1.2 Planifikimi i infrastrukturës si rrugët, shërbimet komunale, parqet dhe objektet publike për të akomoduar nevojat e popullsisë dhe bizneseve në rritje;

1.3 Analizimi dhe vlerësimi i projekteve dhe planeve zhvillimore për të siguruar përputhshmërinë me standardet dhe planet e urbanizmit;

1.4 Menaxhimi efikas dhe transparent i proceseve të lejeve ndërtimore, përfshirë lëshimin e tyre dhe mbikëqyrjen e zbatimit të planeve të ndërtimit në përputhje me lejet e dhëna;

1.5 Shqyrtimi i planeve të zhvillimit urban për të siguruar përputhshmërinë me strategjitë afatgjata të planifikimit të qytetit dhe komunitetit;

1.6 Propozimi i masave për përmirësimin e infrastrukturës urbane dhe modernizimin e zonave të zhvilluara, duke përfshirë përmirësimin e rrugëve, parqeve dhe shërbimeve publike;

1.7 Bashkëpunimi me sektorët e tjerë dhe palët e interesuara për të integruar nevojat e komunitetit në planet urbane dhe për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm;

1.8 Krijimi i strategjive afatgjata për zhvillimin urban, duke përfshirë parashikimin e nevojave të ardhshme të infrastrukturës dhe zhvillimin e zonave të reja urbane;

1.9 Vlerësimi dhe rishikimi periodik i planeve urbane për të siguruar që ato mbeten të përshtatshme me ndryshimet demografike dhe nevojat ekonomike të komunitetit.

2. Sektori për Planifikim dhe Zhvillim Urban, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Zhvillim Urban.

3. Numri i të punësuarve në Sektorin për Planifikim dhe Zhvillim Urban, është katër (4).

Neni 35
Sektori për Mbrojtje të Mjedisit

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Mbrojtje të Mjedisit, janë:

1.1 Hartimi i rregulloreve mjedisore të detajuara, përfshirë përcaktimin e zonave të gjelbra dhe sigurimi që këto rregullore janë në përputhje me standardet mjedisore;

1.2 Ruajtja dhe menaxhimi i parqeve, zonave të mbrojtura dhe burimeve natyrore, dhe zbatimi i masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës;

1.3 Planifikimi dhe zbatimi i masave për menaxhimin e rrezikut mjedisor dhe natyror, veçanërisht në rastet e emergjencave mjedisore ose katastrofave natyrore;

1.4 Menaxhimi efikas dhe transparent i proceseve të lejeve mjedisore, përfshirë lëshimin e tyre dhe mbikëqyrjen e zbatimit të planeve dhe masave mjedisore në përputhje me lejet e dhëna;

1.5 Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor për publikun dhe promovimi i praktikave të qëndrueshme mjedisore;

1.6 Monitorimi dhe raportimi i ndikimit të projekteve të ndërtimit dhe zhvillimit në mjedis, duke propozuar masa korrigjuese kur është e nevojshme;

1.7 Ofrimi i përgjigjeve dhe këshillimeve të nevojshme për ndërtuesit për të siguruar që të gjitha aktivitetet janë në përputhje me ligjet dhe rregulloret mjedisore;

1.8 Koordinimi me organizatat mjedisore dhe institucionet qeveritare për zbatimin e projekteve të përbashkëta që synojnë përmirësimin e mjedisit dhe mbrojtjen e burimeve natyrore.

2. Sektori për Mbrojtje të Mjedisit, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mjedis.

3. Numri i të punësuarve në Sektorin për Mbrojtje të Mjedisit, është tre (3).

Neni 36
Drejtoria për Shërbime Publike

1. Misioni i Drejtorisë së Shërbimeve Publike është të sigurojë dhe të menaxhojë shërbime publike cilësore për banorët e komunës, përfshirë mirëmbajtjen e infrastrukturës publike, furnizimin me ujë të pastër dhe energji elektrike, menaxhimin e mbeturinave dhe kanalizimit, dhe shërbime tjera publike.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Shërbime Publike, janë:

1.1 Hartimi dhe zbatimi i planeve dhe projekteve për përmirësimin e infrastrukturës publike, përfshirë rrugët, trotuaret, ndriçimin publik, dhe rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve;

1.2 Mbikëqyrja dhe mirëmbajtja e parqeve, hapësirave të gjelbra dhe zonave rekreative për të siguruar një mjedis të pastër dhe të sigurt për komunitetin;

1.3 Menaxhimi dhe sigurimi që banorët e komunës të kenë qasje në ujë të pastër, sisteme funksionale të ujërave të zeza dhe shërbime të besueshme elektrike duke siguruar funksionimin e duhur;

1.4 Promovimi i projekteve të energjisë së ripërtëritshme, siç janë energjia diellore dhe era, për të reduktuar konsumin e energjisë dhe ndikimin ambiental;

1.5 Organizimi dhe mbikëqyrja e shërbimeve të mbledhjes dhe largimit të mbeturinave, duke siguruar një sistem efikas të riciklimit dhe menaxhimit të mbetjeve;

1.6 Mbikëqyrja i kompanive të kontraktuara për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave, duke siguruar që shërbimet të kryhen në përputhje me marrëveshjet dhe standardet e vendosura;

1.7 Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe edukimit publik për rëndësinë e riciklimit, zvogëlimit të mbeturinave dhe menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave;

1.8 Sigurimi i zbatimit të legjislacionit lidhur me shërbimet publike dhe menaxhimin e mbeturinave, përfshirë ndështkimin e shkeljeve dhe parandalimin e deponive të paligjshme;

1.9 Krijimi dhe mbikëqyrja e programeve për riciklimin dhe kompostimin e mbeturinave organike, duke promovuar praktikat miqësore me mjedisin.

3. Drejtoria për Shërbime Publike, udhëhiqet nga Drejtori i cili i raporton Kryetarit të Komunës.

4. Në kuadër të kësaj Drejtorie, bëjnë pjesë:

4.1 Sektori për Shërbime Publike;

4.2 Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave.

5. Numri i të punësuarve në Drejtorinë për Shërbime Publike është tetë (8).

Neni 37
Sektori për Shërbime Publike

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Shërbime Publike, janë:

1.1 Hartimi dhe zbatimi i planeve dhe projekteve për përmirësimin e infrastrukturës publike, përfshirë rrugët, trotuaret, ndriçimin publik, dhe rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve;

1.2 Mbikëqyrja dhe mirëmbajtja e parqeve, hapësirave të gjelbra dhe zonave rekreative për të siguruar një mjedis të pastër dhe të sigurt për komunitetin;

1.3 Menaxhimi dhe sigurimi që banorët e komunës të kenë qasje në ujë të pastër, sisteme funksionale të ujërave të zeza dhe shërbime të besueshme elektrike duke siguruar funksionimin e duhur;

1.4 Planifikimi, instalimi, dhe mirëmbajtja e sistemit të ndriçimit publik për të siguruar ndriçim adekuat në rrugë dhe hapësira publike gjatë natës;

1.5 Promovimi i projekteve të energjisë së ripërtëritshme, siç janë energjia diellore dhe era, për të reduktuar konsumin e energjisë dhe ndikimin ambiental;

1.6 Planifikimi dhe menaxhimi i rrjetit të trafikut rrugor në komunë, duke siguruar rrjedhën e qetë të trafikut dhe zvogëlimin e bllokimeve dhe aksidenteve;

1.7 Zhvillimi dhe azhurnimi i planit të qarkullimit urban, duke përfshirë studimin e rrjedhave të trafikut dhe nevojat e transportit publik për të përmirësuar infrastrukturën rrugore dhe shërbimet e transportit;

1.8 Zbatimi i masave për përmirësimin e sigurisë rrugore, duke përfshirë instalimin e sinjalizimeve, vendosjen e kufizimeve të shpejtësisë, dhe organizimin e fushatave për ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi sigurinë në trafik;

1.9 Monitorimi dhe menaxhimi i rrugëve kryesore dhe nyjave të trafikut për të identifikuar dhe adresuar problemet e qarkullimit, si bllokimet dhe devijimet, duke ndërmarrë veprime për përmirësimin e rrjedhës së trafikut;

1.10 Zhvillimi dhe zbatimi i politikave për transportin e qëndrueshëm, si përdorimi i transportit publik, çiklizmi dhe ecja, dhe zbatimi i masave për të reduktuar ndotjen dhe emetimet e karbonit nga transporti;

1.11 Menaxhimi i infrastrukturës për transportin publik, duke përfshirë mirëmbajtjen dhe zhvillimin e stacioneve të autobusëve, ndalesat e taksive dhe korsitë e dedikuara për autobusët;

1.12 Organizimi i fushatave informuese dhe edukative për të informuar dhe edukuar publikun rreth shërbimeve të transportit publik, sigurisë në trafik dhe përfitimeve të transportit të qëndrueshëm.

2. Sektori për Shërbime Publike , udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Shërbime Publike.

3. Numri i të punësuarve në Sektorin Shërbime Publike, është katër (4).

Neni 38
Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave, janë:

1.1 Organizimi dhe mbikëqyrja e shërbimeve të mbledhjes dhe largimit të mbeturinave, duke siguruar një sistem efikas të riciklimit dhe menaxhimit të mbetjeve;

1.2 Përgatitja e planeve për menaxhimin e mbeturinave që përfshin mbledhjen, transportin, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave si dhe identifikimin e zonave problematike dhe propozimi i zgjidhjeve për përmirësim;

1.3 Mbikëqyrja i kompanive të kontraktuara për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave, duke siguruar që shërbimet të kryhen në përputhje me marrëveshjet dhe standardet e vendosura;

1.4 Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe edukimit publik për rëndësinë e riciklimit, zvogëlimit të mbeturinave dhe menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave;

1.5 Sigurimi i zbatimit të legjislacionit lidhur me menaxhimin e mbeturinave, përfshirë ndëshkimin e shkeljeve dhe parandalimin e deponive të paligjshme;

1.6 Krijimi dhe mbikëqyrja e programeve për riciklimin dhe kompostimin e mbeturinave organike, duke promovuar praktikat miqësore me mjedisin;

1.7 Planifikimi dhe koordinimi i zhvillimit të infrastrukturës së re për menaxhimin e mbeturinave, si qendrat e grumbullimit, deponitë e kontrolluara dhe impiantet e trajtimit.

2. Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Shërbime Publike.

3. Numri i të punësuarve në Sektorin Menaxhimin e Mbeturinave, është tre (3).

Neni 39
Drejtoria për Emergjenca, Mbrojtje dhe Shpëtim

1. Misioni i Drejtorisë për Emergjenca, Mbrojtje dhe Shpëtim është të sigurojë mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve përmes planifikimit, koordinimit dhe menaxhimit efektiv të emergjencave dhe situatave të krizës, duke promovuar gatishmërinë dhe reagimin e shpejtë ndaj çdo rreziku.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Emergjenca, Mbrojtje dhe Shpëtim, janë:

2.1 Zhvillimi dhe zbatimi i planeve dhe politikave për sigurinë publike dhe menaxhimin e emergjencave në komunë, duke siguruar mbrojtjen e jetës dhe pronës së qytetarëve si dhe parandalimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe rikuperimin nga situatat emergjente;

2.2 Koordinimi me agjencitë lokale, rajonale dhe qendrore për të siguruar përgjigje efektive ndaj emergjencave dhe krizave, duke përfshirë organizatat e sigurisë dhe shërbimet e urgjencës;

2.3 Hartimi dhe përditësimi i planeve të evakuimit dhe protokolleve të sigurisë për situata emergjente, duke përfshirë fatkeqësitë natyrore, aksidentet industriale, dhe situatat e rrezikut të lartë;

2.4 Ofrimi i trajnimeve dhe fushatave të ndërgjegjësimit për qytetarët dhe institucionet lokale mbi praktikat më të mira për parandalimin e emergjencave dhe reagimin ndaj tyre;

2.5 Monitorimi dhe vlerësimi i rreziqeve në komunë, përfshirë identifikimin dhe analizimin e zonave me rrezik të lartë për emergjenca dhe zhvillimin e masave për të minimizuar këto rreziqe;

2.6 Zhvillimi dhe mbikëqyrja e sistemeve të komunikimit dhe alarmimit për situata emergjente, duke siguruar që informacioni i saktë të arrijë tek qytetarët dhe shërbimet e emergjencës në kohë reale;

2.7 Sigurimi i përputhshmërisë së të gjitha aktiviteteve dhe masave të sigurisë me legjislacionin kombëtar dhe rregulloret lokale, për të garantuar një nivel të lartë sigurie për qytetarët;

2.8 Raportimi dhe analizimi i incidenteve të sigurisë dhe emergjencave, duke zhvilluar rekomandime për përmirësimin e përgjigjes dhe masave të parandalimit në të ardhmen.

3. Drejtoria për Emergjenca, Mbrojtje dhe Shpëtim, udhëhiqet nga Drejtori i cili i raporton Kryetarit të Komunës.

4. Në kuadër të kësaj Drejtorie, bëjnë pjesë:

4.3 Sektori për Siguri dhe Emergjenca.

5. Sektori për Emergjenca, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë Emergjenca, Mbrojtje dhe Shpëtim.

6. Detyrat dhe përgjegjësit e Drejtorisë, njëkohësisht janë edhe detyrat dhe përgjegjësit e Sektorit për Siguri dhe Emergjenca.

7. Numri i të punësuarve në Drejtorinë për Siguri dhe Emergjenca, është katër (4).

Neni 40
Drejtori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

1. Misioni i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dpërfshin zhvillimin e politikave dhe programeve lokale që mbështesin dhe zhvillojnë sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë. Kjo përfshin ofrimin e ndihmës teknike, organizimin e trajnimeve dhe sigurimin e informacioneve të nevojshme për fermerët, promovimi i agroturizmit dhe zhvillimit rural.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Bujqësi dhe, Zhvillim Rural janë:

2.1 Zhvillimi dhe zbatimi i politikave dhe programeve për promovimin e praktikave të qëndrueshme bujqësore si dhe ofrimi i mbështetjes dhe udhëzimeve për fermerët, duke përfshirë qasjen në burime, asistencë teknike dhe trajnime;

2.2 Monitorimi dhe rregullimi i aktiviteteve bujqësore për të siguruar përputhjen me standardet mjedisore dhe të sigurisë si dhe përmirësimi i menaxhimit të tokës dhe ruajtjes së tokës;

2.3 Menaxhimi dhe mbrojtja e pyjeve të komunës, duke përfshirë ruajtjen, ripyllëzimin dhe menaxhimin e lëndës drunore si dhe zbatimi i rregulloreve lidhur me prerjet, shpyllëzimin dhe mbrojtjen e pyjeve;

2.4 Bashkëpunimi me institucionet përkatëse për parandalimin e zjarreve në pyje dhe menaxhimin e habitateve të kafshëve të egra si dhe promovimi i praktikave të qëndrueshme pyjore që balancojnë qëllimet ekonomike dhe ekologjike;

2.5 Zhvillimi dhe zbatimi i programeve për përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të jetës në zonat rurale si dhe infrastrukturës në zonat rurale, duke përfshirë rrugët, sistemet e ujitjes dhe qasjen në ujë të pastër;

2.6 Promovimi i zhvillimit ekonomik rural duke mbështetur bizneset lokale, agroturizmin dhe sipërmarrjet e tjera rurale;

2.7 Sigurimi i subvencioneve dhe mundësive tjera financimi për të mbështetur projektet e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural si dhe menaxhimi i shpërndarjes së fondeve për projektet dhe iniciativat e pranueshme;

2.8 Sigurimi i pajtueshmërisë me rregulloret mjedisore dhe praktikat e qëndrueshme në bujqësi dhe pylltari dhe promovimi i ruajtjes së biodiversitetit dhe mbrojtjes së jetës së egër në zonat rurale dhe pyjore;

2.9 Pjesëmarrja në zhvillimin e planeve të përdorimit të tokës që balancojnë nevojat e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural me qëllimet e ruajtjes së mjedisit;

2.10 Ndërrimi i destinimit të pyjeve dhe tokës pyjore private në territorin e komunës, dhënia e komenteve në planin vjetor të menaxhimit të pyjeve të përgatitur nga Agjencia, ripërtëritja e pyjeve si dhe dhënia e pëlqimit për lokacionin për përpunimin primar të drurit;

2.11 Organizimi i seminareve, sesioneve trajnuese dhe fushatave ndërgjegjësimit për fermerët dhe banorët ruralë për mundësit e zhvillimit rural.

3. Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural udhëhiqet nga Drejtori i cili i raporton Kryetarit të Komunës.

4. Në kuadër të kësaj Drejtorie, bëjnë pjesë:

4.1 Sektori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;

5. Sektori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

6. Detyrat dhe përgjegjësit e Drejtorisë, njëkohësisht janë edhe detyrat dhe përgjegjësit e Sektorit për Shëndetësi.

Numri i të punësuarve në Drejtorinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, është pesë (5).

Neni 41
Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Prona

1. Misioni i Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Prona është të menaxhojë dhe rregullojë në mënyrë efektive tokën dhe pronën brenda juridiksionit të saj, përfshirë mbajtjen e hartave katastrale, të dhënave të sakta të pronësisë, mbikëqyrjen e sistemit të kadastrës për dokumentacionin e detajuar të parcelave të tokës si dhe ofrimin e shërbimeve gjeodezike për të mbështetur planifikimin dhe zhvillimin komunal.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Prona, janë:

2.1 Menaxhimi i pronës së komunës dhe pronave te qytetareve, duke mbajtur të dhëna të sakta për pronat e paluajtshme përfshirë regjistrimin e të drejtës së pronësisë dhe identifikimin e pronës së paluajtshme;

2.2 Zhvillimi dhe menaxhimi i procedurave për transaksionet e pronës duke përfshirë vendimet për regjistrimin e servituteve dhe hipotekave si dhe shqyrtimi i rikthimit të pronës së ish-pronarëve;

2.3 Menaxhimi i pronës së komunës, zhvillimi i procedurave të shpronësimit për interes publik dhe vendimmarrjen për rregullimin e marrëdhënieve pronësore me personat fizikë dhe juridikë;

2.4 Krijimi dhe mirëmbajtja e hartave kadastrale si dhe të dhënave të sistemeve të informacionit gjeografik (GIS) që tregojnë kufijtë e pronave, pronësinë dhe karakteristikat e tokës;

2.5 Sigurimi që të gjitha aktivitetet që lidhen me administrimin e tokës, të dhënat e pronës dhe rilevimet gjeodezike të jenë në përputhje me kornizat përkatëse ligjore dhe rregullatorë;

2.6 Matja, incizimi dhe vendosja e kufijve të saktë të pronave, pikave të referencës dhe rrjeteve të kontrollit gjeodezik që sigurojnë përcaktimin e duhur të parcelave të tokës;

2.7 Ofrimi i të dhënave dhe shërbimeve të sakta kadastrale për planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe rural, duke ndihmuar në vendimmarrjen dhe projektet zhvillimore;

2.8 Sigurimi që qytetarët dhe institucionet të kenë qasje të lehtë dhe transparente në informacionet kadastrale dhe gjeodezike si dhe lëshimi i certifikatave të nevojshme për pronat e paluajtshme;

2.9 Mirëmbajtja, korrigjimi dhe harmonizimi i evidencave të vendbanimeve, rrugëve dhe objekteve, si dhe digjitalizimi i pikave poligonale dhe trigonometrike;

2.10 Zhvillimi i procedurave administrative për uzurpimet e tokës komunale, përgatitja e inicimeve për kallëzim penal për uzurpime, dhe përcjellja e vendimeve për publikim në Gazetën zyrtare;

2.11 Koordinimi dhe bashkëpunimi me drejtoritë e tjera për çështje të ndërtimit dhe të dhënat gjeodezike, si dhe identifikimin e pronës.

3. Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Prona, udhëhiqet nga Drejtori i cili i raporton Kryetarit të Komunës.

4. Në kuadër të kësaj Drejtorie, bëjnë pjesë:

4.3 Sektori për Kadastër dhe Gjeodezi;

4.4 Sektori për Prona të Paluajtshme.

4. Numri i të punësuarve në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Prona, është njëmbëdhjetë (11).

Neni 42

Sektori për Kadastër dhe Gjeodezi

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Kadastër dhe Gjeodezi, janë:

1.1 Menaxhimi i të dhënave për tokën dhe objektet në pronësi përfshirë regjistrimin e të drejtës së pronësisë dhe identifikimin, klasifikimin e pronës së paluajtshme;

1.2 Zhvillimi dhe menaxhimi i procedurave për transaksionet e pronës publike, duke përfshirë vendimet për regjistrimin e servituteve dhe;

1.3 Mbledhja, përpunimi, ruajtja dhe shpërndarjen e të dhënave të sakta dhe të përditësuara për tokat dhe pronat e paluajtshme brenda territorit të komunës;

1.4 Krijimi dhe mirëmbajtja e hartave kadastrale si dhe të dhënave të sistemeve të informacionit gjeografik (GIS) që tregojnë kufijtë e pronave, pronësinë dhe karakteristikat e tokës;

1.5 Matja , incizimin dhe vendosjen e kufijve të saktë të pronave, pikave të referencës dhe rrjeteve të kontrollit gjeodezik;

1.6 Planifikimi dhe përditësimi i e rrjetit me pika të reja kontrolluese si dhe digjitalizimi i pikave poligonale dhe trigonometrike dhe vektorizimin e planeve të skanuara si dhe azhurnimin e pjesës grafike;

1.7 Përfshirja e ndryshimeve gjatë matjeve dhe bartjen e tyre në programin e gjeodezisë, si dhe kontrollin e rrjeteve dhe matjeve gjeodezike;

1.8 Sigurimi që qytetarët dhe institucionet të kenë qasje të lehtë dhe transparente në informacionet kadastrale dhe gjeodezike si dhe lëshimi i certifikatave të nevojshme për pronat e paluajtshme;

1.9 Zhvillimi i procedurave lidhur me transaksioneve të pronës, përfshirë regjistrimin dhe çregjistrimin e hipotekave, servituteve si dhe shqyrtimin e rikthimit të paluajtshmërisë te ish-pronari;

1.10 Mirëmbajtja dhe korrigjimi i evidencave të vendbanimeve, fshatrave, shesheve, rrugëve dhe numrave të objekteve dhe ndërtesave;

1.11 Udhëheqja me kadastrën etazhore dhe ngastrat kadastrale, lëshon certifikata për patundshmëri dhe zhvillon procedurën e regjistrimit sipas dokumentacionit arkivor dhe ligjeve në fuqi.

2. Sektori për Kadastër dhe Gjeodezi udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Prona.

3. Numri i të punësuarve në Sektorin për Kadastër dhe Gjeodezi, është shtatë (7).

Neni 43

Sektori për Prona të Paluajtshme

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Prona të Paluajtshme , janë:

1.1 Menaxhimi efikas dhe transparent i pronës së komunës dhe pronave te qytetareve, duke mbajtur të dhëna të sakta për të gjitha pronat në territorin e komunës;

1.2 Mbajtja e të dhënave të sakta dhe të azhurnuara për tokën dhe objektet në pronësi të komunës, duke siguruar integritetin dhe qasjen e lehtë në të dhëna;

1.3 Zhvillimi dhe zbatimi i procedurave të shpronësimit dhe këmbimit për ngastrat e planifikuara për interes publik, sipas planeve urbanistike të komunës;

1.4 Përgatitja e vendimeve të shpronësimit dhe këmbimit për personat fizikë dhe juridikë, duke siguruar që procesi të jetë i drejtë dhe transparent;

1.5 Sigurimi i marrëveshjeve dhe kontratave për sigurimin e tokës së nevojshme për realizimin e projekteve të interesit publik, duke mbrojtur interesat e Komunës dhe të qytetarëve;

1.6 Trajtimi i uzurpimeve të tokës në pronësi të komunës dhe inicimi kallëzime penal lidhur me uzurpimet arbitrare, nxjerrja e vendimeve për lirimin e pronës së uzurpuar si dhe shqyrtimi dhe vendosja e kërkesave tjera lidhur me pronën komunale;

1.7 Nxjerrja e vendimeve për regjistrimin e të drejtës së pronësisë në emër të Komunës për paluejtshmëritë e mbetura pa pronar, duke siguruar legalitetin dhe mbrojtjen e pronës komunale;

1.8 Shqyrtimi dhe vendosja për kërkesat e personave fizikë dhe juridikë në procedurë administrative për rregullimin e marrëdhënieve pronësore-juridike lidhur me pronën komunale;

1.9 Koordinimi dhe bashkëpunimi me drejtoritë dhe sektorët tjerë lidhur me të dhënat gjeodezike dhe ato pronësore, dhe kompletimi i lëndëve të shpronësimit dhe vlerësimit të pronës;

1.10 Përgatitja e materialeve të nevojshëm lidhur me pronat, për Këshillin e Drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa dhe për Kuvendin e Komunës.

1. Sektori për Prona të Paluajtshme udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi për Prona.

2. Numri i të punësuarve në Sektorin për Prona të Paluajtshme, është tre (3)

Neni 44
Drejtoria për Inspektime

1. Misioni i Drejtorisë për Inspektime është të sigurojë zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve komunale si dhe standardeve përmes inspektimeve të rregullta dhe efektive, duke mbrojtur shëndetin publik, sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve, si dhe të promovojë një mjedis të pastër dhe të rregullt urban.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Inspektime, janë:

2.1 Hartimi dhe zbatimi i planeve për kryerjen e inspektimeve të rregullta lidhur me zbatimin e ligjeve, rregulloreve dhe akteve të tjera komunale, si dhe standardeve në të gjitha fushat e veprimtarisë komunale;

2.2 Mbikëqyrja dhe sigurimi i zbatimit të legjislacionit dhe rregulloreve komunale në fushat e ndërtimit, tregtisë dhe shërbimeve publike, duke siguruar që të gjitha veprimtaritë të jenë në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura;

2.3 Koordinimi i inspektimeve në sektorë të ndryshëm, përfshirë tregjet e hapura, objektet tregtare, objektet në ndërtim, dhe shërbimet publike, për të siguruar një mbikëqyrje të gjithanshme dhe efikase, në përputhje me planet inspektuese të miratuara;

2.4 Sigurimi i përputhshmërisë së ndërtimeve me lejet e dhëna dhe standardet teknike, duke monitoruar procesin e ndërtimit në të gjitha fazat, për të siguruar që ndërtesat përmbushin normat e sigurisë dhe qëndrueshmërisë;

2.5 Sigurimi i inspektimeve të tregjeve dhe veprimtarive tregtare, duke verifikuar përputhshmërinë e produkteve me standardet e cilësisë dhe sigurisë, licencat e nevojshme dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve;

2.6 Monitorimi i funksionimit të infrastrukturës dhe shërbimeve publike, si furnizimi me ujë, energji, menaxhimi i mbetjeve dhe rrjeteve të kanalizimit, për të siguruar që ato përmbushin standardet e sigurisë dhe të cilësisë;

2.7 Zbatimi i masave ndëshkuese për shkeljet, duke përfshirë lëshimin e gjobave administrative, pezullimin e aktivitetit që shkelin rregulloret, dhe paraqitja e rasteve te organet përkatëse në rast të shkeljeve të rënda;

2.8 Lëshimi i paralajmërimeve dhe udhëzimeve për përmirësimin e gjendjes, duke ofruar këshillime teknike dhe juridike për subjektet që janë në shkelje, dhe duke përcjellë progresin e tyre deri në përmbushjen e kërkesave;

2.9 Bashkëpunimi me organet e tjera, përfshirë policinë, prokurorinë dhe drejtoritë komunale, për të siguruar një qasje të koordinuar në zbatimin e ligjeve dhe për të zgjidhur çështje që kërkojnë ndërhyrje të përbashkët;

2.10 Organizimi i fushatave informuese dhe edukative për subjektet tregtare, ndërtimore dhe komunitetin e gjerë, për t'i informuar për të drejtat dhe detyrimet e tyre në lidhje me tregun, ndërtimin dhe shërbimet publike;

2.11 Menaxhimi i ankesave dhe kërkesave të qytetarëve dhe bizneseve që lidhen me tregun, ndërtimin dhe shërbimet publike, duke siguruar që të gjitha çështjet trajtohen me shpejtësi dhe që në rastet e justifikuara të merren masa efektive për zgjidhje.

3. Drejtoria për inspektime, udhëhiqet nga udhëheqësi i Drejtorisë, i cili i raporton Kryetarit të Komunës.

1. Në kuadër të kësaj Drejtorie, bënë pjesë:

4.1 Sektori për Inspektime të Ndërtimit;

4.2 Sektori për Inspektime të Shërbimeve Publike dhe Tregut.

2. Numri i të punësuarve në Drejtorinë për Inspektime, është nëntë (9).

Neni 45
Sektori për Inspektime të Ndërtimit

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Inspektime të Ndërtimit, janë:

1.1 Hartimi i planeve për inspektimet e rregullta të ndërtimit, përfshirë përgatitjen dhe zbatimin e planeve të detajuara për kontrollin dhe mbikëqyrjen e projekteve ndërtimore në të gjitha fazat e zhvillimit;

1.2 Mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit dhe rregulloreve në sektorin e ndërtimit, për të siguruar që të gjitha aktivitetet e ndërtimit janë në përputhje me ligjet, standardet teknike dhe lejet e dhëna;

1.3 Kontrolli i përputhshmërisë së ndërtimeve me projektet e miratuara dhe ligjet në fuqi, përfshirë verifikimin e kushteve të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të ndërtimit;

1.4 Inspektimi i sigurisë së ndërtesave dhe objekteve në ndërtim, duke kryer vizita të rregullta në vend për të kontrolluar përputhshmërinë me standardet e qëndrueshmërisë strukturore dhe masat e sigurisë;

1.5 Shqiptimi i masave ndëshkuese për shkeljet, përfshirë lëshimin e gjobave administrative, pezullimin e ndërtimeve që nuk përmbushin kërkesat ligjore si dhe paraqitjen e rasteve tek organet përkatëse për shkelje të renda;

1.6 Lëshimi i paralajmërimeve dhe udhëzimeve për përmirësime në ndërtim, duke ofruar këshilla teknike për të përmbushur standardet e kërkuara dhe përcjellja e përmbushjes së kërkesave për përmirësime;

1.7 Bashkëpunimi me institucionet përkatëse, për të siguruar një qasje të koordinuar në inspektimin e projekteve të ndërtimit dhe zgjidhjen e çështjeve që kërkojnë ndërhyrje të përbashkët;

1.8 Organizimi i fushatave informuese dhe edukative për industrinë ndërtimore, për t'i informuar mbi standardet ligjore dhe teknike në ndërtim, si dhe për të ngritur ndërgjegjësimin mbi sigurinë në ndërtim;

1.9 Trajtimi i ankesave nga qytetarët dhe bizneset për ndërtimet, duke siguruar që ankesat të shqyrtohen në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë, dhe marrja e masave korrigjuese aty ku është e nevojshme.

2. Sektori për Inspektime të Ndërtimit, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Inspektime.

3. Numri i të punësuarve në Sektorin për Inspektime të Ndërtimit, është tre (3).

Neni 46
Sektori për Inspektime të Shërbimeve Publike dhe Tregut

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Inspektime të Shërbimeve Publike dhe Tregut, janë:

1.1 Hartimi dhe zbatimi i planeve inspektuese për shërbimet publike dhe tregun, duke organizuar inspektime të rregullta për të mbikëqyrur cilësinë dhe standardet e ofrimit të shërbimeve publike dhe veprimtarive tregtare;

1.2 Inspektimi i tregjeve dhe subjekteve tregtare, për të siguruar përputhshmërinë e produkteve dhe shërbimeve me standardet e cilësisë, sigurisë si dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve;

1.3 Monitorimi i funksionimit të infrastrukturës dhe shërbimeve publike, përfshirë furnizimin me ujë, energji, menaxhimin e mbeturinave, dhe rrjetet e kanalizimit, për të siguruar përputhshmërinë me legjislacionin dhe standardet;

1.4 Shqiptimi i masave ndëshkuese për shkeljet, përfshirë lëshimin e gjobave administrative, pezullimin e veprimtarisë që nuk përmbushin kërkesat ligjore si dhe paraqitjen e rasteve tek organet përkatëse për shkelje të renda;

1.5 Lëshimi i udhëzimeve dhe këshillave për përmirësimin e shërbimeve publike dhe tregjeve, duke ofruar mbështetje për subjektet tregtare dhe institucionet për të rritur cilësinë e shërbimeve dhe produkteve të ofruara;

1.6 Bashkëpunimi me organet e tjera për të siguruar që tregjet dhe shërbimet publike funksionojnë në përputhje me ligjet dhe për të ndërmarrë veprime të përbashkëta në rastet kur evidentohen shkelje të rënda;

1.7 Organizimi i fushatave edukative dhe informuese për subjektet tregtare dhe ofruesit e shërbimeve publike, për të rritur njohuritë mbi rregullat dhe standardet që lidhen me shërbimet publike dhe tregun;

1.8 Trajtimi i ankesave të qytetarëve dhe bizneseve në lidhje me tregun dhe shërbimet publike, duke siguruar që ankesat shqyrtohen në kohë dhe merren masa për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve.

2. Sektori për Inspektime të Shërbimeve Publike dhe Tregut, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Inspektime.

3. Numri i të punësuarve në Sektorin për Inspektime të Shërbimeve Publike dhe Tregut, është pesë (5).

Neni 47
Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

1. Misioni i Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore është të menaxhojë në mënyrë efikase proceset e burimeve njerëzore në administratën komunale, duke përfshirë rekrutimin, zhvillimin e kapaciteteve, vlerësimin e performancës dhe kompensimin, me qëllim që të sigurohet që të punësuarit të kontribuojnë në mënyrë efektive në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive të tyre.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, janë:

2.1 Sigurimi i zbatimit të legjislacionit për zyrtarët publikë, pagat dhe kompensimet, si dhe garantimi i zbatimit të standardeve dhe praktikave më të mira në menaxhimin e burimeve njerëzore;

2.2 Menaxhimi dhe organizimi i të gjitha fazave të rekrutimit përfshirë vlerësimin paraprak të kandidateve, procedurave të transferit si dhe mbështetja e Komisionit të pranimit në zhvillimin e testit elektronik dhe intervistave me kandidatët;

2.3 Mbështetja e njësive organizative në zhvillimin e përshkrimeve individuale të punës, menaxhimin e burimeve njerëzore, procesin e vlerësimit të rezultateve në punë dhe pjesëmarrja në vlerësimin e nëpunësve civil;

2.4 Administrimi i pushimeve, trajnimeve dhe sistemit të vijueshmërisë në punë si dhe mbështetja e Komisionit Disiplinor;

2.5 Administrimi i dosjeve të personelit si dhe menaxhimi i tyre përmes Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) në përputhje me legjislacionin për zyrtaret publik dhe atij të privatësisë;

2.6 Administrimi i kompensimit të punonjësve, përfshirë pagat, shtesat, shpërblimet dhe përfitimet tjera si dhe menaxhimi e daljes në pension dhe politikat e pushimit të punonjësve;

2.7 Identifikimi i nevojave për trajnim dhe organizimi i programeve përkatëse të trajnimit, zhvillimi i materialeve dhe burimeve të trajnimit për rritjen e aftësive të punonjësve dhe zhvillimin e karrierës;

2.8 Ndërmjetësimi dhe zgjidhja e konflikteve midis punonjësve, adresimi i ankesave dhe shqetësimeve të tyre dhe promovimi i një mjedisi pune pozitiv dhe gjithëpërfshirës si dhe mbështetja e Komisioneve disiplinore dhe ankesave;

2.9 Menaxhimi i politikave dhe praktikave të shëndetit dhe sigurisë së punëtoreve në vendin e punës në pajtueshmëri me legjislacionin përkatës;

2.10 Përgatitja e planit vjetor dhe planit afatmesëm të personelit, në pajtim me procesin e planifikimit vjetor të buxhetit të komunës si dhe raportin vjetor për gjendjen e shërbimit civil në komunë.

3. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore kryen shërbime për gjithë administratën komunale përfshirë institucionet shëndetësorë, arsimore dhe kulturore.

4. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, udhëhiqet nga udhëheqësi i Njësisë, i cili i raporton Kryetarit të Komunë.

5. Numri i të punësuarve në Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, është tre (3).

Neni 48
Sektori Ligjor

1. Misioni i Sektorit Ligjor është të ofrojë udhëzime ligjore, të sigurojë respektimin e ligjeve dhe akteve normative të komunës, përfshirë ofrimin e këshillave ligjore, hartimin dhe rishikimin e akteve normative komunale, si dhe përfaqësimin e komunës për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e saj ligjore.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit Ligjor, janë:

2.1 Ofrimi i këshillave ligjore për Kryetarin, Kuvendin Komunal dhe strukturat e administratës komunale për çështje ligjore dhe rregullative për t'u siguruar që funksionimi, vendimmarrja është në përputhje me ligjin;

2.2 Hartimi i rregulloreve, urdhëresave, marrëveshje, kontratave dhe politikave për komunën si dhe rishikimi i akteve komunale për të siguruar ligjshmërinë dhe përafrimin e tyre me ligjet përkatëse;

2.3 Përfaqësimi i komunës në procedurat ligjore, në seanca gjyqësore dhe administrative dhe mbrojtjen e komunës kundër pretendimeve të palëve të treta

si dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përmes ndërmjetësimit ose negocimi për të zgjidhur konfliktet pa shkuar në gjykatë;

2.4 Monitorimi i ndryshimeve në ligjet dhe rregulloret e nivelit qendror që mund të ndikojnë në komunë dhe të këshillojë për përshtatjet e nevojshme të politikave dhe praktikave lokale;

2.5 Përfaqësimi i komunën para organeve rregullatore, institucioneve qendrore ose bordeve për të adresuar çështje që ndërlidhen me komunën të tilla si zonimi, lejet dhe licencat;

2.6 Mbështetja e komunës për çështjet që kanë të bëjnë me qeverisjen dhe etikën komunale, përfshirë konfliktin e interesit, kërkesat për të dhënat publike si dhe çështjet që lidhen me privatësinë e të dhënave;

2.7 Trajtimi i aspekteve ligjore të transaksioneve të pronave komunale, përfshirë blerjet, shitjet, dhënien me qira dhe çështjet e përdorimit të tokës (servitutet);

2.8 Hulumtimi i dhe përcjellja e legjislacionit për të qenë të informuar për ndryshimet në ligje dhe rregullore që mund të prekin komunën.

3. Sektori për Çështje Ligjore, udhëhiqet nga udhëheqësi i Sektorit , i cili i raporton Kryetarit të Komunë.

4. Numri i të punësuarve në Sektori për Çështje Ligjore, është pesë (5).

Neni 49
Sektori për Prokurim Publik

1. Misioni i Sektorit për Prokurim Publik është të sigurojë një proces të prokurimeve efikas dhe me kosto efektive për mallrat dhe shërbimet e nevojshme, duke respektuar parimet e drejtësisë, transparencës dhe pajtueshmërisë me ligjet, rregulloret dhe politikat përkatëse komunale, si dhe standardet etike.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Prokurim Publik, janë:

2.1 Identifikimi i nevojave të administratës komunale për mallra, shërbime dhe punë dhe përgatitja e planit vjetor të prokurimit në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe prioritetet e komunës;

2.2 Përgatitja dhe lëshimi i dokumenteve të prokurimit si kërkesat për propozime, kërkesat për kuotime dhe ftesat për ofertë dhe mbledhja e tyre;

2.3 Përcaktimi i metodologjisë së prokurimit dhe procedurat e vlerësimit të çmimeve dhe vlerësimi i ofertave dhe propozimeve për të zgjedhur furnizuesit më të përshtatshëm bazuar në kritere si çmimi, cilësia dhe aftësia;

2.4 Negocimi dhe finalizimi i kontratave me furnitorët dhe ofruesit e shërbimeve të përzgjedhura dhe sigurimi që kontratat janë të qarta, dhe në përputhje me legjislacionin, politikat dhe rregulloret komunale;

2.5 Krijimi dhe mbajtja e marrëdhënieve pozitive me furnitorët, punë kryerësit dhe shitësit si dhe rishikimi i rregullt të performancës së furnitorëve për të vlerësuar aftësinë e tyre për të përmbushur kërkesat e cilësisë, ofrimit dhe shërbimit;

2.6 Bashkëpunimi me furnitorët për të përmirësuar proceset, cilësinë dhe efikasitetin si dhe adresimi i çdo çështjeje ose mosmarrëveshjeje konraktuale;

2.7 Planifikimi dhe koordinimi i shpërndarjes së mallrave dhe materialeve në drejtoritë dhe lokacione të ndryshme komunale;

2.8 Sigurimi që të gjitha aktivitetet e prokurimit respektojnë kërkesat ligjore dhe rregullatore si dhe menaxhimi i dokumentacionit dhe regjistrimeve për proceset e prokurimit për qëllime auditimi;

2.9 Zbatimi i praktikave më të mira, etike dhe transparente të prokurimit për të parandaluar korrupsionin dhe favorizimin, ulur kostot dhe për të rritur efektivitetin e përgjithshëm.

3. Sektori për Prokurim Publik , udhëhiqet nga Udhëheqësi i Sektorit i cili i raporton Kryetarit të Komunës.

4. Numri i të punësuarve në Sektorin për Prokurim Publik, është katër (4).

Neni 50
Sektori për Komunitete dhe Kthim

1. Misioni i Sektorit për Komunitete dhe Kthim është të promovojë dhe mbrojë të drejtat e komuniteteve, të sigurojë qasje të barabartë në shërbimet publike dhe të bashkërendojë procesin e kthimit dhe riintegrimit të personave të zhvendosur, duke krijuar kushte të qëndrueshme për përfshirjen e tyre në jetën komunitare.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Komunitete dhe Kthim, janë:

2.1 Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre;

2.2 Promovimi dhe mbrojtja e qasjes së barabartë të të gjitha komuniteteve në shërbimet publike, duke siguruar përfshirje të plotë dhe të drejtë;

2.3 Bashkërendimi i procesit të kthimit dhe promovimi i krijimit të kushteve për kthim dhe riintegrim të personave të zhvendosur dhe të riatdhesuar në komunë;

2.4 Hartimi i planeve të veprimit në përputhje me politikat e qeverisë dhe prioritetet komunale, për të mbështetur komunën në përmbushjen e detyrimeve lidhur me kthimin dhe riintegrimin;

2.5 Identifikimi i nevojave parësore të komuniteteve jo-shumicë dhe menaxhimi i projekteve që avancojnë të drejtat e komuniteteve, qasjen e tyre në shërbimet publike, si dhe krijimin e kushteve për kthim dhe riintegrim të qëndrueshëm;

2.6 Bashkërendimi i aktiviteteve me institucionet komunale dhe qeverinë qendrore për të siguruar një qasje të unifikuar në çështjet e komuniteteve dhe kthimit;

2.7 Mbikëqyrja dhe përgatitja e raporteve të rregullta për Kryetarin e Komunës, Kuvendin e Komunës dhe institucionet e qeverisë qendrore mbi progresin në fushën e të drejtave të komuniteteve, qasjen e barabartë në shërbimet komunale, kthimin, riatdhesimin dhe riintegrimin.

3. Sektori për Komunitete dhe Kthim, udhëhiqet nga Udhëheqësi i Sektorit i cili i raporton Kryetarit të Komunës.

4. Numri i të punësuarve në Sektorin për Komunitete dhe Kthim, është gjashtë (6).

Neni 51
Zyra për Komunikim me Publikun

1. Misioni i Zyrës për Komunikim me Publikun është të sigurojë shpërndarjen e saktë dhe në kohë të informacionit, komunikimin efektiv me publikun dhe palët e tjera të interesuara, menaxhimin e marrëdhënieve me median, lehtësimin e komunikimit dhe ruajtjen e një komunikimi të brendshëm efikas për të mbështetur qëllimet e përgjithshme të komunës.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për Komunikim me Publikun, janë:

2.1 Menaxhimi i marrëdhënieve me median, duke përfshirë përgjigjen ndaj pyetjeve, organizimin e intervistave dhe nxjerrjen e njoftimeve për shtyp;

2.2 Zhvillimi dhe zbatimi i materialeve të komunikimit për të promovuar misionin, shërbimet dhe arritjet e komunës përfshirë krijimin e fushatave të marketingut, buletineve dhe përmbajtjes së mediave sociale;

2.3 Lehtësimi i komunikimit ndërmjet komunës dhe qytetaret dhe palët e interesuara, përfshirë shpjegimin e procedurave per ofrimin e shërbimeve;

2.4 Sigurimi që stafi i komunës është i mirë informuar për aktivitetet, synimet dhe iniciativat e komunës;

2.5 Organizimi dhe promovimi i ngjarjeve, konferencave dhe seminareve për të shfaqur arritjet e komunës;

2.6 Monitorimi dhe menaxhimi i reputacionit të komunës duke trajtuar çdo publicitet negativ ose dezinformim dhe duke promovuar aspekte pozitive të shërbimeve të komunës;

2.7 Prodhimi i buletineve, broshurave dhe materialeve të tjera informative për të mbajtur të informuar palët e interesuara për shërbimet e komunës dhe arritjet;

2.8 Përditësimi i faqes së internetit të komunës dhe profileve të mediave sociale për të ofruar informacion të saktë dhe në kohë për publikun.

3. Zyra për Komunikim me Publikun udhëhiqet nga udhëheqësi i Zyrës, i cili i raporton Kryetarit të Komunës.

4. Numri i të punësuarve në Zyrën për Komunikim me Publikun, është tre (3)

Neni 52
Njësia e Auditim të Brendshëm

1. Misioni i Njësisë të Auditimit të Brendshëm është të ofrojë vlerësime të paanshme dhe objektive për të përmirësuar funksionimin dhe llogaridhënien institucionale, përfshirë vlerësimin e kontrolleve të brendshme, menaxhimin e rreziqeve, sigurimin e pajtueshmërisë dhe përmirësimin e efikasitetit që kanë për qëllim të forcojnë qeverisjen dhe llogaridhënien si dhe të minimizojnë rreziqet dhe brenda institucionit.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Njësia e Auditim të Brendshëm, janë:

2.1 Përgatitja e planit vjetor të auditimi duke përshkruar qëllimin dhe objektivat e aktiviteteve të auditimit të bazuar në vlerësimin e rrezikut, qëllimet dhe prioritetet e Komunës;

2.2 Vlerësimi i pasqyrave financiare dhe transaksioneve për të siguruar saktësinë dhe pajtueshmërinë me standardet, ligjet dhe rregulloret, përfshirë ekzaminimin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve dhe kontrolleve financiare;

2.3 Vlerësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të kontrolleve dhe proceseve të brendshme për të siguruar që ato mbrojnë asetet, ruajnë integritetin e të dhënave dhe promovojnë pajtueshmërinë me ligjet, rregulloret dhe politikat e brendshme;

2.4 Vlerësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të proceseve dhe procedurave operative duke identifikuar fushat për përmirësim dhe ofrimi i rekomandimeve për të rritur efikasitetin dhe për të ulur kostot;

2.5 Sigurimi i pajtueshmërisë me ligjet, rregulloret dhe politikat e brendshme duke verifikuar nëse respektohen kërkesat përkatëse ligjore dhe rregullatorë;

2.6 Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të auditimit dhe vlerësimi nëse janë ndërmarrë veprime korrigjuese si dhe bashkëpunimi me auditorët e jashtëm për të lehtësuar punën e tyre gjatë auditimit të komunës;

2.7 Vlerësimi sigurinë dhe integritetin e sistemeve të informacionit, menaxhimin e të dhënave dhe kontrollet e TI-së, duke adresuar rreziqet që lidhen me teknologjinë;

2.8 Përgatitja e raporteve të auditimit që përmbajnë gjetjet, rekomandimet dhe planet e veprimit si dhe ofrimi i këshillave për menaxhmentin.

3. Njësia e Auditim të Brendshëm udhëhiqet nga udhëheqësi i Njësisë i cili, i raporton Kryetarit të Komunës.

4. Numri i të punësuarve në Njësinë e Auditim të Brendshëm, është tre (3).

KAPITULLI III
INSTITUCIONET/NJËSITË E SHËRBIMEVE PUBLIKE KOMUNALE

Neni 53
Institucionet/Njësitë e shërbimeve publike komunale

1. Institucionet/Njësitë e shërbimeve publike komunale ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për qytetarët e komunës në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike.

2. Institucionet/Njësitë e shërbimeve publikë komunale, janë:

2.1 Arsimi Parauniversitar;

2.2 Qendra e Kryesore e Mjekësisë Familjare;

2.3 Qendra Kulturore;

2.4 Biblioteka e Qytetit;

2.5 Muzeu dhe Trashëgimia Kulturore;

2.6 Çështjet rezidenciale (Shtëpia e Komuniteteve).

3. Të punësuarit në institucionet e shërbimeve publik janë nëpunës të shërbimeve publike.

4. Procedurat e konkurrimit për institucionet e shërbimeve publike komunale organizohen nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e administratës së komunës.

5. Punëdhënës dhe organ emërtues i nëpunësve të shërbimeve publike është Kryetari i Komunës.

Neni 54
Arsimi Parauniversitar

1. Arsimi parauniversitar përfshin të gjitha nivelet e edukimit që zhvillohen në arsimin parashkollor, arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, i cili synon zhvillimin e njohurive bazë, aftësive dhe vlerave tek nxënësit për t'i përgatitur ata për jetën e përditshme dhe për vazhdimin e studimeve të larta.

1. Arsimi parauniversitar organizohet në si njësi të shërbimit publik, të cilat udhëhiqen nga drejtorët, që i raportojnë Drejtorit të Drejtorisë për Arsim në administratën komunale.

2. Shërbimet administrative, financiare dhe mbështetëse ofrohen nga njësitë organizative përkatëse të administratës komunale.

Neni 55
Qendra e Kryesore e Mjekësisë Familjare

1. QKMF, ofron shërbimet e kujdesi parësor shëndetësor në pajtim me politikat, planet, dhe standardet e përcaktuara me legjislacionin për shëndetësi dhe rregullat dhe planet e përcaktuara nga Drejtori për Shëndetësi në administratën në komunë.

2. QKMF, organizohet si institucion i shërbimit publik, udhëhiqet nga drejtori, i cili i përgjigjet dhe i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi në administratën komunale.

3. Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punë në QKMF bëhet me Rregullore e cila miratohet nga Kuvendi Komunal.

Neni 56
Qendra Kulturore

1. Qendra Kulturore është një institucion publik komunal, një hapësirë që ofron mundësi për organizimin, promovimin dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike, duke përfshirë koncerte, shfaqje teatrale, ekspozita arti, festivale dhe ngjarje të tjera kulturore. Përveç promovimit të krijimtarisë lokale dhe kombëtare, synon të nxisë

pjesëmarrjen aktive të komunitetit në jetën kulturore, duke shërbyer si një vendtakim për artistë, krijues dhe publikun e gjerë.

2. Qendra Kulturore, organizohet si njësi e shërbimit publik, udhëhiqet nga udhëheqësi, i cili i përgjigjet dhe i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe sport në administratën komunale.

3. Shërbimet administrative, financiare dhe mbështetëse ofrohen nga drejtoritë përkatëse të administratës komunale.

Neni 57
Biblioteka e Qytetit

1. Biblioteka e Qytetit është një institucion publik komunal i cili ofron qasje në materiale të ndryshme, përfshirë libra, revista, gazeta, materiale digjitale dhe burime të tjera informacioni për komunitetin lokal. Ajo shërben si qendër e edukimit, studimit dhe hulumtimit për qytetarët, duke ofruar shërbime për huazimin e librave, leximin në vend dhe organizimin e aktiviteteve kulturore dhe edukative.

2. Biblioteka, organizohet si njësi e shërbimit publik, udhëhiqet nga udhëheqësi, i cili i përgjigjet dhe i raporton i Drejtorit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në administratën komunale.

3. Shërbimet administrative, financiare dhe mbështetëse ofrohen nga njësitë organizative përkatëse të administratës komunale.

Neni 58
Muzeu dhe trashëgimia kulturore e qytetit

1. Muzeu dhe trashëgimia kulturore janë të dedikuara për ruajtjen e historisë dhe identitetit lokal, ekspozojnë artefakte të rëndësishme historike, artistike, shkencore dhe kulturore si dhe përfshin ndërtesa historike, tradita dhe forma të ndryshme arti, të cilat kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, veçanërisht përmes turizmit duke krijuar një lidhje të fortë ndërmjet të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes.

2. Muzeu dhe trashëgimia kulturore, organizohet si njësi e shërbimit publik, udhëhiqet nga udhëheqësi, i cili i përgjigjet dhe i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në administratën komunale.

3. Shërbimet administrative, financiare dhe mbështetëse ofrohen nga njësitë organizative përkatëse të administratës komunale.

Neni 59
Çështjet Rezidenciale

1. Shërbimet rezidenciale në Shtëpinë e Komuniteteve (Shtëpinë e të Moshuarve) përfshijnë ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe mbështetjes për banorët e vendosur brenda saj, të cilët janë pjesë e grupeve të cenueshme dhe me nevoja specifike. Shërbimet përfshijnë asistencë mjekësore, ndihmë në kryerjen e aktiviteteve të përditshme dhe mbështetje emocionale, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mirëqenies së tyre.

2. Çështjet rezidenciale organizohet si njësi e shërbimit publik, udhëhiqet nga udhëheqësi, i cili i përgjigjet dhe i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale në administratën komunale.

3. Shërbimet administrative, financiare dhe mbështetëse ofrohen nga njësitë organizative përkatëse të administratës komunale.

KAPITULLI I IV
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 60
Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Ndryshimi dhe plotësimi këtij Akti bëhet sipas procedurës së njëjtë të miratimit të këtij Akti.

2. Lëvizshmëria e personelit brenda institucionit bëhet në pajtim me legjislacionin për zyrtarët publik, nëse konsiderohet e nevojshme për mbarëvajtjen e punës.
3. Pranimi i personelit të parashikuar me këtë Rregullore për të cilin nuk ekziston buxhet aktual do të bëhet pas sigurimit të buxhetit me ligjin vjetor të buxhetit.

4. Rritja apo zvogëlimi i numrit të personelit në pajtim me ligjin vjetor të buxhetit nuk krijon nevojë për ndryshim dhe plotësim e këtij Akti, përveç në rastet kur krijohen dhe/apo shuhen strukturat organizative.

5. Shtojca Nr.1, që përmban klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe Shtojca Nr. 2, që përmban organogramin, janë pjesë përbërëse e këtij Akti.

Neni 61
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore , shfuqizohet Rregullorja për oeganizimin e brendshëm të administratës komunale Nr. 04/2021, datë 27.09.2021 si dhe çdo akt lidhur me organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale.

Neni 62

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në në ueb faqen zyrtare të komunës.

Enver Rugova

_____

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Shtojca Nr. 1 – Klasifikimi dhe sistematizimi i vendeve të punës

Struktura/Pozita	Kategoria/klasa sipas LZP-së	Klasa sipas LPSP-së	Koeficie-nti	Grupi i pozitave	Numri
1. ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS					**Totali: 33**
1.1 Kabineti i Kryetarit					**Totali: 7**
Kryetari i Komunës	Funksionar Publik	Y5	12.4		1
Nënkryetar i Komunës	Funksionar Publik	Y13	9.4		1
Shef i Kabinetit të Kryetarit	Zyrtar Kabineti 1	C8A	9.8		1
Asistente Administrative	Zyrtar Kabineti 1	C18	5		3
Vozitës	Zyrtar Kabineti 2	C23	4		1
Pozitat e nëpunësve civil në kuadër të Zyrës së Kryetarit					**Totali: 2**
Zyrtar i Lartë Certifikues	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i ekonomisë	1
Zyrtar i lartë për Integrime Evropiane	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i shkencave politike	1
Strukturat në kuadër të Zyrës së Kryetarit					
1.2 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore					**Totali: 3**
Udhëheqës i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Burime Njerëzore	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i burimeve njerëzore	2
Zyrtar për Burime Njerëzore	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i burimeve njerëzore	1
1.3 Zyra për Komunikim me Publikun					**Totali: 3**
Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i marrëdhënieve me publikun dhe informimin	1
Zyrtar i Lartë për Informim dhe Monitorim të Mediave	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i marrëdhënieve me publikun dhe informimin	1
1.4 Sektori Ligjor					**Totali: 5**
Udhëheqës i Sektorit Ligjor	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Avokat Komunal	Profesional 1	V6	7.5	Grupi ligjor	1
Zyrtar i Lartë Ligjor	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi ligjor	3
Zyrtar Ligjor	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi ligjor	2

1.5 Sektori për Komunitete dhe Kthim					**Totali: 6**
Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Komunitete	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i shkencave shoqërore	1
Zyrtar për Komunitete	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i shkencave shoqërore	2
Zyrtar për Kthim të Qëndrueshëm	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i shkencave shoqërore	2
1.6 Sektori për Prokurim Publik					**Totali: 4**
Udhëheqës i Sektorit për Prokurim Publik	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Prokurim	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i prokurimit publik	3
Zyrtar për Prokurim	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i prokurimit publik	1
1.7 Njësia për Auditim të Brendshëm					**Totali: 3**
Udhëheqës i Njësisë së Auditimit të Brendshëm	Drejtues i Ulët	W9	8.3	Grupi i auditimit të brendshëm	1
Auditor i Brendshëm	Profesional 1	W15	6	Grupi i auditimit të brendshëm	2
2. DREJTORIA PËR ADMINISTRATË DHE SHËRBIME TË PËRBASHKËTA					**Totali: 42**
Drejtor i Drejtorisë për Administratë dhe Shërbime të Përbashkëta	Funksionar Publik	Y20	8		1
2.1 Sektori për Shërbime të Përbashkëta					**Totali: 18**
Udhëheqës i Sektorit për Shërbime të Përbashkëta	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Çështjet e Kuvendit të Komunës	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi ligjor	1
Zyrtar për Logjistikë	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
Zyrtar i Lartë për Përkthime	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i përkthimit dhe interpretimit	1
Zyrtar për Përkthime	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i përkthimit dhe interpretimit	1
Asistent Administrativ (*recepsionist*)	Profesional 3	GJ45	3.92	Grupi i administrimit të përgjithshëm	2
Asistent i Depos	Profesional 3	GJ45	3.92	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
Mirëmbajtës	NTM2	GJ50	3.8		1
Roje	NTM3	GJ51	3.76		4
Pastrues	NTM3	GJ51	3.76		5
2.2 Sektori për Gjendje Civile					**Totali: 9**
Udhëheqës i Sektorit për Gjendje Civile	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Gjendje Civile	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
Zyrtar për Gjendje Civile	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i administrimit të përgjithshëm	7

2.3 Sektori për Shërbime për Qytetarë					**Totali: 6**
Udhëheqëse e Sektorit për Shërbime për Qytetar	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar për Shërbim me Qytetar	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i administrimit të përgjithshëm	5
2.4 Sektori për Teknologji Informative dhe Arkiv					**Totali: 5**
Udhëheqës i Sektorit për Teknologji Informative dhe Arkiv	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Teknologjisë Informative	Profesional 1 /Specialist	GJ13	6.52	Grupi i teknologjisë informative	1
Zyrtar për Teknologjisë Informative	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i teknologjisë informative	1
Zyrtar i Lartë për Arkiv	Profesional 1	GJ37	5.62	Grupi i arkiv-dokumentacionit	1
Asistent për Arkiv	Profesional 3	GJ45	3.92	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
2.5 Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore					**Totali: 3**
Udhëheqës i Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar për Mbrojtje të Fëmijeve dhe Riintegrim	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i përgjithshëm i shërbimeve sociale	1
Zyrtari lartë për Barazi Gjinore	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i shkencave shoqërore	1
3. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA					**Totali: 20**
Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa	Funksionar Publik	Y20	8		1
3.1 Sektori për Buxhet					**Totali: 6**
Udhëheqës i Sektorit për Buxhet	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Buxhet	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i buxhetit dhe financave	2
Zyrtar për Zotimin e Mjeteve Buxhetore	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i buxhetit dhe financave	1
Zyrtar për Buxhet	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i buxhetit dhe financave	2
3.2 Sektori për Financa					**Totali: 8**
Udhëheqës i Sektorit për Financa	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Financa	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i buxhetit dhe financave	1
Zyrtar për Shpenzime	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i buxhetit dhe financave	1
Zyrtar për Financa	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i buxhetit dhe financave	2
Zyrtar i Lartë për Raportim Financiar	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i buxhetit dhe financave	1
Zyrtar i Pasurisë	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i ekonomisë	1
Zyrtar i Lartë për të Hyra Financiare	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i buxhetit dhe financave	1

3.3 Sektori për Tatimin në Pronë					**Totali: 5**
Udhëheqës i Sektorit për Tatimin në Pronë	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Tatimin në Pronë	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i përgjithshëm i tatim-taksave apo mbledhjes së të ardhurave	2
Zyrtar për Tatim në Pronë	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i përgjithshëm i tatim-taksave apo mbledhjes së të ardhurave	2
4. DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE TURIZËM					**Totali: 8**
Drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik	Funksionar Publik	Y20	8		1
4.1 Sektori për Zhvillim Ekonomik					**Totali: 4**
Udhëheqës i Sektorit për Zhvillim Ekonomik	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Zhvillim të Zonave Ekonomike	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i ekonomisë	1
Zyrtar për Zhvillim të Zonave Ekonomike	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i ekonomisë	1
Zyrtar për Regjistrimin e Bizneseve	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
4.2 Sektori për Turizëm					**Totali: 3**
Udhëheqës për Zhvillim të Turizmit	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Politika të Turizmit	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i turizmit	1
Zyrtar për Promovim të Turizmit	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i turizmit	1
5. DREJTORIA PËR ARSIM					**Totali: 7**
Drejtor i Drejtorisë për Arsim	Funksionar Publik	Y20	8		1
5.1 Sektori për Arsim Parashkollor dhe Fillor					**Totali: 3**
Udhëheqës i Sektorit për Arsim Parashkollor dhe Fillor	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Arsim Parashkollor dhe Fillor	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i arsimit	1
Zyrtar për Çështje Pedagogjike	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i arsimit	1
5.2 Sektori për Arsim të Mesëm të Ulët dhe të Lartë					**Totali: 3**
Udhëheqës i Sektorit për Arsim të Mesëm të Ulët dhe të Lartë	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Arsim të Mesëm të Lartë	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i arsimit	1
Zyrtar i Lartë për Arsim të Mesëm të Ulët	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i arsimit	1
6. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT					**Totali: 7**
Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport	Funksionar Publik	Y20	8		1
6.1 Sektori për Kulturë					**Totali: 3**

Udhëheqës i Sektorit për Kulturë	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Trashëgimi Kulturore dhe Arkiv të Qytetit	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i shkencave shoqërore	1
Zyrtar për Kulturë	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i shkencave shoqërore	1
6.2 Sektori për Rini dhe Sport					**Totali: 3**
Udhëheqës i Sektorit për Rini	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar për Rini	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
Zyrtar i lartë për Sport	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
6.3 Qendra Kulturore - Njësi e shërbimeve publike					**Totali: 5**
Udhëheqës i Qendrës Kulturore	Drejtues i Ulët	I10	7.35		1
Zyrtar për Aktivitete Muzikore	Profesional 2	I15	5.1	Grupi i shkencave shoqërore	1
Bibliotekist	Profesional 2	E23	4.9	Grupi i shkencave shoqërore	3
7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI					**Totali: 4**
Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi	Funksionar Publik	Y20	8		1
7.1 Sektori për Shëndetësi					**Totali: 3**
Udhëheqës i Sektorit për Shëndetësi	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Shëndetësi	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i përgjithshëm i shëndetit	1
Zyrtar për Shëndetësi	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i përgjithshëm i shëndetit	1
8. DREJTORIA PËR MIRËQENIE SOCIALE					**Totali: 14**
Drejtor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale	Funksionar Publik	Y20	8		1
8.1 Sektori për Mirëqenie Sociale					**Totali: 4**
Udhëheqës i Sektorit për Mirëqenie Sociale	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar për Mirëqenie Sociale	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i administrimit të përgjithshëm	2
Zyrtar për Çështjet e Banimit	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
8.2 Sektori për Shërbime Sociale					**Totali: 5**
Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Sociale	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Shërbime Sociale	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i përgjithshëm i shërbimeve sociale	1
Zyrtar për Shërbime Sociale	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i përgjithshëm i shërbimeve sociale	3
8.3 Sektori për Ndihmë Sociale					**Totali: 4**
Udhëheqës i Sektorit për Ndihmë Sociale	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar për Ndihmë Sociale	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i punëve sociale	1

Asistent për Ndihmë Sociale	Profesional 3	GJ45	3.94	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
Pastrues	NTM3	GJ51	3.94		1
8.3 Shtëpia e Komunitetit - Njësi e shërbimeve publike					**Totali: 9**
Udhëheqës i Shtëpisë së Komunitetit	Drejtues i Ulët	I10	7.35		1
Infermier	Teknik mjekësor	H17	5.4		2
Ndihmës Infermier	Teknik mjekësor	H21	4.5		4
Kuzhinier	NTM3	I20	3.94		2
9. DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MJEDIS					**Totali: 8**
Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mjedis	Funksionar Publik	Y20	8		1
9.1 Sektori për Planifikim dhe Zhvillim Urban					**Totali: 4**
Udhëheqës i Sektorit për Planifikim dhe Zhvillim Urban	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Planifikim Urban	Profesional 1 /Specialist	GJ13	6.52	Grupi i planifikimit hapësinor	1
Zyrtar i Lartë për Ndërtim	Profesional 1 /Specialist	GJ13	6.52	Grupi i inxhinierisë së ndërtimit	1
Zyrtar për Leje Ndërtimore	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i inxhinierisë së ndërtimit	1
9.2 Sektori për Mbrojtje të Mjedisit					**Totali: 3**
Udhëheqës i Sektorit për Mbrojtje të Mjedisit	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Mbrojtje të Mjedisit	Profesional 1 /Specialist	GJ13	6.52	Grupi i përgjithshëm i mjedisit	1
Zyrtar për Leje Mjedisore	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i përgjithshëm i mjedisit	1
10. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE					**Totali: 8**
Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike	Funksionar Publik	Y20	8		1
10.1 Sektori për Shërbime Publike					**Totali: 4**
Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore	Profesional 1 /Specialist	GJ13	6.52	Grupi i inxhinierisë së ndërtimit	1
Zyrtar i Lartë për Efiçiencë të Energjisë	Profesional 1 /Specialist	GJ13	6.52	Grupi i inxhinierisë elektrike	1
Zyrtar i Lartë për Planifikim Hapësinor	Profesional 1 /Specialist	GJ13	6.52	Grupi i planifikimit hapësinor	1
10.2 Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave					**Totali: 3**
Udhëheqës i Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinave	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i përgjithshëm i mjedisit	2
11. DREJTORIA PËR EMERGJENCA, MBROJTJE DHE SHPËTIM					**Totali: 4**

Drejtor i Drejtorisë për Emergjenca, Siguri, Mbrojtje dhe Shpëtim.	Funksionar Publik	Y20	8		1
11.1 Sektori për Emergjenca					**Totali: 3**
Udhëheqës i Sektorit për Emergjenca	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar për Emergjenca	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i sigurisë	1
Asistent Administrativ *(për emergjencë)*	Profesional 3	GJ45	3.92	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
12. DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL					**Totali: 5**
Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	Funksionar Publik	Y20	8		1
12.1 Sektori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural					**Totali: 4**
Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Bujqësi	Profesional 1 /Specialist	GJ13	6.52	Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës	1
Zyrtar i Lartë për Pemëtari	Profesional 1 /Specialist	GJ13	6.52	Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës	1
Zyrtar për Pylltari	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës	1
13. DREJTORIA PËR KADASTËR, GJEODEZI DHE PRONA					**Totali: 11**
Drejtor i Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Prona	Funksionar Publik	Y20	8		1
13.1 Sektori për Kadastër dhe Gjeodezi					**Totali: 7**
Udhëheqës i Sektorit për Kadastër	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Kadastër dhe Gjeodezi	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi i gjeodezisë	1
Zyrtar për Kadastër	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i gjeodezisë	2
Zyrtar për Gjeodezi	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i gjeodezisë	1
Asistent për Gjeodezi	Profesional 3	GJ45	3.94	Grupi i administrimit të përgjithshëm	2
13.2 Sektori për Prona					**Totali: 3**
Udhëheqës i Sektorit për Prona	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Zyrtar i Lartë për Çështje Pronësore	Profesional 1	GJ29	5.62	Grupi ligjor	1
Zyrtar për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim	Profesional 2	GJ37	4.9	Grupi i ekonomisë	1
14. DREJTORIA PËR INSPEKTIME					**Totali: 9**
Drejtor i Drejtorisë për Inspektime	Funksionar Publik	Y20	8		1
14.1 Sektori për Inspektime të Ndërtimeve					**Totali 3:**
Udhëheqës i Sektorit për Inspektime të Ndërtimeve	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1

Inspektor për Ndërtime	Profesional 1	GJ21	6.52	Grupi i inxhinierisë së ndërtimit	2
14.2 Sektori për Inspektime të Shërbimeve Publike dhe Tregut					**Totali: 5**
Udhëheqës i Sektorit për Inspektime të Shërbimeve Publike dhe Tregut	Drejtues i Ulët	GJ5	7.22		1
Inspektor për Komunikacion	Profesional 1	GJ21	6.52	Grupi i inxhinierisë së ndërtimit	1
Inspektor për Mbrojtje të Mjedisit	Profesional 1	GJ21	6.52	Grupi i Planifikimit hapësinor	1
Inspektor për Tregun	Profesional 1	GJ21	6.52	Grupi i shkencave shoqërore	1
Inspektor për Veterinari	Profesional 1	GJ21	6.52	Grupi i veterinarisë	1

Komuna e Istogut

PLANI NDËRKOMUNAL PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE (PNMIM) PËR PESË KOMUNAT E RAJONIT TË DUKAGJINIT: PEJË, KLINË, ISTOG, DEÇAN DHE JUNIK 2025 – 2035

Ky plan është hartuar në bashkëpunim me komunat e rajonit të Dukagjinit (Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik), me mbështetje të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, financuar nga qeveria gjermane.

german cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Hartues: GFA CONSULTING GROUP · D&D Business Support Center · Resources & Waste Advisory Group

Numri i projektit : 22.2123.2-001.00

TN: 81305796

Komuna e Istogut

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE		**1**
1	**SFONDI**	**13**
1.1	Objektivi i Përgjithshëm i Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave	13
1.2	Kuadri ligjor dhe rregullator	13
1.2.1	Politikat dhe Direktivat e BE-së	13
1.2.2	Legjislacioni Nacional për Menaxhimin e Mbeturinave	16
1.2.2.1	Legjislacioni primar	17
1.2.2.2	Aktet Nënligjore	19
1.2.2.3	Transpozimi i kornizës ligjore të BE-së për menaxhimin e mbeturinave në kornizën ligjore të Kosovës	23
1.3	Korniza institucionale dhe organizative	24
1.3.1	Niveli nacional	24
1.3.2	Niveli lokal	28
1.4	Strategjia e Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave	29
1.4.1	Planet për Menaxhimim e Mbeturinave Komunale Inerte	30
2	**PËRSHKRIMI I RAJONEVE**	**33**
2.1	Karakteristikat fiziko-gjeografike	33
2.1.1	Vendndodhja Gjeografike	33
2.1.2	Klima	33
2.1.3	Kushtet Fizike	33
2.1.4	Rreziqet Natyrore	33
2.1.5	Përdorimi i Tokës	34
2.1.6	Zonat e Mbrojtura	34
2.2	Popullsia	35
2.3	Përshkrimi socio-ekonomik	35
2.3.1	Të dhëna për të ardhurat dhe shpenzimet për frymë/familje	35
2.3.2	Biznesi dhe industria	38
2.3.3	Turizmi	39
2.3.4	Bujqësia	39
3	**BAZA PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE**	**40**
3.1	Gjenerimi aktual i mbeturinave komunale	40
3.1.1	Amvisëritë	40
3.1.2	Burime komerciale dhe institucionale	41
3.1.3	Mbeturinat e gjelbra nga zonat publike	44
3.1.4	Mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit	44
3.2	Përbërja e mbeturinave	45
3.3	Ofrimi aktual i shërbimeve komunale për menaxhimin e mbeturinave	46
3.3.1	Grumbullimi i mbeturinave	46
3.3.2	Grumbullimi ndaras i mbeturinave	47
3.3.3	Transferimi i mbeturinave	47
3.3.4	Rikuperimi i mbeturinave	48
3.3.5	Deponimi i mbeturinave	48
3.3.6	Lëvizja e mbeturinave	50
3.3.7	Stafi për menaxhimin e mbeturinave	50
3.3.8	Tarifat e mbeturinave	50
3.3.9	Roli i sektorit jo-formal	51
3.4	Menaxhimi i mbeturinave tjera	51
3.4.1	Fraksionet e veçanta të mbeturinave	51
3.4.2	Mbeturinat e rrezikshme të amvisërisë	52
3.4.3	Mbeturinat medicinale	52
3.4.4	Mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit	53
3.4.5	Mbeturinat e vëllimshme	53
3.4.6	Mbeturinat bujqësore	54
3.4.7	Mbeturinat industriale	54

3.4.8	Mbeturinat nga ITUZ	54
3.5	Ndërgjegjësimi publik	54
3.6	Analiza e mangësive të situatës ekzistuese për menaxhimin e mbeturinave	54
4	**OBJEKTIVAT DHE SYNIMET**	**56**
5	**PARASHIKIMI I POPULLSISË DHE GJENERIMIT TË MBETURINAVE**	**58**
6	**ANALIZA E OPSIONEVE**	**60**
6.1	Supozimet dhe metodologjia	60
6.2	Parandalimi i mbeturinave	61
6.3	Grumbullimi i mbeturinave	62
6.3.1	Gjendja aktuale	62
6.3.2	Opsionet për grumbullimin e mbeturinave	62
6.3.3	Vlerësimet e kostos	69
6.4	Transporti dhe transferimi i mbeturinave	72
6.4.1	Situata aktuale	72
6.4.2	Llojet e stacioneve të transferit	72
6.4.3	Opsionet për transportin e mbeturinave	73
6.4.4	Krahasimi i kostos së opsioneve	74
6.5	Grumbullimi ndaras e mbeturinave	76
6.5.1	Gjendja aktuale	76
6.5.2	Pajisjet për magazinimin e mbeturinave dhe sistemet për grumbullimin ndaras të mbeturinave	76
6.5.3	Opsionet për grumbullimin ndaras të mbeturinave	77
6.5.4	Krahasimi i kostos së opsioneve	79
6.6	Riciklimi dhe rikuperimi i mbeturinave	82
6.6.1	Gjendja aktuale	82
6.6.2	Teknologjitë për klasifikimin e mbeturinave	82
6.6.3	Teknologjitë për trajtimin dhe rikuperimin e mbeturinave komunale	84
6.6.4	Kompostimi i mbeturinave të gjelbra	87
6.6.5	Grumbullimi ndaras dhe trajtimi i mbeturinave ushqimore (mbeturinave tjera organike)	92
6.7	Deponimi i mbeturinave	93
6.7.1	Gjendja aktuale	93
6.7.2	Zhvillimi i sistemit të deponimit të mbeturinave	93
6.7.3	Kostot e ndërlidhura	94
6.7.4	Mbyllja e deponive të vjetra	94
6.8	Skenarët për zhvillimin e një sistemi të integruar të menaxhimit të mbeturinave	94
6.8.1	Formulimi i skenarëve për sistemin e ardhshëm të menaxhimit të mbeturinave komunale	95
6.8.2	Krahasimi i kostove të skenarëve	96
6.9	Menaxhimi i fraksioneve tjera të mbeturinave	99
6.9.1	Mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit	99
6.9.2	Mbeturinat e vëllimshme	102
6.9.3	Fraksionet e veçanta të mbeturinave	103
6.9.4	Mbeturinat bujqësore	103
6.10	Opsionet për ndritjen institucionale dhe organizative	105
6.10.1	Grumbullimi i mbeturinave	105
6.10.2	Transferimi i mbeturinave	106
6.10.3	Kompostimi i mbeturinave të gjelbra të grumbulluara ndaras	107
6.10.4	Grumbullimi ndaras dhe klasifikimi i mbeturinave të ambalazhit	108
6.10.5	Operacionet e rikuperimit të mbeturinave	108
6.11	Qëndrueshmëria financiare dhe përballueshmëria e shërbimeve	109
6.12	Integrimi gjinor dhe përfshirja e grupeve të cenueshme	112
7	**ZHVILLIMI I SISTEMIT TË REKOMANDUAR**	**115**
7.1	Konfigurimi i sistemit	115
7.2	Kostot e investive dhe operacionale	117
7.3	Rrjedhat e mbeturinave dhe balanca e përgjithshme/masës i sistemit të rekomanduar	122
8	**PLANI I VEPRIMIT**	**124**
8.1	Aktivitetet kryesore	124

8.1.1	Aktivitetet dhe përgjegjësitë kryesore	124
8.1.2	Ndërlidhjet ndërmjet detyrave	124
8.2	Orari për zbatim	127
8.2.1	Aktivitete afatshkurtra për zbatim	127
8.2.2	Aktivitete afatmesme dhe afatgjata për zbatim	136
8.3	Kostot dhe burimet	142
8.3.1	Grumbullimi ndaras i materialeve të riciklueshme dhe klasifikimi	142
8.3.2	Kompostimi i mbeturinave të gjelbra	145
8.3.3	Kompostimi shtëpiak	147
8.3.4	Grumbullimi dhe transferimi i mbeturinave të përziera	148
8.3.5	Deponia	151
8.3.6	Rikuperimi i mbeturinave	153
8.3.7	Plani i financimit	156
8.3.8	Implikimet tarifore dhe përballueshmëria	156
8.4	Konsultimi publik, ndërgjegjësimi dhe masat edukative	162
8.4.1	Konsultimi publik	162
8.4.2	Masat e ndërgjegjësimit dhe edukimit	162
8.5	Monitorimi, vlerësimi dhe rishikimi i planit	163

SHTOJCA 1. BALANCAT E PËRGJITHSHME/MASËS SIPAS KOMUNAVE **164**

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Objektivat dhe synimet për sistemin rajonal 1
Tabela 2. Prezantimi i sistemit të preferuar 5
Tabela 3. Përmbledhje e planit të investimeve afatgjatë, mijë euro 9
Tabela 4. Tarifat mujore të amvisërisë në vitin 2027 10
Tabela 5. Transpozimi i kornizës ligjore të BE-së për menaxhimin e mbeturinave në kornizën ligjore të Kosovës 23
Tabela 6. Përgatitja për objektivat e ripërdorimit dhe riciklimit të mbeturinave komunale 30
Tabela 7. Objektivat për fraksionet e veçanta të mbeturinave 30
Tabela 8. Objektivat e riciklimit për mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit 30
Tabela 9. Masat e parapara në planet komunale për menaxhimin e mbeturinave 30
Tabela 10. Zonat e mbrojtura në rajon 34
Tabela 11. Popullsia e rajonit, 2011 dhe 2020 35
Tabela 12. Numri i familjeve në secilën komunë 35
Tabela 13. Numri i familjeve të angazhuara në aktivitete bujqësore 39
Tabela 14. Numri i bagëtive (krerë) 40
Tabela 15. Sipërfaqet e të korrave në hektarë (ha) 40
Tabela 16. Sipërfaqet e pemishteve, në ha 40
Tabela 17. Gjenerimi i mbeturinave nga amvisëritë (të mbledhura), 2021 dhe 2022 40
Tabela 18 . Gjenerimi i mbeturinave në rajonin e Pejës, 2023 41
Tabela 19. Normat e gjenerimit të mbeturinave, 2023 41
Tabela 20. Numri i bizneseve që marrin shërbimin e grumbullimit të mbeturinave komunale, 2021 41
Tabela 21. Numri dhe lloji i bizneseve në rajon, 2024 42
Tabela 22. Numri dhe lloji i institucioneve kryesore në rajon , 2024 42
Tabela 23 . Gjenerimi i MNRr-ve në Rajonin e Pejës, 2024 44
Tabela 24 . Përbërja e mbeturinave në Pejë 45
Tabela 25. Pronësia e pajisjeve dhe përgjegjësia për të investuar në pajisje 46
Tabela 26. Kontejnerët e grumbullimit të mbeturinave për amvisëri 46
Tabela 27. Kontejnerët e grumbullimit të mbeturinave për biznese dhe institucione 47
Tabela 28. Trendi i numrit të deponive të egra 49
Tabela 29. Numri dhe Karakteristikat e Venddeponive të Paligjshme, 2021 49
Tabela 30. Efikasiteti i stafit për menaxhimit të mbeturinave, 2021 50
Tabela 31. Tarifa mujore e mbeturinave të amvisërisë, EUR 50
Tabela 32. Tarifat mujore të mbeturinave për personat juridikë, EUR 50
Tabela 33. Tarifat e hyrjes në deponi, EUR 50
Tabela 34. Të hyrat aktuale vjetore nga tarifa e mbeturinave nga amvisëritë, EUR 51
Tabela 35. Të hyrat aktuale nga tarifa e mbeturinave nga personat juridikë 51

Tabela 36. Lista e kompanive të licencuara që merren me mbeturina të veçanta 52
Tabela 37. Mbeturinat medicinale të gjeneruara në spitalin rajonal në Pejë 53
Tabela 38. Sasitë e MM të gjeneruara nga ISh primare 53
Tabela 39. Sasitë e mbeturinave të trajtuara, 2015-2021, kg 53
Tabela 40. Aktivitete dhe fushata ndërgjegjësimi në lidhje me menaxhimin e mbeturinave në rajonin e Dukagjinit 54
Tabela 41. Analiza e mangësive të situatës ekzistuese për menaxhimin e mbeturinave 55
Tabela 42. Objektivat dhe synimet për sistemin rajonal 56
Tabela 43. Krahasimi i sistemeve të ndryshme të para-grumbullimit 63
Tabela 44. Kostot për njësi për kontejnerët dhe automjetet për grumbullimin e mbeturinave 70
Tabela 45. Numri i nevojshëm i kontejnerëve dhe automjeteve grumbulluese 71
Tabela 46. Vlerësimet e kostos për grumbullimin e mbeturinave të përziera komunale 71
Tabela 47. Krahasimi i alternativave për transferimin e mbeturinave 74
Tabela 48. Krahasimi i kostove të zbritura për njësi për grumbullimin dhe transferimin e mbeturinave për ton të mbeturinave të gjeneruara, € /ton 75
Tabela 49. Normat e supozuara të arritjes për fraksione të ndryshme të mbeturinave të ricikluesshme 78
Tabela 50. Krahasimi i alternativave për grumbullimin bdaras të mbeturinave të ricikluesshme 80
Tabela 51. Avantazhet dhe disavantazhet e alternativave të klasifikimit 82
Tabela 52. Çmimet e supozuara të tregut për mbeturinat e artikujve të ricikluesshëm 83
Tabela 53. Vlerësimet e kostos për alternativa të ndryshme për klasifikimin e mbeturinave të ricikluesshme të grumbulluara ndaras 84
Tabela 54. Teknologjitë e shndërrimit të mbeturinave në energji 84
Tabela 55. Vlerësimet e kostos së investimit TMB 87
Tabela 56. Vlerësimet e kostove operacionale të instalimit të TMB 87
Tabela 57. Krahasimi i skemave të ndryshme të grumbullimit të mbeturinave të kopshtit 89
Tabela 58. Karakteristikat kryesore dhe vlerësimet e kostove nëpër për kompostimin e mbeturinave të gjelbra në shtresa 91
Tabela 59. Krahasimi i kostos së alternativave për trajtimin e mbeturinave ushqimore të mbledhura ndaras 92
Tabela 60. Vlerësimet e kostove të investimeve në deponi 94
Tabela 61. Dispozitat për mbylljen e deponive ilegale, në EUR 94
Tabela 62. Opsionet për sistemin e integruar të menaxhimit të mbeturinave komunale 95
Tabela 63. Vlera aktuale e kostove të investimit për skenarë të ndryshëm, mijë € 96
Tabela 64. Kostot operative në vitin 2035 për skenarë të ndryshëm, mijë € 97
Tabela 65. Krahasimi i kostove të zbritura për njësi për ton mbeturinash të gjeneruara, për opsionet e ndryshme 97
Tabela 66. Sasitë e MNRr-ve në Rajonin e Dukagjinit 99
Tabela 67. Pajisjet për grumbullim dhe transport të MNRr-ve 100
Tabela 68. Rrjeti i pikave të hedhjes 100
Tabela 69. Kostot e investimit për menaxhimin e MNRr-ve 101
Tabela 70. Avantazhet dhe disavantazhet e opsioneve për grumbullimin e mbeturinave 105
Tabela 71. Avantazhet dhe disavantazhet e opsioneve për transferimin e mbeturinave 106
Tabela 72. Avantazhet dhe disavantazhet e opsioneve për kompostimin e mbeturinave të gjelbra të grumbulluara ndaras 107
Tabela 73. Avantazhet dhe disavantazhet e opsioneve për rikuperimin e mbeturinave 108
Tabela 74. Shpenzimet mesatare vjetore të familjeve, 2022 109
Tabela 75. Parashikimi i përballueshmërisë së tarifave të mbeturinave, çmimet e vitit 2024 110
Tabela 76. Tarifa e kostos mesatare të rikuperimit drejt vitit 2035, çmimet e vitit 2024 110
Tabela 77. 2022, Pagesa aktuale për person 111
Tabela 78. Tarifa e rikuperimit të kostos për mbeturinat e përziera, sipas komunave drejt vitit 2034 111
Tabela 79. Kostoja e rikuperimit për mbeturinat e përziera me stacion transferi me ngjeshje, 2035 112
Tabela 80. Vlerësimi i ndikimeve të mundshme tek personat e cenueshëm dhe masat specifike për integrimin gjinor dhe përfshirjen sociale 113
Tabela 81. Prezantimi i sistemit të preferuar 115
Tabela 82. Kostot e zbritura për njësi për sistemin e integruar të menaxhimit të mbeturinave për ton mbeturina të gjeneruara, € /ton 121
Tabela 83. Transporti dhe transferimi i mbeturinave 127
Tabela 84. Aktivitetet për zbatimin afatmesëm dhe afatgjatë, 2028-2035 137
Tabela 85. Materialet e ricikluesshme të graumbulluara ndaras nga komunat, ton, 2027-2035 142
Tabela 86. Sasitë vjetore të mbeturinave të gjelbra të grumbulluara ndaras 146
Tabela 87. Kostot investimit fillestar për kompostimin e mbeturinave të gjelbra 146
Tabela 88. Kostot e vlerësuara operacionale dhe mirëmbajtjes për kompostimin e hapur palë palë 146

Tabela 89. Të hyrat potenciale nga shitja e kompostit 147
Tabela 90. Kostot vjetore që do të mbulohen nga tarifa e mbeturinave, mijë euro 147
Tabela 91. Kostot komunale dhe mbeturinat e gjelbra dhe ushqimore të kompostuara në shtëpi në zonat rurale 148
Tabela 92. Pajisjet e nevojshme për grumbullimin e mbeturinave të përziera 2027 149
Tabela 93. Kostot investive në stacionet e transferit, mijë euro 150
Tabela 94. Kostot e grumbullimit të mbeturinave të përziera në Pejë, mijë euro 150
Tabela 95. Kostot e grumbullimit dhe transferimit të mbeturinave të përziera në Istog, mijë euro 150
Tabela 96. Kostot e grumbulllimit të mbeturinave të përziera në Klinë, mijë euro 150
Tabela 97. Kostot e grumbullimit dhe transferit të mbeturinave të përziera në Deçan, mijë euro 151
Tabela 98. Kostot e brumbullimit dhe transferimit të mbeturinave të përziera në Junik, mijë euro 151
Tabela 99. Sasitë e parashikuara të mbeturinave për deponi 151
Tabela 100. Vlerësimet e kostove fillestare të investimit në deponi 151
Tabela 101. Rrjedha e parasë në deponi, mijë euro 153
Tabela 102. Mbeturinat e pranuara për trajtim dhe rikuperim 153
Tabela 103. Vlerësimet e kostos së investimit në TMB dhe në kontejnerë të specializuar 154
Tabela 104. Kostot operatcionale për TMB-së dhe kompostimit në kontejnerë të specializuar, 2032 154
Tabela 105. Balanca e përgjithshme/masës e impiantit TMB 155
Tabela 106. Përmbledhja e kostove të rikuperimit dhe deponimit përfundimtar të mbeturinave, mijë euro 155
Tabela 107. Përmbledhje e planit afatgjatë të investimit, mijë euro 156
Tabela 108. Parashikimi i përballueshmërisë së tarifëave së mbeturinave, çmimet e vitit 2025 157
Tabela 109. Llogaritja e tarifës, komuna e Pejës, mijë euro 157
Tabela 110. Llogaritja e tarifës, komuna e Istogut, mijë euro 158
Tabela 111. Llogaritja e tarifës, komuna e Klinës, mijë euro 159
Tabela 112. Llogaritja e tarifës, komuna e Deçanit, mijë euro 160
Tabela 113. Llogaritja e tarifës, komuna e Junikut, mijë euro 161
Tabela 114. Balanca e përgjithshme/masës së mbeturinave në komunën e Pejës 164
Tabela 115. Balanca e përgjithshme/masës së mbeturinave në komunën e Istogut 164
Tabela 116. Balanca e përgjithshme/masës së mbeturinave në komunën e Klinës 165
Tabela 117. Balanca e përgjithshme/masës së mbeturinave në komunën e Deçanit 166
Tabela 118. Balanca e përgjithshme/masës së mbeturinave në komunën e Junikut 166

LISTA E FIGURAVE

Figura 1 . Parashikimi i popullsisë për Rajonin e Dukagjinit, 2024-2035 3
Figura 2. Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave komunale, 2024-2035 4
Figura 3. Vendndodhja e objekteve të parashikuara për menaxhimin e mbeturinave në ZMM 7
Figura 4. Kostot e investimit për operacionalizimin e menaxhimit të mbeturinave 8
Figura 5. Kostot vjetore operacionale për operacionet e menaxhimit të mbeturinave 9
Figura 6. Balanca e përgjithshme/masës e sistemit të propozuar të menaxhimit të mbeturinave 10
Figura 7. Bilanca e përgjithshme/masës e sistemit në vitin 2035 11
Figura 9. Korniza institucionale për menaxhimin e mbeturinave në nivel nacional 27
Figura 10. BPV për kokë banori sipas rajoneve dhe nivelit nacional, €, 2020 dhe 2021 36
Figura 11. Struktura ekonomike e rajonit të Pejës, vlera bruto e shtuar sipas aktiviteteve kryesore ekonomike, 2021, burimi ASK 37
Figura 12. Shkalla e punësimit dhe papunësisë në Kosovë, 2018-2023, Burimi ASK 38
Figura 13. Numri i vizitorëve vendas dhe ndërkombëtarë dhe netët e kaluara 39
Figura 14. Përbërja e MKI-ve sa i përket potencialit për riciklim/rikuperim 45
Figura 15. Pamje e deponisë në Sverkë 49
Figura 16 . Parashikimi i popullsisë për Rajonin e Dukagjinit, 2024-2035 58
Figura 17. Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave komunale, 2024-2035 59
Figura 18. Përbërja e mbeturinave komunale 59
Figura 19. Stacioni i transferi me ngjeshje 73
Figura 20. Stacione transferi pa ngjeshje 73
Figura 21. Ringarkimi nga automjeti mobil/satelitor (majtas) dhe ringarkimi në kontejnerin me ngjeshje (djathtas) 76
Figure 23. Lloje të ndryshme të sistemeve për sjelljen e mbeturinave 77
Figura 24. Banorët të cilëve u ofrohen shërbime të grumbullimit ndaras të mbeturinave 78

Figura 25. Shembuj të TMB 86
Figura 26. Sistemet e kompostimit 88
Figure 27. Shembull i një komposteri jo të kushtueshëm 91
Figure 28. Thërrmuesi për MNRr 101
Figure 29. Pikë grumbullimi për mbeturinat e vëllimshme 102
Figure 30. Oborr tipik riciklimi 103
Figura 31. Vendndodhja e objekteve të parashikuara për menaxhimin e mbeturinave në WMZ 117
Figura 32. Kostot e investimit për operacionalizimin e menaxhimit të mbeturinave 118
Figura 33. Kostot vjetore operacionale për operacionet të menaxhimit të mbeturinave 119
Figura 34. Kostot vjetore për operacione të menaxhimit të mbeturinave 120
Figura 35. Kostot vjetore për llojin e kostos 120
Figura 36. Kostot vjetore për njësi për ton mbeturina të gjeneruara 121
Figura 37. Bilanca e përgjithshme/masës e sistemit të propozuar të menaxhimit të mbeturinave gjatë periudhës së planifikimit. 123
Figura 38. Balanca e përgjithshme/masës e sistemit në vitin 2035 123
Figura 39. Kostot e investimieve për grumbullimin ndaras të mbeturinave 143
Figura 40. Kostot vjetore për grumbullimin ndaras, klasifikimin e materialeve të riciklueshme të grumbulluara ndaras dhe të hyrat nga shitjet e materialeve të riciklueshme 145
Figure 41. Impiant tipik kompostimi palë palë 146
Figura 42. Kostot vjetore operacionale në deponinë rajonale 152
Figura 43. Të hyrat e Pejës të parashikuara nga tarifat e amvisërisë në lidhje me përballueshmërinë 158
Figura 44. Të hyrat e Istogut të parashikuara nga tarifat e amvisërisë në lidhje me përballueshmërinë 159
Figura 45. Të hyrat e Klinës të parashikuara nga tarifat e amvisërisë në lidhje me përballueshmërinë 160
Figura 46. Të hyrat e Deçanit të parashikuara nga tarifat e amvisërisë në lidhje me përballueshmërinë 161
Figura 47. Të hyrat e Junikut të parashikuara nga tarifat e amvisërisë në lidhje me përballueshmërinë 162

LISTA E SHKURTESAVE

AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BNK	Bashkëpunimi Ndërkomunal
BPV	Bruto Produkti Vendor
DIMNUNI	Departamenti për Inspektimin e Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Infrastrukturës
EQ	Ekonomia Qarkore
IKMM	Inspektoriati i Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
IKSh	Institucionet e Kujdesit Shëndetësor
ITUZ	Impiant për Trajtimin e Ujërave të Zeza
KDM/RDF	Karburante të Derivuara nga Mbeturinat
KRM	Kompania Rajonale e Mbeturinave
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
ME	Ministria e Ekonomisë
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MKI/MSW	Mbeturina Komunale Inerte
MKSh	Mbeturinat e Kujdesit Shëndetësor
MIM	Menaxhim i Integruar i Mbeturinave
MMI	Menaxhimi i Mbeturinave Inerte
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MNRr/CDW	Mbeturina të Ndërtimit dhe Rrënimit
MpE/WfE	Mbeturina për Energji
NB/SAS	Ndarje në Burim
NP	Ndërmarrje Publike
OPP/PRO	Organizata me Përgjegjësi të Zgjeruar
OR/CAC	Oborr Riciklimi
ORM/MRF	Objekte për Rikuperimin e Mbeturinave

PNj	Plastikë Njëpërdorimëshe
PKMMNRr	Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbeturinave të Ndërtimit dhe Rrënimit
PNMIM	Plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave
SKMIM	Strategjia e Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave
ST	Stacion Transferi
TMB/MBT	Trajtimi Mekanik Biologjik
ZMM	Zona e Menaxhimit të Mbeturinave (Rajoni i Dukagjinit)

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Plani Ndërkomunal i Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave për rajonin e Dukagjinit synon të përmirësojë kushtet për ofrimin e shërbimeve publike dhe zhvillimin e ekonomive lokale në përputhje me kërkesat e BE-së, përmes promovimit të bashkëpunimit rajonal ndërkomunal dhe transferimit të njohurive midis sektorit publik, sektorit privat dhe shoqërisë civile. Ky plan synon gjithashtu t'u mundësojë autoriteteve lokale të përmirësojnë shërbimet komunale në përputhje me Agjendën e Gjelbër të BE-së për Ballkanin Perëndimor, duke kontribuar në arritjen e Agjendës 2030 dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Më konkretisht, objektivi kryesor i planit është të sigurojë krijimin e praktikave më të mira mjedisore për menaxhimin e integruar të mbeturinave në Rajonin e Dukagjinit. Megjithatë, transformimi drejt një sistemi të integruar dhe qarkor të menaxhimit të mbeturinave është sfidues për kokmunat individuale si në aspektin financiar ashtu edhe teknik dhe kërkon një përpjekje të koordinuar midis komunave për të zhvilluar një sistem rajonal të menaxhimit të mbeturinave me kosto efektive dhe të përballueshme.

Procesi i përgatitjes së këtij Plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) është mbikëqyrur në mënyrë aktive nga një Grup Teknik Pune, i përbërë nga përfaqësuesit e komunave të këtij rajoni. Procesi ka përfshirë një sërë prezantimesh nga një ekip konsulentësh, në fazat kryesore të procesit, duke përfshirë Studimin Bazë, Analizën e Opsioneve, Planin e Veprimit dhe PNMIM përfundimtar. Diskutimet e zhvilluara dhe refleksionet e marra në process mbi draft dokumentet kanë qenë shumë të çmueshme në sigurimin që ky PNMIM të përfshijë masa që janë si teknikisht të pranueshme ashtu edhe të mbështetura nga komunat partnere.

Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë (SKMIM) është marrë plotësisht në konsideratë, veçanërisht pasi ajo lidhet me përgjegjësitë e komunave në menaxhimin e integruar të mbeturinave (MIM), nevojën për të përmbushur në të ardhmen objektivat e riciklimit dhe shkarkimit të deponive, si dhe nevojën për të orientuar investimet në objektet dhe shërbimet e menaxhimit në burim të mbeturinave, duke mbështetur një tranzicion drejt një ekonomie rrethore.

Objektivat dhe synimet e PNMIM

Tabela më poshtë paraqet objektivat dhe synimet për sistemin e menaxhimit të mbeturinave në Rajonin e Dukagjinit, në përputhje me dispozitat e SKMIM 2024-2035.

Tabela 1Objektivat dhe synimet për sistemin rajonal

Objektivi	Treguesi	Baza	Objektivi	Viti
Rritja e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave	Përqindja e popullsisë së përgjithshme me qasje adekuate dhe të rregullt në shërbimet komunale të mbledhjes së mbeturinave	99%	100%	2026
Rritja e riciklimit dhe rikuperimit të burimeve	Mbeturinat komunale të gatshme për ripërdorim dhe riciklim	< 5%	20%	2030
			50%	2035
			60%	2045
	Popullsia që i ofrohen shërbime të grumbullimit të ndarë të mbeturinave	0%	80%	2030
			90%	2035
			100%	2045
	Rikuperimi i të gjitha mbeturinave të ambalazhit	< 5%	45%	2028
			60%	2030
			70%	2035

Objektivi	Treguesi	Baza	Objektivi	Viti
	Riciklimi i të gjitha mbeturinave të ambalazhit, përfshirë:			
	Plastikë	< 5%	22.5%	2028
			30%	2030
			50%	2035
	Letër dhe karton	< 5%	60%	2028
			70%	2030
			75%	2035
	Qelqi	< 5%	30%	2028
			50%	2030
			70%	2035
	Metalet me ngjyra	< 5%	30%	2028
			50%	2030
			70%	2035
	Alumin	< 5%	30%	2028
			40%	2030
			50%	2035
	Dru	< 5%	10%	2028
			15%	2030
			25%	2035
Të zvogëlohet varshmëria nga deponimi i mbeturinave	Deponimi i mbeturinave komunale	> 95%	< 30%	2035
			< 10%	2045
	Mbyllja e deponive komunale	70	0	2028
Rritja e riciklimit dhe rikuperimit të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit	Ripërdorimi dhe riciklimi i MNRr-ve	0%	40%	2030
			50%	2035
	Ripërdorimi, riciklimi dhe rikuperimi i materialeve të tjera të MNRr-ve	0%	60%	2030
			70%	2035

Parashikimi i popullsisë dhe gjenerimit të mbeturinave

Analiza e opsioneve është zhvilluar sipas parashikimeve të popullsisë dhe parashikimeve të gjenerimit të mbeturinave siç paraqitet në figurat e mëposhtme. Të dhënat e popullsisë bazohen në regjistrimin e fundit të popullsisë, publikuar në vitin 2024.



Figura 1. Parashikimi i popullsisë për Rajonin e Dukagjinit, 2024-2035

Siç shihet nga diagrami i mësipërm, popullsia e rajonit të Dukagjinit pritet të zvogëlohet në mënyrë të pandjeshme në periudhën e planifikimit dhe të mbetet pak nën 180 mijë banorë.

Figura më poshtë tregon një parashikim për sasitë e mbeturinave gjatë periudhës së planifikimit.



Figura 2Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave komunale, 2024-2035

Megjithëse popullsia e rajonit pritet të mbetet mjaft konstante, sasia e mbeturinave pritet të rritet me 7% në fund të periudhës së planifikimit dhe të arrijë në rreth 73,000 tonë në vitin 2035. Kjo vjen si pasojë e rritjes së pritshme të BPV-së gjatë kësaj periudhe.

Analiza e opsioneve dhe zhvillimi i sistemit të rekomanduar
Janë vlerësuar opsionet, të cilat mbulojnë komponentët e mëposhtëm të sistemit:

- Parandalimi i mbeturinave
- Mbledhja e mbeturinave
- Transporti dhe transferimi i mbeturinave
- Mbledhja ndaras e mbeturinave
- Riciklimi dhe rikuperimi i mbeturinave
- Deponimi i mbeturinave
- Marrëveshjet institucionale dhe organizative

Analiza e opsioneve krahasoi skenarë të ndryshëm me qëllim të identifikimit të shkallës së mundshme të kostove dhe përfitimeve që mund të vijnë nga këta skenarë të ndryshëm të riciklimit dhe trajtimit më intensiv në zonën e menax-himit të mbeturinave (ZMM).

Tabela më poshtë paraqet një përmbledhje të detajuar të sistemit të preferuar për sistemin e integruar të menaxhimit të mbeturinave inerte.

Tabela 2Prezantimi i sistemit të preferuar

Elementi i sistemit	Përshkrimi	Kapaciteti	Viti/periudha
Parandalimi i mbeturinave	Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të kompostimit shtëpiak Miratimi i udhëzimeve për prokurimin e gjelbër publik Mbështetja e bizneseve lokale në zbatimin e masave për parandalimin e mbeturinave ushqimore Pjesëmarrja në nismat kombëtare për reduktimin e plastikës njëpërdorimshe	• n/a	Vazhdimisht
Grumbullimi i mbeturinave të përziera	Shporta individuale plastike 120/240 l për shtëpi familjare Shporta plastike individuale 120/240 l ose kontejnerë 1.1 m³ për ndërtesa shumëkatëshe në zonat urbane	• 54,234 tonë mbeturina të përziera të mbledhura në vitin 2026 • 37,644 ton të mbledhura në vitin 2035	Ndërrimi gradual i kontejnerëve dhe automjeteve grumbulluese
Mbledhja ndaras e mbeturinave	Shporta individuale plastike 120/240 l për grumbullimin e materialeve të ricikluesshme, Kontejnerë 1.1 - 1.5 m³ për grumbullimin e veçantë të qelqit	• 100% e banorëve në zonat urbane dhe 80% e banorëve në zonat rurale • 19,000 tonë mbeturina të mbledhura ndaras më 2035	2026 në zonat urbane 2030 për zonat rurale
Oborret e Riciklimit (OR)	Do të krijohen 5 OR, një në secilën komunë	Fraksionet e mbeturinave që do të grumbullohen: • Mbeturinat e vëllimshme • Mbeturinat e rrezikshme shtëpiake • Fraksionet e veçanta të mbeturinave	2025
Transporti dhe transferimi	Stacionet e transferit do të ngriten në Istog dhe Deçan	• Istog – kapacitet prej 9,700 tonë /vit • Deçan – kapacitet prej 6,700 tonë/vit	2026
Klasifikimi i mbeturinave	Një stacion klasifikimi për materialet e grumbulluara ndaras do të ngritet në deponinë rajonale në Sferkë	• Kapaciteti i objektit ORM – 21,000 tonë/vit të lëndëve të ricikluesshme të mbledhura ndaras	2026
Kompostimi	Katër objekte kompostimi për mbeturinat e gjelbra të grumbulluara veçmas do të ngriten në komunat Pejë, Istog , Klinë dhe Deçan. Kompostimi në Pejë do të organizohet në lokacion të përhershëm, ndërsa në komunat tjera do të zbatohet kompostimi i decentralizuar duke përdorur pajisje mobile.	• Objekti i kompostimit në Pejë – kapacitet prej 2,400 tonë/vit • Objekti i kompostimit në Istog – kapacitet 600 tonë/vit • Objekti i kompostimit në Klinë – kapacitet 600 tonë/vit • Objekti i kompostimit në Deçan – kapacitet 550 tonë/vit	2026

Elementi i sistemit	Përshkrimi	Kapaciteti	Viti/periudha
	Filiimi me kompostimin shtëpiak në zonat rurale	• n/a	I perhershem
Rikuperimi i mbeturinave	Do të ngritet 1 impiant TMB i cili do të trajtojë mbeturinat e përziera komunale nga të pesë komunat	• Kapaciteti prej 40,000 tonë/ vit • Prodhimi prej 12,000 tonë/vit KDM	2031
	1 impiant kompostimi brenda kontonjerëve të specializuar do të ngritet[1]në hapësirën e impiantit TMB ose në objektin e kompostimit në Pejë	• Kapaciteti prej 3,500 tonë/vit	2031
Deponimi i mbeturinave	Përmirësimi ildeponisë sanitare rajonale ekzistues për të gjithë ZMM	• Kapaciteti i deponisë prej rreth 475 mijë tonë[2] për një periudhë 20 vjeçare	2026 për qelinë e parë dhe infrastrukturën e përbashkët
MNRr	Rrjeti i pikave të hedhjes	• Pejë (që shërben edhe Deçanin dhe Junikun) me kapacitet prej 5,400 m³/vit	2025-2027
		• Istog - kapaciteti 2,900 m³/vit	2025-2027
		• Klinë - kapaciteti 2,400 m³/vit	2025-2027
		• Deçan (që shërben edhe Junikun) me kapacitet 2,400 m³/vit	2025-2027
	Një objekt riciklimi me një thërmues mobil	• Kapaciteti 12,800 m³/vit	2027
	Një objekt deponimi	• Kapaciteti 19,300 m³/vit	2027

Shifrat e mëposhtme paraqesin vendndodhjen e objekteve të parashikuara për menaxhimin e mbeturinave në ZMM

[1]Përndryshe, mund të ngritet një strukturë e tretjes anaerobe në vendin e impiantit TMB, në varësi të gjetjeve të studimit përkatës të fizibilitetit.

[2] Nuk përfshihen mbeturinat industriale jo të rrezikshme



Figura 3 Vendndodhja e objekteve të parashikuara për menaxhimin e mbeturinave në ZMM

PNMIM gjithashtu identifikon menaxhimin e preferuar të fraksioneve tjera të mbeturinave, si mbeturinat e vëllimshme, mbeturinat bujqësore dhe fraksionet e veçanta të mbeturinave, Masat fillestare për mbeturinat e vëllimshme do të përqendrohen në shërbimin e grumbullimit të planifikuar të organizuar nga komunat. Përveç kësaj, familjeve do t'u ofrohet gjithashtu mundësia që mbeturinat e tyre të vëllimshme t'I dërgojnë në oborret e centralizuara të riciklimit. Lidhur me mbeturinat bujqësore, do të zhvillohen udhëzuesit për ruajtjen e plehut organik në fermë, kompostimin e mbeturinave bujqësore dhe rikuperimin e energjisë nga biomasa.

Pasi skemat e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (PZP) të funksionalizohen plotësisht në vend, komunat në ZMM do të lidhin kontrata me operatorët e PZP-së për mbledhjen ndaras të fraksioneve specifike të mbeturinave, si mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike, vajrat e përdorura, automjetet e hedhura dhe mbeturinat e tyre, bateritë dhe akumulatorët e harxhuar dhe gomat e shpenzuara. Amvisëritë do të lejohen të hedhin në oborret e riciklimit fraksione të ndryshme të grumbulluara ndaras, si lloje të ndryshme të mbeturinave të ricklueshme, mbeturina të gjelbra, mbeturina të vëllimshme, vajra të përdorura, lloje specifike të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit. Oborret e riciklimit do të jenë gjithashtu të pajisura për të mbledhur mbeturnat e rrezikshme shtëpiake.

Çdo komunë do të jetë përgjegjëse për rritjen e ndërgjegjësimit të banorëve të saj në lidhje me kërkesat dhe detyrimet e menaxhimit të mbeturinave dhe për rritjen e pjesëmarrjes së publikut në programet e ardhshme të grumbullimit ndaras dhe të kompostimit shtëpiak.

Kostot dhe financimi i menaxhimit të mbeturinave

Kostot e investimit gjatë periudhës së planifikimit vlerësohen në 54.6 milionë €, duke përfshirë kostot për zëvendësimin e aseteve.



Figura 4 Kostot e investimit për operacionalizimin e menaxhimit të mbeturinave

Kostot vjetore të operacionale pritet të rriten me ndërtimin e deponisë së re dhe me filimin e grumbullimit ndaras të mbeturinave të riciklueshme dhe kompostimit të mbeturinave të gjelbra, nga 5.3 milionë € në 2026 në 7.8 milionë € në 2031 kur priten të funksionalizohen impianti TMB si dhe grumbullimi ndaras i mbeturinave ushqimore.



Figura 5 Kostot vjetore operacionale për operacionet e menaxhimit të mbeturinave

Tabela më poshtë përmbledh investimet e vlerësuara për masat e planifikuara për periudhën 2026-2031 në Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave (ZMM):

Tabela 3Përmbledhje e planit të investimeve afatgjatë, mijë euro

	2026	2027	2028	2029	2030	2031	Burimi
	Faza I					Faza II	
Pajisjet e grumbullimit ndaras të mbeturinave & objekti i klasifikimit	1,575	2,855	567	570	397	444	**PZP**
OR-të	800						grant
Objekti i kompostimit në Pejë	912						grant
Pajisjet për kompostim në Istog, Klinë, Deçan	702						grant
Stacioni i Transferit Istog	575	119					grant
Stacioni i Transferit Deçan	607	119					grant
Deponia rajonale	10,248					1,458	grant/hua
TMB rajonale						15,254	grant
Objekti rajonal i trajtimit në kontejnerë të specializuar						3,897	grant
Gjithsej	15,419	3,093	567	570	397	21,053	

	2026	2027	2028	2029	2030	2031	Burimi
Totali, pa investimet nga skema PZP	13,844	238	0	0	0	20,609	

Investimi total për periudhën arrin në 41 milionë euro, 6.4 milionë euro do të sigurohen nga skema PZP. Kredia është konsideruar për ndërtimin e qelisë së dytë të deponisë. Për pjesën tjetër të investimit do të kërkohet financim me grante, nga të cilat 14 milionë euro për fazën e parë dhe 19 milionë euro për fazën e dytë.

Masat e planifikuara janë të përballueshme nën supozimin se financimi fillestar i grantit të kapitalit për të gjitha komunat do të sigurohet. Tarifa mesatare mujore në secilën komunë për një familje prej 4 personash është vlerësuar për vitin 2027 (me çmimet e vitit 2025) dhe paraqitet në tabelën vijuese.

Tabela 4Tarifat mujore të amvisërisë në vitin 2027

Komuna	Pejë	Istog	Klinë	Deçan	Junik
Tarifa mesatare mujore për amvisëri	8 €	8 €	7.6 €	6.6 €	5.7 €

Rrjedha e mbeturinave dhe bilanca e përgjithshme/masive e sistemit të rekomanduar

Shifrat e mëposhtme tregojnë balancën e përgjithshme/masës të sasive të mbeturinave për periudhën e planifikimit dhe për referencën e vitit të kaluar (2035).



Figura 6 Balanca e përgjithshme/masës e sistemit të propozuar të menaxhimit të mbeturinave gjatë periudhës së planifikimit

Figura 7Bilanca e përgjithshme/masës e sistemit në vitin 2035

Balanca e përgjithshme/masës tregon se në vitin 2035 do të arrihet një shkallë riciklimi 50.1% për peshën e mbeturinave të gjeneruara komunale ndërsa sasia e mbeturinave komunale të deponuara do të reduktohet në 17.8%.

Plani i Veprimit

Një Plan Veprimi përcakton veprimet prioritare të nevojshme për zbatimin e masave të parashikuara, duke mbuluar të gjitha fraksionet me prioritet të mbeturinave, buxhetin e nevojshëm për secilin aktivitet, burimin e financimit, përgjegjësitë për zbatim dhe treguesit e performancës. Plani i Veprimit do të përditësohet sipas nevojës dhe në varësi të progresit të zbatimit të aktiviteteve.

Plani i Veprimit përmban aktivitete të cilat do të jenë përgjegjësi individuale e komunave dhe si të tilla të ndërlidhen me ngritjen e objekteve rajonale për menaxhimin e mbeturinave dhe rrjedhimisht do të jenë përgjegjësi e të gjitha komunave.

Më poshtë janë renditur aktivitetet kryesore të cilat do të jenë përgjegjësi e komunave individuale :

- Masat për parandalimin e mbeturinave (të 5 komunat)
- Të fillohet me grumbullimin ndaras të mbeturinave të riciklueshme të thata (të 5 komunat)
- Ngritja e oborreve të riciklimit (të 5 komunat)
- Krijimi i dy stacioneve të transferit (për komunën e Istogut dhe Deçanit)
- Krijimi i një objekti kompostimi për mbeturinat e gjelbra të grumbulluara ndaras (në komunën e Pejës) dhe zbatimi i kompostimit të decentralizuar të mbeturinave të gjelbra duke përdorur pajisje mobile në komunat Istog, Klinë, Deçan dhe Junik.
- Të fillohet me kompostimin shtëpiak në zonat rurale (të 5 komunat)

- Krijimi i katër pikave të hedhjes së mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi (në komunat Pejë, Istog, Klinë dhe Deçan)

Lista e mëposhtme tregon aktivitetet kryesore që do të zbatohen në nivel rajonal :

- Përmirësimi i deponisë sanitare rajonale ekzistuese
- Krijimi i një objekti klasifikimi për mbeturinave të riciklueshme të grumbulluara ndaras
- Ngritja e një impianti TMB për trajtimin e mbeturinave të përziera komunale
- Ngritja e një impianti për trajtimin e mbeturinave organike (kompostimi në kontenjerë të specializuar ose impiant të tretjes anaerobe)
- Ngritja e një objekti riciklimi për mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit
- Ngritja e një venddeponimi për mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit

Aktivitetet e parashikuara për vitet e para të zbatimit synojnë adresimin e problemeve dhe mangësive më urgjente për periudhën 2025-2027. Aktivitetet e parashikuara për zbatim afatmesëm (për periudhën 2028-2035) synohet të ngriten mbi veprimet afatshkurtra me qëllim të krijimit të një sistemi të integruar ndërkomunal të menaxhimit të mbeturinave, duke i mundësuar komunave të arrijnë objektivat e vendosura për vitin 2035.

1 SFONDI

1.1 Objektivi i Përgjithshëm i Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave

Plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Dukagjinit synon të përmirësojë kushtet për ofrimin e shërbimeve publike dhe zhvillimin e ekonomive lokale në përputhje me kërkesat e BE-së, përmes promovimit të bashkëpunimit ndërkomunal rajonal dhe transferimit të njohurive ndërmjet sektorit publik, sektorit privat dhe shoqërisë civile. Ky plan synon gjithashtu të mundësojë që autoritetet lokale të përmirësojnë shërbimet komunale në përputhje me Agjendën e Gjelbër të BE-së për Ballkanin Perëndimor, duke kontribuar në arritjen e Agjendës 2030 dhe të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Më konkretisht, objektivi primar i planit është të sigurojë vendosjen e praktikave më të mira mjedisore për menaxhimin e integruar të mbeturinave në Rajonin e Dukagjinit. Transformimi drejt sistemit qarkor dhe të integruar të menaxhimit të mbeturinave, megjithatë, është financiarisht dhe teknikisht sfidues për komunat veç e veç dhe kërkon një përpjekje të koordinuar ndërmjet komunave për të zhvilluar një sistem rajonal të menaxhimit të mbeturinave me kosto efikase dhe të përballueshme.

Qëllimi i Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave është të përcaktojë status quo-në e menaxhimit të mbeturinave dhe të identifikojë masat për përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave në Rajonin e Dukagjinit. Objektivi i këtijj PNMIM/IIWMP është të paraqesë një vizion të menaxhimit të mbeturinave për vitet në vijim.

Plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM/IIWMP) për rajonin është zhvilluar në përputhje me objektivat shtetërore për menaxhimin e mbeturinave dhe i udhëhequr nga masat e parapara për rajonin në Strategjinë e Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 2024-2035 dhe Planin e Veprimit 2024-2026 (SKMIM/KIWMS).

1.2 Kuadri ligjor dhe rregullator

1.2.1 Politikat dhe Direktivat e BE-së

Legjislacioni i BE-së për menaxhimin e mbeturinave përbëhet nga aktet kryesore të mëposhtme:

- Direktiva Kuadër për Mbeturpnat (Direktiva 2008/98/KE)
- Direktiva 94/62/KE për paketimin dhe mbeturinat e paketimit
- Direktiva 1999/31/KE për vendgrumbullimin e mbeturinave
- Direktiva (BE) 2019/904 për reduktimin e ndikimit të disa produkteve plastike në mjedis
- Direktiva 2012/19/BE për mbeturinat nga pajisjeve elektrike dhe elektronike (MPEE/WEEE)
- Direktiva 2011/65/BE për kufizimin e përdorimit të substancave të caktuara të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike
- Direktiva 2006/66/KE për bateritë dhe akumulatorët dhe mbeturinat e baterive dhe akumulatorët
- Direktiva 2000/53/KE për automjetet mbeturinë
- Direktiva 2010/75/BE mbi emetimet industriale
- Direktiva 96/59/KE deponimi i bifenileve të poliklorinuara dhe terfenileve të poliklorinuara (PCB/PCTs)
- Rregullorja (KE) Nr. 2150/2002 për statistikat e mbeturinave të BE-së
- Rregullorja No 1013/2006 për dërgesat e mbeturinave

Direktiva 2008/98/KE për mbeturinat (Direktiva Kuadër për Mbeturinat). Kjo krijon kuadrin ligjor për menaxhimin e mbeturinave në Bashkimin Evropian. Direktiva përcakton hierarkinë e mëposhtme të aktiviteteve për menaxhimin e mbeturinave:

Figura 8. Hierarkia e mbeturinave siç përshkruhet në DKM/WFD

Ai konfirmon parimin 'ndotësi paguan', sipas të cilit prodhuesi fillestar i mbeturinave duhet të paguajë për kostot e menaxhimit të mbeturinave. Ai prezanton konceptin e 'përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit', sipas të cilit prodhuesit e produkteve mbajnë përgjegjësi financiare ose përgjegjësi financiare dhe organizative për menaxhimin e fazës së mbeturinave të ciklit jetësor të një produkti .

Direktiva përmban gjithashtu dispozitat kryesore të mëposhtme:

- Menaxhimi i mbeturinave duhet të kryhet pa asnjë rrezik për ujin, ajrin, tokën, bimët ose kafshët, pa shkaktuar shqetësime përmes zhurmës ose aromave, ose pa dëmtuar fshatin ose vendet me interes të veçantë.
- Prodhuesit ose mbajtësit e mbeturinave duhet t'i trajtojnë ato vetë ose t'ia lënë ato një operatori të njohur zyrtarisht. Të dyja kërkojnë leje dhe inspektohen periodikisht.
- Autoritetet kombëtare kompetente duhet të hartojnë plane për menaxhimin e mbeturinave dhe programe për parandalimin e mbeturinave.
- Kushte të veçanta zbatohen për mbeturinat e rrezikshme, vajrat e përdorur dhe mbeturina organike.
- Ai prezanton objektivat e riciklimit dhe rikuperimit që duhen arritur deri në vitin 2020 për mbeturinat shtëpiake (50%) dhe mbeturinat e ndërtimit dhe prishjes (70%).

Si pjesë e një pakete masash mbi ekonominë rrethore, Direktiva (BE) 2018/851 ndryshon Direktivën 2008/98/KE. Ajo përcakton kërkesat minimale operative për skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit. Këto mund të përfshijnë gjithashtu përgjegjësinë organizative dhe një përgjegjësi për të kontribuar në parandalimin e mbeturinave dhe në ripërdorshmërinë dhe riciklueshmërinë e produkteve. Ajo forcon rregullat mbi parandalimin e mbeturinave.

Direktiva gjithashtu vendos objektiva të reja për riciklimin e mbeturinave komunale:

- Deri në vitin 2025, të paktën 55% e mbeturinave urbane sipas peshës do të duhet të riciklohen. Ky objektiv do të rritet në 60% deri në vitin 2030 dhe në 65% deri në vitin 2035.
- Shtetet Anëtare duhet:
  - të vendosin, deri më 1 janar 2025, një grumbullim të veçantë të tekstileve dhe mbeturinave të rrezikshme të krijuara nga familjet;

- të sigurojnë që deri më 31 dhjetor 2023, mbeturinat biologjike të mblidhen veçmas ose të riciklohen në burim (për shembull, përmes kompostimit).

Direktiva thekson gjithashtu shembuj të stimujve për të aplikuar hierarkinë e mbeturinave, të tilla si tarifat e deponimit dhe asgjësimit me djegie si dhe skemat e pagesës sipas sasisë së hedhur.

Direktiva 94/62/EC për paketimin dhe mbeturinat e paketimit. Ajo përcakton rregullat e BE-së për menaxhimin e paketimit dhe mbeturinat e paketimit. Synon harmonizimin e masave kombëtare në lidhje me menaxhimin e ambalazheve dhe mbeturinave të paketimit dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit duke parandaluar dhe reduktuar ndikimin e ambalazheve dhe mbeturinave të paketimit në mjedis.

Vendet e BE-së duhet gjithashtu të marrin masat e nevojshme për të përmbushur objektivat e riciklimit, të cilat ndryshojnë në varësi të materialit të paketimit. Për këtë qëllim, ata duhet të zbatojnë rregullat e reja të llogaritjes për raportimin mbi objektivat e reja të riciklimit që duhet të arrihen deri në vitin 2025 dhe 2030.

Deri më 31 dhjetor 2025, të paktën 65% e sasisë së të gjitha mbeturinave të paketimit duhet të riciklohen. Deri më 31 dhjetor 2030, të paktën 70% e sasisë së të gjitha mbeturinave të paketimit duhet të riciklohen.

Direktiva 1999/31/EC për vendgrumbullimin e mbetuirnave. Direktiva synon të parandalojë, ose të zvogëlojë sa më shumë që të jetë e mundur, çdo ndikim negativ nga deponia në ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore, tokën, ajrin ose shëndetin e njerëzve. Ajo e bën këtë duke futur kërkesa të rrepta teknike. Deponitë ndahen në 3 kategori: deponi për mbetuirna të rrezikshme; deponi për mbetuirna jo të rrezikshme; dhe deponi për mbetuirna inerte (mbeturinat të cilat nuk do të dekompozohen apo digjen, si zhavorri, rëra dhe gurët).

Vendet e BE-së duhet të zbatojnë strategji kombëtare për të reduktuar në mënyrë progresive sasinë e mbetuirnave të biodegradueshme të dërguara në deponi. Objektet e deponive nuk mund të pranojnë goma të përdorura ose mbetuirna të lëngshme, të ndezshme, shpërthyese ose gërryese, ose ato nga spitalet dhe praktikat mjekësore dhe veterinare. Vetëm mbeturinat që janë trajtuar mund të deponohen.

Direktiva (BE) 2019/904 për reduktimin e ndikimit të disa produkteve plastike në mjedis. Direktiva synon të parandalojë dhe zvogëlojë ndikimin e produkteve të caktuara plastike në mjedis dhe të promovojë një tranzicion drejt një ekonomie qarkore në të gjithë Bashkimin Evropian (BE) duke futur një kombinim masash të përshtatura për produktet e mbuluara nga direktiva, në veçanti duke siguruar që produktet plastike njëpërdorimshe(PNjP/SUP), për të cilat ekzistojnë alternativa më të qëndrueshme dhe të përballueshme, nuk mund të vendosen në treg. Ajo ofron strategjinë e BE-së për plastikën, një element i rëndësishëm në lëvizjen e BE-së drejt një ekonomie qarkore.

Direktiva 2012/19/BE për mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike (MPEE/WEEE). Direktiva synon të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut duke inkurajuar prodhimin dhe konsumin e qëndrueshëm. Kjo bëhet duke parandaluar krijimin e mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike (MPEE/WEEE), duke promovuar ripërdorimin, riciklimin dhe mënyra tjera të rikuperimit të mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike (PEE/EEE), dhe duke mbështetur përdorimin efikas të burimeve dhe rikuperimin e lëndëve të para të vlefshme dytësore.

Direktiva 2011/65/BE — kufizim i përdorimit të substancave të caktuara të rrezikshme nga pajisjet elektrike dhe elektronike. Direktiva forcon rregullat ekzistuese për përdorimin e substancave të rrezikshme, si plumbi, zhiva dhe kadmiumi, në pajisjet elektrike dhe elektronike (PEE/EEE) për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin, në veçanti duke mundësuar rikuperimin dhe trajtimin e mbeturinave nga PEE/EEE. Kjo përditëson Direktivën 2002/95/KE e cila kufizoi përdorimin e substancave të caktuara të rrezikshme nga PEE/EEE, ndër të tjera, duke zgjeruar kufizimet në përdorimin e substancave të rrezikshme në një gamë më të gjerë të PEE/EEE.

Direktiva 2006/66/KE për bateritë dhe akumulatorët dhe mbeturinat e baterive dhe akumulatorëve. Direktiva ndalon vendosjen në treg të disa baterive (ose akumulatorëve) me përmbajtje merkuri ose kadmiumi mbi një prag të dakorduar. Ajo promovon një shkallë të lartë të grumbullimit dhe riciklimit të baterive mbeturinë dhe përmirësimin e performancës mjedisore të të gjithë të përfshirëve në ciklin e jetës së baterive, duke përfshirë riciklimin dhe deponimin e tyre. Qëllimi është të zvogëlohet sasia e substancave të rrezikshme – në veçanti, merkurit, kadmiumit dhe plumbit – të hedhura në mjedis; kjo duhet bërë duke reduktuar përdorimin e këtyre substancave në bateri dhe duke trajtuar dhe ripërdorur sasitë që përdoren.

Direktiva 2000/53/KE për automjetet e hedhura dhe mbeturinat e tyre. Direktiva përcakton masat për të parandaluar dhe kufizuar mbeturinat nga automjetet mbeturinë (AM/ELV) dhe përbërësit e tyre duke siguruar ripërdorimin, riciklimin dhe rikuperimin e tyre. Ajo synon gjithashtu të përmirësojë performancën mjedisore të të gjithë operatorëve ekonomikë të përfshirë në ciklin e jetës së automjeteve. Gjatë projektimit dhe prodhimit të produkteve të tyre, prodhuesit e automjeteve dhe pajisjeve përcjellëse duhet të marrin parasysh çmontimin, ripërdorimin dhe rikuperimin e automjeteve. Ata duhet të sigurojnë që automjetet e reja janë:

- të ripërdorshme dhe/ose të riciklueshme në një minimum prej 85% të peshës për automjet
- të ripërdorshme dhe/ose të rikuperueshme në një minimum prej 95% të peshës për automjet.

Direktiva 2010/75/BE mbi emetimet industriale. Direktiva përcakton rregulla për të parandaluar ose, kur kjo nuk është praktike, për të reduktuar emetimet industriale në ajër, ujë dhe tokë dhe për të parandaluar gjenerimin e mbeturinave, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit. Të gjitha instalimet e mbuluara nga direktiva duhet të parandalojnë dhe zvogëlojnë ndotjen duke aplikuar teknikat më të mira të disponueshme (AMD/BAT) dhe të adresojnë përdorimin efikas të energjisë, parandalimin dhe menaxhimin e mbeturinave dhe masat për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre.

Direktiva 96/59/KE - asgjësimi i bifenileve të poliklorinuara dhe terfenileve të poliklorinuara (PCB/PCTs). Direktiva harmonizon ligjin për deponimin/asgjësimin e bifenileve të poliklorinuara dhe terfenileve të poliklorinuara (PCB/PCTs) dhe dekontaminimin ose deponimin/asgjësimin e pajisjeve që i përmbajnë ato.

Rregullorja (KE) Nr. 2150/2002 mbi statistikat të BE për mbeturina. Ky ligj i Bashkimit Evropian (BE) lejon mbledhjen e të dhënave të rregullta dhe të krahasueshme për mbeturinat në vendet e BE-së dhe transmetimin e tyre në Eurostat, zyrën e statistikave të BE-së. Statistikat e mbledhura mundësojnë mpnitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të politikave të BE-së.

Rregullorja (KE) Nr. 1013/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 qershor 2006 mbi dërgesat e mbeturinave. Rregullorja përcakton rregullat për kontrollin e dërgesave të mbeturinave në mënyrë që të përmirësohet mbrojtja e mjedisit. Ajo gjithashtu përfshin dispozitat e Konventës së Bazelit dhe rishikimin e vendimit të OECD-së të vitit 2001 për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbeturinave të destinuara për operacione rikuperimi (d.m.th. kur një mbeturinë përpunohet për të rikuperuar një produkt të përdorshëm ose konvertohet në lëndë djegëse) në ligjin e BE-së.

1.2.2 Legjislacioni Nacional për Menaxhimin e Mbeturinave

Në Kosovë, korniza ligjore për menaxhimin e mbeturinave është ndërtuar në mënyrë të strukturuar dhe të qëndrueshme. Në nivelin më të lartë juridik, Kushtetuta e Republikës së Kosovës parashikon parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit, të cilat konkretizohen më tej përmes ligjeve dhe akteve nënligjore përkatëse.

Në këtë kontekst, Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturinat (Ligji për Mbeturinat) përbën bazën kryesore ligjore për rregullimin e këtij sektori. Ky ligj është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071, duke e bërë atë më të përshtatshëm me

kërkesat aktuale dhe standardet ndërkombëtare, përfshirë ato të Bashkimit Evropian. Kjo kornizë ligjore është gjithëpërfshirëse dhe përcakton qartë parimet, përgjegjësitë institucionale dhe mekanizmat për menaxhimin e mbeturinave.

Përveç legjislacionit primar, janë miratuar edhe një sërë aktesh nënligjore (legjislacion dytësor), të cilat ndihmojnë në zbatimin praktik të ligjit dhe mbulimin e aspekteve specifike të menaxhimit të mbeturinave. Seksionet në vijim do të ofrojnë një përmbledhje të legjislacionit primar dhe sekondar, si dhe një pasqyrë të procesit të transpozimit të direktivave të Bashkimit Evropian në kornizën ligjore të Kosovës për menaxhimin e mbeturinave.

1.2.2.1 Legjislacioni primar

Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Kushtetuta[3], në nenin 7 [Vlerat], paragrafi 1, përcakton se: "Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, **mbrojtjes së mjedisit**, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushteteve shtetërore dhe ekonomisë së tregut". Gjithashtu, Kushtetuta në nenin 52 [Përgjegjësia për Mjedisin e Jetës], përcakton se:

- **"1. Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi** dhe trashëgimia kombëtare janë përgjegjësi e të gjithëve.
- 2. Secilit duhet t'i jepet mundësia për t'u dëgjuar nga institucionet publike dhe për t'u marrë parasysh mendimet e tyre për çështje që ndikojnë në **mjedisin** ku ai jeton.
- 3. Ndikimi në mjedis merret parasysh nga institucionet publike në proceset e tyre vendimmarrëse".

Ligji nr. 04/L-060 për mbeturinat. Ligji për Mbeturina[4] parashikon dhe përcakton parimet për mbrojtjen e mjedisit dhe përcakton rolet dhe përgjegjësitë e organeve të administratës shtetërore në nivel qendror dhe lokal, si dhe licencimin e operatorëve, personave juridikë dhe fizikë, për menaxhimin e mbeturinave. Ligji për Mbeturina përcakton dhe rregullon parimet dhe objektivat për menaxhimin e mbeturinave, strategjitë, planet dhe programet për menaxhimin e mbeturinave, të drejtat dhe detyrimet e personave juridikë dhe fizikë në lidhje me menaxhimin e mbeturinave, mënyrën dhe kushtet në të cilat mund të bëhet grumbullimi, transporti, ripërdorimi, trajtimi, ruajtja, përpunimi dhe asgjësimi i mbeturinave, importin, eksportin dhe tranzitin e mbeturinave, krijimin e sistemit të informacionit, si dhe financimin dhe mbikëqyrjen e menaxhimit të mbeturinave.

Ligji përcakton menaxhimin e mbeturinave të pajisjeve elektrike dhe elektronike, dispozitat për menaxhimin e mbeturinave të baterive dhe akumulatorëve, si dhe ka dispozitat që lidhen me përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesve për menaxhimin e mbeturinave të produkteve të tyre. Ligji për Mbeturina prezanton dispozita për mbeturinat e vajrave dhe fraksioneve tjera të mbeturinave në lidhje me sistemin e zgjeruar të përgjegjësisë së prodhuesit, si dhe zgjidhje të reja ligjore për katër fushat e reja. Megjithatë, kushtet e kërkuara minimale për skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit ende nuk janë përcaktuar. Gjithashtu, procedura e lejes për organizatat që zbatojnë obligimet e zgjeruara të përgjegjësisë së prodhuesit në emër të prodhuesve të produkteve nuk janë të përcaktuara me ligj.

Një koncept dokument është përgatitur nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHIP). Qëllimi i këtij Koncept Dokumenti është të ofrojë një analizë gjithëpërfshirëse të politikave dhe legjislacionit në fushën e menaxhimit të mbeturinave si dhe të analizojë opsionet për përmirësimin e legjislacionit dhe të rekomandojë opsionin e preferuar. Për më tepër, Koncept Dokumenti përshkruan objektivat dhe veprimet konkrete për të përmirësuar sistemin e menaxhimit të mbeturinave. Një nga rekomandimet kryesore të Koncept Dokumentit është që kuadri ligjor në fushën e menaxhimit të mbeturinave të përmirësohet dhe të miratohet një ligj i ri për mbetuirna. Koncept Dokumenti është në pritje të miratimit nga Qeveria.

[3] Kushtetuta e Republikës së Kosovës e vitit 2008, e ndryshuar më vonë, e disponueshme në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702

[4] Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina, Gazeta Zartare e Republikës së Kosovës nr. 17/29, Qershor 2012; Ligji nr. 08/L-071 për plotësim ndryshimin e Ligjit për Mbeturina Ligji Nr. 04/L-060e,Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 29 / 1 Shtator 1, 2022.

Ligje tjera që kanë efekt në rregullimin e sektorit të menaxhimit të mbeturinave përfshijnë:

Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit. Ligji parashikon që objektet e trajtimit dhe depozitimit të mbetuirnave të vendosen në vende që sigurojnë mbrojtje të plotë të mjedisit. Ligji kërkon që funksionimi i impianteve dhe aktiviteteve që mund të kenë ndikim negativ në shëndetin e njeriut dhe mjedisin duhet të kërkojnë licencë të integruar. Ligji parashikon gjithashtu kërkesat për lejet mjedisore për të gjitha objektet, instalimet dhe makineritë e ndërtuara që i janë nënshtruar Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Komunat janë gjithashtu të autorizuara të lëshojnë leje mjedisore komunale.

Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Qëllimi i këtij ligji është: (i) të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit nëpërmjet parandalimit të dëmeve dhe efekteve negative në mjedis të projekteve publike ose private; (ii) të përcaktojë rregullat dhe procedurat për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të projekteve dhe aktiviteteve në mjedis, për të siguruar parandalimin ose reduktimin e ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private; dhe (iii) garantimin e procesit gjithëpërfshirës dhe të hapur të vendimmarrjes nëpërmjet përcaktimit të rregullave dhe procedurave administrative, gjatë procesit të vendimmarrjes për marrjen e pëlqimit mjedisor.

Ligji është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2014/52/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 16 prill 2014 e cila ndryshon Direktivën 2011/92/BE për vlerësimin e ndikimit mjedisor të projekteve të caktuara publike dhe private.

Ligji Nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes. Ky ligj synon të përcaktojë kompetencat, procedurat dhe përgjegjësitë e institucioneve për pajisjen me leje të impianteve, mbikëqyrjen inspektuese, si dhe detyrimet e operatorëve, në lidhje me parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes nga aktivitete të ndryshme industriale, për të arritur një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit. Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2010/75/BE, për shkarkimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes).

Ligji nr.03/L–233 për Mbrojtjen e Natyrës. Ligji përcakton një sistem për mbrojtjen dhe ruajtjen e përgjithshme të natyrës dhe vlerave të saj. Natyra në kuptimin e Ligjit përfaqëson të gjithë diversitetin biologjik dhe peizazhor. Natyra dhe trashëgimia natyrore janë me interes për Republikën e Kosovës dhe kanë mbrojtje të veçantë.

***Ligji № 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale**. Ligji vendos bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Kosovë. Ligji gjithashtu përcakton statusin juridik të komunave, kompetencat e tyre dhe parimet e përgjithshme të financave komunale, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, aranzhimet ndërkomunale dhe bashkëpunimin ndërkomunal duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet midis komunave dhe ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror. Për më tepër, neni 17, kompetencat vetanake, paragrafi 17.1, përcakton se: "Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për aq sa kanë të bëjnë me interesin lokal, duke respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi në fushat e mëposhtme: ……*

- e*) mbrojtjen lokale të mjedisit;*
- f) *ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike, duke përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimet dhe, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportin lokal dhe skemat e ngrohjes lokale".*

Ligji № 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike[5]. Ligji ofron një kornizë ligjore për pronësinë e Ndërmarrjeve Publike (NP) dhe për qeverisjen e tyre në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtarisht të qeverisjes korporative për ndërmarrjet në pronësi publike. Për sa i përket pronësisë, Ligji bën dallimin ndërmjet NP-ve qendrore (në pronësi të qeverisë

5 Ndryshuar me akte nënligjore duke ndryshuar Ligjin për Ndërmarrjet Publike nr. 05/L-009 dhe No. 04/L-111

qendrore) dhe NP-ve lokale (në pronësi të komunave). Nëse një ndërmarrje ofron shërbime të grumbullimit të mbeturinave për më pak se tre komuna, ajo do të jetë NP Lokale, përndryshe do të jetë NP Qendrore.

Komunat, përmes kuvendeve komunale, caktojnë një Komitet të palëve të interesit prej 3 anëtarësh, organ i cili mbikëqyrë ndërmarrjen, zgjedh bordin e drejtorëve dhe i raporton pronarit (në këtë rast, kuvendet komunale përkatëse). Bordi i drejtorëve është organi vendimmarrës që zgjedh kryeshefin ekzekutiv të ndërmarrjes. Anëtarët e bordit zgjidhen në përputhje me pasurinë/asetet që posedon secila komunë.

Ligji № 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës[6]. Qëllimi i ligjit është të sigurojë përdorimin sa më efikas, me kosto efektive, transparente dhe të drejtë të fondeve publike, burimeve publike dhe çdo fondi dhe burimi tjetër të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet e kërkuara dhe rregullat që do të respektohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të realizohen nga personat, operatorët ekonomikë, sipërmarrjet, autoritetet kontraktore, koncesionarët e punimeve dhe organet publike që kryejnë, ose përfshihen, marrin pjesë ose interesohen në një aktivitet prokurimi që përfshin ose ndërlidhen me përdorimin e këtyre fondeve dhe/ose burimeve. Prandaj, blerja e çdo malli apo shërbimi për menaxhimin e mbeturinave duhet të ndjekë procedurat e përcaktuara në këtë ligj.

Ligji № 04/L-045 për Partneritetin Publiko-Privat. Qëllimi i ligjit është të krijojë kuadrin ligjor për Partneritetet Publiko-Private, duke përfshirë procedurat për dhënien e Partneritetit Publiko-Privat, përmbajtjen dhe strukturën e një Marrëveshjeje të Partneritetit Publiko-Privat dhe kuadrin institucional përgjegjës për menaxhimin dhe zhvillimin e Partneriteteve Publiko-Private në Republikën e Kosovës. Dispozitat në ligj rregullojnë Partneritetin Publiko-Privat për ofrimin e shërbimeve publike dhe/ose infrastrukturës publike në të gjithë sektorët ekonomikë dhe socialë, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në: "...**grumbullimin, deponimin, riciklimin dhe menaxhimin e mbeturinave**".

Ligji № 04/L-197 për Kimikatet[7]. Qëllimi i ligjit është të përcaktojë kushtet për vendosjen në treg të substancave të rrezikshme, procedurën për marrjen e lejes së kimikateve, kushtet për klasifikimin, etiketimin, paketimin, importin e kimikateve të rrezikshme, përgjegjësitë e autoritetit kompetent për zbatimin, kontrollin, raportimin dhe monitorimin e ligjit si dhe administrimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e detergjentëve.

1.2.2.2 Aktet Nënligjore

Udhëzimi Administrativ (QRK) № 08/2017 për menaxhimin e deponisë së mbeturinave. UA rregullon llojin e mbeturinave të pranuara në deponi dhe menaxhimin e tyre. Ndër dispozitat e tjera, ai përcakton gjithashtu:

- Klasa të ndryshme të deponive
- Detyrimet e operatorit të deponive
- Kushtin që deponitë duhet të operojnë në bazë të planeve të menaxhimit të deponive dhe dispozitave se çfarë duhet të përfshijë një impiant i menaxhimit të deponive
- Procedurat e pranimit të mbeturinave të mbeturinave në deponi
- Masat e kontrollit të mjedisit
- Masat për mbylljen e deponisë dhe kujdesin pasues

Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr.02/2024 Për përcaktimin e kushteve, kritereve dhe procedurave për dhënien e lejeve për import, eksport dhe tranzit të mbeturinave. Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i kushteve,

6 Ndryshuar dhe plotësuar me akte nënligjore duke ndryshuar dhe plotësuar Ligjin ër Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës nr. 04/L-237 të vitit 2014, 05/L-068 të vitit 2016 dhe nr. 05/L-092 të vitit 2016

7 Ligji nr. 08/l-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/l-197 për Kemikatet

kritereve dhe procedurave për dhënien e lejeve për eksport, import dhe tranzit të mbeturinave në Republikën e Kosovës, si dhe mbikëqyrjen e lëvizjes ndërkufitare të mbeturinave. Ky Udhëzim Administrativ është pjesërisht në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 1013/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 14 qershor 2006, për lëvizjen ndërkufitare të mbeturinave.

Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr.03/2024 Për Kriteret e Përzgjedhjes së Lokacioneve të Deponive dhe Kushtet Teknike të tyre sipas destinacionit të tyre. Ky Udhëzim Administrativ synon të përcaktojë kriteret për përzgjedhjen e vendndodhjes së deponisë dhe kushtet teknike sipas destinacionit të tyre, qofshin ato të rrezikshme, jo të rrezikshme apo inerte. Ky Udhëzim Administrativ është pjesërisht në përputhje me Direktivën e Këshillit 1999/31/EC e datës 26 prill 1999 për deponinë e mbeturinave.

Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 07/2023 për Ambalazhin dhe Mbeturinat nga Paketimi. Ky Udhëzim Administrativ synon të përcaktojë kushtet, procedurat, përgjegjësitë dhe detyrimet për prodhuesit, importuesit, shitësit dhe palët e tjera, për menaxhimin e ambalazhit dhe mbeturinave të paketimit.

Udhëzimi Administrativ MMPH - Nr. 07/2015 për Menaxhimin e Mbeturinave nga Ndërtimi dhe Demolimi i Objekteve të Ndërtimit. Udhëzimi Administrativ përcakton kushtet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja, nga mbeturinat ndërtimore dhe rrënimi i objekteve ndërtimore, si dhe përcakton kushtet dhe mënyrën e largimit të tyre brenda territorit të komunës.

Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2020 për Menaxhimin e Mbeturinave që Përmbajnë Asbest. Udhëzimi Administrativ përcakton masat e nevojshme për menaxhimin dhe zvogëlimin e ndikimit negativ të mbeturinave që përmbajnë azbest, duke përfshirë: mbledhjen, paketimin, grumbullimin, ruajtjen, transportimin, përpunimin, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave që përmbajnë azbest.

Udhëzimi Administrativ MMPH - Nr. 15/2015 për Menaxhimin e Mbeturinave nga Tubat fluoreshente që përmbajnë merkur. Udhëzimi Administrativ përcakton kushtet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve nga ndotja nga mbeturinat e tubacioneve fluoreshente, si dhe zbatimin dhe funksionimin e një sistemi mjedisor të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm për parandalimin dhe kufizimin e ndikimeve negative në mjedis dhe në jetën e njeriut në përgjithësi të tubave fluoreshente që përmbajnë merkur. Gjithashtu, ky Udhëzim Administrativ përcakton rregullat, kushtet dhe kërkesat për menaxhimin dhe kontrollin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me grumbullimin, trajtimin, ruajtjen dhe transportimin e tubave fluoreshente që përmbajnë merkur.

Udhëzimi Administrativ MMPH – Nr. 25/2014 për menaxhimin e mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike dhe kufizimin e përdorimit të substancave të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike. Udhëzimi Administrativ synon të përcaktojë detyrimet dhe kushtet për mbledhjen, grumbullimin, ruajtjen, përpunimin, transportimin, ripërdorimin, trajtimin, ruajtjen dhe mënyrën e menaxhimit të mbetuirnave nga pajisjet elektrike dhe elektronike, lista e pajisjeve elektrike dhe elektronike (Shtojca I, II, III dhe IV). Gjithashtu, ky UA përcakton masat për ndalimin ose kufizimin e përdorimit të produkteve që përmbajnë përbërës të dëmshëm për të parandaluar ose reduktuar efektet negative në mjedis dhe shëndetin e njeriut nga mbeturinat nga pajisjeve elektrike dhe elektronike, si dhe kufizimin e përdorimit të substancave të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike.

Udhëzimi Administrativ MMPH -Nr.26/2014 për Menaxhimin e Mbeturinave nga Bateritë dhe Akumulatorët. Udhëzimi Administrativ synon të përcaktojë rregullat, detyrimet dhe kushtet për parandalimin ose zvogëlimin e efekteve negative në mjedis dhe shëndetin e njeriut, mënyrën dhe kërkesën mjedisore për prodhimin, vendosjen në treg, grumbullimin, ruajtjen, përpunimin, riciklimin, trajtimin dhe deponimin e baterive dhe akumulatorëve mbeturinë. Gjithashtu, kjo UA përcakton masat për ndalimin ose kufizimin e përdorimit të produkteve që përmbajnë përbërës të dëmshëm, si dhe kufizimin e vendosjes në treg të baterive dhe akumulatorëve që përmbajnë lëndë të rrezikshme.

Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2013 për Menaxhimin e Vajrave të Përdorura dhe Vajrave Mbeturinë. Udhëzimi Administrativ synon të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njerëzve nga ndotja nga vajrat e përdorura dhe vajrat mbeturinë, si dhe të mundësojë ngritjen dhe funksionimin e sistemit të përshtatshëm dhe të sigurt për mjedisin për

menaxhimin dhe kontrollin e vajrave të përdorur dhe vajrave mbeturinë, duke parandaluar reduktimin dhe kufizimin e ndotjes së ujit, tokës dhe ajrit, nëpërmjet përcaktimit të kushteve për grumbullimin, transportimin, ripërdorimin dhe ruajtjen e vajrave të përdorura dhe vajrave mbeturinë.

Udhëzimi Administrativ Nr. 19/2012 për Menaxhimin e Automjeteve Mbeturinë dhe dhe Përbërësve të tyre. Udhëzimi Administrativ synon parandalimin dhe uljen e ndotjes së mjedisit nga automjetet mbeturinë dhe përbërësit e tyre, duke arritur një nivel të lartë përdorimi, riciklimi, vendosja e kushteve të përshtatshme për ruajtjen, grumbullimin, klasifikimin, trajtimin dhe forma të tjera të përpunimit të automjeteve mbeturinë dhe përbërësve të tyre. Gjithashtu, ky UA krijon sistemin e grumbullimit, transportit dhe trajtimit të automjeteve mbeturinë, si dhe operatorëve ekonomikë që merren me këtë aktivitet me qëllim të mbrojtjes së mjedisit.

Udhëzimi Administrativ Nr. 23/2012 për Menaxhimin e Gomave jashtë përdorimit dhe dhe Mbeturinave të Gomës . Udhëzimi Administrativ ka për qëllim:

- parandalimi dhe reduktimi i ndotjes së mjedisit nga gomat e përdorura dhe mbetuirnat e gomave
- rritja e nivelit të ripërdorimit të gomave dhe mbetuirnave të gomave jashtë përdotimit; riciklimi i gomave të përdorura dhe mbetuirnave të gomës
- krijimi i sistemit të informacionit për grumbullimin, transportimin dhe trajtimin e gomave jashtë përdorimit dhe mbeturinave të gomave.

Udhëzimi Administrativ MMPH - Nr. 20/2014 për Menaxhimin e Mbeturinave të Biodegradueshme. Udhëzimi Administrativ synon të merret me mbrojtjen e mjedisit nga mbeturinat e biodegradueshme, të krijojë një sistem për grumbullimin dhe trajtimin e tyre, si dhe të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e operatorëve dhe personave që merren me trajtimin e këtyre mbeturinave.

Udhëzimi Administrativ (QRK) - Nr. 03/2021 për Menaxhimin e Mbeturinave të Rrezikshme. Udhëzimi Administrativ përcakton rregullat për grumbullimin, klasifikimin, ruajtjen, transportimin, si dhe ruajtjen dhe paketimin e mbeturinave të rrezikshme.

Udhëzimi Administrativ MMPH - Nr. 10/2015 për trajtimin e mbeturinave nga produktet medicinale. Udhëzimi Administrativ përcakton kushtet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve nga ndotja nga mbeturinat e produkteve medicinale, si dhe përcakton kushtet për dhënien e këshillave dhe udhëzimeve për trajtimin e sigurt të këtyre mbeturinave, si dhe përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë për menaxhimin e tyre.

Udhëzimi Administrativ nr. 07/2014 për kompetencat e pronarit, prodhuesit dhe importuesit të produktit të mbeturinave. Udhëzimi Administrativ përcakton detyrimet, kushtet dhe masat për trajtimin e mbeturinave dhe shfrytëzimin sa më të mirë të lëndëve të para, zvogëlimin e sasisë së mbeturinave, kursimin e burimeve natyrore dhe shfrytëzimin e energjisë. Gjithashtu, ky Udhëzim Administrativ përcakton të drejtat dhe detyrimet e të gjithë aktorëve që merren me trajtimin e mbeturinave, qofshin prodhuesë, importuesë, operatorë ekonomikë, persona fizikë apo juridikë, si dhe mbikëqyrjen dhe monitorimin e trajtimit të mbeturinave.

Udhëzimi Administrativ MMPH - Nr. 21/2014 për Menaxhimin e Mbeturinave nga Industria Ekstraktive dhe Minerare. Udhëzimi Administrativ synon të përcaktojë masat, procedurat dhe udhëzimet, si dhe menaxhimin e mbeturinave që rrjedhin nga kërkimi, shfrytëzimi, trajtimi, ruajtja e burimeve minerale të krijuara nga puna në grup në objekte dhe pajisje si dhe të parandalojë ose reduktojë efektet negative në mjedis, veçanërisht mbi ujin, ajrin, tokën, florën, faunën dhe peizazhin, si dhe çdo gjë që rrezikon shëndetin e njeriut, si rezultat i administrimit të mbeturinave nga industria ekstraktive dhe minerare.

Udhëzimi Administrativ MMPH - Nr. 29/2014 për Menaxhimin e Lymit nga Trajtimi i Ujërave Ndotës. Udhëzimi Administrativ ka për qëllim menaxhimin e mbeturinave të lymit nga trajtimi i ujërave, duke përcaktuar kushtet dhe kriteret për përdorimin e mbeturinave nga lymi i ujëravet të trajtuar, metodat e shqyrtimit të tyre, kushtet për lejimin e

përdorimit të tyre, kushtet që duhet plot[soj[toka në të cilën përdoret uji (vetëm në bujqësi brenda vlerave të caktuara), si dhe kushtet në të cilat duhet të trajtohen dhe depozitohen këto mbeturina. Gjithashtu, ky UA përcakton masat për ndalimin ose kufizimin e përdorimit të lymit përtej kufijve të caktuar, për të parandaluar ose reduktuar efektet negative në mjedis dhe në shëndetin e njeriut nga mbeturinat e lymit gjatë përdorimit bujqësor.

Udhëzimi Administrativ MMPHI NR.02/2024 për përcaktimin e kushteve, kritereve dhe procedurave për dhënien e lejeve për import, eksport dhe tranzit të mbeturinave. Ai përcakton kushtet dhe procedurat për dhënien e lejeve për import, eksport dhe tranzit të mbeturinave në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, ky Udhëzim Administrativ rregullon procedurat për mbikëqyrjen e lëvizjes ndërkufitare të mbeturinave në vendkalimet kufitare që kanë të bëjnë me lëvizjen e mbeturinave në Republikën e Kosovës.

Udhëzimi Administrativ (MMPH) - Nr. 02/2017 për Listën e Kategorive të Mbeturinave të Rrezikshme sipas Prejardhjes. Udhëzimi Administrativ përcakton dhe udhëzon personat juridikë dhe fizikë për mënyrën e Listës së kategorisë së mbeturinave të rrezikshme sipas origjinës, e cila është pjesë përbërëse e Konventës së Bazelit dhe Ligjit për Mbeturina të Republikës së Kosovës.

Udhëzimi Administrativ (MMPH) - Nr. 14/2017 për Mbeturinat që përmbajnë Ndotës Organik të Qëndrueshëm. Udhëzimi Administrativ synon të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njerëzve nga mbeturinat që përmbajnë Materie me Ndotës Organik të Qëndrueshëm (MNOQ), duke kufizuar dhe ndaluar prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e materialeve që përmbajnë NOQ me qëllim minimizimin dhe eliminimin e këtyre çështjeve. Gjithashtu, ky Udhëzim Administrativ rregullon mënyrat dhe procedurat e menaxhimit të mbeturinave me NOQ, vlerat kufitare dhe përqendrimet e NOQ-ve, në lidhje me mbeturinat që përmbajnë ose janë të kontaminuara me NOQ, si më poshtë:

- Mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike që përmbajnë bifenile të poliklorinuara që përmbajnë NOQ dhe vajrat mbeturinë që përmbajnë PCB;
- Mbetjurinat e ndërtimit që përmbajnë NOQ dhe PCB, duke përfshirë materialet e kontaminuara me NOQ ose PCB;
- Mbeturinat nga pesticidet që përmbajnë substanca NOQ;
- Mbetuirnat e kontaminuara gjatë prodhimit të materialeve që përmbajnë NOQ.

Udhëzimi Administrativ MMPHI - Nr. 01/2015 për Listën e mbeturinave të OECD. Udhëzimi Administrativ merr parasysh dhe udhëzon përdorimin e Listës e OECD-së për Mbeturinat, Listat e Legjislacionit të BE-së për Mbeturinat, si dhe Listën e Konventës së Bazelit për Mbeturinat, të cilat janë pjesë përbërëse e Ligjit për Mbeturina dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Udhëzim Administrativ MMPH - Nr. 05/2015 për Menaxhimin e Bifenileve dhe Trefenileve të Poliklorinuara dhe Mbeturinave të PCB-ve dhe PCT-ve. Udhëzimi Administrativ përcakton kushtet e nevojshme për mbledhjen, ruajtjen, trajtimin dhe kontrollin e bifenileve të poliklorinuara (PCB) dhe trifenileve të poliklorinuara (PCT) në materialet dhe mbeturinat e pajisjeve, në mënyrë që të mos rrezikohet shëndeti i njeriut dhe mjedisi.

Udhëzimi Administrativ Nr. 13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave. Udhëzimi Administrativ synon të udhëzojë personat fizikë dhe juridikë për përdorimin e Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, harmonizimin e tij me Katalogun Evropian të Mbeturinave dhe kategorizimin e mbeturinave sipas llojeve në Shtojcën I të këtij UA. Katalogu i mbeturinave është një listë që përfshin të gjitha mbeturinat e rrezikshme, jo të rrezikshme dhe inerte, sipas të cilave mbeturinat klasifikohen duke i shënuar me numra të caktuar.

Udhëzimi Administrativ Nr. 16/2013 për vlerat kufitare të përqendrimeve për komponentët e rrezikshëm në mbeturina. Udhëzimi Administrativ synon klasifikimin e mbeturinave dhe vlerat kufitare të përqendrimit për komponentët e rrezikshëm në mbeturina, në bazë të të cilave përcaktohen karakteristikat e mbeturinave, sipas shtojcave të përcaktuara në këtë UA.

Udhëzimi Administrativ (MMPH) Nr. 22/2013 për Menaxhimin e Mbeturinave nga Produktet Medicinale Humane dhe Veterinare. Udhëzimi Administrativ synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve nga kontaminimi me mbeturina të produkteve medicinale, humane dhe veterinare, si dhe të përcaktojë kompetencat dhe përgjegjësitë si dhe ngritjen e sistemit të duhur për grumbullimin, trajtimin, paketimin, ruajtjen, deponimin dhe transportimin e mbeturivae Medicinale, humane dhe veterinare me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik dhe mjedisit.

1.2.2.3 Transpozimi i kornizës ligjore të BE-së për menaxhimin e mbeturinave në kornizën ligjore të Kosovës

Tabela e mëposhtme tregon direktivat kryesore për menaxhimin e mbetuirnave në nivel të BE-së dhe aktet përkatëse legjislative primare dhe sekondare të miratuara në nivel nacional.

Tabela 5Transpozimi i kornizës ligjore të BE-së për menaxhimin e mbeturinave në kornizën ligjore të Kosovës

Aktet ligjore të BE-së në menaxhimin e mbeturinave	Transpozimi në kornizën ligjore të Kosovës
Direktiva 2008/98/KE për mbeturinat dhe shfuqizimi i disa direktivave Ndryshuar me Direktivën (BE) 2018/851	Ligji nr. 04/L-060 për mbeturinat Ligji nr. 08/I-071 që ndryshon dhe plotëson Ligjin nr. 04/I-060 për mbeturinat Ligji nr. 03/I-025 për mbrojtjen e mjedisit
Direktiva 1999/31/KE për deponinë e mbeturinave	Ligji nr. 04/L-060 për mbeturinat Ligji nr. 08/I-071 që ndryshon dhe plotëson Ligjin nr. 04/I-060 për mbeturinat Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2017 për menaxhimin e deponive të mbeturinave
Direktiva 2010/75/BE për emetimet industriale	Ligji nr. 03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit Udhëzim Administrativ Nr. 11/2018 për vlerat kufitare të emetimeve të ndotësve në tokë Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2009 për nivelet maksimale të lejuara të shkarkimit dhe shpërndarjes së ndotësve në tokë Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2022 për leje mjedisore Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2022 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (mea) Nr. 01/2021 për autorizimin mjedisor Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2018 për parandalimin e aksidenteve të mëdha që përfshijnë substanca të rrezikshme Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2017 për lejet mjedisore Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017 për dhënien e lejes mjedisore komunale Udhëzimi Administrativ Nr. 17/2013 për regjistrin e shkarkimeve të ndotësve në mjedis;
Direktiva 94/62/KE për ambalazhin dhe mbeturinat e ambalazhit	Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 07/2023 për ambalazhin dhe mbeturinat e ambalazhit
Direktiva (BE) 2019/904 për reduktimin e ndikimit të produkteve të caktuara plastike në mjedis	Ligji nr. 04/L-060 për mbeturinat dhe Ligji nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturinat Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 07/2023 për ambalazhin dhe mbeturinat e ambalazhit (Nenet 6, 7, 8 dhe 42).
Direktiva 96/59/KE - asgjësimi i bifenileve të poliklorinuara dhe terfenileve të poliklorinuara (PCB/PCTs)	Udhëzimi Administrativ №. 05/2015 Për menaxhimin e bifenileve dhe trifenileve të poliklorinuara dhe mbeturinave me PCB dhe PCT
Direktiva 2006/66/EC për bateritë dhe akumulatorët dhe menaxhimin e mbeturinave nga bateritë dhe akumulatorët	Udhëzimi Administrativ №. 26/2014 për mbeturinat nga bateritë dhe akumulatorët e shpenzuar;
Direktiva 2012/19/BE për mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike	Udhëzimi Administrativ №. 25/2014 për menaxhimin e mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike

Aktet ligjore të BE-së në menaxhimin e mbeturinave	Transpozimi në kornizën ligjore të Kosovës
Direktiva 2000/53/EC për automjetet mbeturinë	Udhëzimi Administrativ №. 19/2012 për menaxhimin e automjeteve mbeturin[dhe komponentet e tyre shfuqizon: Udhëzimin Administrativ -№. 02/2009 për administrimin e automjeteve të deponuara dhe mbeturinate tyre Udhëzimi Administrativ №. 05/2013 për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe mbeturinave me vajra
Direktiva 91/271/EEC – Trajtimi i ujërave të zeza urbane	LIGJI №. 04/L-147 për ujërat e Kosovës Udhëzimi Administrativ №. 02/2022 për kushtet, metodat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin publik të kanalizimit dhe në trupin ujor
Rregullorja Nr. 1013/2006 për dërgesat e mbeturinave	Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr.02/2024 për përcaktimin e kushteve, kritereve dhe procedurave për dhënien e lejeve për import, eksport dhe tranzit të mbeturinave.

Harmonizimi i kornizës ligjore të Republikës së Kosovës me acquis të BE-së ka qenë synim i vazhdueshëm i politikës së Qeverisë së Kosovës. Megjithatë, ka ende boshllëqe të rëndësishme në kuadrin ligjor ekzistues, të cilat duhet të adresohen për zbatimin e politikës nacionale të menaxhimit të mbeturinave, siç përshkruhet në SKMIM e rishikuar.

1.3 Korniza institucionale dhe organizative

1.3.1 Niveli nacional

MMPHI

Sipas Ligjit për Mbeturina, institucioni kryesor nacional përgjegjës për mbeturinat është Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Neni 14 i Ligjit për Mbeturina përcakton kompetencat e MMPHI-së. Disa nga kompetencat kryesore janë:

- Përcaktimi i politikave të përgjithshme, hartimi i Strategjisë, ligjet që rregullojnë menaxhimin e mbeturinave.
- Rregullimi i sektorit të mbeturinave.
- Hartimi i planit të veprimit për menaxhimin e mbeturinave.
- Zbatimi strategjisë dhe planit.
- Lëshimi i lejeve përkatëse dhe mbajtja e dëshmive në regjistrin e lejeve.
- Lëshimi i lejeve për import, eksport dhe tranzit të mbetzurinave.
- Krijimi i bazave të të dhënave dhe sistemit të informacionit për menaxhimin e mbeturinave nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit.
- Përpilimi i raporteve për menaxhimin e mbeturinave në Republikën e Kosovës nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit.
- Zbatimi i marrëveshjeve në sferën e bashkëpunimit ndërkombëtar për menaxhimin e mbeturinave.
- Zbatimi i masave të nevojshme për të siguruar menaxhimin e mbeturinave në objektet e pajisura me lejet përkatëse mjedisore.
- Mbulimi i shpenzimeve administrative dhe shpenzimeve për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme dhe mbetuirnave tjera që nuk janë nën juridiksionin e komunës dhe pronari i të cilave nuk dihet.
- Të marrë pjesë në hartimin e dispozitave ligjore për ruajtjen dhe deponimin e mbeturinave të bimëve narkotike dhe substancave narkotike të sekuestruara, në bashkëpunim me institucionet kompetente.

Strategjia e Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 2024-2035 dhe Plani i Veprimit 2024-2026 është dokumenti kryesor i planifikimit i hartuar nga MMPHI, i cili ofron udhëzim strategjik për zhvillimin e sektorit të menaxhimit të mbeturinave, duke përfshirë investimet prioritare dhe caktimin e përgjegjësive.

MMPHI ka autoritetin të zbatojë parimin ndotësi paguan për prodhuesit dhe mbajtësit e mbeturinave, si dhe për të zbatuar politikat dhe instrumentet ekonomike si ndalimin e ambalazhit për një përdorim, kufizimet në depozitimin e mbeturinave, taksat për ambalazhin etj. MMPHI është autoriteti përgjegjës për të krijuar fondin mjedisor, taksat e produkteve dhe burimeve etj.

MMPHI është institucioni përgjegjës për zbatimin e skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (PZP) për të siguruar që prodhuesit e produkteve të mbajnë përgjegjësi financiare ose përgjegjësi financiare dhe organizative për menaxhimin e fazës së mbeturinave të ciklit jetësor të një produkti.

MMPHI është gjithashtu autoriteti licencues dhe lejues për operatorët e mbeturinave që merren me menaxhimin e mbeturinave komunale. MMPHI gjithashtu lëshon licenca për operatorët që merren me mbeturinat e ndërtimit dhe demolimit (MND) të objekteve ndërtimore, automjetet mbeturinë, vajrat e përdorura, gomat e hedhura, mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike, azbestin, bateritë dhe llambat fluoreshente. MMPHI lëshon licenca edhe për importuesit dhe eksportuesit e mbeturinave.

Përveç këtyre funksioneve, MMPHI koordinon menaxhimin e llojeve specifike të mbeturinave me ministritë e tjera: mbeturinat medicinale me Ministrinë e Shëndetësisë, mbeturinat bujqësore me Ministrinë e Bujqësisë, mbeturinat industriale me Ministrinë e Tregtisë, deponimin e mbeturinave – me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.

MMPHI përbëhet nga gjashtë departamente kryesore. Menaxhimi i mbeturinave bie në përgjegjësinë e Departamentit të Mbrojtjes së Mjedisit. Vetë Departamenti përbëhet nga 4 Divizione; Divizioni i Mbeturinave dhe Kimikateve (DMK) është Divizioni përgjegjës direkt për funksionet e mandatuara.

AMMK dhe IMMK

Agjencia pë Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovës (AMMK), e themeluar brenda MMPHI siguron monitorimin dhe raportimin e ligjit për mbeturinat. Inspektorati për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë (IMMK) është organi ekzekutiv vartës i MMPHI që siguron mbikëqyrjen dhe kontrollin e operacioneve të mbeturinave dhe ndotjes mjedisore. AMMK është organi kombëtar për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për mbeturinat dhe është përgjegjës për krijimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave për menaxhimin e mbeturinave dhe për përpilimin e raporteve mbi mbeturinat.

Inspektorati për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës është organ ekzekutiv vartës i MMPHI që, si i vetëm dhe/ose në bashkëpunim me inspektoriatet komunale, siguron mbikëqyrjen dhe kontrollin e operimit të mbeturinave dhe ndotjes së mjedisit, dhe mbikëqyrë zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore për mbeturinat dhe aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave.

Ministritë tjera

Ministria e Ekonomisë (ME) është përgjegjëse për Ndërmarrjet Publike Qendrore, siç është Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK), duke emëruar bordin e saj të drejtorëve, duke miratuar planin e saj të biznesit dhe duke kontrolluar performancën e përgjithshme të KMDK-së. Gjithashtu, ME cakton tarifën e portës për deponimin e mbeturinave komunale në deponitë e menaxhuara nga KMDK.

Ministria e Financave është ministria e linjës përgjegjëse për procesin e planifikimit dhe buxhetimit të Kosovës. Në kontekstin e vendit, buxheti qendror siguron një pjesë të konsiderueshme të buxhetit të komunave të Kosovës.

Roli i Ministrisë së Adminjstrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) është të rrisë autonominë lokale dhe të forcojë aftësinë e komunave për të ofruar shërbime me kosto efektive për qytetarët. MAPL mbështet komunat në forma të ndryshme duke përfshirë grantin për garën për mjedis të pastër.

Sipas dispozitave të Ligjit për Mbeturina, Dogana e Republikës së Kosovës kryen kontrolle, regjistron dhe mbikëqyrë importin, eksportin dhe tranzitin e mbeturinave, mban evidencë të shkeljeve doganore dhe bashkëpunon me MMPHI.

Objektet e trajtimit të mbeturinave, stacionet e transferit dhe deponitë/venddepozitimet e mbeturinave menaxhohen në nivel qendror.

- Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovës (KMDK) menaxhon deponitë rajonale dhe stacionet e transferit
- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës (AUVK) menaxhon objektin e trajtimit të mbeturinave nga përpunimi i kafshëve.
- Ministria e Shëndetësisë menaxhon objektet e trajtimit të mbeturinave të rrezikshme të kujdesit shëndetësor në spitalet rajonale.

Institucionet kryesore publike të përfshira në menaxhimin e mbeturinave në nivel nacional paraqiten në Figurën 1 më poshtë:



Figura 8Korniza institucionale për menaxhimin e mbeturinave në nivel nacional

1.3.2 Niveli lokal

Përgjegjësitë komunale

Në përputhje me nenin 17 të LIGJIT NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE, cikli i plotë i menaxhimit të mbeturinave komunale është përgjegjësi e Komunave.

Sipas Ligjit për mbeturina, komunat janë përgjegjëse për ngritjen e sistemit të menaxhimit të mbeturinave në përputhje me parimin e hierarkisë së menaxhimit të mbeturinave në territorin e tyre dhe për zhvillimin e planeve komunale për menaxhimin e mbeturinave të harmonizuara me planin nacional për menaxhimin e mbeturinave. Për sa i përket fraksioneve të mbeturinave, ato janë përgjegjëse për mbeturinat e ngurta komunale (përfshirë mbeturinat shtëpiake, komerciale dhe ato të vëllimshme) dhe MND.

Nga komunat kërkohet të përcaktojnë tarifat për mbeturina dhe mënyrën e grumbullimit të të hyrave për shërbimet komunale; për të mbledhur, dokumentuar dhe raportuar të dhëna për sasitë e mbeturinave; të inspektojë zbatimin e ligjit në bashkëpunim me inspektoriatin e mjedisit; për të monitoruar dhe pastruar mbeturinat historike dhe për të parandaluar hedhjen e paligjshme të mbeturinave. Komunat caktojnë edhe tarifat për deponimin e mbeturinave në ato objekte që janë pasuri e komunës.

Komunat mund të ofrojnë shërbime të grumbullimit të mbeturinave përmes një sërë modelesh operative, duke përfshirë kontraktimin e brendshëm, kontraktimin e ndërmarrjeve publike, kontraktimin e kompanive private nëpërmjet Tenderëve të hapur, partneritet publik privat (PPP) ose mënyra të tjera.

Udhëzimet specifike administrative vendosin obligime specifike ndaj Komunave për të organizuar grumbullimin, ruajtjen dhe transferimin e mbeturinave, vetëm ose në bashkëpunim me sektorin e biznesit. Udhëzimet administrative që u delegojnë më shumë kompetenca komunave janë:

- Udhëzim Administrativ (MEA) nr. 01/2020 për menaxhimin e mbeturinave që përmbajnë azbest.
- Udhëzim Administrativ MMPH - nr. 06/2018 për ndështkimet me gjoba mandatare,
- Udhëzim Administrativ MEPH - nr. 07/2015 për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi i objekteve ndërtimore.

Gjithashtu, udhëzime të tjera administrative u delegojnë përgjegjësi të caktuara komunave.

Për qëllime të përmirësimit të menaxhimit të mbeturinave, dy ose më shumë komuna mund të hyjnë në marrëveshje dhe të krijojnë një bashkëpunim ndërkomunal, Duke marrë parasysh që Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturinat, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071, Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligjin Nr. 04/L-010 për Bashkëpunimin Ndërkomunal ofrojnë bazën ligjore për zhvillimin e planeve të përbashkëta komunale dhe për bashkëpunimin ndërkomunal, duke përfshirë marrëveshjen për bashkëpunimin ndërkomunal (Neni 8 i Ligjit për Bashkëpunimin Ndërkomunal);

Kompetencat e komunave në përputhje me Ligjin për Mbeturinat përfshijnë:

- Krijimi i një sistemi për menaxhimin e mbeturinave bazuar në parimin e hierarkisë për menaxhimin e mbeturinave për territorin e tyre, hartimi i një plani të veprimit lokal për menaxhimin e mbeturinave dhe krijimi i kushteve për zbatimin e tij;
- Përgjegjës për Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave (5 vjet), i cili parashikon masa konkrete për sektorin së bashku me burimet financiare dhe zbatimin e tij;
- Nxjerr Rregulloren Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave (akte nënligjore që e kanë shumica e komunave), me këtë rregullore, përcaktohen tarifat dhe shërbimet për familjet rezidente, jorezidentët (turistët), bizneset, institucionet dhe kontratat e veçanta për shërbimet. Kjo rregullore përcakton mënyrën e shërbimit, itineraret, shërbimin sipas zonave, përcakton tarifën e deponimit (në ato depo ku pronare është komuna), rregullon procedurën për përzgjedhjen e mosmarrëveshjeve midis ofruesve të shërbimeve dhe klientëve, etj.

- Hartimi i raportit vjetor për menaxhimin e mbeturinave. Raporti vjetor duhet t'i dorëzohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Rregullimi i përgjegjësive dhe detyrimeve për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, zbatimin e tyre, organizimin dhe menaxhimin e mbeturinave në territorin e tyre;
- Mirëmbajtja dhe kujdesi për sistemin e informimit dhe raportimit publik për kryerjen e punëve të përcaktuara me këtë ligj, si dhe aktet tjera ligjore për menaxhimin e mbeturinave;
- Zbatimi i procedurave të prokurimit, përzgjedhja e personave të licencuar për mbledhjen, grumbullimin, ruajtjen dhe transportimin e mbeturinave: inerte, komunale, komerciale, të vëllimshme, si dhe mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi i objekteve ndërtimore brenda territorit të tyre;
- Përcaktimi i tarifave dhe mënyrës së mbledhjes së mjeteve financiare për shërbimet komunale;
- Identifikimi i vendeve të ndotura në territorin e tyre, hartimi i projekteve për sanimin e tyre me shënime mbi vendndodhjen, karakteristikat gjeometrike hapësinore, llojin e ndotjes, sasinë e mbeturinave, afatet për përmirësimin e gjendjes dhe shënime të tjera të rëndësishme për realizimin e projekteve.
- Ligji për Mbeturinat, si 'lex specialis', parashikon shprehimisht se komunat kanë përgjegjësi dhe detyra për të zbatuar dispozitat e ligjit, duke përfshirë, ndër të tjera, zbatimin e procedurave të prokurimit, përzgjedhjen e personave të licencuar për mbledhjen, ruajtjen dhe transportimin e mbeturinave: inerte, komunale, komerciale, të vëllimshme dhe mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi i objekteve ndërtimore brenda territorit të tyre. 1 Neni 17.
- Përcaktimi i lokacioneve për deponimin e mbeturinave, vendndodhjet e pikave të grumbullimit të mbeturinave, llojin e shërbimit, harton Planin Operacional të shërbimeve.
- Përcaktimi i mënyrës së menaxhimit të mbeturinave inerte, demolimi i konstruksioneve nëdrtimore dhe përcakton vendndodhjen për deponim.
- Janë përgjegjëse për trajtimin sekondar të mbeturinave (ndarja e mbeturinave në burim dhe procesi i riciklimit).

Rolet dhe përgjegjësitë e organeve komunale në menaxhimin e mbeturinave paraqiten si më poshtë:

- Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim - është përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave.
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa - është përgjegjëse për propozimin e taksave, tarifave dhe ngarkesave tjera komunale, si dhe për përfshirjen e tyre.

Çdo komunë ka personelin e vet të caktuar për menaxhimin e mbeturinave.

1.4 Strategjia e Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave

Dokumenti kryesor strategjik i zhvilluar nga MMPHI është Strategjia e Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 2024-2035 dhe Plani i Veprimit 2024-2026. Ai përcakton objektiva strategjikë, objektiva specifikë, objektiva dhe tregues për menaxhimin e mbetturinave të fraksioneve të ndryshme të mbeturinave. Strategjia synon të çojë përpara përmirësime të mëdha në sektorin e menaxhimit të mbeturinave duke vendosur dhe realizuar katër objektiva strategjikë.

Ndërsa Ligji për Mbeturina përcakton kornizën për krijimin e një Përgjegjësie të Zgjeruar të Prodhuesit (PZP/EPR)[8], SKMIM identifikon katër produkte/materiale prioritare për të cilat duhet të organizohen skema të ndryshme të PZP-së. Në Strategji është vendosur një objektiv që deri në vitin 2024, mbeturinat nga pajisjeve elektrike dhe elektronike (MPEE), bateritë, automjetet mbeturinë (AM) dhe mbeturinat e vajrave të mbulohen nga skemat PZP.

[8] Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit është një qasje ndaj politikës së menaxhimit të mbeturinave, përmes së cilës prodhuesi i një produkti është përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave të produktit pasi ai të ketë arritur fundin e jetëgjatësisë së përdorimit

Kosova ka objektiv që të arrijë një pajtueshmëri afatgjate me kërkesat e BE-së në sektorin e menaxhimit të mbeturinave. Përkatësisht, objektivat për përgatitjen për ripërdorim dhe riciklim të mbeturinave komunale, devijimin e deponive dhe objektivat për fraksionet specifike të mbeturinave të përcaktuara në SKMIM janë formuluar në përputhje me Direktivën Kornizë të Mbeturinave. Objektivat e vendosura në nivel nacional duhet të transpozohen në planet ndërkomunale për menaxhimin e integruar të mbeturinave. Disa nga objektivat shkojnë përtej afatit kohor të këtij PNMIM/IIWMP, por që atë të arrihen kërkohet ndërmarrjs e masave në periudhën deri në vitin 2030.

Objektivat e menaxhimit të mbeturinave, siç janë identifikuar në SKMIMI, paraqiten në tabelat më poshtë.

Tabela 6Përgatitja për objektivat e ripërdorimit dhe riciklimit të mbeturinave komunale

Objektivi	Deri në vitin 2030	Deri në vitin 2035	Deri në vitin 2045
Mbeturinat komunale të përgatitura për ripërdorim dhe riciklim	20%	50%	60%
Deponimi i mbeturinave komunale		< 30%	< 10%
Popullata pajiset me shërbime të veçanta të grumbullimit të mbeturinave	80%	90%	100%

Tabela 7Objektivat për fraksionet e veçanta të mbeturinave

Lloji i mbetjurinave të ambalazhit	Deri në vitin 2028	Deri në vitin 2030	Deri në vitin 2035
Rikuperimi i të gjitha mbetjurinave të ambalazhit	45%	60%	70%
Riciklimi i të gjitha mbeturinave të ambalazhit, duke përfshirë	40%	55%	65%
Plastikë	22.5%	30%	50%
Letër dhe karton	60%	70%	75%
Xham	30%	50%	70%
Metalet me ngjyra	30%	50%	70%
Alumin	30%	40%	50%
Dru	10%	15%	25%

Tabela 8Objektivat e riciklimit për mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit

Objektivi	Deri në vitin 2030	Deri në vitin 2035
Ripërdorimi dhe riciklimi i MNRr-ve	40%	50%
Ripërdorimi, riciklimi dhe rikuperimi i materialeve të tjera të MNRr-ve	60%	70%

1.4.1 Planet për Menaxhimim e Mbeturinave Komunale Inerte

Tabela më poshtë paraqet masat kryesore të parashikuara në planet komunale për menaxhimin e mbeturinave.

Tabela 9Masat e parapara në planet komunale për menaxhimin e mbeturinave

Komuna	Statusi i planit dhe afati kohor	Parandalimi	Riciklim dhe Rimëkëmbje	Masa të tjera
Pejë	Adoptuar 2023-2027	Aplikimi i tarifave të pagesës në vitin 2025 Futja e stimujve financiarë për bizneset Shpërndarja e 250 kompostatorëve shtëpiak çdo vit për familjet dhe bizneset (në varësi të interesit)	Futja e sistemit të ndarjes së burimit Riciklimi i mbeturinave të biodegradueshme Krijimi i qendrës së ripërdorimit për mbeturinat e vëllimshme dhe fraksionet specifike. Ngritja e qendrës së riciklimit të mbeturinave	Digjitalizimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave. Përmirësimi i deponisë ekzistuese. Forcimi i kapaciteteve institucionale të komunës

Komuna	Statusi i planit dhe afati kohor	Parandalimi	Riciklim dhe Rimëkëmbje	Masa të tjera
		Fushata ndërgjegjësuese publike për parandalimin e mbeturinave	të ndërtimit dhe demolimit. Aktivitete ndërgjegjësuese për ripërdorimin dhe riciklimin	
Istog	Adoptuar 2023-2027	Ndërgjegjësimi i qytetarëve për parandalimin e mbeturinave. Riorganizimi i shërbimit për të mundësuar matjen e mbeturinave të grumbulluara Shpërndarja e 120 kompostatorëve shtëpiak për familjet dhe bizneset, çdo vit për periudhën 2024-2027,	Zgjerimi i mbulimit me shërbimin e ndarjes së mbeturinave në burim Riciklimi i mbeturinave të riciklueshme jo të degradueshme Riciklimi i mbeturinave të bio-degradueshme.	Zgjerimi i mbulimit me shërbimin e ndarjes së mbeturinave në burim Riciklimi i mbeturinave të riciklueshme jo të degradueshme Riciklimi i mbeturinave të bio-degradueshme.
Klinë	Adoptuar 2023-2027	Fokusimi në reduktimin dhe minimizimin e gjenerimit të mbeturinave. Promovimi i ripërdorimit të materialeve përpara se të hudhen. Zbatimi i nismave dhe programeve të riciklimit për të rritur normat e riciklimit dhe rikuperimin e burimeve. Shpërndarja e kompostatorëve nëpër amvisëri dhe restorante.	Futja e sistemit të ndarjes në burim Ndërtimi i oborrit të riciklimit për klasifikimin dhe ngjeshjen e mbeturinave që do t'u shiten rickluesve përfundimtarë. Kontraktimi i operatorëve të licencuar për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave të riciklueshme.	Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për ndarjen e mbeturinave përmes programeve. Promovimi i Ripërdorimit të materialeve përpara hudhjes/deponimit. Përmirësimi i deponisë ekzistuese. Forcimi i kapaciteteve institucionale të komunës
Deçan	Adoptuar 2023-2027	Ristrukturimi i grumbullimit të mbetuirnave për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin në menaxhimin e mbeturinave Vendosja e tarifave bazuar në vëllimin e mbeturinave të gjeneruara për të inkurajuar reduktimin e mbeturinave.	Futja e sistemit të ndarjes në burim. Krijimi i objekteve për klasifikimin e materialeve të riciklueshme Përmirësimi i infrastrukturës për grumbullimin dhe transportin e lëndëve të riciklueshme Zbatimi i fushatave ndërgjegjësuese për rritjen e pjesëmarrjes së publikut në programet e riciklimit.	Krijimi i një fondi të dedikuar për të mbështetur projektet e vazhdueshme të menaxhimit të mbeturinave. Rritja e inspektimeve dhe gjobave për mosrespektim të rregulloreve për menaxhimin e mbeturinave. Shtrirja e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave në zonat

Komuna	Statusi i planit dhe afati kohor	Parandalimi	Riciklim dhe Rimëkëmbje	Masa të tjera
		Sigurimi i kompostuesve për familjet për të promovuar kompostimin dhe reduktimin e mbeturinave organike	Krijimi i partneriteteve me kompanitë e riciklimit për të lehtësuar ripërdorimin e materialeve	rurale të pashërbyera për të siguruar mbulim gjithëpërfshirës në të gjithë komunën.
Junik	Adoptuar 2020-2025	Edukimi npër shkolla dhe qendra komunitare mbi teknikat e reduktimit të mbeturinave. Reduktimi i gjenerimit të mbeturinave në burim duke imponuar rregulloret për bizneset dhe institucionet publike Shpërndarja e 100 kompostuesve shtëpiak	Kontraktimi i operatorëve të licencuar për grumbullimin dhe transportin e materialeve të riciklueshme. Zbatimi i sistemeve të grumbullimit të veçantë për lloje të ndryshme të materialeve të riciklueshme. Sigurimi i stimujve për familjet dhe bizneset që marrin pjesë aktive në programet e riciklimit	Pastrimi dhe rregullimi i venddepozitimeve të paligjshme për të reduktuar rreziqet mjedisore. Zbatimi i strategjive për optimizimin e kostos së shërbimeve dhe rritjen e të hyrave përmes tarifave të menaxhimit të mbeturinave.

2 PËRSHKRIMI I RAJONEVE

2.1 Karakteristikat fiziko-gjeografike

2.1.1 Vendndodhja Gjeografike

Rajoni i Pejës ndodhet në pjesën veriperëndimore të Kosovës, në kufi me Malin e Zi dhe Shqipërinë. Përfshin një sipërfaqe të përgjithshme prej 1,808.67 km² dhe përfshin 5 komuna: Pejën, Deçanin, Istogun, Klinën dhe Junikun. Rajoni shtrihet përgjatë fushës aluviale të lumit Lumbardhi në Pejë, në hyrje të grykës së Rugovës, një zonë malore, majat e së cilës formojnë një kurorë të lartë, duke përfshirë Kopranikun (2460m), Zhlebin (2352m), Hajlën (2460m), Mokrën (1932m), Guri i Verdhë (2522m), e të tjera.

Pozita gjeografike e Pejës, së bashku me pasuritë e saj të pasura natyrore dhe trashëgiminë kulturore, e bën atë një zonë jetike jo vetëm brenda Kosovës, por edhe si një lidhje me Ballkanin Perëndimor dhe kontekstin më të gjerë evropian.

2.1.2 Klima

Klima në rajonin e Pejës është kontinentale, e karakterizuar nga një ndryshim i klimës në komunat e saj për shkak të veçorive të ndryshme gjeografike. Rajoni përjeton katër stinë të dallueshme, me verë të ngrohtë ku temperaturat mesatare janë rreth 19.7°C në gusht dhe dimra të ftohtë me një mesatare prej -1.9°C në janar. Komunat si Deçani dhe Istogu ndajnë modele të ngjashme të motit me reshje pak më të larta vjetore, përkatësisht rreth 1100 mm dhe 950 mm, për shkak të afërsisë së tyre me malet. Klina dhe Juniku përjetojnë klimë të moderuar me verë pak më të ngrohtë. Në përgjithësi, rajoni ka rreth 1,000 mm reshje në vit, ku muaji nëntor është muaji më i lagësht dhe gushti më i thati. Peja dhe zonat përreth gëzojnë rreth 85 orë diell në muaj, duke mbështetur një sërë aktivitetesh në natyrë dhe biodiversitet të pasur.

2.1.3 Kushtet Fizike

Rajoni i Pejës karakterizohet nga formacione të ndryshme gjeologjike dhe llojllojshmëri të përdorimit të tokës. Formacione të spikatura shkëmbore gjenden veçanërisht në pjesët veriore dhe perëndimore pranë zonave malore. Luginat pjellore, veçanërisht ato përgjatë lumenjve Bistrica e Pejës dhe Drinit të Bardhë, mbështesin një sërë aktivitetesh bujqësore, duke përfshirë kultivimin e kulturave të ndryshme. Rajoni është gjithashtu i pasur me burime ujore, me lumenj të shumtë e të rrjedhshëm, burime natyrore dhe liqene artificiale. Kanioni i Rugovës, një tipar i rëndësishëm gjeografik, është i njohur për bukurinë e tij piktoreske dhe ujërat e rrjedhshëm. Pellgjet kryesore të ujit që ushqejnë lumenjtë Bistrica e Pejës dhe Drini i Bardhë kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në rezervat ujore të zonës, duke mbështetur nevojat për ujë të pijshëm dhe ujitje.

Diversiteti gjeologjik i Pejës shtrihet në peizazhet e tij të larmishme, nga luginat pjellore të lumenjve deri te terrenet e thyera malore. Ky variacion mbështet lloje të ndryshme të vegjetacionit dhe përdorimit të tokës, me zonat e pyllëzuara, tokat bujqësore dhe vendbanimet urbane që bashkëjetojnë. Prania e veçorive të rëndësishme natyrore si burimi i Drinit në Radavc dhe shpellat dhe kanionet e ndryshme në Luginën e Rugovës rrit vlerën ekologjike dhe turistike të rajonit. Vendndodhja strategjike e Pejës, pranë kufijve me Malin e Zi dhe Shqipërinë, së bashku me pasuritë e mëdha natyrore, e bëjnë atë një rajon me rëndësi ekonomike dhe ekologjike.

2.1.4 Rreziqet Natyrore

Rajoni i Pejës përballet me disa rreziqe natyrore për shkak të terrenit malor dhe kushteve gjeologjike. Tërmetet janë një rrezik i madh, pasi Kosova shtrihet në një zonë aktive sizmike (tektonike), duke rritur mundësinë e aktiviteteve sizmike që mund të dëmtojnë infrastrukturën dhe të paraqesin rreziqe sigurie. Për më tepër, zona është e prirur ndaj rrëshqitjeve të dheut, veçanërisht gjatë reshjeve të dendura ose shkrirjes së shpejtë të borës, të cilat mund të pengojnë transportin dhe të kërcënojnë vendbanimet. Përmbytjet janë një tjetër rrezik, veçanërisht në luginat pjellore përgjatë lumenjve Bistrica e Pejës dhe Drinit të Bardhë, ku reshjet e tepërta mund të çojnë në

derdhje të lumenjve, duke prekur tokat bujqësore dhe zonat e banuara. Këto rreziqe natyrore kërkojnë strategji efektive të menaxhimit dhe zvogëlimit të fatkeqësive për të mbrojtur rajonin dhe banorët e tij.

2.1.5 Përdorimi i Tokës

Bujqësia luan një rol vendimtar në zhvillimin lokal të rajonit të Pejës. Luginat pjellore, veçanërisht përgjatë lumenjve Bistrica e Pejës dhe Drinit të Bardhë, përdoren kryesisht për rritjen e të korrave dhe blegtorinë. Të lashtat e zakonshme përfshijnë grurin, misrin dhe perime të ndryshme. Blegtoria, veçanërisht gjedhët dhe dhentë, është domethënëse, ku bletaria gjithashtu shfaqet si një aktivitet i rëndësishëm, duke kontribuar në prodhimin e mjaltit dhe produkteve të tjera të lidhura me bletët. Peizazhi i larmishëm i rajonit mbështet aktivitete të shumta ekonomike, ku turizmi është një kontribuues i madh për shkak të atraksioneve si Lugina e Rugovës, e cila ofron shëtitje, skijim dhe aktivitete të tjera në natyrë. Resurset e pasura natyrore të Pejës plotësohen nga prodhimet bujqësore, duke e bërë atë një zonë jetike për zhvillimin lokal.

Peja është gjithashtu e njohur për pylltarinë dhe pasuritë e saj minerale. Zonat e gjera të pyllëzuara ofrojnë lëndë drusore dhe dru zjarri, ndërsa pasuria minerale e rajonit përfshin depozita plumbi, zinku dhe argjendi, megjithëse aktivitetet minerare kanë ndikuar historikisht në mjedis. Përveç kësaj, zona është e njohur për pikat e saj turistike kulturore dhe natyrore, si burimi i Drinit në Radavc dhe kanioni i Rugovës. Përafërsisht 60% e popullsisë së Pejës jeton në zonat rurale, duke u angazhuar në bujqësi, pylltari dhe aktivitete të ngjashme. Ky angazhim rural, i kombinuar me florën e pasur dhe klimën e favorshme të rajonit, mbështet kultivimin e frutave të malit dhe bimëve mjekësore, duke i dhënë dimensione të mëtejshme ekonomisë lokale. Peizazhi i larmishëm, nga luginat pjellore deri te terrenet e thyera malore, gjithashtu mbështet lloje të ndryshme të vegjetacionit dhe përdorimit të tokës, duke rritur vlerën ekologjike dhe turistike të Pejës.

2.1.6 Zonat e Mbrojtura

Tabela më poshtë paraqet zonat e mbrojtura në territorin e pesë komunave.

Tabela 10Zonat e mbrojtura në rajon

Kodi	Emri i zonës/objektit	Komuna/zona	Sipërfaqja / ha	Kategoria sipas IUCN	Vitet e Mbrojtjes	Përshkrim i shkurtër i vlerave
PARKU KOMBËTAR (gjithsej 50,000 ha)						
NP_001	Parku Kombëtar 'Bjeshkët e Nemuna'	Pejë, Deçan	50,000	II	2012	I pasur me specie endemike të florës dhe faunës, me veçori të theksuara gjeologjike dhe hidrologjike.
MONUMENTE NATYRORE (10,085 ha, gjithsej)						
MN_201	Kanioni i Rugovës	Pejë	450	III	1985	Kanion spektakolar me rëndësi gjeomorfologjike dhe hidrologjike.
MN_202	Burimi i Drinit të Bardhë	Pejë	20	III	1985	Vend i rëndësishëm hidrologjik me vlerë të konsiderueshme ekologjike.
MN_203	Shpella e Radavcit	Pejë	10	III	2000	Monument i shquar speleologjik me formacione unike shpellore.
MN_204	Gryka e Istogut	Istog	15	III	2010	Vend i rëndësishëm gjeologjik dhe hidrologjik me florë dhe faunë të larmishme.
MN_205	Gryka e Deçanit	Deçan	5	III	2015	Monument gjeologjik me biodiversitet të spikatur.
MN_206	Malet e Junikut	Junik	100	III	2000	Vargmal me biodiversitet të pasur dhe bukuri piktoreske.

Kodi	Emri i zonës/objektit	Komuna/zona	Sipërfaqja / ha	Kategoria sipas IUCN	Vitet e Mbrojtjes	Përshkrim i shkurtër i vlerave
MN_207	Ujëvarat e Mirushës	Klinë	200	III	1983	Ujëvara me vlerë të konsiderueshme ekologjike dhe turistike.
MN_208	Kanioni i Deçanit	Deçan	50	III	1985	Kanion me formacione gjeologjike dhe biodiversitet unik.
MN_209	Bifurkacioni i Pejës	Pejë	25	III	1975	Pikë bifurkacioni me rëndësi hidrologjike dhe ekologjike.
MN_210	Mokna Gora (Mali i Lagësht)	Pejë	200	III	2000	I pasur me florë dhe faunë me karakteristika të rëndësishme gjeologjike.
MN_213	Patriarkana e Pejës	Pejë	10	III	1979	Monument kulturor dhe historik me një mjedis natyror të rëndësishëm.

2.2 Popullsia

Në vitin 2024, nga data 5 prill deri më 24 maj, Kosova ka realizuar Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave. Rezultatet e para përfundimtare janë publikuar në dhjetor 2024

Tabela 11Popullsia e rajonit, 2011 dhe 2020

Komuna				2020
Pejë				82,745
Istog				33,008
Klinë				30,503
Deçan				27,775
Junik				3,943
Totali				**177,947**

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Tabela më poshtë tregon numrin e familjeve në secilën komunë, sipas të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2024.

Tabela 12Numri i familjeve në secilën komunë

Komuna	Numri i familjeve	Madhësia e familjeve
Deçan	5,790	4.8
Istog	7,374	4.3
Junik	860	4.6
Klinë	6,541	4.7
Pejë	19,112	4.3
Totali	**39,677**	**4.5**

Sipas këtyre të dhënave, madhësia mesatare e një familjeje ishte 4.5 persona për familje.

2.3 Përshkrimi socio-ekonomik

2.3.1 Të dhëna për të ardhurat dhe shpenzimet për frymë/familje

Bruto-produkti i vendor për kokë banori

ASK publikoi në dhjetor 2023 të dhënat statistikore rajonale për periudhën 2018/2021[9]. Figura më poshtë përmbledh BPV-në për frymë sipas rajoneve dhe mesatares kombëtare për vitet 2020-2021:



Figura 9BPV për kokë banori sipas rajoneve dhe nivelit nacional, €, 2020 dhe 2021

BPV për kokë banori të rajonit të Pejës përfaqëson 68% të BPV-së nacional (mesatarja) për frymë në vitin 2021. BPV-ja nacionale për kokë banori u rrit me 19% në vitin 2021, në terma nominalë, me rritje prej 26% në Prishtinë dhe 9% në rajonin e Pejës. Sipas të dhënave në publikim, BPV për kokë banori në rajonin e Pejës është rritur me normë mesatare vjetore prej 4.4% në periudhën 2018-2021, përkundër rënies prej 5% në vitin 2020, për shkak të krizës së COVID.

Vlera rajonale e shtuar bruto për rajonin e Pejës arrin në 540 milionë euro në vitin 2021 dhe struktura e tij sipas aktiviteteve ekonomike është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:

9 https://askapi.rks-gov.net/Custom/54ab93a9-061e-4b12-b850-dff45dd32637.pdf - Llogaritë Rajonale të Produktit të Brendshëm Bruto sipas Rajoneve Statistikore 2018/2021 - vlerësime eksperimentale



Figura 10Struktura ekonomike e rajonit të Pejës, vlera bruto e shtuar sipas aktiviteteve kryesore ekonomike, 2021, burimi ASK

Prodhimi, tregtia dhe bujqësia janë aktivitetet kryesore ekonomike në rajon.

Shpenzimet e familjeve/për frymë

Të dhënat për shpenzimet e familjeve për kokë banori janë të disponueshme vetëm në nivel nacional, të ofruara nga Anketimi i buxheteve të familjeve.

I fundit i publikuar është ai i qershorit 2023[10] për vitin 2022 dhe përcakton shpenzimet mesatare vjetore për person prej 1,903 €. Në zonat urbane është pak më e lartë - 2,004 €, derisa në zonat rurale është 1,817 €. Të dhënat për shpenzimet e ekonomive familjare janë gjithashtu të disponueshme, por meqenëse madhësia e ekonomisë familjare ndryshon nuk citohen këtu. ASK nuk publikon të dhëna për të ardhurat familjare.

Anketa e publikuar më parë është për vitin 2017.

Punësimi

Shkalla e punësimit pasqyron përqindjen e popullsisë në moshë pune (15-64 vjeç) që është e punësuar. Shkalla e përgjithshme e punësimit në Kosovë po rritet vazhdimisht në 5 vitet e fundit, përveç në vitin 2020, për shkak të krizës Covid, siç shihet në grafikun e mëposhtëm dhe në anën tjetër paraqitet trendi i shkallës së papunësisë:

[10] https://askapi.rks-gov.net/Custom/05ec40da-61a2-4ace-ae25-241e2c38c050.pdf Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2022



Figura 11Shkalla e punësimit dhe papunësisë në Kosovë, 2018-2023, Burimi ASK

Në rajonin e Pejës, punësimi është përqendruar kryesisht në sektorët e mëposhtëm:

- Bujqësia: Shumë banorë merren me bujqësi, blegtori dhe pylltari.
- Shërbimet: Përfshirë shitjen me pakicë, mikpritjen (veçanërisht shërbimet që lidhen me turizmin) dhe administratën publike.
- Industria: Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) të përfshira në prodhim, veçanërisht në tekstil, mobilje dhe përpunimin e ushqimit.
- Sektori Publik: Punë në arsim, kujdes shëndetësor dhe shërbime të qeverisjes lokale.

Shkalla e papunësisë në Kosovë, përfshirë Pejën, është relativisht e lartë, veçanërisht në mesin e të rinjve dhe grave. Çështjet strukturore të tilla si mospërputhja e aftësive, mundësitë e kufizuara të punësimit jashtë qendrave urbane dhe varësia ekonomike nga remitancat kontribuojnë në këto sfida.

Sfidat socio-ekonomike

Shumë familje në rajonin e Pejës përballen me varfëri ose janë të ndjeshme ndaj goditjeve ekonomike, pavarësisht përpjekjeve për të përmirësuar standardin e jetesës. Ekziston një hendek i rëndësishëm midis familjeve me të ardhura të larta dhe me të ardhura të ulëta, duke kontribuar në pabarazitë sociale. Ekonomia lokale mbështetet shumë në remitancat nga diaspora, duke e bërë atë të pambrojtur ndaj kushteve të jashtme ekonomike. Sfidat në zhvillimin e infrastrukturës, veçanërisht në transport dhe shërbime komunale, pengojnë rritjen ekonomike dhe aksesin në shërbime.

Mundësitë për Zhvillim Ekonomik

Modernizimi i bujqësisë, promovimi i praktikave të qëndrueshme dhe rritja e produktivitetit mund të rrisin të ardhurat rurale. Zhvillimi i infrastrukturës turistike dhe promovimi i eko-turizmit në zonat natyrore si kanioni i Rugovës dhe vendet kulturore mund të krijojnë vende pune dhe të stimulojnë bizneset lokale. Ofrimi i mbështetjes për bizneset e vogla dhe bizneset fillestare përmes trajnimeve, financimit dhe programeve të inkubacionit të biznesit. Investimi në arsim, trajnim profesional dhe programe për ndërtimin e aftësive për t'u përshtatur me nevojat e tregut dhe për të rritur mundësitë e punësimit. Përmirësimi i rrugëve, shërbimeve komunale dhe telekomunikacionit për të tërhequr investime, për të lehtësuar tregtinë dhe për të përmirësuar standardet e jetesës.

Duke adresuar këto sfida socio-ekonomike dhe duke shfrytëzuar mundësitë në dispozicion, rajoni i Pejës mund të nxisë rritje të qëndrueshme ekonomike, të ulë varfërinë dhe të përmirësojë cilësinë e jetës për banorët e saj.

2.3.2 Biznesi dhe industria

Seksioni 3.1.2 paraqet informacion për numrin dhe llojin e subjekteve tregtare në rajon. Lloji i mbeturinave të prodhuara nga këto biznese është kryesisht i ngjashëm me mbeturinat e anvisërisë.

Industritë në rajonin e Pejës mund të gjenerojnë disa lloje të mbeturinave që mund të kategorizohen kryesisht në dy kryesore: mbeturina industriale jo të rrezikshme dhe të rrezikshme.

2.3.3 Turizmi

Në nivel rajonal janë zhvilluar shtigje për ecje malore dhe çiklizëm që lidhin 3 komuna (Pejë, Deçan dhe Junik) duke përshkuar Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna, ndërsa janë zhvilluar oferta për çiklizëm rekreativ që lidhin 6 komuna të fushës së Dukagjinit.

Në nivel ndërkufitar janë zhvilluar shtigje ecjeje që lidhin Kosovën me Shqipërinë dhe Malin e Zi. Shtegu 'Balkan Peaks', i cili është 192 km i gjatë dhe kalon nëpër Bjeshkëve të Nemuna në tre shtete, nga Këshilli Botëror i Udhëtimit dhe Turizmit[11] ka fituar çmimin e parë në botë për menaxhim të suksesshëm. Përveç kësaj, 300 km shtigje për ecje dhe çiklizëm janë zhvilluar ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi përmes Bjeshkëve të Nemuna.

Grafiku i mëposhtëm tregon numrin e vizitorëve dhe qëndrimeve vendase dhe ndërkombëtare në rajon për periudhën 2008 – 2017.



Figura 12Numri i vizitorëve vendas dhe ndërkombëtarë dhe netët e kaluara

Burimi: përshtatur nga ASK, 2018

Sipas të dhënave të ASK-së, numri i vizitorëve vendas dhe të huaj ishte: 65.099 në vitin 2019, 42.521 në vitin 2020 dhe 76.013 në vitin 2021. Numri i njësive akomoduese është 93, me 1.235 dhoma dhe 2.327 shtretër.

2.3.4 Bujqësia

Të dhënat e fundit të Regjistrimit treguan se bujqësia ishte profesioni kryesor në rajon me rreth 20,000 amvisëri të angazhuara në bujqësi, që ishte mbi 50% e familjeve në rajon.

Tabela 13Numri i familjeve të angazhuara në aktivitete bujqësore

Komuna	Numri i familjeve të angazhuara në aktivitete bujqësore
Deçan	3,936
Istog	5,063
Junik	343
Klinë	4,442
Pejë	6,038

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), 2014 (të dhënat e regjistrimit të popullsisë)

Tabela më poshtë tregon të dhënat e Regjistrimit për numrin e bagëtive në rajon.

[11] https://www.youtube.com/watch?v=xAI7B-vrodc.

Tabela 14Numri i bagëtive (krerë)

Komuna	Lopë	Dele	Dhi	Pula	Derra
Deçan	11,367	3,139	216	9,874	36
Istog	15,817	10,055	1,153	41,957	607
Junik	1,113	1,000	23	1,619	-
Klinë	10,474	2,345	606	41,546	4,160
Pejë	18,199	8,599	1,420	61,411	829

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), 2014 (të dhënat e regjistrimit të popullsisë)

Tabela më poshtë paraqet të dhënat për sipërfaqet në rajon të mbjellura me kultura bujqësore.

Tabela 15Sipërfaqet e të korrave në hektarë (ha)

Komuna	Grurë	Misër	Elb	Të tjera
Deçan	1,685	823	7	2,481
Istog	6,038	2,137	71	9,052
Junik	325	111	-	278
Klinë	7,586	1,767	48	10,214
Pejë	4,096	1,825	21	7,419

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), 2014

Tabela më poshtë paraqet të dhënat për sipërfaqet në rajon të mbjellura nga pemishtet.

Tabela 16Sipërfaqet e pemishteve, në ha

Komuna	Mollë	Kumbull	Dardhë	Qershi	Qershi e thartë	Të tjera
Deçan	68.22	4.59	8.72	0.49	0.57	8.89
Istog	272.63	4.79	27.51	0.09	0.21	9.88
Junik	18.00	0.19	0.42	k	9.09	0.25
Klinë	73.67	18.81	50.00	0.66	1.69	25.27
Pejë	176.70	8.92	28.52	0.31	0.30	16.74

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), 2014 (të dhënat e regjistrimit të popullsisë)

3 BAZA PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

3.1 Gjenerimi aktual i mbeturinave komunale

Mbeturinat e menaxhuara nga komunat gjenerohen kryesisht nga 3 kategori kryesore përdoruesish: i) amvisëritë, ii) institucionet dhe iii) bizneset. Ky seksion synon të vlerësojë sasinë e mbeturinave komunale të gjeneruara nga secila komunë për të ofruar një vlerësim të përgjithshëm për mbeturinat e prodhuara në rajonin e Pejës, të cilat do të duhet të menaxhohen në objektet e caktuara.

3.1.1 Amvisëritë

Tabela më poshtë paraqet sasitë e mbeturinave të brumbulluara nga secila komunë në vitin 2021 dhe 2022.

Tabela 17Gjenerimi i mbeturinave nga amvisëritë (të mbledhura), 2021 dhe 2022

Komuna	Mbeturinat e mbledhura, 2021	Mbeturinat e mbledhura, 2022	kg/kokë banori/vit, 2022
Pejë	36,063	36,113	436
Istog	16,256	11,892	360
Klinë	9,758	9,173	300
Deçan	8,298	8,289	300

Komuna	Mbeturinat e mbledhura, 2021	Mbeturinat e mbledhura, 2022	kg/kokë banori/vit, 2022
Junik	818	920	233
Totali	**71,193**	**66,396**	436

Burimi: Raporti i Gjendjes së Mjedisit, i AMMK, 2021 dhe 2022

Në raportimin ekzistues të AMMK-së, të dhënat e gjenerimit të mbeturinave nuk janë të ndara për kategori të ndryshme të prodhuesve kryesorë të mbeturinave. Prandaj, numrat e paraqitur janë shifra të përmbledhura për mbeturinat e përziera nga secila komunë.

Tabela më poshtë paraqet mbeturinat e gjeneruara në vitin 2023 sipas kategorive të ndryshme (aty ku ka) në secilën komunë.

Tabela 18. Gjenerimi i mbeturinave në rajonin e Pejës, 2023

Burimi	Pejë	Istog	Klinë	Deçan	Junik	Totali
Amvisëritë	30,500	11,569	7,738	3,913	860	54,580
Entitetet komerciale	5,150			2,134		7,284
Institucionet	1,650			712		2,362
Industritë				356		356
Totali	**37,300**	**11,569**	**7,738**	**7,115**	**860**	**64,582**

Burimi: të dhëna nga komunat, 2024

Shënim: Sasitë e mbeturinave të raportuara nga komunat e Istogut, Klinës dhe Junikut përbëjnë totalin e mbeturinave komunale (nga familjet dhe burime të ngjashme me familjet)

Siç shihet nga Tabelat e mësipërme, vetëm në Pejë prodhimi i mbeturinave ka shënuar rritje të lehtë. Në të gjitha komunat e tjera, gjenerimi i mbeturinave ka shënuar rënie në vitet e fundit.

Tabela më poshtë tregon normat e përllogaritura të gjenerimit të mbeturinave në secilën komunë bazuar në sasitë e raportuara të mbeturinave të gjeneruara në vitin 2023.

Tabela 19Normat e gjenerimit të mbeturinave, 2023

Komuna	Popullsia, 2024	Mbeturinat e gjeneruara, 2023	kg/kokë banori/vit	kg/kokë banori/ditë
Pejë	82,745	451	374	1.24
Istog	33,008	350	278	0.96
Klinë	30,503	254	189	0.70
Deçan	27,775	256	166	0.70
Junik	3,943	218	133	0.60

Burimi: bazuar në të dhënat nga komunat dhe ASK-ja

Gjenerimi mesatar i mbeturinave për kokë banori ndryshon midis komunave nga 218 (Junik) në 451 (Pejë) kg/vit me një **mesatare të përgjithshme për rajonin prej 363 kg/kokë banori/vit ose 0.99 kg/kokë banori/ditë** .

3.1.2 Burime komerciale dhe institucionale

Të dhënat nga AMKM tregojnë numrin e bizneseve aktive në rajon dhe ato kanë marrë shërbimin komunal për grumbullimin e mbeturinave komunale në vitin 2022.

Tabela 20Numri i bizneseve që marrin shërbimin e grumbullimit të mbeturinave komunale, 2021

Komuna	Numri i bizneseve aktive në komunë	Numri i institucioneve në komunë	Numri i bizneseve që marrin shërbimin	Numri i institucioneve që marrin shërbimin
Pejë	2,737	91	2,737	91
Istog	1,484	69	742	69

Komuna	Numri i bizneseve aktive në komunë	Numri i institucioneve në komunë	Numri i bizneseve që marrin shërbimin	Numri i institucioneve që marrin shërbimin
Klinë	1.211	64	744	64
Deçan	1,3053	50	590	50
Junik	120	8	107	8

Burimi: AMMK 2022

Tabela më poshtë tregon numrin dhe llojin e bizneseve në rajon.

Tabela 21Numri dhe lloji i bizneseve në rajon, 2024

Komuna	Me shumicë	Restorante	Kasapë	Të tjera
Pejë	1942	743	n/a	n/a
Istog	2	30	5	753
Klinë	n/a	n/a	n/a	n/a
Deçan	597	19	3	-
Junik	-	7	1	112

Burimi: të dhëna komunale, 2024

Numri i institucioneve për secilën komunë është renditur në tabelën më poshtë. Institucionet kryesore në rajon janë objektet e kujdesit shëndetësor dhe shkollat/institucionet arsimore.

Institucionet kryesore në secilën komunë janë renditur në Tabelën më poshtë.

Tabela 22Numri dhe lloji i institucioneve kryesore në rajon , 2024

Komuna	Kujdes Shëndetësor	Shkolla	Institucione kulturore	Të tjera
Pejë	**24** 23 Qendra të Kujdesit Primar 1 Kujdesi Sekondar SPITAL	**54** 46 objekte shkollore 4 Kopshte fëmijësh 1 universitet publik 1 Kolegj Privat 2 Shkolla private	**11** "Jusuf Gërvalla" Kinema-Teatër Kompleksi Rinor (Zum) Qendra Rinore Shtëpia e Kulturës Istref Begolli Teatri i Qytetit Muzeu Etnografik Stadiumi Shahin Haxhi Islami	**48** **Ndërmarrje publike:** Stacioni i autobusëve Ambienti Eko-Sig Hidrodrini Drini i Bardhë Infrakos Zyra Postare Institucione të tjera: Zyra për ndihmë juridike Ministria e Punëve të Brendshme - ish ndërtesa e Bankosit (pasaporta) Qendra e regjistrimit të automjeteve Gjykata Themelore në Pejë Divizioni për Kundërvajtje Prokuroria Themelore Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë Stacioni veterinar Qendra Rajonale e Punësimit Administrata Tatimore e Kosovës ATK

Komuna	Kujdes Shëndetësor	Shkolla	Institucione kulturore	Të tjera
			Qendër shumëprofesionale Shtëpia e Kulturës Halla e Sportit Qendra Sportive "Tahir Vokshi"	Kryqi i Kuq i Kosovës Spitali i Përgjithshëm Q.Sh. Qendra e Ministrisë së Punëve të Brendshme për regjistrimin e automjeteve Qendra e Mirëqenies së Gruas “Perandori Justinian” Agjencia Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pasurisë Ministria e Arsimit Qendra për aftësi profesionale Qendra për mirëqenie sociale Instituti Bujqësor i Kosovës MBPHR Instituti i Pyjeve Agjencia Pyjore Njësia e fishekzjarrëve UNMIK-u Universiteti Publik “Haxhi Zeka” Gjykata Themelore-Pejë Inspektorati i Arsimit Agjencia shtetërore e arkivave të Kosovës Arkivi ndërkomunal - Pejë Instituti për mbrojtjen e monumentit “Kulla e Gjokajve” Kisha Katolike Subjekti Hidromed "Ali Kelmendi" INFRAKOS SH.A. Hekurudha HEKURUDHA E KOSOVËS Hendikos Qendra e Bashkësisë Islame Qendra e shëndetit mendor Ministria e Mirëqenies Sociale e Shërbimit Sprovues të Republikës së Kosovës Life-Pharm Ministria e Shëndetësisëa Pema - Qendra e Kujdesit Ditor Ent Higjienik Burgu i Qarkut Doganat Ministria e MTPT-së Shoqatat e dala nga lufta
Istog	1 CCMF 8 QMF	13 shkolla fillore 2 shkolla të mesme 8 institucione 10 institucione parashkollore	1 Bibliotekë	3 zyra postare 1 stacion zjarrfikës
Klinë	13 QKMF 3 QMF 11 AMF – Spitali rajonal	26 shkolla fillore 2 shkolla të mesme	1 Bibliotekë 1 shtëpi e kulturës	1 Zyrë Postare 1 stacion zjarrfikësish 13 zyra të gjendjes civile 1 QKRA

Komuna	Kujdes Shëndetësor	Shkolla	Institucione kulturore	Të tjera
				1CRC
Deçan	1 QKMF, QMF, spital rajonal, klinika, klinikë private	19 shkolla fillore 2 shkollë e mesme institucionet parashkollore Universiteti	1 Muze 1 Bibliotekë	1 Zyrë Postare 1 stacion zjarrfikësish
Junik	1 Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare	1 Shkollë e Mesme e Ulët 1 Gjimnaz		Komuna Zyra postare Stacion zjarrfikësish Stacion i Policisë Qendra për Regjistrimin Civil dhe të Automjeteve QPS

Burimi: të dhëna komunale, 2024

Sasia e saktë e mbeturinave komerciale është e vështirë të përcaktohet për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme. Për bizneset e vogla dhe të mesme, shërbimi ofrohet në të njëjtën mënyrë si për amvisëritë, që do të thotë në bazë të shpeshtësisë së caktuar të inkasimit. Bizneset më të mëdha janë të pajisura me kontejnerë dhe tarifohen ose për zbrazje ose sipas kërkesës.

Në mungesë të të dhënave të besueshme, vlerësimi i mbeturinave të gjeneruara nga institucionet dhe institucionet komerciale, zakonisht të referuara si të ngjashme me ato të amvisërisë, zakonisht bazohet në dy supozimet e mëposhtme:

- Në zonat urbane, mbeturinat e ngjashme me ato të amvisërisë përbëjnë 15% të totalit të mbeturinave të amvisërisë.
- Në zonat rurale, mbeturinat e ngjashme me ato të amvisërisë përbëjnë 5% të totalit të mbeturinave të amvisërisë.

3.1.3 Mbeturinat e gjelbra nga zonat publike

Përveç familjeve, bizneseve dhe institucioneve, një burim tjetër i gjenerimit të mbeturinave komunale janë sipërfaqet e gjelbra publike. Sipërfaqet e gjelbra publike përfshijnë: parqet, varrezat, mirëmbajtjen e rrugëve, hotelet, pronat komerciale, etj. Si pritet, sasitë e mbeturinave të gjelbra nga sipërfaqet e gjelbra publike nuk janë të regjistruara, për faktin se mbeturinat e gjelbra pasi që mblidhen, në vend që të kompostohen në një objekt të caktuar, përfundojnë në deponinë rajonale.

Në mungesë të të dhënave të besueshme, vlerësimi i mbeturinave të gjelbra të gjeneruara në zonat publike të gjelbra zakonisht bazohet në dy supozimet e mëposhtme:

- Në zonat urbane, mbeturinat e gjelbra nga zonat publike përbëjnë 30 kg për person në vit.
- Në zonat rurale, mbeturinat e gjelbra nga zonat publike përbëjnë 10 kg për person në vit.

3.1.4 Mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbeturinave nga Ndërtimi dhe Rrënimi (PKMMNRr) ofron një vlerësim të sasive të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit (MNRr) të gjeneruara në rajon. Këto paraqiten në tabelën më poshtë.

Tabela 23. Gjenerimi i MNRr-ve në Rajonin e Pejës, 2024

Burimi	Rajoni i Pejës, m^3/vit	Rajoni i Pejës, ton/vit
Mbeturinat e ndërtimit	37,731	31,339
Mbeturinat e rrënimit	15,092	12,536
MNRr nga familjet	1,580	1,313

Burimi	Rajoni i Pejës, m³/vit	Rajoni i Pejës, ton/vit
Totali i MNRr-ve	**54,404**	**45,188**

Burimi: PKMMNRr

Tonelatat janë vlerësuar me supozimin se dendësia e MNRr-ve është 830.6 ton/m³. Sipas PMMNRr, familjet kontribuojnë në gjenerimin e përgjithshëm të MNRr-ve me vetëm 3%. Burimi më i rëndësishëm i gjenerimit të MNRr-ve është sektori i ndërtimit - rreth 70%.

3.2 Përbërja e mbeturinave

Analiza e përbërjes së mbeturinave komunale është bërë për 1 vit, nga tetori 2021 deri në nëntor 2022, në 7 regjionet e Kosovës, në komunat e Prishtinës, Prizrenit, Ferizajt, Gjakovës, Mitrovicës Jugore, Gjilanit dhe Pejës. Mostrat janë marrë në 4 zona të qyteteve, duke përfshirë ambiente banimi kolektive, individual, biznese dhe kategori të përziera (kompani kolektive, individuale dhe afariste).

Rezultatet mesatare të kombinuara të tre anketave në Pejë janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 24. Përbërja e mbeturinave në Pejë

Kategoria e mbeturinave	Rezultati mesatar
Mbeturinat organike	29.7%
Mbeturinat e gjelbra	3.3%
Tetrapak	1.9%
Plastikë	18.5%
Letër/karton	16.8%
Tekstil	6.8%
Metal	1.8%
Qelq	7.1%
Dru	1.8%
MNRr	2.4%
Mbeturina të rrezikshme	0.1%
Pelena	2.4%
Mbeturina të imëta	7.4%
Totali	**100.0%**

Sa i përket potencialit për riciklimin dhe rikuperimin e mbeturinave, figura më poshtë tregon përmbajtjen e mbeturinave të biodegradueshme dhe të riciklueshmeve të thata në totalin e MKI-ve.



Figura 13Përbërja e MKI-ve sa i përket potencialit për riciklim/rikuperim

Siç shihet nga figura më sipër, 88% e MKI-ve kanë potencial për një formë riciklimi dhe rikuperimi.

3.3 Ofrimi aktual i shërbimeve komunale për menaxhimin e mbeturinave

3.3.1 Grumbullimi i mbeturinave

Komuna e Pejës. Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave ofrohet nga KRU Ambienti. Shërbimi ofrohet nga 17 kamionë grumbullues mbeturinash me kapacitet nga 1 deri në 8 tonë. Pesë nga ata kamionë janë të rinj (të prodhuar në vitin 2022), ndërsa pjesa tjetër janë kryesisht të vjetër (prodhuar midis viteve 1985 dhe 2012).

Komuna e Istogut. Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave ofrohet nga KRU Ambienti. Shërbimi ofrohet nga 10 kamionë grumbullues mbeturinash me kapacitet nga 1 deri në 11 tonë. Vetëm një nga këta kamionë është i ri (prodhuar në vitin 2022), ndërsa pjesa tjetër janë kryesisht të vjetër (prodhuar midis viteve 2000 dhe 2011). Të gjithë kamionët janë të pajisur me kompakt; vetëm një është një kamion i hapur, i prodhuar në vitin 1987.

Komuna e Klinës. Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave ofrohet nga KRU Ambienti. Shërbimi ofrohet nga 6 kamionë grumbullues mbeturinash me kapacitet nga 4 deri në 10 tonë. Tre nga këta kamionë janë të rinj (prodhuar në vitin 2022), ndërsa tre të tjerët janë të vjetër (prodhuar midis viteve 1997 dhe 2001). Të gjithë kamionët janë të pajisur me sistemin kompakt.

Komuna e Deçanit. Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave ofrohet nga një kompani komunale. Kompania përdor 10 kamionë për grumbullimin e mbeturinave. Vetëm 1 është i ri (prodhuar në vitin 2023); pjesa tjetër është mjaft e vjetër (prodhuar midis viteve 1996 dhe 2007).

Komuna e Junikut. Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave ofrohet nga një kompani private – Euro Steel LLC. Grumbullimi i mbeturinave organizohet me një kamion grumbullues mbeturinash me kapacitet 8 m^3 dhe prodhuar në vitin 2005.

Tabela më poshtë paraqet pronësinë e aseteve në secilën komunë dhe përgjegjësinë për investimin në pajisjet e grumbullimit të mbeturinave.

Tabela 25Pronësia e pajisjeve dhe përgjegjësia për të investuar në pajisje

Komuna	Kontejnerët, amvisëritë	Kontejnerët, bizneset	Kamionët	Përgjegjësia për investimin në pajisje
Pejë	KRM Ambienti	KRM Ambienti	KRM Ambienti	Komuna dhe KRM-ja
Istog	KRM Ambienti	KRM Ambienti	KRM Ambienti	Komuna dhe KRM-ja
Klinë	Komuna	Komuna	Komuna	Komuna dhe kompania komunale
Deçan	Kompania komunale	Kompania komunale	Kompania komunale	Komuna dhe KRM-ja
Junik	Komuna/përdoruesit	Komuna/përdoruesit	Operator privat	Operatori privat (automjete), komuna (kontejnerë)

Burimi: të dhënat nga komunat (2024)

Tabelat më poshtë paraqesin numrin dhe llojin e kontejnerëve në përdorim për grumbullimin e mbeturinave nga amvisëritë dhe bizneset/institucionet, si dhe frekuencën e grumbullimit të mbeturinave.

Tabela 26Kontejnerët e grumbullimit të mbeturinave për amvisëri

Komuna	Masa	1.1 m^3	120 litra
Pejë	numri	-	22,000
	frekuenca e grumbullimit	-	1 herë në javë
Istog	numri	50	870
	frekuenca e grumbullimit	1 herë në javë	1 herë në javë
Klinë	numri	180	4,825

Komuna	Masa	1.1 m³	120 litra
	frekuenca e grumbullimit	1 herë në javë	1 herë në javë
Deçan	numri	-	7,853
	frekuenca e grumbullimit	-	1 herë në javë
Junik	numri	-	1,000
	frekuenca e grumbullimit	-	një herë në javë

Burimi: të dhënat nga komunat (2024)

Tabela 27Kontejnerët e grumbullimit të mbeturinave për biznese dhe institucione

Komuna	Masa	1.1 m³	240 litra	120 litra	> 4 m³
Pejë	numri	390	850	-	45
	frekuenca e grumbullimit	me kontratë	1 herë në javë	-	sipas kërkesës
Istog	numri	150	-	-	-
	frekuenca e grumbullimit	1-3 herë në javë	-	-	-
Klinë	numri	133	-	30	-
	frekuenca e grumbullimit	sipas kërkesës	-	1 herë në javë	-
Deçan	numri	171	-	-	-
	frekuenca e grumbullimit	1-3 herë në javë (biz-nese); me kërkesë (institucione)	-	-	-
Junik	numri	26	-	6	-
	frekuenca e grumbullimit	1 herë në javë	-	1 herë në javë	-

Burimi: të dhënat nga komunat (2024)

Siç shihet nga tabelat e mësipërme, lloji mbizotërues i kontejnerit që përdoret për grumbullimin e mbeturinave nga amvisëritë është 120 litërsh, për shkak të llojit të banimit të përhapur në rajon (shtëpi individuale). Kontejnerët më të mëdhenj 1.1 m³ janë zgjedhja e preferuar për grumbullimin e mbeturinave nga bizneset dhe institucionet. Komuna e Pejës përdorë edhe një numër të madh të kontejnerëve 240 litërsh për grumbullimin e mbeturinave nga bizneset.

Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave u ofrohet 100% të banorëve të përhershëm në 4 nga 5 komunat. Në Klinë raportohet se grumbullimi i mbeturinave i ofrohet 98% të popullsisë me plane për të rritur mbulimin e shërbimeve në 100%.

3.3.2 Grumbullimi ndaras i mbeturinave

Grumbullimi ndaras i mbeturinave të materialeve të ricikluesshme nuk është organizuar në asnjë nga pesë Komunat. Është planifikuar nga Komunat që kjo të fillojë nga viti 2025 e në vazhdim. Komuna e Pejës ka përvojë të mëparshme me nisma pilot, rezultatet e të cilave treguan se përpjekjet e tilla sporadike nuk janë të suksesshme nëse nuk mbështeten nga kushtet e tjera të nevojshme dhe nëse nuk ekziston infrastruktura e nevojshme.

Të 5 komunat kanë lokacione të caktuara për ngritjen e oborreve të riciklimit (OR).

3.3.3 Transferimi i mbeturinave

Asnjë stacion transferi nuk është në përdorim në Zonat e Menaxhimit të Mbeturinave (ZMM). Një lokacion në Istog fillimisht ishte paraparë të shfrytëzohej si stacion transferi nga ku mbeturinat do të transportoheshin në deponinë rajonale të Pejës. Mirëpo, për shkak të problemeve fillestare të pajisjeve dhe kostove të larta të transportit deri në deponinë e Pejës, lokacioni në Istog përfundoi duke u përdorur si deponi. Ky i fundit tani është i mbyllur dhe mbeturinat nga Istogu transportohen direkt në deponinë rajonale në Pejë.

3.3.4 Rikuperimi i mbeturinave

Në ZMM-të mungojnë objektet formale të trajtimit për fraksionet e ndryshme të mbeturinave që gjenerohen në rajon. Ky është një nga faktorët kryesorë kufizues për trajtimin e duhur të mbeturinave në ZMM.

Një rol aktiv në grumbullimin e veçantë të shumëllojshmërisë së materialeve të riciklueshme ka Euro Steel Nushi Ltd, kompania për ndërtim dhe riciklim, me seli në qytetin e Pejës. Kompania mbledh materiale të riciklueshme kryesisht nga bizneset në të gjithë rajonin dhe ka vendosur kontakte me ricikluesit në tregun ndërkombëtar. Kompania aktualisht është duke ofruar shërbimin e grumbullimit të mbeturinave edhe për Komunën e Junikut.

SKMIM e përditësuar parashikon infrastrukturën e mëposhtme të riciklimit dhe rikuperimit të mbeturinave për të gjithë ZMM-në:

- Objekti për rikuperimin e materialeve (ORM/MRF) në Pejë për materialet e riciklueshme të grumbulluara ndaras
- Impianti i kompostimit për mbeturinat e gjelbra të grumbulluara ndaras në ZMM.
- Impianti i trajtimi mekaniko-biologjik (TMB/MBT) për mbeturinat e përziera komunale për prodhimin e karburantit të derivuar nga mbeturinat (KDM/RDF) për të gjithë ZMM-në
- Tretje anaerobe për mbeturinat ushqimore të grumbulluara ndaras në zonat urbane për të gjithë ZMM-në.

KDM-ja e prodhuar nga të gjitha ZMM-të në vend do të trajtohet në një objekt qendror nacional të caktuar për djegien e KDM-së me rikuperim energjie.

Një studim fizibiliteti për krijimin e një ORM-je në Pejë është kryer tashmë.

3.3.5 Deponimi i mbeturinave

Deponia e Pejës

Të gjitha komunat e rajonit i deponojnë mbeturinat e tyre komunale në deponinë e Pejës. Deponia e Pejës është ndërtuar në vitin 2001. Është projektuar në sipërfaqe prej 3.6 ha, me gjeomembranë të vendosur në sipërfaqe prej 3 ha. Është projektuar me një kapacitet prej 1.5 milion m^3. Fillimisht, stacioni i pompës së riqarkullimit të kullimit është jashtë funksionit duke çuar në rrjedhjet dhe ujërat sipërfaqësore të kontaminuara që rrjedhin nga zona e deponisë. Vetëm procedura të kufizuara operacionale zbatoheshin në baza ditore – profilizimi dhe ngjeshja e mbetjurinave. Aktualisht, trupi i deponisë është shumë i lartë dhe pothuajse nuk zbatohen procedura operacionale. Kapaciteti i deponisë është varfëruar për një kohë të gjatë.

Figura 14Pamje e deponisë në Sverkë

Projektimi i detajuar dhe dokumentet e tenderit për mbylljen e lokacionit ekzistues dhe ndërtimin e deponisë të re janë në përgatitje dhe rishikim tash e disa vite. Plani parashikon mbylljen dhe rehabilitimin e zonës ekzistuese të depozitimit; dhe ndërtimi i një qelie deponie, si një zgjatim i deponisë aktuale, e cila do të plotësojë kriteret e përcaktuara në Direktivën e BE-së për Deponitë[12].

Deponitë e hapura

Numri i deponive të hapura u rrit ndjeshëm në vitin 2019 krahasuar me vitin 2017. Pas kësaj, numri i tyre ka shënuar rënie të ndjeshme, siç paraqitet në tabelën më poshtë. Në përgjithësi, numri i përgjithshëm i deponive ilegale është ulur me 57% nga 162 në 2019 në 70 deponi ilegale në 2022.

Tabela 28Trendi i numrit të deponive të egra

Komuna	Numri i deponive ilegale		
	2017	2019	2022
Pejë	19	73	13
Istog	22	22	10
Klinë	9	46	33
Deçan	31	21	8
Junik	22	0	3
Totali	**103**	**162**	**67**

Burimi: AMMK

35% e deponive ilegale klasifikohen si mbeturina komunale të përziera (MKP), 28% si mbeturina nga ndërtimi dhe rrënimi (MNRr) dhe 38% si mbeturina tjera. Në Pejë, 1% e deponive ilegale janë klasifikuar Mbeturina të Rrezikshme Industriale (MRrI). Asnjë nga venddeponitë nuk u klasifikua për mbeturinat e vëllimshme(MV).

Tabela 29Numri dhe Karakteristikat e Venddeponive të Paligjshme, 2021

Komuna		Shpërndarja e mbeturinave				
	Totali	MKP	MNRr	MRrI	MV	Të tjera
Pejë	21	41.0%	5.0%	1.0%	0.0%	53.0%
Istog	16	55.0%	18.0%	0.0%	0.0%	27.0%
Klinë	31	43.0%	35.0%	0.0%	0.0%	22.0%

[12] Direktiva e Këshillit 1999/31/EC e datës 26 prill 1999 për depozitimin e mbeturinave

Komuna		Shpërndarja e mbeturinave				
	Totali	MKP	MNRr	MRrl	MV	Të tjera
Deçan	2	0.0%	52.0%	0.0%	0.0%	48.0%
Junik	0	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Totali	**70**	**34.8%**	**27.5%**	**0.3%**	**0.0%**	**37.5%**

Burimi: AMMK

3.3.6 Lëvizja e mbeturinave

Informacioni i kufizuar është i disponueshëm për lëvizjen e mbeturinave brenda dhe jashtë ZMM-ve. Komuna e Pejës ka vlerësuar se 12,176 tonë mbeturina të ricklueshme janë eksportuar në vitin 2023. Fraksionet e mbeturinave të ricklueshme dhe PZP transportohen brenda dhe jashtë rajonit në varësi të vendndodhjes së objekteve të licencuara të grumbullimit, magazinimit, përpunimit/riciklimit/trajtimit. Siç është përmendur tashmë në Seksionin 0, rol udhëheqës në eksportin e materialeve të ricklueshme ka kompania Euro Steel, me seli në Pejë.

3.3.7 Stafi për menaxhimin e mbeturinave

Situata ekzistuese e punonjësve në menaxhimin e mbeturinave në ZMM është renditur në tabelën vijuese. Ndryshimet e stafit për klient janë mjaft të ngjashme ndërmjet komunave. Përjashtim bën vetëm Komuna e Junikut, ku efikasiteti i stafit për 1,000 konsumatorë të shërbyer është më i lartë në krahasim me 4 komunat tjera.

Tabela 30Efikasiteti i stafit për menaxhimit të mbeturinave, 2021

Komuna	Stafi i Ofruesit të Shërbimeve	Klientët e shërbyer	Efikasiteti i stafit për 1,000 klientët e shërbyer
Pejë	110	20,455	5
Istog	33	7.746	4
Klinë	46	7.219	6
Deçan	55	8,242	6
Junik	11	1,033	10

Burimi: AMMK 2021

3.3.8 Tarifat e mbeturinave

Të dhënat mbi tarifat e fundit të mbeturinave për amvisëritë janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 31Tarifa mujore e mbeturinave të amvisërisë, EUR

Viti	Deçan	Istog	Klinë	Pejë	Junik
2023	6.85	6	6	6	6
2024	6.85	7	6	6	6

Burimi: të dhëna komunale, 2024

Tabela më poshtë përmbledh gamën e tarifave të mbeturinave të aplikuara për personat juridikë:

Tabela 32Tarifat mujore të mbeturinave për personat juridikë, EUR

Viti	Deçan	Istog	Klinë	Pejë
2023	11.95	5.40 -50	7.5-40	5.4-24
2024	14.52	5.94 – 100	14	7.6-26

Burimi: të dhëna komunale, 2024

Tarifat e portës së deponisë për ton mbeturina të aplikuara për personat juridikë janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Tabela 33Tarifat e hyrjes në deponi, EUR

Viti	Deçan	Istog	Klinë	Pejë	Junik
2023	8	9	9	5	14
2024	9	9	9	5	15

Burimi: të dhënat komunale, 2024

Të dhënat për të hyrat aktuale nga tarifat e mbeturinave janë paraqitur në tabelën në vijim. Tarifa për kokë banori paraqet matjet e popullsisë nga ASK për vitin 2022.

Tabela 34Të hyrat aktuale vjetore nga tarifa e mbeturinave nga amvisëritë, EUR

Viti	Deçan	Istog	Klinë	Pejë	Junik[13]
2021	322,086	324,264	266,360	893,282	54,720
2022	294,457	351,352	316,528	875,587	41,100
2022 për kokë banori[14]	10.6	10.6	10.4	10.6	10.4

Burimi: AMMK, 2021 dhe 2022

Tabela e mëposhtme përmbledh të hyrat aktuale nga tarifat e mbeturinave nga personat juridikë:

Tabela 35Të hyrat aktuale nga tarifa e mbeturinave nga personat juridikë

Viti	Deçan	Istog	Klinë	Pejë	Junik
2021	123,588	154,710	122,286	381,654	15,767
2022	281,585	169,957	115,196	372,018	15,560

Burimi:AMMK, 2021 dhe 2022

Shkalla e grumbullimit të tarifave të mbeturinave (pagesat e faturuara/arkëtuara) është më e lartë se 90% si për amvisëritë ashtu edhe për personat juridikë. Pagesat e amvisëritë përfaqësojnë 50 deri në 72% të të hyrave totale nga tarifa e mbeturinave. Pjesa tjetër mbulohet nga persona juridikë.

3.3.9 Roli i sektorit jo-formal

Sektori jo-formal është i përfshirë në mënyrë aktive në aktivitetet e riciklimit në të gjithë vendin si dhe në ZMM kryesisht në ndarjen e materialeve të ricikluesshme. Sektori jo-formal mbledh të gjitha llojet e materialeve të ricikluesshme me vlerë pozitive tregu, të cilat më pas u dërgohen operatorëve të riciklimit.

Nuk ka të dhëna të disponueshme për sasitë e materialeve të ricikluesshme të mbledhura veçmas në ZMM.

3.4 Menaxhimi i mbeturinave tjera

3.4.1 Fraksionet e veçanta të mbeturinave

Kuadri rregullator kombëtar përcakton që fraksionet e veçanta të mbeturinave duhet të menaxhohen përmes mekanizmit të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (PZP). Fraksionet e tilla të mbeturinave përfshijnë:

- Automjetet mbeturinë (AM)
- Vajrat e përdorura
- Mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike (MPEE)
- Gomat e harxhuara
- Bateritë e shpenzuara

[13] Të dhënat për Junikun janë marrë nga raportet e AMMK-së, komuna ka ofruar të dhëna për të ardhurat në total.

[14] 2024 Census data applied for population applied

Kuadri rregullator, megjithatë, nuk përcakton kërkesat minimale për krijimin e skemave PZP, siç përshkruhet në Direktivën Kuadër të Mbeturinave. Si rezultat, skemat PZP nuk janë krijuar ende për fraksionet e sipërpërmendura të mbeturinave.

Në mungesë të skemave PZP, në të dy rajonet ka operatorë të cilët janë të licencuar për të kryer grumbullimin dhe aktivitete tjera të menaxhimit të mbeturinave për mbeturinat e veçanta. Lista e kompanive të licencuara që merren me mbeturinat PZP është paraqitur në Tabelën më poshtë:

Tabela 36Lista e kompanive të licencuara që merren me mbeturina të veçanta

Emri i kompanisë	Vendndodhja	Fraksioni i mbeturinave	Aktiviteti i licensuar
Riciklimi MOS HARRO "Euro Steel" Sh.P.K. Riciklimi – ED Vemor	Pejë	Automjetet Mbeturinë dhe mbeturinat metalike, grumbullimi i plastikës, metaleve, etj. Rikuperimi i materialeve të klasifikuara	Grumbullimi, përpunimi, trajtimi, presimi dhe riciklimi i automjeteve skrap, grumbullimi i plastikës dhe metalit
VALKOS SH.P.K. N.B.S. SH.P.K. N.P.T. "Vellezërit Sadrijaj Te Aleni SH.P.K. N.T.P. " Niti -Com"	Istog	Automjetet Mbeturinë dhe mbeturinat metalike, grumbullimi i plastikës, metaleve, etj.	Grumbullimi, përpunimi, trajtimi, presimi dhe riciklimi i automjeteve skrap, grumbullimi i plastikës dhe metalit
EVOLVE SRL S L.L.C. Eli SH.P.K.	Klinë	Automjetet Mbeturinë dhe mbeturinat metalike, grumbullimi i plastikës, metaleve, etj.	Grumbullimi, përpunimi, trajtimi, presimi dhe riciklimi i automjeteve skrap, grumbullimi i plastikës dhe metalit
DEKOR SH.P.K. Valmir Zogaj B.I.	Deçan	Grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme (veprimtari dytësore)	Grumbullimi, përpunimi, trajtimi, presimi dhe riciklimi i automjeteve skrap, grumbullimi i plastikës dhe metalit
N/A	Junik	N/A	N/A

3.4.2 Mbeturinat e rrezikshme të amvisërisë

Asnjë nga komunat në Rajonin e Dukagjinit nuk zbaton një sistem për grumbullimin ndaras të mbeturinave të rrezikshme amvisërisë (MRrA).

3.4.3 Mbeturinat medicinale

Ligji nr. 04/L-125 për Shëndetësinë organizon shërbimet shëndetësore për institucionet shëndetësore të tri niveleve: primar, sekondar dhe terciar, dhe bën dallimin ndërmjet shërbimeve shëndetësore të ofruara nga institucionet publike, private dhe publike-private.

Sa i përket institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor (IKPSH), në çdo komunë ekziston Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) si njësi parësore me njësitë e saj përbërëse përkatëse: Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulantat e Mjekësisë Familjare (AMF). Një pjesë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor sekondar dhe terciar organizohen përmes 7 spitaleve rajonale, duke përfshirë një në Pejë.

Tabela 37Mbeturinat medicinale të gjeneruara në spitalin rajonal në Pejë

Nr. i shtretërve			Shkalla e zënies %			Gjenerimi i MM (kg/shtretër të zënë/vit)		
2019	2020	2021	2019	2020	2021	2019	2020	2021
376	387	390	53.95	40.20	44.65	101524	77853	87144

Burimi: Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbeturinave Medicinale

Në vitin 2021, sasia e Mbeturinave Medicinale (MM) të gjeneruara në spitalin rajonal në Pejë ishte rreth 87 tonë.

Tabela më poshtë tregon sasitë e MM të gjeneruara nga Institucionet Shëndetësore (ISh) në ZMM.

Tabela 38Sasitë e MM të gjeneruara nga ISh primare

Komunat	Vizitat e mjekësisë familjare 2019	Vizitat e mjekësisë familjare 2020	Mbeturinat e gjeneruara/pacientët ambulantorë (2019), kg	Mbeturinat e gjeneruara/pacientët ambulatorë (2020), kg
Pejë	139,061	134,189	2,086	2,013
Istog	41,945	233,941	629	3,509
Klinë	79,610	59,252	1,194	889
Deçan	42,482	73,041	637	1,096
Junik	17,731	13,626	266	204
Totali në ZMM	**320,829**	**514,049**	**4,812**	**7,711**

Burimi: Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbeturinave Medicinale

Në vitin 2020, më pak se 8 tonë të MM u gjeneruan nga ISh parësore në ZMM.

Mbeturinat infektive dhe të mprehta trajtohen në autoklava hibride në spitalin rajonal në Pejë. Autoklava është instaluar në vitin 2012 dhe ka kapacitet prej 350 litra për cikël.

Tabela më poshtë paraqet sasitë e MM të rrezikshme të trajtuara në autoklava të vendosura në spitalin rajonal në Pejë për periudhën 2015-2021.

Tabela 39Sasitë e mbeturinave të trajtuara, 2015-2021, kg

2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
44,418	49,403	49,351	49,215	45,720	50,480	47,560

Burimi: AMMK

3.4.4 Mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit

Mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit aktualisht trajtohen vetëm në Komunën e Junikut, e cila ka marrëveshje me operatorë privat në ZMM. Disa komuna, si Peja dhe Klina, kanë ndarë lokacione specifike për deponim të përkohshëm.

Nga raporti më i fundit nacional për deponitë e egra, u vlerësua se 27.5% e mbeturinave në deponitë ilegale janë në të vërtetë MNRr.

3.4.5 Mbeturinat e vëllimshme

Sipas Ligjit për mbeturina, komunat janë përgjegjëse për organizimin e menaxhimit të mbeturinave të vëllimshme. Nuk ka të dhëna të disponueshme për sasinë e mbeturinave të vëllimshme në mbeturinat e përziera komunale dhe raportohet se këto mbeturina shpesh përfundojnë në deponitë e egra. Megjithatë, mbeturinat e vëllimshme nuk u hasën në deponitë e egra në vitin 2022 (AMMK).

Vetëm Komuna e Pejës ofron shërbimin e grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme edhe pse ende nuk ka një sistem për trajtimin e tyre.

3.4.6 Mbeturinat bujqësore

Nuk ka informacion se si menaxhohen aktualisht mbeturinat nga aktivitetet bujqësore. Siç tregohet në Seksionin 2.3, bujqësia është një aktivitet i rëndësishëm ekonomik në Rajonin e Dukagjinit. Çdo vit, ga aktivitetet bujqësore në rajon gjenerohen sasi të konsiderueshme mbeturinash. Menaxhimi i mbeturnave bujqësore duhet të ndjekë parimin "ndotësi-paguan", që do të thotë se gjeneruesit e mbeturinave bujqësore duhet të jenë përgjegjës për menaxhimin e tyre dhe duhet të mbulojnë kostot e menaxhimit.

3.4.7 Mbeturinat industriale

Në rajon nuk funksionon asnjë minierë aktive. Gjithashtu, 35% e deponive ilegale klasifikohen si mbeturina komunale të përziera (MKP), 28% si mbeturina nga ndërtimi dhe rrënimi (MNRr) dhe 38% si mbeturina tjera. Në Pejë, 1% e deponive ilegale janë klasifikuar Mbeturina të Rrezikshme Industriale (MRrI). Asnjë nga venddeponitë nuk u klasifikua për mbeturinat e vëllimshme(MV).

Tabela 29 e këtij Plani tregon se mbeturinat e rrezikshme industriale janë hasur vetëm në Komunën e Pejës, duke përbërë 1% të mbeturinave të deponuara në deponitë ilegale. Ndryshe, mbeturinat jo të rrezikshme industriale po deponohen në deponinë rajonale të Pejës – rreth 8,500 tonë në vitin 2023.

Industritë e mëdha janë të detyruara të operojnë sipas lejeve të Kontrollit të Integruar të Parandalimit të Ndotjes, të cilat lëshohen nga autoritetet, vetëm nëse industritë kanë plane për menaxhimin e mbeturinave.

3.4.8 Mbeturinat nga ITUZ

Në rajon ekziston vetëm një impiant për trajtimin e ujërave të zeza (ITUZ), në qytetin e Pejës, i ndërtuar në vitin 2022. Proceset e trajtimit që përdoren në impiant janë stacionet e pompimit, trajtimi mekanik dhe biologjik i kanalizimeve, tretja anaerobe e lymit, prodhimi dhe shfrytëzimi i biogazit dhe prodhimi i energjisë elektrike dhe nxehtësisë që mbulojnë shumicën e kërkesave të impiantit për furnizim me energji elektrike.

Prodhimi vjetor i lymit nga trajtimi vlerësohet të jetë 2.9 tonë në vit. Lymi hiqet dhe depozitohet në ambientet e fabrikës sipas metodave dhe proceseve të përcaktuara në projekt. Supozohet se pas stabilizimit lymi mund të përdoret si pleh organik.

3.5 Ndërgjegjësimi publik

Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese të publikut për menaxhimin e mbeturinave dhe për ekonominë qarkore në 3 vitet e fundit është renditur në tabelën më poshtë.

Tabela 40Aktivitete dhe fushata ndërgjegjësimi në lidhje me menaxhimin e mbeturinave në rajonin e Dukagjinit

Komuna	Numri i aktiviteteve me popullatën për rritjen e ndërgjegjësimit		
	2021	2022	2023
Pejë	Kalendari i ditëve mjedisore	Kalendari i ditëve mjedisore	Kalendari i ditëve mjedisore
Istog	n/a	n/a	n/a
Klinë	Kalendari i ditëve mjedisore (22 prill, 24 maj, 5 qershor)	Kalendari i ditëve mjedisore (22 prill, 24 maj, 5 qershor)	Kalendari i ditëve mjedisore (22 prill, 24 maj, 5 qershor)
Deçan	E kryer, nuk specifikohet	E kryer, nuk specifikohet	E kryer, nuk specifikohet
Junik	Fushata ndërgjegjësimi në shkolla, fushata "Pastroni Kosovën"	Fushata ndërgjegjësimi në shkolla, fushata "Pastroni Kosovën"	Fushata ndërgjegjësimi në shkolla, fushata "Pastroni Kosovën"

3.6 Analiza e mangësive të situatës ekzistuese për menaxhimin e mbeturinave

Analiza e mangësive të situatës ekzistuese për menaxhimin e mbeturinave paraqitet në tabelën më poshtë.

Tabela 41Analiza e mangësive të situatës ekzistuese për menaxhimin e mbeturinave

Kategoria	Situata ekzistuese	Masat për përmirësim	Qëllimi
Parandalimi i mbeturinave	Nuk ka strategji për parandalimin e mbeturinave dhe synëhen vetëm disa fushata ndërgjegjësuese	Plani për parandalimin e mbetjurinave dhe fushata ndërgjegjësuese	Ulja e niveleve aktuale të gjenerimit të mbeturinave
	Deri më tani kompostuesit shtëpiak u janë shpërndarë amvisërive vetëm në Komunën e Pejës	Rritja e përqindjes së shtëpive me kompostuesnë zonat e rezidenciale dhe rurale	Reduktimi i prodhimit të mbeturinave biologjike në zonat rurale
Grumbullimi i Mbeturinave	Shërbimet e grumbullimit të mbeturinave i ofrohen 100% të popullsisë në 4 prej 5 komunave. Në Klinë grumbullimi i mbeturinave u sigurohet 98% të popullsisë	Ruajtja e përqindjes së popullsisë së lidhur me shërbimet bazë (amvisëritë, biznese dhe institucione)	Arritja 100% dhe mirëmbajtja e shërbimeve të mbuluara
Grumbullimi ndaras i mbeturinave	Nuk ka sisteme të drejtuara nga komunat për ndarjen në burim (NB)	Zhvillimi i sistemit NB dhe rritja e përqindjes së popullsisë me qasje në sistemin me 2 ose 3 shporta për grumbullim (amvisëritë, bizneset dhe institucionet)	Futja e sistemit të NB në të gjitha zonat urbane dhe fshatrat e mëdha dhe arritja e normave të përcaktuara të riciklimit
	Nuk ka Oborr Riciklimi (OR) për grumbullimin ndaras të mbeturinave të fraksioneve të veçanta të mbeturinave	Zhvillimi i sistemit rajonal të OR-ve	Rritja e përqindjes së popullsisë me qasje në OR
	Nuk ka sistem formal për grumbullimin e fraksioneve prioritare të mbeturinave (PZP)	Futja e sistemit formal për grumbullimin dhe trajtimin ndaras të fraksioneve të mbeturinave PZP në përputhje me zhvillimet në nivelin nacional	Fraksionet kryesore të PZP mbulohen nga sektori privat
Riciklimi dhe trajtimi i mbeturinave	Nuk ka objekte riciklimi dhe rikuperimi të drejtuara nga komunat në ZMM Sektori privat është i pranishëm dhe aktiv në organizimin e aktiviteteve të riciklimit	Zhvillimi i objekteve rajonale për rikuperimin dhe riciklimin e materialeve	Arritja e normave të përcaktuara të riciklimit dhe zvogëlimi i sasisë së mbeturinave të dërguara në deponi
Deponimi i mbeturinave	100% e mbeturinave komunale të grumbulluara hidhen në një deponi, e cila duhej të ishte mbyllur dhe rehabilituar vite më parë. Deponia rajonale në Pejë nuk i plotëson standardet moderne mjedisore.	Përmirësimi i deponimit aktual të mbeturinave duke ndërtuar një kapacitet të ri deponie që plotëson të gjitha standardet mjedisore	Zgjerimi i deponisë rajonale me qelia sanitare dhe rritja e rikuperimit të mbeturinave për të zvogëluar përqindjen e mbeturinave që deponohen
Qëndrueshmëri financiare	Shkalla e arkëtimit nga klientët e faturuar për shërbimet bazë të grumbullimit të mbeturinave komunale është mbi 90%	Efikasiteti, planifikimi financiar dhe mbulimi i kostove u përmirësuan për të mbuluar kostot e investimeve të planifikuara, kostot operacionale dhe kostot e	Krijimi i një sistemi të deponimit të mbeturinave në bazë të mbulimit të plotë të kostos

Kategoria	Situata ekzistuese	Masat për përmirësim	Qëllimi
	Kostot e deponimit të mbeturinave nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar koston e plotë për funksionimin, rehabilitimin dhe ri-investimet në një deponi sanitare Mbledhja e tarifave është e mjaftueshme për të mbuluar kostot e grumbullimit, trajtimit dhe deponimit të mbeturinave	riinvestimit, mirëmbajtjes dhe rehabilitimit Kostot e e deponive të rishikuara dhe të harmonizuara me kostot e rehabilitimit dhe investimeve	
Ndërgjegjësimi i publikut	Pak fushata sporadike janë zhvilluar për të rritur ndërgjegjësimin publik.	Fushata të synuara për rritjen e ndërgjegjësimit mbi NB dhe parandalimin e mbeturinave	Rritja e ndërgjegjësimit mbi parandalimin e mbeturinave dhe ekonominë qarkore

4 OBJEKTIVAT DHE SYNIMET

Tabela e mëposhtme paraqet objektivat dhe synimet për sistemin e menaxhimit të mbeturinave në Rajonin e Dukagjinit , në përputhje me dispozitat e Strategjisë së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 2024-2035 (SKMIM).

Tabela 42Objektivat dhe synimet për sistemin rajonal

Objektivi	Treguesi	Baza	Synimi	Viti
Rritja e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave	Përqindja e popullsisë së përgjithshme me qasje adekuate dhe të rregullt në shërbimet komunale të mbledhjes së mbeturinave	99%	100%	2026
Rritja e riciklimit dhe rikuperimit të burimeve	Mbeturinat komunale të gatshme për ripërdorim dhe riciklim	< 5%	20%	2030
			50%	2035
			60%	2045
	Popullsia që i ofrohen shërbime të grumbullimit të ndarë të mbeturinave	0%	80%	2030
			90%	2035
			100%	2045
	Rikuperimi i të gjitha mbeturinave të ambalazhit	< 5%	45%	2028
			60%	2030
			70%	2035
	Riciklimi i të gjitha mbeturinave të ambalazhit, përfshirë:			
	Plastikë	< 5%	22.5%	2028
			30%	2030

Objektivi	Treguesi	Baza	Synimi	Viti
			50%	2035
	Letër dhe karton	< 5%	60%	2028
			70%	2030
			75%	2035
	Qelq	< 5%	30%	2028
			50%	2030
			70%	2035
	Metale me ngjyra	< 5%	30%	2028
			50%	2030
			70%	2035
	Alumin	< 5%	30%	2028
			40%	2030
			50%	2035
	Dru	< 5%	10%	2028
			15%	2030
			25%	2035
Të zvogëlohet varshmëria nga deponimi i mbeturinave	Deponimi i mbeturinave komunale	> 95%	< 30%	2035
			< 10%	2045
	Mbyllja e deponive komunale	70	0	2028
Rritja e riciklimit dhe rikuperimit të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit	Ripërdorimi dhe riciklimi i MNRr-ve	0%	40%	2030
			50%	2035
	Ripërdorimi, riciklimi dhe rikuperimi i materialeve tjera të MNRr-ve	0%	60%	2030
			70%	2035

5 PARASHIKIMI I POPULLSISË DHE GJENERIMIT TË MBETURINAVE

Analiza e opsioneve është zhvilluar sipas parashikimeve të popullsisë dhe parashikimeve të gjenerimit të mbeturinave siç paraqitet në figurat e mëposhtme. Të dhënat e popullsisë bazohen në regjistrimin e fundit të popullsisë, publikuar në vitin 2024.



Figura 15. Parashikimi i popullsisë për Rajonin e Dukagjinit, 2024-2035

Siç shihet nga diagrami i mësipërm, popullsia e rajonit të Dukagjinit pritet të zvogëlohet në mënyrë të pandjeshme në periudhën e planifikimit dhe të mbetet pak nën 180 mijë banorë.

Figura më poshtë tregon një parashikim të sasive të mbeturinave gjatë periudhës së planifikimit.



Figura 16Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave komunale, 2024-2035

Megjithëse popullsia e rajonit pritet të mbetet mjaft konstante, sasia e mbeturinave pritet të rritet me 7% në fund të periudhës së planifikimit dhe të arrijë në rreth 73,000 tonë në vitin 2035. Kjo vjen si pasojë e rritjes së pritshme të BPV-së gjatë kësaj periudhe.

Figura më poshtë tregon përbërjen e mbeturinave në rajon. Të dhënat bazohen në anketën e përbërjes së mbeturinave komunale të kryer nga GIZ më 2021 dhe 2022.



Figura 17Përbërja e mbeturinave komunale

Siç shihet nga figura e mësipërme, fraksioni më i madh i mbeturinave është ai i mbeturinave ushqimore, ndjekur nga plastika, letra dhe kartoni.

6 ANALIZA E OPSIONEVE

6.1 Supozimet dhe metodologjia

Planifikimi i integruar i menaxhimit të mbeturinave inerte përfshin një qasje strategjike për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave që mbulon të gjitha burimet dhe të gjitha aspektet, duke përfshirë minimizimin e mbeturinave, ndarjen nga burimi, trajtimin, rikuperimin dhe deponimin në një mënyrë që i jep përparësi parandalimit të mbeturinave dhe maksimizon efikasitetin e burimeve.

Metodologjia e përdorur për zhvillimin e opsioneve për krijimin e një sistemi të integruar të menaxhimit të mbeturinave në zonën e menaxhimit të mbeturinave (ZMM) bazohet në kriteret kryesore të mëposhtme:

- Hierarkia e aktiviteteve të menaxhimit të mbeturinave siç përcaktohet nga legjislacioni i BE-së për mbeturinat
- Shërbimet ekzistuese dhe të planifikuara të menaxhimit të mbeturinave si dhe infrastruktura.
- Vlerësimi i nevojave aktuale dhe të ardhshme në menaxhimin e mbeturinave
- Identifikimi i masave, në përputhje me legjislacionin ekzistues dhe në përputhje me masat e përcaktuara në SKMIM 2024-2035
- Objektivat e menaxhimit të mbeturinave të përcaktuara në SKMIM 2024-2035
- Analiza e opsioneve teknikisht të zbatueshme bazuar në praktikat më të mira të disponueshme dhe standardet e BE-së
- Analiza e opsioneve teknikisht të zbatueshme në lidhje me përballueshmërinë e tyre dhe zbatueshmërinë lokale

Analiza e opsioneve bazohet në supozimin kryesor se shërbimet e menaxhimit të mbeturinave në ZMM do të ofrohen ose në bazë rajonale ose nën-rajonale, krahasuar me ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave nga secili autoritet publik lokal.

Supozimet specifike në lidhje me opsionet e ndryshme teknike përfshihen në seksionet e elementeve të veçanta të sistemit.
Llogaritjet e kostos janë përgatitur në bazë të kushteve të mëposhtme:

- Vlerësimet e kostos janë bërë në terma reale dhe shprehen në vlera konstante të vitit 2024, pra pa marrë parasysh inflacionin.
- Kostot janë kalkuluar veçmas për aktivitete të ndryshme, p.sh. mbeturinat komunale, grumbullimi i ndarë.
- Të gjitha llogaritjet janë kalkuluar në EUR.
- Kostot janë llogaritur pa TVSH.
- Për llogaritjen e kostos janë marrë parasysh kostot e investimit, si:
  - Kostot kapitale që lidhen me investimet në infrastrukturë
  - Dispozitat për koston investive në të ardhmen në lidhje me zëvendësimin e aseteve.
- Amortizimi

- Për qëllime të llogaritjes së kostove vjetore, kostot e investimeve kapitale përgjithësisht janë amortizuar gjatë periudhave që pasqyrojnë jetëgjatësinë tipike të funksionimit ekonomik të asetevet.
- Kostot operacionale
- Kostot e operacionale dhe të mirëmbajtjes së sistemeve të reja të prezantuara janë llogaritur në bazë të teknologjive të parashikuara dhe supozimeve të nivelit të punës, çmimeve për materialet harxhuese, etj. Kostot operacionale për menaxhimin e mbeturinave janë kalkuluar bazuar në komponentet dhe hapësirave si dhe mbi bazën e kostove të artikujve; mirëmbajtjes dhe riparimit, punës; materialeve harxhuese; administratës; taksave dhe sigurimeve.

Analiza e flukseve monetare të skontuara është përdorur gjithashtu për llogaritjen dhe krahasimin e kostos për njësi për ton mbeturina për alternativat e ndryshme dhe për komponentet specifike të secilës alternativë. Këto janë llogaritur për secilën kategori të kostove dhe për secilin element. Kostot për njësi të llogaritura në këtë mënyrë janë tregues të tarifave që do të nevojiteshin (para TVSH-së) për të mbuluar kostot në tërësi për secilin skenar ose komponent skenari përgjatë periudhës së refereruar.

6.2 Parandalimi i mbeturinave

Çdo ton i parandaluar i mbeturinave të amvisërisë nënkupton kosto të kursyera nga buxheti komunal për trajtimin e mbeturinave. Autoritetet në novelin nacional janë palët kryesore të interesit në parandalimin e mbeturinave. Nëpërmjet pushtetit të tij legjislativ dhe ekzekutiv, shteti mund të krijojë rregullore dhe mjedis efikas për të mbështetur pjesëmarrësit në aktivitetet e parandalimit të mbeturinave. Megjithatë, ekziston një gamë e gjerë masash që autoritetet publike mund të ndërmarrin për promovimin e parandalimit të mbeturinave:

- Miratimi i skemave të tarifimit që stimulojnë parandalimin e mbeturinave.
- Informimi i qytetarëve dhe të ndikojnë, ku është e mundur, në sjelljen e tyre për të mirën e mjedisit.
- Koordinimi i aktiviteteve dhe fushatave me donatorë.
- Ofrimi i shërbimeve e tyre ose të punojnë me organizatat ekzistuese për të promovuar dhe inkurajuar ripërdorimin e mbeturinave.

Strategjia e rishikuar e Kosovës për menaxhimin e integruar të mbeturinave parasheh zhvillimin e një programi nacional për parandalimin e mbeturinave që në radhë të parë synon të minimizojë gjenerimin e mbeturinave dhe më pas të ruajë vlerën e produkteve, materialeve dhe burimeve në ekonomi për sa më gjatë të jetë e mundshme. Për më tepër, fokusi do të jetë në dizajnimin më të mirë të produkteve dhe pajisjeve në mënyrë që të ngadalësohet dalja e parakohshme nga përdorimi. Derisa të hartohet një program i detajuar dhe multisektorial për parandalimin e mbeturinave në nivelin nacional, fokusi prioritar i komunave në ZMM do të përcaktohet në masat prioritare si më poshtë:

- Pjesëmarrja në iniciativat për reduktimin e përdorimit të produkteve plastike njëpërdorimëshe (PNj) në përpjekje të përbashkët mes sektorit publik dhe privat.
- Promovimi i kompostimit shtëpiak dhe rritja e ndërgjegjësimit të publikut.
- Krijimi i mekanizmave dhe stimujve nëpër komuna për të mbështetur zhvillimin e rrjeteve të riparimit dhe ripërdorimit për produktet e hedhura dhe/ose përbërësit e tyre.
- Zbatimi nga autoritetet publike i kritereve të prokurimit publik të gjelbër për blerjen e mallrave dhe aranzhimin e punimeve.

Një nga opsionet më praktike për reduktimin e sasive të mbeturinave që dërgohen në deponi është zbatimi i kompostimit shtëpiak. Në mënyrën më të zakonshme, procesi i kompostimit kërkon thjesht grumbullimin e mbeturinave të gjelbra. Procesi i dekompozimit ndihmohet nga copëtimi i bimëve dhe degëve të pemëve. Për të

përshpejtuar procesin e dekompozimit duhet të sigurohet ajrosja e duhur duke rrotulluar rregullisht përzierjen. Mbeturinat e kuzhinës gjithashtu mund të shtohen në proces, por vetëm mbeturinat e pëzgjedhura ushqimore. Produktet e qumështit dhe mishi duhet të shmangen pasi tërheqin parazitët dhe minjtë.

Kompostimi shtëpiak mund të lehtësohet duke përdorur pajisje speciale. Këto pajisje (kompostorët shtëpiak) janë të qëndrueshme (zakonisht prej plastike) dhe kanë një periudhë funksionimi 7-10 vjet. Çmimet e kontejnerëve të tillë variojnë nga 100 deri në 200 euro. Një njësi kompostimi shtëpiak mund të bëhet gjithashtu nga druri, ose materiale të tjera dhe mund të jetë shumë e thjeshtë dhe më pak e kushtueshme.

6.3 Grumbullimi i mbeturinave

6.3.1 Gjendja aktuale

Vetëm në Komunën e Klinës raportohet se grumbullimi i mbeturinave u ofrohet 98% të popullsisë. Në katër komunat tjera shërbimi i grumbullimit të mbeturinave ofrohet për 100% të popullsisë. Në komunat e Pejës , Istogut dhe Klinës , shërbimi i grumbullimit të mbeturinave ofrohet nga KRU 'Ambienti' . Në Komunën e Deçanit shërbimin e grumbullimit të mbeturinave e ofron kompania komunale 'Higjiena', ndërsa në Junik shërbimin e ofron një operator privat.

6.3.2 Opsionet për grumbullimin e mbeturinave

Sistemi i grumbullimit dhe transportit përbëhet nga elemente si më poshtë:

- Sistemi i para-grumbullimit;
- Vendosja dhe vëllimi i kontejnerit të ofruar, nëse sistemi i para-grumbullimit bazohet në një sistem me kontejnerë;
- Frekuenca e grumbullimit në javë;
- Lloji i kamionit, i cili përdoret për grumbullim dhe transporti në distanca të shkurtra;
- Ndërrimet e grumbullimit.

Sistemi i grumbullimit do të marrë gjithashtu parasysh vendndodhjen e vendit të përzgjedhur për deponim e ardhshëm rajonal, relievin e rajonit dhe gjendjen e rrugëve.
Elementët e ndryshëm janë të ndërlidhur ngushtë. Prandaj, një rekomandim përfundimtar mund të bëhet vetëm për sistemet e grumbullimit të plotë dhe transportit.

Sistemi i para-grumbullimit

Një krahasim i llojeve të ndryshme të sistemeve të para-grumbullimit është paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela 43Krahasimi i sistemeve të ndryshme të para-grumbullimit

	Lloji 1: Grumbullimi i qeseve/thasëve	Lloji 2: Shporta dhe kontejnerë individualë	Lloji 3a: Pikat e grumbullimi nëpër rrugë Euro-kontejnerë me rrota 1.1 m³	Tipi 3b: Pikat e grumbullimit nëpër rrugë Kontejnerë statik 1.8, 2.4 dhe 3.6 m³	Lloji 4 Skip kontejnerë 4.0 m³
Përshkrim i shkurtër			Tipike për një sistem pikash grumbullimi rrugor është vendosja e kontejnerëve përgjatë rrugës në një distancë nga ndërtesat, e cila nuk i kalon 100 m. Njerëzit duhet t'i çojnë mbeturinat e tyre në kontejnerë.		Grumbullimi në skip kontejnerë të stacionuar
	Mbeturinat paketohen në qese plastike dhe vendosen para ndërtesës, në rrugë, në ditën e grumbullimit. Qeset mblidhen me dorë nga ngarkuesit dhe hidhen në kamionin grumbullues	Çdo shtëpi ose ndërtesë është e pajisur me shportën ose kontejnerin e vet. Shporta ose kontejneri zakonisht vendosen brenda ose drejt para lokaleve dhe se pronari i shtëpisë ose kujdestari i një ndërtese kujdeset për pastërtinë e tyre, vendosjen e saktë dhe vendosjen e llojeve të duhura të mbeturinave. Zakonisht, shporta ose kontejneri vendoset në anë të rrugës në ditën e grumbullimit. Ekipi i grumbullimit i rrotullon	 Me këtë lloj mbeturinat grumbullohen duke rrotulluar eurokontejnerët deri tek pajisja e ngarkimit në kamionin grumbullues dhe më pas kontejnerët zbrazen në mënyrë hidraulike në kamion.	 Duke pasur parasysh karakteristikat e palëvizshme të këtij lloji të kontejnerit, ai duhet të trajtohet drejtpërdrejt nga kamioni grumbullues. Zakonisht një kamion ngarkues anësor (shih më pas) përdoret për ngritjen dhe zbrazjen hidraulike.	 Opsion i përshtatshëm për fshatra të vegjël pa rrugë të asfaltuar. .

		shportat/kontejnerët deri tek kamioni i grumbullimit dhe shportat/kontejnerët ngarkohen në mënyrë hidraulike			
Madhësia e disponueshme	Zakonisht qeset kanë një kapacitet prej 50 ose 80 l. Njerëzit shpesh përpiqen të përdorin qese plastike për blerje për të kursyer kostot e qeseve, nëse nuk është e detyrueshme një qese e standardizuar.	Shportat prej120 l, 240 l dhe 360 l janë të disponueshme në plastikë dhe me ngjyra të ndryshme , kontejnerët me unazë 110 l janë të disponueshëm në metal. Euro kontejnerët prej 1.1 m³ janë të disponueshëm në plastikë dhe metal.	Euro kontejnerët 1.1 m³ janë të disponueshëm në plastikë dhe metal. Megjithatë, zakonisht, për grumbullimin nëpër rrugë, aplikohen kontejnerë metalikë, për të parandaluar dëmtime të mëdha kur deponohet hiri i nxehtë ose objekte të tjera që digjen.	1.8 m³, 2.4 m³ dhe 3.6 m³ janë në disponueshëm në plastikë dhe metal	4.0 m³ dhe 7.0 m³ janë të disponueshëm
Komoditeti për përdoruesin	Komoditet i lartë lidhur me grumbullimin: sepse mbeturinat mblidhen drejtpërdrejt nga shtëpitë individuale. Komoditet i ulët në lidhje me hapësirën e kërkuar sepse qeset duhet të ruhen në lokale, deri në datën ecaktuar të grumbullimit.	Komoditet i lartë lidhur me grumbullimin: sepse mbeturinat mblidhen drejtpërdrejt nga shtëpitë individuale. Komoditet i ulët në lidhje me hapësirën e kërkuar sepse shportatkontejnerët zakonisht vendosen në lokale.	Komoditet mesatar në lidhje me grumbullimin në blloqe banesash: sepse mbeturinat duhet të barten tek kontejneri, i cili mund të jetë në një distancë deri në 100 m nga hyrja e bllokut. Komoditet i keq në zonat e banimit familjar, duke pasur parasysh distancat e gjata për të sjellë mbetjurinat në kontejner. Komoditet i lartë në lidhje me hapësirën e kërkuar: sepse kontejnerët vendosen në rrugë, pra jashtë çdo lokali, duke pasur zakonisht një frekuencë të lartë grumbullimi.		Komoditet i ulët për përdoruesin. Shqetësim për banorët pasi kontejnerët e tillë zakonisht vendosen në periferi të fshatrave.
Kërkesa për kamionë grumbullues	Kamion ngarkues nga fundi i pasmë me lartësi të ulët ngarkimi.	Ngarkuesi i pasëm, anësor ose i përparmë, pajisje ngarkimi për shporta dhe/ose kontejnerë	Ngarkuesi i pasëm, anësor ose i përparmë, pajisje ngarkimi për Euro kontejnerët.	Kamion ngarkues anësor i përshtatshëm për këtë lloj kontejnerësh.	Kërkohet kamion i veçantë për ngarkimin e tij. Zakonisht merret me një kamion skip (pa ngjeshje) Përdorimi i mundshëm i kamionëve ngjeshës me vëllim të madh

Numri i ngarkuesve të nevojshëm për ngarkim në makinat për grumbullimin e mbeturinave (RCV)	Minimumi 2 persona Nëse pranohen qeset plastike për blerje, kërkohen 3 persona.	Minimumi 2 persona, më mirë 3 persona	Minimumi 2 persona, nëse pjesërisht mbeturinat vendosen jashtë kontejnerëve më mirë të jenë 3.	Minimumi 1, për të kontrolluar kontejnerin. Nëse mbeturinat vendosen edhe jashtë kontejnerëve më mirë ta bëjnë 2 persona.	Nuk kërkohen ngarkues
Përgatitja e magazinimit / vendosjes së shportave / kontejnerëve	Nuk kërkohet	Nuk kërkohet për shporta, Euro kontejnerët kërkojnë terren të rrafshët ose pllakë të shtruar	Kontejnerët kërkojnë terren të rrafshët ose pllakë të shtruar	Terren i sheshtë, i asfaltuar ose i shkallëzuar është me përparësi	Terren i sheshtë, i asfaltuar ose i shkallëzuar është me përparësi
Efikasiteti i ngarkimit	Në zonat e dendura, janë të mundshme efikasitete të larta ngarkimi. Në zonat e banimit familjar ka një efikasitet të ulët grumbullimi, veçanërisht nëse mbeturinat grumbullohen çdo ditë	Shporta: Në mënyrë të pavarur, 2 shporta mund të ngarkohen në të njëjtën kohë. Cikli i ngarkimitpër 2 shporta është rreth 50 sekonda, pra deri në 720l. Zakonisht, shkalla e mbushjes së shportave është e ulët nëse ato mblidhen çdo ditë, sepse ato ndodhen në zona banimi familjar. Kontejnerët: Cikli i ngarkimit rreth 50-60 sekonda për kontejner	Cikli i ngarkimit është rreth 50-80 sekonda për kontejner . Edhe nëse mblidhen çdo ditë, lejon efikasitet të mirë të grumbullimit në zonat e banimit familjar, nëse 20 deri në 30 shtëpi janë të lidhura me të njëjtin kontejner.	Në varësi të madhësisë, cikli i ngarkimit është rreth 50-100 sekonda për kontejner,. Edhe nëse mblidhen çdo ditë, lejon efikasitet të mirë të grumbullimit në zonat e banimit familjar, nëse 20 deri në 30 shtëpi janë të lidhura me të njëjtin kontejner.	Ngarkimi i kontejnerit zakonisht zgjat deri në 3 minuta. Efikasitet i ulët i grumbullimit sepse kontejneri zakonisht transportohet dhe zbrazet në deponi (nuk ka ngjeshje të mbeurinave)
Kostot e kontejnerit	Nuk ka kosto për sistemin e grumbullimit, thasët sigurohen nga gjeneruesit e mbeturinave.	Investim 50-90 €/shportë; 350 €/kontejnerë nga plastika (1,100l) dhe 650 €/kontejnerë metalik (1,100l)	Investimi 350 €/kontejnerë nga plastika (1,100l) dhe 650 €/kontejnerë metalik (1,100l) Kostot duhet të mbulohen nga	Investim 700 – 1,000 €/kontejner Kostot duhet të mbulohen nga sistemi i grumbullimit.	Investim 1,800 – 3,000 €/kontejner Kostot duhet të mbulohen nga sistemi i grumbullimit.

		Kostot duhet të mbulohen nga sistemi i grumbullimit	sistemi i grumbullimit		
Përshtatshmëria për tarifat e lidhura me sasinë	I përshtatshëm për tarifat lidhur me volumin për çdo familje, nëse aplikohet si sistem wesesh me parapagim. Në këtë rast do të mblidhen vetëm qeset me parapagim. Nëse jo, prezantohen qeset me parapagesë, është pothuajse e pamundur të identifikohet prodhuesi. Prandaj, herë pas here duhet të mblidhet çdo qese për të pastruar zonën.	I përshtatshëm për tarifat e vëllimit të lidhura me shtëpitë ose ndërtesat/hyrjet;	Jo i përshtatshëm.	Jo i përshtatshëm.	Jo i përshtatshëm.
Probleme të parashikueshme	Nëse mbeturinat komunale vendosen në anë e rrugës më shumë se 1 orë përpara grumbullimit, kafshët si macet dhe qentë mund të rrëmojnë qeset dhe të shpërndajnë mbeturinat. Mbledhja sipas planit po ashtu kufizon kohën e funksionimit të automjeteve grumbulluese, respektivisht do të kërkohet një numër më i madh i automjeteve.	Në ndërtesat shumëkatëshe, kujdestari i hyrjes në diskutim me banorët të vendosin për vendin ku i lënë mbetirunat. Probleme të mundshme lidhur me gjetjen e vendit të përshtatshëm për vendosjen e kontejnerëve në ndërtesat shumëkatëshe.	Pas ca kohësh rrotat thyhen dhe trupat e dëmtohen. Mbulesa shpesh mbyllet, Mbeturinat vendosen krahas/në afërsi të kontejnerit.	Pas ca kohësh trupat e dëmtohen. Mbeturinat vendosen krahas/në afërsi të kontejnerit.	Trupat e dëmtohen. Erë e shtuar kundërmuese për shkak të frekuencës më të ulët të zbrazjes së kontejnerëve të tillë. Rritja e tendencës për t'u mbushur me mbeturina të gjelbra, të vëllimshme dhe të ndërtimit sesa me mbeturina shtëpiake
Përfundim	Nuk rekomandohet për zbatim në të ardhmen	Ky sistem është i zbatueshëm nëse kushtet paraprake të ndërlidhura me tarifën të zbatohen. Sistem i rekomanduar për të dy zonat e banimit - shtëpi familjare dhe ndërtesa	Të merret parasysh për zonat me ndërtesa shumëkatëshe në zonat urbane në rast se nuk mund të sigurohet vendi për shporta/kontejnerë individualë.	Me këtë sistem problemi me rrotat do të mund të zgjidhej. Nëse mbeturinat do të vendoseshin siç duhet në kontejnerë, sistemi madje mund të funksiononte vetëm me një ose edhe pa ngarkues.	Nuk rekomandohet për zbatim në të ardhmen

		shumëkatëshe.		Sistemi kërkon investime më të larta për kamionët dhe kontejnerët, sesa sistemi 3 A. Prandaj nuk rekomandohet për periudhë afatshkurtër.	

Krahasimi i sistemeve të ndryshme të para-grumbullimit sjell rezultatin e mëposhtëm:

- Sistemet e para-grumbullimit të bazuara në qese plastike (tipi 1), pikat e grumbullimit rrugor me kontejnerë statik (tipi 3B) dhe kontejnerët skip (lloji 4) nuk konsiderohen për zbatim në të ardhmen.
- Në parim, sistemi aktual i grumbullimit me shporta individuale të plastikës (tipi 2) është i përshtatshëm për zonat me shtëpi familjare dhe gjithashtu është zbatuar në disa zona urbane në rajonin e projektit. Shportat e plastikës 240 l duket se janë më të përshtatshëm në krahasim me shportat plastike 120 l, duke pasur parasysh se aktualisht, shpesh, sasi të tjera mbeturinash hidhen në qese plastike pranë kontejnerëve. Gjithashtu, shportat 240 l do të mundësojnë uljen e frekuencës së mbledhjes së mbeturinave në krahasim me kontejnerët 120 l. Megjithatë, përdorimi paralel i shportave plastike me madhësi të ndryshme mund të merret në konsideratë dhe të mundësojë përshtatjen me madhësitë e ndryshme të familjeve. Shportat individualë do të jenë gjithashtu më të përshtatshëm në terma afatgjatë kur do të futet grumbullimi i ndaras i mbeturinave të riciklueshme dhe organike. Megjithatë, shërbimi i ofruar me shporta individuale do të ketë kosto më të lartë zbatimi për shkak të efikasitetit më të ulët të ngarkimit të automjeteve të grumbullimit në krahasim me kontejnerët 1.1 m³.
- Një sistem i bazuar në pikat e grumbullimit në rrugë meeuro kontejnerë me rrota 1.1 m³ (tipi 3A) mund të jetë i përshtatshëm për të gjithë zonën e shërbimit. Nga pikëpamja tarifore, kontejnerët individualë për blloqe banimi, apo edhe të vendosura në hyrje të blloqeve të banimit mund të kenë përparësi në krahasim me sistemet e pikave të grumbullimit të rrugëve. Hapësira të tilla nuk janë ende të disponueshme dhe gjithashtu do të zvogëlojnë efikasitetin e grumbullimit, sepse këto vende ndoshta jo gjithmonë do të ishin pranë rrugës. Për ndërtesat shumëkatëshe, veçanërisht në Pejë, vendosja e kontejnerëve nëntokësor gjithashtu mund të jetë zgjidhje afatgjate.

Vendosja e kontejnerëve dhe vëllimi i kontejnerit

Për të arritur avantazhet e mësipërme të sistemit të rekomanduar të grumbullimit, ekzistojnë disa kërkesa, të cilat duhet të merren parasysh gjatë projektimit të numrit dhe vendosjes së kontejnerëve:

- Kontejnerët 1.1 m³ në zonat urbane duhet të vendosen në një numër dhe vend që të mbushen mesatarisht në 80 deri në 90% në momentin e zbrazjes (në varësi të frekuencës së caktuar të grumbullimit).
- Një rreze prej maksimumi 100 m njihet ndërkombëtarisht si një distancë, e cila përgjithësisht është e pranueshme nga qytetarët për të transportuar mbeturinat e tyre nga hyrja e ndërtesës e deri te pika e grumbullimit. Kjo do të thotë se në blloqe të mëdha banesash do të vendosen disa kontejnerë në një pikë grumbullimi.
- Vendi i pikë grumbullimit duhet të zgjidhet, në mënyrë që kamioni grumbullues të mund të hyjë lehtësisht në pikën e grumbullimit pa pasur nevojë për manovra të mëdha. Më e mira do të ishte tl jenë në skaj të rrugës.
- Për të mundësuar trajtimin e lehtë dhe për të kursyer konsumimin e rrotave, vendndodhja e kontejnerit 1.1 m³ duhet të jetë e shtruar (pllakë) dhe të ketë një lidhje të nivelizuar me rrugën. Kjo ndihmon për rrotullimin e lehtë të kontejnerit në pjesën e pasme të kamionit grumbullues dhe përsëri në rivendosjen e tij. Nuk duhet të kërkohet asnjë manovrim i kamionit.
- Rrotat duhet të mbahen në gjendje të mirë dhe rrotat e thyera duhet të zëvendësohen menjëherë. Rrotat e thyera reduktojnë ndjeshëm shpejtësinë e grumbullimit dhe rrjedhimisht efikasitetin e grumbullimit.
- Përdoruesit shtëpiak ose të pronës duhet të kenë një vend të caktuar për shporta individuale plastike.
- Orari i grumbullimit duhet t'u komunikohet përdoruesve të shërbimit dhe ata duhet të kenë detyrimin që në ditën e grumbullimit të vendosin shportat skaj rrugës.

Frekuenca e grumbullimit së mbeturinave

Shërbimi për shportat individualë zakonisht ofrohet një herë në javë ose një herë në dy javë. Në të ardhmen, kur të fillojë grumbullimi ndaras i mbeturinave organike, mund të lejohet edhe frekuencë më e ulët e grumbullimit.

Për grumbullimin me kontejnerë 1.1 m³, është i mundur një minimizim i kostos së investimit në frekuencë më të lartë të servisimit si një kompensim i kostos së investimit dhe kostos operacionale; dmth sa më shpesh të zbrazen kontejnerët, aq më pak kërkohet numri i kontejnerëve, derisa numri më i madh i kontejnerëve kërkohet nëse ata zbrazen më rrallë.

Në përcaktimin e shpeshtësisë së grumbullimit, përdoren supozimet e mëposhtme:

- Frekuenca një herë në javë e grumbullimit të shportave individuale 120/240 l është e pranueshme.
- Shërbimi në zonat urbane me kontejnerët 1.1 m³ propozohet të jetë çdo të dytën ditë në mënyrë që të përshtatet me luhatjet e sasisë së mbeturinat ditore. Frekuenca më të ulëta të grumbullimit një herë në javë ose dy herë në javë janë të mundshme për kontejnerët individualë të caktuar për ndërtesa specifike.

Automjete për grumbullimin e mbeturinave

Automjetet e grumbullimit të mbeturinave me ngarkim të pasëm dhe ngjeshje do të përdoren për shërbimin e shportave plastikë dhe të kontejnerëve 1.1 m³.

Vëllimi optimal i automjeteve grumbulluese që do të përdoren do të varet nga disa faktorë:

- distanca e transportit deri në deponi.
- qasja rrugore e disponueshëm tek kontejnerët dhe shportat individuale, duke pasur parasysh se automjetet me vëllim të madh nuk do të jenë të përshtatshme në rrugë të ngushta ose zona me qasje të vështirë.
- sasia e mbetjurinave që do të grumbullohet.

Vëllimi i automjetit të përzgjedhur duhet të lejojë norma të larta shfrytëzimi mbi 85%.
Përdorimi i stacioneve të transferit do të ketë ndikim edhe në automjetet që do të përdoren duke marrë parasysh distancat më të shkurtra të transportit.
Për qëllime të përgatitjes së vlerësimeve të kostos janë marrë në konsideratë automjetet grumbulluese 16 m³ me ngjeshje. Automjetet e grumbullimit me volum më të vogël mund të përdoren për zona me qasje të vështirë dhe për distanca të shkurtra transporti.

6.3.3 Vlerësimet e kostos

Në bazë të të gjitha konsideratave të mësipërme, modelet e mëposhtme të grumbullimit janë përllogaritur:

- Grumbullimi i mbeturinave me kontejnerë 1.1 m³ për zonat urbane të komunës së Pejës, Istogut , Klinës dhe Deçanit ;
- Mbledhja e mbeturinave me shporta individuale plastike për zonat rurale (dhe zonat me shtëpi familjare).

Llogaritjet e kostove të mbledhjes kryhen veçmas për zonat urbane dhe për zonat rurale në secilën komunë, duke marrë parasysh llojet e ndryshme të kontejnerëve dhe automjeteve të mbledhjes së mbeturinave të përdorura.

Supozimet e mëposhtme u bënë për llogaritjen e kostove të grumbullimit të mbeturinave:

- Numrat dhe kapacitetet e kontejnerëve dhe automjeteve të nevojshme grumbulluese korrespondojnë me sasitë e mbeturinave të grumbulluara, të llogaritura në bazë të numrit të banorëve të shërbyer dhe normave përkatëse të gjenerimit për frymë të mbeturinave në zonat urbane dhe rurale për vitin përkatës. Është marrë parasysh sasia e mbeturinave të grumbulluara ndaras.
- Densiteti i mbeturinave në kontejnerë 180 kg/m³.
- Shkalla mesatare e mbushjes së pranueshme të kontejnerëve është 80% për kontejnerët 1.1 m³ dhe 85% për shportat 240 l.

- Koeficienti i parregullsisë që përfaqëson raportin ndërmjet maksimumit dhe sasisë mesatare javore të mbeturinave është i barabartë me 1.3.
- Shpejtësia e pranueshme e udhëtimit të automjeteve për grumbullimin e mbeturinave është 35 km/orë.
- Shfrytëzimi 85% i ngarkesës nominale të mjeteve grumbulluese.
- 85% disponueshmëria e automjeteve grumbulluese.
- Kontejnerë rezervë për mirëmbajtje - 5%.
- Koha mesatare për ngritjen e kontejnerit 1.1 m³ është 1.0 minutë. Koha për zbrazjen e shportave të mbeturinave vlerësohet të jetë 0,67 minuta (40 sekonda).
- Distancat mesatare të udhëtimit midis deponisë dhe komunave të veçanta maten nga qendrat përkatëse të qytetit. Distanca e udhëtimit për zonat rurale është e pranueshme të jetë 10 km më e gjatë se për zonat urbane.
- Koha mesatare e shpenzuar për shkarkim në deponi do të jetë gjysmë ore; Koha e ndërmjetme midis udhëtimeve do të jetë gjithashtu gjysmë ore.
- Automjetet prej 16 m³ për grumbullimin e mbeturiva 16 me ngarkesë prej 8 tonë mbeturina për automjet (korrespondon me 500 kg/m³mbeturina të ngjeshura).
- Jetëgjatësia e pranueshme për kontejnerët dhe shportat është 7 vjet dhe 10 vjet për automjetet për grubmullimin e mbeturinave.
- Kontejnerët dhe automjetet ekzistuese nuk janë marrë parasysh dhe vlerësimet e kostove janë përgatitur për pajisje krejtësisht të reja.
- Kostot e pranueshme vjetore të mirëmbajtjes janë 4% e kostove të investimit për kontejnerët dhe 5% për automjetet.
- Kostot për administrimin e sistemit janë 10% e kostove direkte operacionale.
- Sigurimi i automjeteve grumbulluese dhe personelit – 1% e kostos së investimit.
- Shërbime jashtë orarit – 10% e kostove operacionale plus amortizimi vjetor.
- Kostot e punës llogariten për 46 javë pune për person, 5 ditë pune në javë dhe mesatarisht 5% pushim mjekësor.

Tabela e mëposhtme paraqet kostot për njësi për grumbullimin e mbeturinave të përziera të supozuara përqëllimin e analizës së opsioneve.

Tabela 44Kostot për njësi për kontejnerët dhe automjetet për grumbullimin e mbeturinave

Pajisjet	Kapaciteti, m³	Qëllimi	Çmimi për njësi, €
Kontejnerë (metal)	1.1	Shpie drejt sistemit të grumbullimit	650
Shporta	0.24	Grumbullimi derë më derë	80
Kamionë	16	Si për shportat individuale ashtu edhe për kontejnerët 1.1 m³	140,000

Projeksionet për numrin e nevojshëm të kontejnerëve dhe mjeteve grumbulluese dhe vlerësimet e kostove për grumbullimin e mbeturinave komunale janë paraqitur në tabelat e mëposhtme.

Tabela 45Numri i nevojshëm i kontejnerëve dhe automjeteve grumbulluese

Parametri	Pejë	Istog[15]	Klinë	Deçan[16]	Junik[17]
Kontejnerë 1.1 m³ të instaluar	763	54	40	24	-
Kontejnerë 1.1 m³ për t'u blerë	801	57	42	25	-
Shporta 240 l të instaluara	12,307	6,743	4,439	4,315	584
Shporta 240 l të blera	12,922	7,080	4,661	4,531	613
Automjete grumbullimi 16 m³ që operojnë në zona urbane	3.8	0.2	0.2	0.1	-
Automjete grumbullimi 16 m³ që operojnë në zona rurale	7.6	3.3	3,9	2.1	0.3
Automjete grumbullimi 16 m³ të blera	12	4	5	3	-

Kostot e investimit dhe ato operacionale për grumbullimin e mbeturinave të përziera komunale janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 46Vlerësimet e kostos për grumbullimin e mbeturinave të përziera komunale

Parametri	Pejë	Istog	Klinë	Deçan	Junik
Kostoja e investimit					
Kontejnerë/shporta, mijë €	1,555	603	400	379	49
Automjete, mijë €	1,680	490	700	434	42[18]
Kostot O&M, mijë €	**1,218**	**409**	**415**	**233**	**26**
Kostot totale vjetore, mijë €	**1,612**	**548**	**546**	**330**	**37**
Sasitë e grumbulluara, tonë	32,042	9,919	6,620	6,134	720
Kostoja vjetore për njësi, € / tonë e mbledhur	**50.3**	**55.2**	**82.5**	**53.8**	**51.6**
Kostot mesatare rritëse[19], € / tonë të gjeneruar	31.02	35.38	52.13	34.66	32.57

Kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes (O&M) përfshijnë kostot për personelin, karburantin, vajin dhe kostot e mirëmbajtjes për pajisjet. Kostot vjetore përfshijnë kostot O&M dhe kostot për amortizimin vjetor të kontejnerëve dhe të automjeteve.

Kostot më të ulëta të grumbullimit për ton mbeturina të gjeneruara/grumbulluara janë vlerësuar për komunën e Pejës për shkak të distancës më të shkurtër deri në deponinë rajonale dhe sasive më të mëdha të mbeturinave. Kostot në komunat e Istogut, Deçanit dhe Junikut janë më të ulëta se kostot e Klinës për shkak të stacioneve të transferit dhe distancave më të shkurtra të transportit (shih seksionin vijues).

[15]Llogaritjet e paraqitura për rastin e stacionit të transferit
[16]Llogaritjet e paraqitura për rastin e stacionit të transferit
[17]Llogaritjet e paraqitura për rastin e stacionit të transferit
[18]Pjesa e mjetit të grumbullimit
[19]Ulja e kostos për njësi për periudhën 2025-2035, norma e uljes 5%.

6.4 Transporti dhe transferimi i mbeturinave

6.4.1 Situata aktuale

Asnjë stacion transferimi nuk është në përdorim në ZMM. Një lokacion në Istog fillimisht ishte paraparë të përdorej si stacion transferimi por përfundoi duke u përdorur përkohësisht si deponi.

6.4.2 Llojet e stacioneve të transferit

Stacionet e transferit (ST) justifikohen kur kostoja e transportit direkt të mbeturinave nga pika e gjenerimit në një deponi është më e madhe se kostoja e transportit të mbeturinave nga burimi i gjenerimit në një pikë ku mbeturinat transferohen në një kontejner më të madh dhe më pas transportohen në një deponi. Përshtatshmëria ekonomike e stacioneve të transferit ndikohet nga disa faktorë: (i) distancat; (ii) sasitë e mbeturinave; (iii) kushtet e rrugës dhe topografia; (iv) densiteti i ulët në zonat e shërbimit; dhe (v) teknologjia e transferimit.

Llojet e stacioneve të transferit
Për sa i përket teknologjisë së transferimit, stacionet e transferit mund të ndahen kryesisht në tre lloje:

- Stacion transferimi me ngjeshje
- Stacion transferimi pa ngjeshje
- Transferimi i mbeturinave nga një kamion i vogël në një më të madh

Stacionet e transferit pa ngjeshje përdoren kur distancat nuk janë të mëdha dhe atëherë kur kostot më të larta të investimit në stacionet e transferit me ngjeshje nuk mund të justifikohen. Me distanca më të mëdha kostot operacionale të ST pa ngjeshje bëhen më të larta në krahasim me ato të ST me ngjeshje. Zgjedhja e ST është në fakt një kompromis midis kostove investive dhe operacionale.

Stacionet e transferit me ngjeshje
Qëllimi i stacioneve të transferit me ngjeshje është rritja e densitetit të mbeturinave dhe rrjedhimisht e sasive të mbeturinave që transportohen në një drejtim. Siç tregohet në figurën më poshtë, stacione të tilla transferi janë të pajisura me një rampë me pikë shkarkimi, bunker pritës (me rreth 45 m³), pajisje ngjeshëse, kontejnerë të mëdhenj të transportueshëm (midis 27 m³ dhe 32 m³), sistem kangjellash për zhvendosjen e kontejnerëve dhe automjete për transport në distanca të gjata.

Pajisjet e stacioneve të tilla të transferit janë projektuar për të minimizuar kohën e ngarkimit nga kamionët grumbullues dhe për të minimizuar kohën e ngjeshjes së mbeturinave. Gjithashtu është instaluar një sistem kangjellash automatike për zhvendosjen e kontejnerëve për të zvogëluar kohën operative. Ndërsa një automjet transporti për distanca të gjata është duke u ngarkuar me një kontejner të plotë, një kontejner tjetër mund të mbledhë mbeturina të reja.

Pajisja statike e ngjeshjes mund të zëvendësohet me kontejnerë të mëdhenj të transportueshëm vetngjeshës, midis 25 dhe 32 m³, të aftë për të ruajtur midis 15 dhe 19 tonë.



Figura 18Stacioni i transferi me ngjeshje

Stacione transferi pa ngjeshje

Në shumicën e rasteve ky stacion transferi përdor kontejnerë të hapur, siç tregohet në foton më poshtë, ku mbeturinat shkarkohen direkt nga kamioni grumbullues. Në vend të kontejnerëve, mbeturinat mund të shkarkohen në rimorkio. Në fakt automjetet e transportit mund të marrin dy, madje edhe tre rimorkio, në varësi të topografisë dhe rregulloreve të ngarkesës të vendeve përkatëse.

Në varësi të raportit të ngjeshjes së mbeturinave hyrëse, një kontenier prej 35 m³ mund të transportojë nga 4 deri në 10 tonë.



Figura 19Stacione transferi pa ngjeshje

6.4.3 Opsionet për transportin e mbeturinave

Alternativat e mëposhtme janë analizuar për transferimin e mbeturinave:

- Alternativa 1: Krijimi i 3 stacioneve të transferit pa ngjshje në komunat Istog , Klinë dhe Deçan[20]. Në këtë rast do të përdoren kontejnerë të hapur me rrotullim prej 30 m³. Do të përdoret një mjet transporti me rimorkio që lejon transportimin e dy kontejnerëve me rrotullim për çdo udhëtim.
- Alternativa 2: Krijimi i 3 stacioneve të transferimit me ngjeshje stacionare në komunat e Istogut dhe Deçanit.

Të dyja opsionet janë krahasuar me transportin e drejtpërdrejtë të mbeturinave në deponinë rajonale.

6.4.4 Krahasimi i kostos së opsioneve

Tabela e mëposhtme përmbledh krahasimin e kostove të opsioneve të ndryshme.

Tabela 47Krahasimi i alternativave për transferimin e mbeturinave[21]

Parametri	Njësia	Istog		Deçan		Klinë
		me ngjeshje	pa ngjeshje	me ngjeshje	pa ngjeshje	pa ngjeshje
Mbeturinat e transferuara	ton	9,700	9,700	6,700	6,700	6,500
Distanca nga deponia	km	36	36	27	27	20
Sasia mesatare e mbeturinave për udhëtim	ton	17.1	17.5	17.1	17.5	17.5
Numri i udhëtimeve në ditë	Jo	3	3	3	3	3
Kosotot e investimit në stacionin e transferit	mijë €	571.2	267.7	603.1	302.4	302.4
Numri i kërkuar i mjeteve të transportit		1 (0.5)	1 (0.5)	1 (0.4)	1 (0.4)	1 (0.4)
Kostot e investimit - automjetet e transportit	mijë €	119.0	142.8	119.0	142.8	142.8
Kostot operacionale - stacioni i transferit	mijë €	88.5	48.3	85.9	46.0	46.0
Kostot operacinale të transportit	mijë €	83.6	88.5	72.8	77.4	74.1
Kostot totale vjetore	mijë €	233.4	168.1	222.5	157.7	154.4
Kostot për ton mbeturina të transferuara	€/ton	24.21	17.44	35.21	23.79	24.00

Krahasimi i alternativave bazohet në kostot e zbritura për njësi për ton mbeturina të gjeneruara gjatë periudhës së planifikimit 2025 – 2035.

[20] Stacioni i transferit në komunën e Deçanit është paraparë t'i shërbejë edhe komunës së Junikut

[21] Llogaritjet e përgatitura për operacion me një turn, 7 ditë në javë

Tabela 48Krahasimi i kostove të zbritura për njësi për grumbullimin dhe transferimin e mbeturinave për ton të mbeturinave të gjeneruara, € /ton

Parametri	Istog			Deçan			Klinë	
	me ngjeshje	pa ngjeshje	transport direkt	me ngjeshje	pa ngjeshje	transport direkt	pa ngjeshje	transport direkt
Mbledhja e mbeturinave								
Kostot e investimit	10.33	10.33	13.68	11.66	11.66	15.78	12.56	14.49
Kostot operacionale	25.05	25.05	39.98	23.00	23.00	37.28	25.19	37.64
Grumbullimi total	*35.38*	*35.38*	*53.67*	*34.66*	*34.66*	*53.06*	*37.75*	*52.13*
Transferimi i mbeturinave								
Kostot e investimit	5.80	2.72	-	7.48	4.23	-	4.82	-
Kostot operacionale	11.52	8.57	-	13.08	9.85	-	10.36	-
Transferimi total	*17.32*	*11.29*	*-*	*20.56*	*14.08*	*-*	*15.18*	*-*
Kostot totale	**52.70**	**46.67**	**53.67**	**55.22**	**48.75**	**53.06**	**52.93**	**52.13**

Analiza tregon se stacionet e transferit pa ngjeshje kanë kosto më të ulëta zbatimi për ton për komunat e Istogut dhe Deçanit, ndërsa transporti direkt ka kosto më të ulët për komunën e Klinës.
Stacioni i transferit me ngjeshje po ashtu ka kosto më të ulët për komunën e Istogut në krahasim me transportin direkt.
Megjithatë, të gjitha alternativat e konsideruara kanë kosto të krahasueshme për ton dhe vendimi përfundimtar do të varet nga konsiderata të tjera si vullneti politik i komunave, disponueshmëria e financimit të investimeve (granteve) dhe disponueshmëria e vendeve të përshtatshme për vendndodhjen e stacioneve të transferit.
Duhet të theksohet gjithashtu se stacionet e transferit mund të kombinohen me oborret e riciklimit që janë planifikuar së fundmi për komunat e Istog, Deçan dhe Klinë (shih seksionin 3.9.3) që do të rezultojë në uljen e kostos së përgjithshme të implementimit.
Vendndodhja optimale e stacioneve të transferit duhet të jetë afër vendbanimit kryesor të komunës respektive dhe në drejtim të rrugës për në deponinë rajonale.
Duke konsideruar se komuna e Istogut ka vështirësi në identifikimin e vendndodhjes së duhur për stacionin e transferit, një zgjidhje alternative do të jetë përdorimi i automjeteve mobile/satelit të grumbullimit, ose ringarkimi në kontejnerë shtypës siç tregohet në figurën më poshtë.

Figura 20Ringarkimi nga automjeti mobil/satelitor (majtas) dhe ringarkimi në kontejnerin me ngjeshje (djathtas)

Në rastin e automjeteve të grumbullimit satelitor, grumbullimi në zonat me qasje të vështirë kryhet me automjete të vogla grumbulluese (6-8 m³) me ose pa ngjeshje, dhe më pas ringarkohet drejtpërdrejt në një automjet më të madh grumbullues mbeturinash (21–28 m³).
Zgjidhja me kontejnerë me ngjeshje do të mund të zbatohej vetëm për një pjesë të komunës së Istogut duke supozuar se një kontejner i tillë do të mund të instalohej në të ardhmen në Oborrin e Riciklimit (OR).

6.5 Grumbullimi ndaras e mbeturinave

6.5.1 Gjendja aktuale

Grumbullimi ndaras i mbeturinave të materialeve të riciklueshme nuk është i organizuar në asnjërën nga pesë komunat. Nga komunat është planifikuar që kjo të fillojë nga viti 2025 e në vazhdim.

6.5.2 Pajisjet për magazinimin e mbeturinave dhe sistemet për grumbullimin ndaras të mbeturinave

Faktorët që luajnë rol në përzgjedhjen e një sistemi për grumbullimi veç eveç ndërlidhen me sistemin ekzistues të grumbullimit të mbeturinave, i cili lidhet me pranueshmërinë e publikut, sistemin tarifor në fuqi dhe praninë e sektorit informal në grumbullimin e mbeturinave. Pranueshmëria publike është një nga parakushtet për krijimin e një sistemi efikas për grumbullimin ndaras të materialeve të riciklueshme.

Në thelb, ekzistojnë dy forma kryesore të grumbullimit - grumbullimi derë më derë dhe sistemi i sjelljes së mbeturinave në vendin e caktuar. Të dy këto sisteme përdoren aktualisht në ZMM për grumbullimin e mbeturinave të përziera shtëpiake.

Figura 22. Shembuj të kontejnerëve që përdoren zakonisht për grumbullimin derë më derë (majtas) dhe për të sjellë mbeturinat te vendi i caktuar (djathtas)

Grumbullimi derë më derë, i quajtur edhe grumbullimi buzë bordurave, nënkupton caktimin e kontejnerëve (ose qeseve) individuale familjeve për ndarjen në burim të fraksioneve specifike të mbeturinave. Materialet e ricikluesshme zakonisht mblidhen në shporta me rrota ose qese plastike, të përcaktuara posaçërisht për përmbajtjen, bazuar në frekuencën e caktuar të grumbullimit. Vëllimet e zakonshme të shportave që përdoren për grumbullim të ndaras janë 120, 240 dhe 360 litra, të cilat do të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në frekuencën e grumbullimit. Mbledhja skaj rrugës është veçanërisht e përshtatshme për familjet që jetojnë në shtëpi individuale.
Sistemi i sjelljes së mbeturinave te vendi i caktuar, përbëhet nga pika kontenierësh, duke shërbyer një mori familjesh. Sistemi përdoret zakonisht si për grumbullimin e ndaras ashtu edhe për mbeturinat e përziera, Kontejnerët vendosen anës së rrugës publike, në qendra komunitare, parkingje supermarketesh dhe vende të tjera ku gjeneruesit e mbeturinave sjellin aty materialet e ndara ndaras.

Lloji standard i Euro kontejnerëve me rrota

Kamionët standard për kontejnerët me rrota

Lloji Igloo i kontejnerëve të stacionuar

Kamionët e specializuar për kontejnerët e llojit Igloo

Figure 21. Lloje të ndryshme të sistemeve për sjelljen e mbeturinave

Sistemi përdoret më së shpeshti për mbeturina të ambalazhit, veçanërisht për qelq dhe karton, dhe shpesh financohet përmes mekanizmit PZP. Kontejnerët e përdorur zakonisht janë paraqitur në figurën më lart.

Siç shihet nga figura e mësipërme, përparësia kryesore e kontejnerëve me rrota është se ata mund të zbrazen nga kamionët me ngarkesë nga pas, që zakonisht përdoren në Kosovë për grumbullimin e përgjithshëm të mbeturinave. Këta kontejnerë kanë një vëllim prej 1,100 litrash. Kontejnerët e tipit Igloo janë me pozicion statik dhe mund të blihen në madhësi të ndryshme – nga 1 m³ deri në 5 m³. Sistemi me kontejnerë Igloo zakonisht është i përshtatshëm për të mbuluar mbledhjen e qelqit.

6.5.3 Opsionet për grumbullimin ndaras të mbeturinave

Sasitë e mbeturinave të grumbulluara ndaras llogariten bazuar në supozimet për numrin e banorëve që ju ofrohet shërbimi dhe normat e që arrihen për fraksione të ndryshme të ricikluesshme.
Është e pranueshme se grumbullimi ndaras të fillojë me ofrimin e shërbimeve për 100% të banorëve që jetojnë në zonat urbane dhe për 80% të banorëve që jetojnë në zonat rurale. Numri total i banorëve të përfshirë në grumbullim ndaras të mbeturinave është paraqitur në figurën e mëposhtme.





Figura 22Banorët të cilëve u ofrohen shërbime të grumbullimit ndaras të mbeturinave

Shkalla e arritjes për fraksionin përkatës të mbeturinave pranohet të jetë në nivelin minimal në vitin e parë kur fillon grumbullimi ndaras i mbeturinave dhe më pas rritet me 5% derisa të arrihet niveli maksimal i arritjes (shih tabelën më poshtë).

Tabela 49Normat e supozuara të arritjes për fraksione të ndryshme të mbeturinave të riciklueshme

Fraksioni i mbeturinave	Shkalla e arritjes	
	Minimumi	Maksimumi
Tetrapak	10%	20%
Letër / karton	50%	85%

Plastikë	40%	70%
Qelq	60%	90%
Metale	40%	60%

Për të përcaktuar pajisjet e nevojshme për grumbullimin ndaras të mbeturinave, janë përdorur supozimet e mëposhtme:

- Numrat dhe kapacitetet e kontejnerëve dhe mjeteve të nevojshme grumbulluese korrespondojnë me sasitë e mbetjurinave të grumbulluara, të përllogaritura sipas numrit të banorëve të shërbyer dhe normave për frymë të grumbullimit të mbeturinave të ricikluesshme në zonat urbane dhe rurale për vitin përkatës;
- Densiteti i materialeve në kontejnerë supozohet të jetë: 0,125 ton/m³ për letër dhe karton; 0,030 ton/m³ për plastikë; 0,150 ton/m³ për metalet; 0,300 ton/m³ për qelqin dhe 0,240 ton/m³ për mbetturinat e papastërta që mbesin nga mbeturinat e grumbulluara ndaras;
- Mbeturina të papastërta në kontejnerët e grumbullimit ndaras supozohet të jenë 15% e materialeve me vlerë.
- Mbushja mesatare e kontejnerit supozohet të jetë 80% e kapacitetit;
- Numri i kontejnerëve është përllogaritur duke supozuar 5% si rezervë;
- Koha për ngritjen/zbrazjen e një shporte prej 240 l supozohet të jetë 40 sekonda, ndërsa koha për ngritjen/zbrazjen e kontejnerit 1.5 m³ për qelq është e pranueshme të jetët mesatarisht 4 minuta (përfshirë kohën e udhëtimit deri rek kontejneri tjetër).
- Shpejtësia e lëvizjes së kamionëve grumbullues deri në objektin e klasifikimit supozohet të jetë 35 km/orë;
- Kostot e mirëmbajtjes për kamionët vlerësohen të jenë 5% të kostove të investimit;
- Kostot vjetore të mirëmbajtjes për kontejnerët janë të pranueshme të jenë 2% e kostos së investimit;
- Frekuenca e grumbullimit do të jetë 52 herë në vit për kontejnerët për letër dhe karton dhe plastikë (ose kontejnerët e thatë) dhe 12 herë në vit për kontejnerët për qelqin;
- 85% supozihet të jetë shfrytëzimi i ngarkesës nominale të automjeteve grumbulluese dhe 85% disponueshmëria kur përcaktohet numri i nevojshëm i automjeteve grumbulluese;
- Jetëgjatësia për kontejnerët dhe shportat është e pranueshme të jetë 7 vjet dhe 10 vjet për makinat për grumbulimin e mbeturinave;
- Kostot për njësi prej 900 €/copë janë përdorur për kontejnerin Igloo 1,5 m³, 80 €/copë janë përdorur për shporta plastike 240 l dhe 140,000 €/copë për automjetet e grumbullimi prej 16,0 m³ . Kostot për mekanizmin e të kontejnerëve nuk janl marrë parasysh;
- Distancat mesatare të udhëtimit ndërmjet komunave dhe objektit të klasifikimit është matur në drejtim qendrës përkatëse të qytetit. Supozohet se objekti i klasifikimit do të jetë i pozicionuar në deponinë rajonale;
- Koha mesatare e shpenzuar për shkarkim në vendin e klasifikimit do të jetë gjysmë ore. Koha ndërmjet udhëtimeve do të jetë gjithashtu gjysmë ore;
- Kostot e punës llogariten për 46 javë pune për person, 5 ditë pune në javë dhe mesatarisht 5% pushim mjekësor mesatarisht ;
- Kostot për ndërgjegjësimin e publikut llogariten në masën 10% të kostos vjetore;
- Kostot për administrimin e sistemit supozohet të jenë 10% e kostos direkte operacionale.

6.5.4 Krahasimi i kostos së opsioneve

Tabela e mëposhtme paraqet dy opsionet me informacion mbi sasitë e mbeturinave të mbledhura ndaras, pajisjet e nevojshme, kostot e vlerësuara investuese dhe operacionale.

Tabela 50Krahasimi i alternativave për grumbullimin bdaras të mbeturinave të ricikluesshme

Parametri	Pejë		Istog		Klinë		Deçan		Junik
	Igloo 3x1,5 m³	Shporta 240 l	Igloo 3x1,5 m³	Shporta 240 l	Igloo 3x1,5 m³	Shporta 240 l	Igloo 3x1,5 m³	Shporta 240 l	Shporta 240 l
Mbeturinat e mbledhura ndaras (2030)	10,065	10,065	2,670	2,670	1,797	1,797	1,616	1,616	189
Kërkohen kontejnerë të veçantë grumbullimi:[22]									
Shporta individuale 240 l	-	16,207	-	4,529	-	6,589	-	5,972	711
Igloo 1.5 m³ për letër dhe karton	799	-	217	-	145	-	133	-	-
Igloo 1.5 m³ për plastikë dhe metale	799	-	217	-	145	-	133	-	-
Igloo 1.5 m³ për xhami	509	239	94	94	64	64	55	55	5
Kërkohen automjete për grumbullimin e mbeturinave	6.9	4.4	2.3	1.9	1.5	0.8	1.4	0.9	0.2
Automjetet e koleksionit që do të blihen	9.0	6.0	4.0	3.0	2.0	1.0	2.0	1.0	0.3[23]
Investimet, mijë €[24]	3,492.8	2,342.0	1,208.7	777.2	691,1	754.0	659.3	693.6	106.4
Amortizimi, mijë €	429.7	302.2	142.6	97.8	83,7	101.7	79.2	93.1	13.4
Kostot operacionale, mijë €[25]	807.3	507.9	280.2	233.2	159,6	120.9	157,6	119.6	25.8
Ulja e kostos për njësi për ton të gjeneruar, €/ ton	26.1	16.88	27.60	22.40	26.25	23.75	25.19	24.50	32.80

[22]Numrat i referohen kontejnerëve të instaluar në vitin 2030 kur sistemi është plotësisht funksional. Numri i kontejnerëve dhe automjeteve të kërkuara rritet me numrin e banorëve të shërbyer dhe me sasinë e grumbulluar

[23]Përdorimi i përbashkët i automjeteve grumbulluese

[24]Kostot e paraqitura përfshijnë investimet deri në vitin 2030

[25]Për vitin 2030

Sistemi i veçantë i grumbullimit i bazuar në shporta plastikë individualë për mbeturina të përziera të ricklueshme dheai i kontejnerëve Igloo për grumbullimin e ambalazheve prej qelqi rekomandohet për zbatim në të ardhmen.
Sistemi për grumbullimin ndaras të materialeve të ricklueshme duhet të krijohet bazuar në parimin PZP. Për mbeturinat komunale, PZP do të duhet të mbulojë të gjitha mbeturinat e ambalazhit. Pritet që skema(t) e PZP për mbeturinat e ambalazhit të bëhen funksionale në vitin 2026. Pasi të vendosen skemat PZP, komunat do të duhet të bashkëpunojnë me Organizatën e Përgjegjësisë së Prodhuesit (OPP) në ngritjen e sistemeve të veçanta të grumbullimit të mbeturinave në territoret e tyre.
Skemat PZP do të jenë përgjegjëse për mbulimin e kostove të sistemit për grumbullimin veç eveç të mbeturinave. Përkatësisht, të hyrat nga shitja e lëndëve të ricklueshme do t'i takojnë OPP-së.

Përgjegjësia e Zgjeruar e Prodhuesit për mbeturinat e ambalazhit

Për të forcuar parandalimin, ripërdorimin, riciklimin dhe rikuperimin e mbeturinave, vendet mund të marrin masa legjislative ose jo legjislative për të siguruar që çdo person fizik ose juridik që zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon produkte në mënyrë profesionale (prodhuesi i produktit) ka përgjegjësi të zgjeruar të prodhuesit. Masa të tilla mund të përfshijnë pranimin e produkteve të kthyera dhe të mbeturinave që mbeten pasi ato produkte janë përdorur, si dhe menaxhimin e mëpasshëm të mbeturinave dhe përgjegjësinë financiare për aktivitete të tilla. Masat gjithashtu mund të nxisin dizajnimin e produkteve me qëllim që të reduktohen ndikimet e tyre mjedisore dhe gjenerimi i mbeturinave gjatë prodhimit dhe përdorimit pasues të produkteve. Masa të tilla mund të nxisin zhvillimin, prodhimin dhe marketingun e produkteve që janë të përshtatshme për përdorim të shumëfishtë, që janë teknikisht të qëndrueshme dhe që, pasi janë bërë mbeturinë, janë të përshtatshme për rikuperim të duhur e të sigurt dhe për deponim në pajtueshmëri me mjedisin.

Mbeturinat e ambalazhimit paraqesin një pjesë të konsiderueshme të fraksioneve të mbeturinave të ricklueshme që ndodhen në mbeturinat komunale.
Skemat e Përgjegjësisë së Prodhuesit (ose PZP) konsiderohen si një mjet kryesor zbatimi për krijimin e një sistemi të grumbullimit dhe riciklimit të mbeturinave të ambalazhit për të garantuar arritjen e objektivave siç parashihen në Strategjinë e re të Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave në Kosovë.

“Skemat e Përgjegjësisë së Prodhuesit” (SPP) në fushën e ambalazhit dhe mbeturinave të ambalazhit mund të përkufizohet si: 'Prodhuesit, shpërndarësit dhe importuesit e ambalazheve dhe mallrave të paketuara janë përgjegjës për grumbullimin dhe rikuperimin e mbeturinave të ambalazhit rezultojnë prej tyre.'
Krijimi i skemës PZP për mbeturinat e ambalazhit ka këto objektiva kryesore:

- Të garantojë arritjen e objektivave të riciklimit dhe rikuperimit të përcaktuara në politikën/legjislacionin shtetëror.
- Të ofrojë rrjedha financiare shtesë dhe stimuj për grumbullim ndaras, klasifikim dhe riciklim.
- Të shmang ndërprerjet e përkohshme në proceset e grumbullimit në rast të tendencave negative të çmimeve të mbeturinave të ricklueshme.
- Të përfshijë çështjet e parandalimit, ripërdorimit dhe riciklimit të mbeturinave në dizajnimin e produktit.

Krijimi i një skeme të përgjegjësisë së prodhuesit për t'u marrë me mbeturinat e ambalazhit supozon se industria do të jetë përgjegjëse për financimin dhe organizimin e grumbullimit ndaras dhe klasifikimin e mbeturinave të ambalazhit. Për këtë qëllim kompanitë që vendosin mallra të ambalazhuara në tregun e Kosovës duhet të themelojnë një ose disa Organizata të Përgjegjësisë së Prodhuesit (OPP) për të zbatuar obligimet e tyre dhe për të paguar tarifat. OPP do të ketë obligim për të nënshkruar kontrata me komunat për organizimin e grumbullimit ndaras dhe riciklimit të mbeturinave të ambalazhit dhe financimin e kostove përkatëse. Modalitetet e sakta të zbatimit do të përcaktohen në legjislacionin shtetëror.

6.6 Riciklimi dhe rikuperimi i mbeturinave

6.6.1 Gjendja aktuale

ZMM-ve ju mungojnë objektet formale për trajtimin e fraksionet e ndryshme të mbeturinave që gjenerohen në rajon. Ky është një nga faktorët kryesorë kufizues për trajtimin e duhur të mbeturinave në ZMM.

Seksionet e mëposhtme shqyrtojnë teknologjitë dhe zgjidhjet teknike të mundshme për klasifikimin e fraksioneve të mbledhura ndaras dhe mbeturinave të përziera, kompostimin e mbeturinave të gjelbërta/kopshtit, trajtimin e mbeturinave organike të mbledhura ndaras si dhe trajtimin e mbeturinave të përziera komunale.

6.6.2 Teknologjitë për klasifikimin e mbeturinave

Klasifikimi i mbeturinave komunale dhe përgatitja për riciklim, në thelb, mund të zbatohet në dy mënyra:

- Ndarja e lëndëve të riciklueshme nga mbeturinat e përziera komunale të grumbulluara në stacionin e seleksionimit dmth e gjithë fraksionet e mbeturinave komunale i nënshtrohet klasifikimit;
- Ndarja e materialeve të riciklueshme në stacionin e klasifikimit nga fraksionet e mbeturinave të grumbulluara ndaras, p.sh. mbeturinat e përziera të grumbulluara nuk i nënshtrohet ndarjes së mëtejshme.

Tabela e mëposhtme paraqet avantazhet dhe disavantazhet e këtyre dy alternativave.

Tabela 51Avantazhet dhe disavantazhet e alternativave të klasifikimit

Alternativa	Avantazhet kryesore	Disavantazhet kryesore
Objektet e klasifikimit për mbeturinat e përziera inerte	• Nuk kërkon kosto shtesë grumbullimi dhe ndryshim praktike • Fleksibilitet në klasifikimin e një numri më të madh të materialeve në varësi të potencialit të tregut • Fleksibilitet për ta përshtatur potencialisht me teknologjinë e trajtimit mekanik-biologjik (TMB)	• Materialet e riciklueshme janë të kontaminuara, me më pak vlerë, letra dhe kartoni vështirë se mund të riciklohen • Kosto më të larta investimi • I kufizuar për sa i përket rikuperimit të burimeve (midis 5 dhe 10% të sasive totale të mbeturinave) • Nuk çon në zhvillimin e sistemit të riciklimit dhe nuk ndryshon sjelljen e konsumatorit
Stacion klasifikimi për materialet e riciklueshme të mbledhura ndaras	• Kosto më të ulëta investimi • Materiale të riciklueshme më të pastra me vlerë më të lartë tregu. • Siguron zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të riciklimit dhe rritjen e përfshirjes së publikut	• Kosto më të ulëta të zbatimit ; por të kombinuara me përpjekjet më të larta të grumbullimit çojnë në kosto të përafrta totale • Kërkon ndryshim të qëndrimit dhe praktikës së banorëve • Kërkon përpjekje të vazhdueshme për përfshirjen e publikut dhe kosto për rritjen e ndërgjegjësimit publik

Duke marrë në konsideratë objektivat e larta të riciklimit që duhet të arrihen nga e gjithë ZMM, objektet e klasifikimit për mbeturinat e përziera inerte nuk janë të përshtatshme për shkak të sasive të ulëta të mbeturinave që nxirren

si rikuperimi materialeve të riciklueshme (midis 5 dhe 10% të sasive totale të mbeturinave). Përveç kësaj, të gjitha komunat në ZMM synojnë të fillojne me sisteme për grumbullimin ndaras të materialeve të riciklueshme të thata, gjë që do të kërkojë instalimin e sistemit për klasifikimin e materialeve të grumbulluara ndaras. Prandaj, **sistemi i klasifikimit në rajon duhet të bazohet në objektin(et) e klasifikimit të materialeve të riciklueshme të mbledhura ndaras**. Klasifikimi i mbeturinave të përziera nuk siguron individualisht reduktim të konsiderueshëm të sasive mneturinave të përcaktuara për deponim dhe mund të zbatohet vetëm si një objekt më i madh trajtimi (p.sh. impianti TMB).

Opsionet për klasifikimin e mbeturinave të grumbulluara ndaras
Sasia totale e materialeve të mbledhura ndaras në rajon vlerësohet të rritet nga 8,608 tonë në vitin 2026 në 18,915 tonë në vitin 2035. Këto sasi janë relativisht të ulëta dhe supozojnë krijimin e një objekti të centralizuar klasifikimi për të gjithë zonën e menaxhimit të mbeturinave. Megjithatë, duke marrë parasysh ndërtimin e mundshëm të stacioneve të transfertit dhe oborreve të riciklimit, një qasje e decentralizuar për mbeturinat gjithashtu konsiderohet.

Tabela më poshtë paraqet çmimet mesatare aktuale të tregut për materialet e riciklueshme të përdorura për vlerësimin e të hyrave.

Tabela 52Çmimet e supozuara të tregut për mbeturinat e artikujve të riciklueshëm

Material i riciklueshëm	Mbeturinat e grumbulluara ndaras, €/ton	Mbeturinat e përziera, €/ton
Plastikë	180	50
Letër dhe karton	75	10
Qelq	10	10
Metal	200	200

Çmimet e mësipërme janë nga 'vendi i gjenerimit' objekti i klasifikimit/impianti TMB.

Janë konsideruar dy alternativa për klasifikimin e mbeturinave të grumbulluara ndaras:

- Alternativa 1 – Objekti i përbashkët i centralizuar i klasifikimit, i vendosur në komunën e Pejës.
  Objekti i centralizuar i klasifikimit do të jetë i pajisur me kabinën e ventiluar të klasifikimit, shiritat transportues, kanalin e automatizuar për presim.
- Alternativa 2 – Objektet e vogla individuale (të decentralizuara) të klasifikimit të vendosura në komunat e Pejës, Istogut , Klinës dhe Deçanit. Mbeturinat e mbledhura ndaras nga komuna e Junikut do të dedikohen në një nga këto objekte të klasifikimit. Në instalimet më të vogla të klasifikimit në Istog , Klinë dhe Deçan do të sigurohet presa më e vogël topthuese me perforator dhe nuk do të vendosen kabina për klasifikim. Klasifikimi do të organizohet në platonë e rripit transportues direkt në nivelin e tokës.

Të dyja alternativat nuk parashikojnë klasifikim/trajtim të qelqit të mbledhur veçmas për shkak të sasive të vogla të grumbulluara.

Kostot për zbatimin e alternativave të ndryshme janë përmbledhur në tabelën vijuese.

Tabela 53Vlerësimet e kostos për alternativa të ndryshme për klasifikimin e mbeturinave të ricikluesshme të grumbulluara ndaras

Parametri	Klasifikimi i përbashkët	Objektet individuale të klasifikimit			
		Pejë	Istog	Klinë	Deçan[26]
Inputi i mbeturinave (2035), ton	21,065	12,859	3,495	2,350	2,361
Mbeturinat e ndara për riciklim (2035), ton	18,915	11,529	3,147	2,116	2,123
Kostot e investimit, mijë €	1,570	1,007	346	339	339
Kostot operacionale, mijë €	677	530	172	140	140
Të hyrat nga shitjet, mijë €	2,096	1,260	356	239	242
Kostot e zbritura për njësi, input €/ton	- 44.83	-54.44	-59.53	-86.13	-84.93
Të ardhura me ulje për njësi, input €/ton	100.87	98.28	102.73	102.53	103.48
Kostot me ulje neto për njësi, input €/ton	55.24[27]	43.84	43.20	16.40	18.54

Krahasimi tregon se klasifikimi I përbashkët ka kosto më të ulët zbatimi krahasuar me klasifikimin e decentralizuar.

6.6.3 Teknologjitë për trajtimin dhe rikuperimin e mbeturinave komunale

Ekzistojnë disa teknologji të trajtimit të mbeturinave. Teknologjitë më të rëndësishme janë:

- Teknologjitë e mbeturinave për energji
- Trajtimi mekanik biologjik (TMB) i lidhur me kompostimin e centralizuar

Teknologjitë për trajtimin e fraksioneve të mbledhura ndaras të mbeturinave organike si kompostimi dhe tretja anaerobe janë konsideruar veçmas në seksionet e mëposhtme.

Teknologjitë e shndërrimit të mbeturinave në energji

Mbeturinat për energji (MpE) përfshijnë metodat sipas të cilave energjia që ndodhet në mbeturina nxirret për prodhimin e energjisë elektrike dhe nxehtësisë. Tabela e mëposhtme paraqet disa nga teknologjitë më të përdorura.

Tabela 54Teknologjitë e shndërrimit të mbeturinave në energji

Teknologjitë MpE	Përshkrimi
Teknologjitë termike	
Djegia	Djegia e mbeturinave i referohet trajtimit të kontrolluar në temperaturë të lartë të mbeturinave, shoqëruar me trajtim/filtrim të gjerë të emetimeve në ajër dhe hirit të mbetur. Në mënyrë tipike, energjia e nxehtësisë përdoret për të prodhuar energji elektrike. Avantazhi kryesor i djegies së mbeturinave është se procesi çon në një reduktim të ndjeshëm të sasive të mbeturinave që deponohen – dhe rreth 95% e mbeturinave digjen.
Gazifikimi	Ky është një proces termo-kimik në të cilin inputi organik nxehet në një atmosferë me mungesë oksigjeni për të prodhuar një të ashtuquajtur gaz sintetik, i cili më pas mund të përdoret si lëndë djegëse në një turbinë ose motor me djegie për të prodhuar energji elektrike ose nxehtësi.

[26]Përfshin edhe sasitë e mbeturinave tëgrumbulluara ndaras nga komuna e Junikut

[27]Vlera pozitive do të thotë që të ardhurat janë më të larta se kostot. Kostot neto llogariten vetëm për ndarjen dhe nuk përfshijnë kostot për grumbullimin ndaras të mbeturinave.

Teknologjitë MpE	Përshkrimi
Depolimerizimi	Depolimerizimi termik (ose vajrimi) i mbeturinave i shndërron ato në një lloj karburanti me naftë. Në fakt kjo teknologji është projektuar për të punuar me lloje të ndryshme të xhiros - lloje të ndryshme materialesh organike, gome, yndyrna të të gjitha llojeve etj. Substancat e dëmshme si klori, dioksidi dhe furanet neutralizohen nga katalizatorët dhe përgatiten për asgjësim të sigurt.
Piroliza	Teknologjia përfshin degradimin e materialit organik në mbeturina nga nxehtësia në mungesë të oksigjenit, gjë që rezulton në prodhimin e qymyrit, produkteve të lëngshme dhe të gazta. Nëse qëllimi është të maksimizohet prodhimi i produkteve të lëngshme që rrjedhin nga piroliza e materialit organik, do të kërkohet një temperaturë e ulët me shpejtësi të lartë ngrohjeje dhe proces të shkurtër qëndrimi në gaz. Nëse qëllimi është të maksimizohet prodhimi i karbonit të lartë, atëherë do të kërkohet një temperaturë e ulët me një proces të ulët ngrohjeje. Dhe, për prodhimin e gazit me lëndë djegëse të lartë, do të zgjidhej një temperaturë e lartë me shpejtësi të ulët ngrohjeje dhe një proces të gjatë qëndrimi në gaz.
Gazifikimi i harkut plazmatik	Kjo teknologji bazohet në një pajisje të quajtur konvertues plazmatik, i cili përdor energjinë elektrike për të arritur temperaturën e lartë, ku mbeturinat grupohen në gaz të thjeshtë dhe baltë mbeturinash. Gazifikimi i harkut të plazmës lejon që sasi të mëdha mbeturinash të mënjanohen nga deponia dhe të prodhojnë energji elektrike, e cila varet nga përbërja e mbeturinave hyrëse.
Teknologjitë jo-termike	
Tretje anaerobe	Pjesa organike në mbetuirna dekompozohet dhe mineralizohet pjesërisht në një mjedis pa oksigjen. Si rezultat gjenerohet metani dhe ai mund të përdoret për të gjeneruar energji elektrike ose nxehtësi. Në varësi të cilësisë së prodhimit nga procesi, ai ose mund të përdoret drejtpërdrejt si kondicioner i tokës, ose, nëse ende nuk është plotësisht i degraduar, mund të kompostohet më tej. Tretja anaerobe nuk kërkon zona të mëdha, megjithatë praktika tregon se zakonisht është një qasje më e kushtueshme sesa sistemet e trajtimit aerobik.
Trajtim mekanik biologjik	Disa teknologji MBT përshkruhen më poshtë në seksionin 4.1.3.2.
Shfrytëzimi i gazit të deponive	
Shfrytëzimi i gazit në deponi	Megjithëse deponia e mbeturinave nuk është një opsion trajtimi, metani që prodhohet nga degradimi i mbeturinave organike mund të përdoret për të gjeneruar energji. Ky opsion mbështetet në fizibilitetin e teknologjive për kapjen e gazit të deponisë, nxjerrjen e metanit dhe përdorimin e tij direkt si lëndë djegëse dhe për prodhimin e energjisë elektrike. Kjo është një metodë me kosto relativisht të ulët për rikuperimin e energjisë nga mbeturinat organike. Prodhimi i metanit ndryshon shumë nga deponia në deponi në varësi të karakteristikave specifike të vendit , si p.sh. mbeturinat e deponuara, përbërja e mbeturinave, përmbajtja e lagështisë, dizajni i deponisë dhe praktikat e funksionimit.

Kostot e lidhura me depolimerizimin termik, pirolizën dhe gazifikimin e harkut të plazmës janë të ngjashme me djegien e mbeturinave komunale inerte – mbi 100-200 €/t (kosto totale)[28]. Ashtu si djegia e MKI, zbatimi i teknologjive termike MpE në ZMM do të ishte shumë i kushtueshëm dhe kostot e shërbimit të MMI do të rriteshin në një nivel që do ta bënte mbulimin e kostos të paarritshëm. Prandaj, **zbatimi i teknologjive MpE në ZMM nuk konsiderohet më tej në PNMIM**.

Kostot e lidhura me tretjen anaerobe (TA) në vendet e BE-së janë brenda intervalit 25-50 €/t (kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes) ose 50-90 €/t (kostot totale)[29] dhe janë teknologjikisht të besueshme kur aplikohen vetëm për mbeturina organike të mbledhura ndaras. Duke marrë parasysh objektivin për riciklimin 50% të MKI deri në vitin

[28] JASPERS Dokument i punës së stafit, Punime mbi Trajtimin Mekanik Biologjik, nga Jonas Byström, Mars 2010 (Rishikuar gusht 2010)

[29] Po aty.

2035, bëhet e qartë se TA do të duhet të merret parasysh për periudhën pas vitit 2030 në mënyrë që të arrihen objektivat e riciklimit.

Megjithatë, duke qenë se kostot që lidhen me teknologjitë jotermike, veçanërisht trajtimin mekanik-biologjik (TMB), janë dukshëm më të ulëta se teknologjitë termike, seksioni në vijim do të ofrojë analiza të opsioneve të mundshme për trajtimin mekanik-biologjik në ZMM.

Trajtimi mekanik biologjik (TMB)
TMB është një familje teknologjish me kosto dhe kompleksitete të ndryshme. Teknologjitë TMB janë teknologji të pranueshme dhe solide në vendet e BE-së. Teknologji të ndryshme janë aktualisht në funksion pasi proceset e ndryshme janë testuar dhe optimizuar për një periudhë të gjatë kohore.

Zhvillimi i teknologjive TMB u inkurajua nga ndryshimet në politikën e përgjithshme të BE-së për menaxhimin e mbeturinave dhe objektivat e caktuara të vendosura. Këto përfshijnë:

- Ndalimi i deponimit të MKI të patrajtuara; dhe
- Reduktimi i sasive të mbeturinave të biodegradueshme npër deponi.

TMB mund të përfshijë një sërë teknologjish të ndryshme procesesh. Disa sisteme përfshijnë pajisje për të para-vlerësuar mbeturinat dhe në këtë mënyrë prodhojnë një fraksion të kompostueshëm të përshtatshëm për proceset e kompostimit në natyrë, të mbuluar ose të kontrolluar brenda kontenjerit. Një tjetër qasje TMB përfshin nxjerrjen fillestare të materialeve të ricikluesshme, e ndjekur nga homogjenizimi i mbeturinavetë përziera përpara përpunimit të tyre në një impiant tretjeje anaerobe ose një impianti trajtimi aerobik.

Figura 23Shembuj të TMB

Bazuar në llojin e trajtimit biologjik, MBT në thelb mund të ndahet në tre teknologji kryesore:

- Bio-stabilizimi. Kjo teknologji përfshin nxjerrjen e materialeve të ricikluesshme të ndjekura nga bio-stabilizimi i fraksionit të mbeturinave të biodegradueshme, të kryera në mjedis aerobik, përpara dërgimit në deponi ose përdorimit në aplikime jo bujqësore si rehanilitimi i minierave;
- Bio-tharje. Me këtë teknologji prodhohet karburant nga mbeturinat e jo ricikluesshme (SRF) përmes trajtimit intensiv aerobik të mbeturinave komunale. Prodhimi i këtij fraksioni me kalori të lartë pason nxjerrjen e metaleve të ricikluesshme dhe materialeve inerte;
- TMB me rikuperim energjie. Me këtë teknologji prodhohet një fraksion i ndryshëm me kalori të lartë (karburante që Derivojnë nga Mbeturinat – KDM/RDF). Pas nxjerrjes së materialeve të ricikluesshme dhe materialeve inerte, fraksioni më i lehtë përgatitet për prodhimin e KDM me trajtim paralel aerobik/anaerobik të fraksionit organik më të rëndë. Ambbientet e mundshme për KDM-në janë furrat e çimentos, inceneratorët e ndërtuar për qëllime me fuqi dhe prodhim të nxehtësisë (CHP), bashkëndezje me qymyr në termocentrale.

Bio-stabilizimi është metoda më pak e kushtueshme. Megjithatë, si synimet e shkarkimit të deponive ashtu edhe synimet e riciklimit për MKI mund të arrihen vetëm me sasi maksimale të MKI që riciklohen dhe/ose rikuperohen energjikisht. Prandaj, TMB me rikuperim të energjisë (prodhimi KDM) është teknologjia e preferuar për Rajonin. Është gjithashtu një nga dispozitat në Strategjinë e Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 2024-2035 për Rajonin e Dukagjinit.

Objekti i centralizuar TMB për trajtimin e mbeturinave të përziera
Arritja e synimeve të riciklimit dhe shkarkimit të deponive do të kërkojë ngritjen e objektit TMB për të marrë mbeturinat e përziera nga i gjithë rajonin.
Kapaciteti i kërkuar i instalimit vlerësohet në 40,000 tonë mbeturina të përziera në vit dhe supozohet se do të ngritet në hapësirën e deponisë rajonale. Trajtimi biologjik në tunele dhe prodhimi i KDM konsiderohet si teknologji më e përshtatshme e trajtimit.

Vlerësimet treguese të kostos për ndërtimin e instalimit TMB janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 55Vlerësimet e kostos së investimit TMB

Përbërësit e kostos	Vlera, €
Tokë	-
Punime civile	3,140,000
Mekanike	8,275,000
Automjetet	469,000
Kontingjenca, inxhinieri, komisione	3,370,000
Kostot totale të investimit	15,254,000

Kostot operacionale për vitin e parë të funksionimit (2031) paraqiten në tabelën vijuese.

Tabela 56Vlerësimet e kostove operacionale të instalimit të TMB

Përbërësit e kostos	Vlera, €
Personeli	270,000
Mirëmbajtja	683,000
Materialet harxhuese	157,000
Transporti i mbeturinave në deponi	24,000
Administrata	200,000
Taksat, sigurimet	80,000
Kostot totale operacionale	1,481,000

Kostoja mesatare me ulje për ton të mbeturinave hyrëse është vlerësuar në 76 €/ton, ndërsa kostot neto duke marrë parasysh të hyrat nga shitja e materialeve të riciklueshme janë 69 €/ton.

6.6.4 Kompostimi i mbeturinave të gjelbra

Trajtimi i mbeturinave organike në ZMM mund të fillojë me metoda relativisht të thjeshta, si kompostimi i mbeturinave organike të gjelbra (p.sh. mbeturinat fushore, mbeturinat nga kopshtet etj.) që kërkon një paraprocesim minimal dhe që do të rezultojë në cilësinë më të lartë të produktit përfundimtar të kompostimit i cili mund të përdoret si kondicioner i tokës dhe do të jetë i përshtatshëm për përdorime bujqësore dhe të tjera.

Dallimi kryesor midis kësaj metode dhe bio-stabilizimit të mbeturinave organike të përziera është se për të prodhuar një kompost të cilësisë së lartë, i cili mund të aplikohet për qëllime të ndryshme (dhe të shmanget nga deponia), metoda kërkon që materiali hyrës të mblidhet ndaras për të shmangur kontaminimin e produktit përfundimtar.

Aktivitetet e kompostimit synojnë të arrijnë:

- Reduktimi i mbeturinave organike në rrjedhën totale të mbeturinave për deponim, dhe
- Kthimi i një pjese të fraksionit organik për ripërdorim

Kompostimi zakonisht bëhet në të ashtuquajturat dritare. Është një zgjidhje e thjeshtë dhe e lirë. Është gjithashtu i adaptueshëm ndaj zgjerimit të ardhshëm (rritjes së kapacitetit) ose përditësimit të pajisjeve. Disavantazhi është periudha relativisht e gjatë e nevojshme për maturimin e kompostit.

Kompostimi i mbeturinave të gjelbra të mbledhura ndaras përfshin shkarkimin e tyre në një vend të caktuar, copëtimin dhe vendosjen e tyre në piramida. Për qëllime të ajrosjes, materiali duhet të rrotullohet rregullisht nga një rrotullues i shtresave të grumbulluarai, ose përmes një pajisje të projektuara posaçërisht për këtë, siç tregohet në figurën më poshtë.

Figura 24Sistemet e kompostimit

Duhet të kryhen teste të rregullta për temperaturën, lagështinë dhe fertilizimin e kompostit. Për të prodhuar një produkt cilësor (komposto), i cili mund të përdoret për qëllime bujqësore, duhet të bëhet analiza periodike e përmbajtjes së metaleve të rënda, veçanërisht nëse lënda e parë përmban mbeturina tjera përveç "mbeturinave të gjelbra", si mbeturinat ushqimore nga tregjet. Cilësitë më të ulëta të kompostos janë të përshtatshme për rehabilitimin e tokës dhe ndërtimin e fushave sportive, autostradave dhe aplikime të tjera.

Grumbullimi i mbeturinave të gjelbra nga kopshtet private është një sistem më i vështirë, duke qenë se në secilin rast mbeturinat krijohen në sasi relativisht të vogla gjatë gjithë vitit, duke arritur kulmin në pranverë dhe vjeshtë. Si më poshtë, ekzistojnë mundësi të grumbullimit:

- Deponimi i mbeturinave të gjelbra ashtu siç janë, dmth vendosni mbeturinat skaj rrugës menjëherë pas gjenerimit, në të njëjtën mënyrë siç bëni me mbeturinat e vëllimshme.
- Midis marsit dhe nëntorit, një herë në muaj mbledhja shtëpi më shtëpi në data të caktuara.
- Vendosja e kontejnerëve të mbeturinave të gjelbra (7 deri në 10 m³) në vende të caktuara që mbulojnë një sipërfaqe një rreze prej 500 m deri në 1 km, në ambientet e shtëpive familjare dhe kopshteve, një herë në muaj gjatë pranverës, verës dhe vjeshtës.
- Mbledhja bazuar në thirrje, disa herë në vit pa pagesë, arkëtime të mëtejshme me një tarifë të caktuar;
- Instalimi i oborreve të riciklimit për mbeturina të gjelbra, ku njerëzit mund të sjellin mbeturinat e tyre të gjelbra pa pagesë. Oborret e tilla të riciklimit mund të funksionojnë gjithashtu si magazinim i përkohshme për mbeturinave të gjelbra, derisa grirësi i lëvizshëm të vijë herë pas here dhe të copëtojë mbeturinat e gjelbra. Më pas ato transportohen në impiantin e kompostimit të mbeturinave të gjelbra.

Në tabelën e mëposhtme, krahasohen sistemet e ndryshme të grumbullimit:

Tabela 57Krahasimi i skemave të ndryshme të grumbullimit të mbeturinave të kopshtit

Kriteret	Opsioni 1 Deponimi i mbeturinave ashtu siç gjenerohen	Opsioni 2 Grumbullimi javor shtëpi më shtëpi	Opsioni 3 Vendosja e kontejnerëve të mbeturinave të gjelbra	Opsioni 4 Grumbullimi në bazë të thirrjeve	Opsioni 5 Oborret e riciklimit me magazinim
Komoditet për gjeneruesit e mbeturinave	Shumë i përshtatshëm, sepse mbeturinat mblidhen menjëherë	Sistem i përshtatshëm grumbullimi për gjenruesin. Nisur nga grumbullimi javor, edhe mbetuirnat shumë të lagështa nuk përbëjnë problem të madh	Skemë relativisht e përshtatshme, pasi kontejnerët do të vendoseshin në një distancë të përshtatshme	Grumbullim i përshtatshëm i mbetuirnave nga ambientet. E papërshtatshme, sepse prerja e pemëve dhe shkurreve duhet të koordinohet me mbledhjen e aranzhuar.	E papërshtatshme, sepse gjeneruesit e mbeturinave duhet t'i transportojnë ato në oborrin riciklues për disa km. Jo çdo prodhues i mbeturinave ka një automjet të përshtatshëm. I përshtatshëm nga pikëpamja që mbeturinat mund të largohen sa herë që shfaqen.
Komoditet për autoritetet lokale	AL duhet të organizojnë në mënyrë të përhershme grumbullimin ad hoc të mbetjurinave të gjelbra	AL duhet të organizojnë mbledhjen me kosto relativisht të lartë.	AL duhet organizojnë datat kur vendosen kontejnerët.	Kompania e grumbullimit duhet të organizojë itinerarin më të mirë të grumbullimit.	Kërkohet operacionalizimi i disa oborreve të riciklimit (mbulimi me diametër 5 deri në 10 km).
Cilësia e mbeturinave	Cilësi e lartë, sepse do të merren vetëm mbeturinat e gjelbra. Mbeturinatt e gjelbra janë të freskëta.	Cilësi e lartë, sepse do të merren vetëm mbeturinat e gjelbra. Mbeturinat e gjelbra kanë një moshë maksimale 1 javore.	Kualitet mesatar, kontejnerët mund të përdoren gjithashtu për mbeturina të vëllimshme dhe mbeturina ndërtimi. Mbeturinat e gjelbra mund të jenë ruajtur për ca kohë.	Cilësi e lartë, sepse do të merren vetëm mbeturinat e gjelbra. Mbeturinat e gjelbra mund të jenë ruajtur për ca kohë.	Cilësi e lartë, sepse do të pranohen vetëm mbeturinat e gjelbra. Mbeturinat e gjelbra janë të freskëta.
Sasitë	E tëtë sasia e gjeneruar mblidhet	Sasi të larta të mbeturinave të gjelbra të grumbulluara nga ata që kanë aplikuar për një shportë të mbeturinave	Sasia e mbledhur e reduktuar. Mbeturinat e gjelbra mund të përzihen me mbeturinat komunale	Sasia e mbledhur e reduktuar. Mbetjurinat e gjelbra mund të përzihen me mbeturinat komunale	Sasia e mbledhur e reduktuar. Mbeturinat e gjelbra mund të përzihen me mbeturinat komunale

Kriteret	Opsioni 1 Deponimi i mbeturinave ashtu siç gjenerohen	Opsioni 2 Grumbullimi javor shtëpi më shtëpi	Opsioni 3 Vendosja e kontejnerëve të mbeturinave të gjelbra	Opsioni 4 Grumbullimi në bazë të thirrjeve	Opsioni 5 Oborret e riciklimit me magazinim
		të gjelbra.			
Rreziqet	Asnjë	Mbeturinat e gjelbra vendosen skaj rrugës sa herë që gjenerohen	Mbeturinat e gjelbra vendosen skaj rrugës sa herë që gjenerohen	Mbeturinat e gjelbra vendosen skaj rrugës sa herë që gjenerohen	Mbeturinat e gjelbra vendosen skaj rrugës sa herë që gjenerohen
Koment	Sistemi është i ngjashëm me sistemin ekzistues të grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme. Relativisht e shtrenjtë, por më e përshtatshme për gjenruesit e mbeturinave	Ky është një sistem i organizuar mirë. Relativisht i shtrenjtë, por shumë i përshtatshme për gjeneruesit e mbeturinave	Në parim, një sistem i mirë, megjithatë, ka një rrezik të lartë, që të ketë mbeturina të tjera në kontejnerë. Sistemi duhet të testohet përpara prezantimit.	Ky sistem i mban vendbanimet të pastra, pasi që mbeturinat vendosen vetëm në datën e caktuar. Megjithatë, mund të ketë shumë njerëz që nuk do ta pëlqenin sistemin e thirrjeve.	Ky opsion ka kuptim, nëse një sistem i oborreve ricikluese parashikohet edhe për lloje të tjera mbeturinash. Jo i përshtatshëm për zonat rurale
Rekomandim	Rekomandohet, bazuar në sistemin ekzistues, ku grumbullimi i mbeturinave të vëllimshme tashmë funksionon në baza ad-hoc, derisa të fillohet me një sistem më të organizuar .	Nuk rekomandohet në afat të shkurtër. Në periudhën afatmesme mund të konsiderohet në të ardhmen të fillohet me një sistem vullnetar shportash për mbeturina të gjelbra .	Nuk rekomandohet derisa të ketë një disiplinë të qëndrueshme në ndarjen e mbeturinave.	Nuk rekomandohet. Duke pasur parasysh frekuencën e lartë të prerjeve të barit, kjo do të kërkonte thirrje dhe mbledhje të shpeshta. Kështu, një sistem i rregullt është më i përshtatshëm.	Nuk rekomandohet. Nuk ka gjasa që një numër i konsiderueshëm njerëzish të transportojnë mbeturinat e tyre në oborret e ricklimit .

Kompostimi shtëpiak

Një tjetër mundësi praktike për reduktimin e sasive të mbeturinave për deponi është të fillohet me kompostimin shtëpiak. Kjo është një metodë riciklimi që ndihmon në transformimin e sasive të mbeturinave të gjelbra në kompost të vlefshëm, i cili mund të përdoret nga banorët drejtpërdrejt në tokën e tyre për të rritur prodhimin e perimeve dhe luleve. Në të njëjtën kohë, kompostimi shtëpik rezulton në sasi të reduktuara të mbeturinave që kërkojnë grumbullim dhe në këtë kuptim mund të ndihmojë në uljen e kostove për grumbullimin e mbeturinave dhe menaxhimin e mëvonshëm.

Në mënyrën më të zakonshme, procesi i kompostimit kërkon thjesht grumbullimin e mbeturinave të gjelbra. Procesi i dekompozimit ndihmohet nga copëtimi i bimëve dhe degëve nga pemët. Për të përshpejtuar procesin e dekompozimit duhet të sigurohet ajsja e duhur duke e rrotulluar rregullisht masën e mbeturinave. Mbeturinat e kuzhinës mund të shtohen gjithashtu në proces, por vetëm mbeturinat e zgjedhura ushqimore. Produktet e qumështit dhe mishi duhet të shmangen pasi tërheqin parazitë dhe brejtës. Në përgjithësi, mbeturinat e kuzhinës në vendbanimet rurale përdoren kryesisht për ushqimin e kafshëve dhe kompostuesit shtëpiak pritet të përdoren kryesisht për mbeturinat e gjelbra nga oborret.

Figure 25. Shembull i një kompostëri jo të kushtueshëm

Kompostimi në shtëpi mund të lehtësohet duke përdorur pajisje speciale. Këto pajisje (komposterët shtëpiak) janë të qëndrueshme (zakonisht prej plastike) dhe kanë një periudhë funksionimi 7-10 vjet. Çmimet e kompostuesve të tillë variojnë nga 40 deri në 100 euro.

Një njësi kompostimi shtëpiak mund të bëhet gjithashtu nga druri, ose materiale të tjera dhe mund të jetë shumë e thjeshtë dhe më pak e kushtueshme.
Zbatimi i programit të kompostimit shtëpiak rekomandohet për të gjitha zonat rurale dhe për shtëpitë familjare në zonat urban.

Vlerësimet e kostove për kompostimin e mbeturinave të gjelbra

Lloji i objekteve të përshtatshme për kompostimin e mbeturinave të gjelbra duhet të vendoset në bazë të sasive të vlerësuara të mbeturinave të gjelbra të grumbulluara.
Ndërsa kompostimi shtëpiak do të jetë alternativa parësore për mbeturinat e gjelbra të krijuara në zonat rurale dhe shtëpitë familjare në zonat urbane, ndërtimi i instalimeve të kompostimit duhet të konsiderohet për mbeturinat nga mirëmbajtja e zonave të gjelbra publike. Për të shmangur transportimin e mbeturinave të gjelbra në distanca të mëdha, kompostimi do të organizohet në nivel komunal.
Sasitë e vlerësuara të mbeturinave të gjelbra të përcaktuara për kompostim të organizuar përcaktojnë llojet e përshtatshme të objekteve që do të përdoren. Në këtë drejtim, përcaktimi i lokacionit të centralizuar të kompostimit është i justifikuar vetëm në komunën e Pejës ku sasia e mbeturinave të gjelbra të grumbulluara ndaras tejkalon 2,000 tonë në vit. Skemat e decentralizuara të kompostimit duke përdorur pajisje të lëvizshme përfshirë traktorin, pajisjen për prerjen e drnjve dhe pajisjen tërheqëse do të jenë më të përshtatshme për komunat e Istogut , Klinës dhe Deçanit ku sasia e mbeturinave të gjelbërta është nën 600 tonë në vit. Për komunën e Junikut ku sasitë e mbeturinave të gjelbra janë shumë të vogla, rekomandohet kompostimi në vend.
Tabela e mëposhtme paraqet vlerësimin e kostos për zbatimin e kompostimit të mbeturinave të gjelbra nëpër komuna.

Tabela 58Karakteristikat kryesore dhe vlerësimet e kostove nëpër për kompostimin e mbeturinave të gjelbra në shtresa

Parametri	Pejë	Istog	Klinë	Deçan	Junik
Mbeturinat e gjelbra të mbledhura veçmas, ton	**2,400**	**600**	**600**	**550**	**65**
Lloji i objektit	Vend i përhershëm i centralizuar	Kompostimi i decentralizuar me pajisje të lëvizshme	Kompostimi i decentralizuar me pajisje të lëvizshme	Kompostimi i decentralizuar me pajisje të lëvizshme	Kompostimi i decentralizuar me pajisje të lëvizshme
Kostot e investimit, mijë €					Shërbyer në mënyrë periodike
Tokë	-	-	-	-	

Parametri	Pejë	Istog	Klinë	Deçan	Junik
Punime civile	125	-	-	-	me pajisje të lëvizshme të siguruara nga komunat e tjera
Makineri	370	39	39	39	
Automjetet	12	75	75	75	
Inxhinieri, komisionim, kontingjente	25	6	6	6	
Investimet totale	532	119	119	119	
Amortizimi, mijë €	**46**	**12**	**12**	**12**	
Kostot operacionale, mijë €					
Mirëmbajtje dhe riparim	25	10	10	10	
Personeli	55	24	24	24	
Materiale harxhuese	59	11	11	10	
Administrata	14	4	4	4	
Taksat, sigurimet	6	2	2	2	
Kostot totale operacionale	158	51	51	50	
Grumbullimi i mbeturinave të gjelbra, mijë €	**47**	**11**	**11**	**10**	

6.6.5 Grumbullimi ndaras dhe trajtimi i mbeturinave ushqimore (mbeturinave tjera organike)

Mbeturinat ushqimore/kuzhinës janë fraksioni më i ndërlikuar i mbeturinave që grumbullohet ndaras. Megjithatë, duke marrë parasysh sasinë e konsiderueshme të fraksionit të mbeturinave ushqimore, do të kërkohet grumbullimi ndaras për të arritur objektivat e riciklimit dhe shmangjes së deponive për mbeturinat komunale.
Shumica e popullsisë në rajon jeton në zonat rurale ku mbarështimi i kafshëve (pulat, lepujt, etj) është ende i zakonshëm dhe shumica e mbeturinave organike tashmë ose kompostohen në shtëpi ose përdoren si ushqim për kafshët. Hyrja në praktikë e grumbullimit ndaras të mbeturinave organike për momentin nuk do të jepte rezultate domethënëse.

Prandaj, për zonat urbane në rajon rekomandohet grumbullimi ndaras i mbeturinave të kuzhinës.

Për më tepër, prania e mbeturinave ushqimore në materialet e grumbulluara do të kërkojë zbatimin e teknologjive më të avancuara të trajtimit si sistemet e kompostimit të mbyllura ose tretja anaerobe. Metoda të tilla janë dukshëm më të shtrenjta në krahasim me kompostimin me dritare të hapur derisa do të kenë ndikim shtesë në tarifat për shërbimin e ofruar.
Kostot e vlerësuara të investimit dhe ato operiacionale për ngritjen e një impianti të centralizuar të tretjes anaerobe ose impiantit të kompostimit të mbyllur me një kapacitet prej 3,500 tonë janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 59Krahasimi i kostos së alternativave për trajtimin e mbeturinave ushqimore të mbledhura ndaras

Parametri	Impiant për tretje anaerobe[30]	Kompostimi në kontejnerë të veçantë
Kostot e investimit, mijë €	3,904	2,503
Shpenzimet operative vjetore, mijë €	471	333

[30]Të ardhurat potenciale nga shitja e energjisë elektrike nuk merren parasysh

Impianti i TA ka investim fillestar dhe kosto operative më të larta krahasuar me instalimin e kompostimit në enë. Megjithatë, nuk do të ketë ndonjë ndryshim të rëndësishëm në kosto nëse merren parasysh të ardhurat nga shitjet e energjisë elektrike të prodhuar nga TA, të cilat pritet të mbulojnë afërsisht gjysmën e kostove operative.
Nga ana tjetër, kompostimi në enë mund të kombinohet lehtësisht me impiantin TMB ose instalimin e kompostimit të mbeturinave të gjelbra në komunën e Pejës.

6.7 Deponimi i mbeturinave

6.7.1 Gjendja aktuale

Të gjitha komunat e rajonit i deponojnë mbeturinat e tyre komunale në deponinë e Pejës. Kapaciteti i ldeponisë është varfëruar për një kohë të gjatë. Projektimi i detajuar dhe dokumentet e tenderit për mbylljen e lokacionit ekzistues dhe ndërtimin e deponisë së re janë në përgatitje dhe rishikim tash e disa vite.

6.7.2 Zhvillimi i sistemit të deponimit të mbeturinave

Pavarësisht nga të gjitha masat e ardhshme që lidhen me shmangien e mbeturinave, riciklimin dhe trajtimin e mbeturinave, një sasi e caktuar mbeturinash të përziera do të mbetet për deponim. Kështu, në çdo rast kërkohen deponi sanitare për deponim të sigurt dhe në përputhje me mjedisin.

SKMIM 2024-2035 ka identifikuar se Rajoni i Dukagjinit duhet të shërbehet nga një deponi rajonale. Siç është përmendur tashmë, dizajni i detajuar për përmirësimin dhe zgjerimin e lokacionit aktual të deponimit të mbeturinave në Sferkë është në përgatitje e sipër. Bazuar në parcelën në dispozicion dhe sasitë e parashikuara të mbeturinave që do të deponohen, projekti i detajuar do të përcaktojë periudhën e funksionimit të deponisë në vazhdim.
Ndërtimi i deponisë duhet të kryhet në faza. Faza e parë duhet të përfshijë infrastrukturën e mëposhtme:

- Qelia e parë me kapacitet për t'u mjaftuar për 5 deri në 7 vjet deponim;
- Sistemet e grumbullimit dhe trajtimit për kullimin dhe gazin në deponi;
- Infrastruktura shtesë, si: peshore, rrethojë, objekte zyrash dhe garazhesh;
- Pajisjet e nevojshme të lëvizshme, si kompaktori, kamioni, ngarkuesi i përparmë etj.

Para përfundimit të qelisë së parë, duhet të fillojë ndërtimi i qelisë së dytë.

Secila prej qelive, e cila do të ndërtohet në fazën e parë, duhet të ketë jetëgjatësi jo më pak se 5 vjet.

Kapaciteti i nevojshëm i deponisë përcaktohet në bazë të parashikimeve të gjenerimit të mbeturinave dhe merren parasysh sasitë e reduktuara të mbeturinave që do të deponohen si rezultat i krijimit të planifikuar të grumbullimit ndaras të mbeturinave të riciklueshme, kompostimit të mbeturinave të gjelbërta/kopshtit, trajtimit të mbeturinave tjera organike të grumbulluara ndaras dhe TMB-së.

Supozohet se deponia do të përbëhet nga disa qelia deponimi, secila prej tyre me jetëgjatësi të vlerësuar prej 5 vjetësh. Kapaciteti i deponisë vlerësohet në 475 mijë tonë mbeturina të përziera komunale gjatë periudhës 20 vjeçare të funksionimit. Madhësia minimale e deponisë së kërkuar është 7.5 ha, duke supozuar një lartësi maksimale deponimi prej 10 m dhe me densitet të ngjeshur mbeturinash prej 1 ton/ m^3. Duhet të theksohet se pas ndërtimit të impiantit TMB, sasitë e destinuara për deponim do të ulen ndjeshëm dhe vlerësohen në 14.5 mijë tonë në vitin 2035.

Deponia e re rajonale do të projektohet dhe funksionalizohet në përputhje me standardet e fundit teknike në mënyrë që të mbrojë shëndetin e njerëzve, të parandalojë shqetësimet, të mbrojë ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore nga ndotja dhe të minimizojë emetimin në ajër të metanit.

6.7.3 Kostot e ndërlidhura

Vlerësimet paraprake për ndërtimin e deponisë rajonale të mbeturinave janë paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela 60Vlerësimet e kostove të investimeve në deponi

Përbërësit e kostove	Vlera, mijë €
Tokë	-
Ndërtesat e punimeve civile dhe infrastruktura e përbashkët	2,433
Punimet civile Qelia 1	2,979
Mekanike	2,864
Automjetet	1,972
Kostot totale të investimit	10,248

Kostot e mësipërme nuk përfshijnë mbylljen e deponisë ekzistuese.

Kostot vjetore operacionale janë vlerësuar në 1,066 mijë € për vitin e parë të operimit dhe ulen pas ndërtimit të impiantit TMB.

6.7.4 Mbyllja e deponive të vjetra

Në territorin e komunave ende janë 67 deponi ilegale. Tabela e mëposhtme paraqet dispozitat për mbylljen e deponive të vjetra.

Tabela 61Dispozitat për mbylljen e deponive ilegale, në EUR

Komuna	2023	2024	2025	2026	2027	Gjithsej, EUR
Pejë	30,000	25,000	22,500	22,500	20,000	120,000
Istog	30,000	25,000	22,500	22,500	20,000	120,000
Klinë	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	25,000
Deçan	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	50,000
Gjithsej	**75,000**	**65,000**	**60,000**	**60,000**	**55,000**	**315,000**

Burimi: planet komunale për menaxhimin e mbeturinave

Në planet e tyre të menaxhimit të mbetuirnave komunale, të gjitha komunat parashikojnë fonde për mbylljen graduale të të gjitha deponive në territorin e tyre deri në vitin 2027. Prandaj, aktivitetet që kanë të bëjnë me mbylljen e deponive nuk janë të përfshira në Planin e Veprimit të këtij PNMIM.

6.8 Skenarët për zhvillimin e një sistemi të integruar të menaxhimit të mbeturinave

Ky seksion shqyrton disa opsione të ndryshme, në mënyrë që të identifikojë shkallën e mundshme të kostove dhe përfitimeve që mund të rezultojnë nga skenarë të ndryshëm të riciklimit dhe trajtimit më intensiv në ZMM.

6.8.1 Formulimi i skenarëve për sistemin e ardhshëm të menaxhimit të mbeturinave komunale

Skenarët për zhvillimin e sistemit të ardhshëm të menaxhimit të integruar të mbeturinave janë formuluar si kombinim i alternativave të ndryshme për operacionet individuale të menaxhimit të mbeturinave, të shqyrtuara në seksionet e mëparshme,

Tabela më poshtë paraqet grupimin e opsioneve të mundshme të sistemit.

Tabela 62Opsionet për sistemin e integruar të menaxhimit të mbeturinave komunale

Elementet e Sisitemit	Opsioni 1	Opsioni 1a	Opsioni 2	Opsioni 3	Opsioni 4	Opsioni 5
Grumbullimi i mbeturinave të përziera[31]	Sistemi aktual i grumbullimit i bazuar në kontejnerë 1.1 m³ dhe shporta individuale 240 l	Sistemi aktual i grumbullimit i bazuar në kontejnerë 1.1 m³ dhe shporta individuale 240 l	Sistemi aktual i grumbullimit i bazuar në kontejnerë 1.1 m³ dhe shporta individuale 240 l	Sistemi aktual i grumbullimit i bazuar në kontejnerë 1.1 m³ dhe shporta individuale 240 l	Sistemi aktual i grumbullimit i bazuar në kontejnerë 1.1 m³ dhe shporta individuale 240 l	Sistemi aktual i grumbullimit i bazuar në kontejnerë 1.1 m³ dhe shporta individuale 240 l
Mbledhja e ndaras e mbeturinave	Shporta individuale plastike 240 l për ambalazhim të përzier dhe kontejnerë Igloo 1.5 m³ për qelq	Sistemi për sjelljen e mbeturinave me kontejnerë të llojit Igloo me ngjyra 3x1.5 m³	Shporta individuale plastike 240 l për ambalazhim të përzier dhe kontejnerë Igloo 1.5 m³ për qelq	Shporta individuale plastike 240 l për ambalazhim të përzier dhe kontejnerë Igloo 1.5 m³ për qelq	Shporta individuale plastike 240 l për ambalazhim të përzier dhe kontejnerë Igloo 1.5 m³ për qelq	Shporta individuale plastike 240 l për ambalazhim të përzier dhe kontejnerë Igloo 1.5 m³ për qelq
Transferimi dhe transporti	ST pa ngjeshje në Istog , transport direkt për komunat tjera	ST pa ngjeshje në Istog , Klinë dhe Deçan (që shërben edhe Junikun)	Transport direkt, pa stacione transfer	ST pa ngjeshje në Istog , Klinë dhe Deçan (që shërben edhe Junikun)	Transport direkt, pa stacione transfer	ST me ngjeshje në Istog dhe Deçan. Transport direkt për Klinë
Klasifikimi i mbeturinave	Objekt i centralizuar për klasifikim në Pejë	Objekt i centralizuar për klasifikim në Pejë	Objekt i centralizuar për klasifikim në Pejë	Objekt i centralizuar për klasifikim në Pejë	Instalime individuale të klasifikimit me kapacitet të vogël në Pejë, Istog , Klinë dhe Deçan	Objekt i centralizuar për klasifikim në Pejë
Kompostimi i mbeturinave të gjelbra	Vend për kompostim në Pejë, pajisje mobile kompostimi për	Vend për kompostim në Pejë, pajisje mobile kompostimi	Vend për kompostim në Pejë, pajisje mobile kompostimi për	Vend për kompostim në Pejë, pajisje mobile	Vend për kompostim në Pejë, pajisje mobile kompostimi për Istog , Klinë,	Vend për kompostim në Pejë, pajisje mobile

[31] Distanca të ndryshme transporti në varësi të disponueshmërisë së stacionit të transferit në komunat përkatëse

Elementet e Sisitemit	Opsioni 1	Opsioni 1a	Opsioni 2	Opsioni 3	Opsioni 4	Opsioni 5
	Istog , Klinë, Deçan dhe Junik	për Istog , Klinë, Deçan dhe Junik	Istog , Klinë, Deçan dhe Junik	kompostimi për Istog , Klinë, Deçan dhe Junik	Deçan dhe Junik	kompostimi për Istog , Klinë, Deçan dhe Junik
Kompostimi shtëpiak	Të gjitha zonat rurale	Të gjitha zonat rurale	Të gjitha zonat rurale	Të gjitha zonat rurale	Të gjitha zonat rurale	Të gjitha zonat rurale
Mbeturinat organike	Objekti për djegje anaerobe në Pejë	Objekti për djegje anaerobe në Pejë	Objekti për djegje anaerobe në Pejë	Impianti i kompostimit brenda kontejnerëve të specializuar në Pejë	Objekti për djegje anaerobe në Pejë	Objekti për djegje anaerobe në Pejë
TMB	Impianti i centralizuar TMB	Impianti i centralizuar TMB	Impianti i centralizuar TMB	Impianti i centralizuar TMB	Impianti i centralizuar TMB	Impianti i centralizuar TMB
Deponitë	Deponia rajonale	Deponia rajonale	Deponia rajonale	Deponia rajonale	Deponia rajonale	Deponia rajonale

Të gjithë skenarët përmbajnë impiantin e centralizuar të TMB dhe deponinë rajonale që do të vendoset në deponinë ekzistuese në komunën e Pejës.

6.8.2 Krahasimi i kostove të skenarëve

Tabela më poshtë paraqet vlerën aktuale të kostove të investimit për secilin nga skenarët e konsideruar[32]

Tabela 63Vlera aktuale e kostove të investimit për skenarë të ndryshëm, mijë €

Operacioni i menaxhimit të mbeturinave	Opsioni 1	Opsioni 1a	Opsioni 2	Opsioni 3	Opsioni 4	Opsioni 5
Grumbullimi ndaras	5,604	5,604	7,190	5,604	5,459	5,604
Grumbullimi i mbeturinave të përziera	7,285	6,931	7,678	7,093	8,054	6,931
Transferimi i mbeturinave të përziera	371	1,143	-	701	-	2,113
Kompostimi i mbeurinave të gjelbra	818	818	818	818	818	818
Klasifikimi i mbledhjes ndaras	1,156	1,156	1,156	1,156	1,365	1,156
Trajtimi i mbeturinave të përziera (TMB)	5,726	5,726	5,726	5,726	5,726	5,726
TA ose kompostimi i mbeturinave ushqimore në kontejnerë të specializuar	1,392	1,392	1,392	1,077	835	1,392

[32]Vlera aktuale e aseteve është llogaritur për periudhën 2025 – 2035. Vlera e mbetur e aseteve është marrë në konsideratë.

Impianti KDM MpE	-	-	-	-	-	-
Deponia	11,200	11,200	11,200	11,200	11,200	11,200
Kostot totale të investimit	33,552	33,969	35,160	33,376	33,457	34,940

Kostot e vlerësuara operacionale për operacione të ndryshme të menaxhimit të mbeturinave në vitin e fundit të periudhës së planifikimit (2035) janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 64Kostot operative në vitin 2035 për skenarë të ndryshëm, mijë €

Operacioni i menaxhimit të mbeturinave	Opsioni 1	Opsioni 1a	Opsioni 2	Opsioni 3	Opsioni 4	Opsioni 5
Grubmullimi ndaras	1,331	1,331	1,793	1,331	1,181	1,331
Grumbullimi i mbeturinave të përziera	2,186	1,921	2,383	2,049	2,435	1,921
Transferimi i mbeturinave të përziera	131	310	-	222	-	416
Kompostimi i mbeturinave të gjelbra	393	393	393	393	393	393
Kompostimi shtëpiak	334	334	334	334	334	334
Klasifikimi i mbledhjes ndaras	677	677	677	677	982	677
Trajtimi i mbeturinave të përziera (TMB)	1,446	1,446	1,446	1,446	1,450	1,446
TA ose kompostimi i mbeturinave ushqimore në kontejnerë të specializuar	471	471	336	333	336	471
Impianti KDM MpE	286	286	286	286	286	286
Deponia	788	788	788	788	793	788
Kostot totale operacionale	7,910	7,824	8,438	7,861	8,192	7,930

Skenarët janë krahasuar gjithashtu bazuar në kostot e zbritura për njësi për ton të mbeturinave të gjeneruara.

Tabela 65Krahasimi i kostove të zbritura për njësi për ton mbeturinash të gjeneruara, për opsionet e ndryshme

Operacioni i menaxhimit të mbeturinave	Opsioni 1	Opsioni 1a	Opsioni 2	Opsioni 3	Opsioni 4	Opsioni 5
Grumbullimi ndaras						
Kostot e investimit	8.06	8.06	10.34	8.06	7.85	8.06
Kostot operacionale	11.70	11.70	16.39	11.70	10.46	11.70
Kostot totale të grumbullimit ndaras	19.76	19.76	26.74	19.76	18.31	19.76
Mbledhja e mbeturinave të përziera						
Kostot e investimit	10.48	9.97	11.05	9.97	11.59	9.97
Kostot operacionale	26.20	23.06	28.70	23.06	29.15	23.06
Kostot totale të grumbullimit të mbetuinave të përziera	36.68	33.04	39.75	33.04	40.73	33.04
Transferimi i mbeturinave të përziera						

PNMIM, Rajoni i Dukagjinit

Operacioni i menaxhimit të mbeturinave	Opsioni 1	Opsioni 1a	Opsioni 2	Opsioni 3	Opsioni 4	Opsioni 5
Kostot e investimit	0.53	1.64	-	1.64	-	3.04
Kostot operacionale	1.59	4.07	-	4.07	-	5.35
Kostot totale të transferimit të mbeturinave	2.12	5.71	-	5.71	-	8.39
Mbledhja dhe kompostimi i mbeturinave të gjelbra						
Kostot e investimit	1.18	1.18	1.18	1.18	1.18	1.18
Kostot operacionale	4.46	4.46	4.46	4.46	4.46	4.46
Kostot totale të kompostimit të mbeturinave të gjelbra	5.64	5.64	5.64	5.64	5.64	5.64
Programi i kompostimit shtëpiak OPEX	*3.17*	*3.17*	*3.17*	*3.17*	*3.17*	*3.17*
Impianti i klasifikimit të mbeturinave të grumbulluara ndaras						
Kostot e investimit	1.66	1.66	1.66	1.66	1.96	1.66
Kostot operacionale	6.56	6.56	6.56	6.56	9.45	6.56
Kostot totale të impiantit të klasifikimit	8.22	8.22	8.22	8.22	11.41	8.22
Trajtimi i mbetjurinave të përziera (TMB)						
Kostot e investimit	8.24	8.24	8.24	8.24	8.24	8.24
Kostot operacionale	7.94	7.94	7.94	7.94	7.96	7.94
Kostot totale të TMB	16.18	16.18	16.18	16.18	16.20	16.18
Tretje anaerobe						
Kostot e investimit	2.00	2.00	2.00	1.55	1.20	2.00
Kostot operacionale	2.34	2.34	1.67	1.78	1.67	2.34
Kostot totale të TA	4.34	4.34	3.67	3.33	2.87	4.34
Kostot e rikuperimit të RDF/KDM	1.63	1.63	1.63	1.63	1.63	1.63
Deponia						
Kostot e investimit	16.11	16.11	16.11	16.11	16.11	16.11
Kostot operacionale	10.73	10.73	10.73	10.73	10.76	10.73
Kostot totale të deponisë	26.84	26.84	26.84	26.84	26.87	26.84
Totalet						
Kostot totale të investimit	48.27	48.87	50.58	48.42	48.13	50.27
Kostot totale operatcionale	92.79	92.13	97.73	91.57	95.17	93.41
Kostot totale	141.06	141.00	148.31	139.99	143.31	143.68
Të hyrat totale	12.49	12.49	12.49	12.49	12.49	12.49
Kostot neto	127.90	127.84	135.82	127.50	130.81	130.52

Duke marrë parasysh krahasimin e kostos së mësipërme, Skenari 3 rekomandohet për t'u zhvilliuar në të ardhmen. Megjithatë, duhet theksuar se të gjithë skenarët kanë kosto të krahasueshme për ton dhe të gjitha janë të mundshëm për zbatim.

6.9 Menaxhimi i fraksioneve tjera të mbeturinave

6.9.1 Mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit

Ndarja e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit (MNRr) dhe shmangja e tyre nga deponia e ardhshme është shumë e rëndësishëm për t'i ikur shterimit të shpejtë të kapaciteteve deponuese në deponi. Për më tepër, mbeturinat ndërtimore mund të përmbajnë substanca të rrezikshme, si azbesti dhe llaqet, të cilat janë burime të mundshme të rreziqeve shëndetësore nga thithja e grimcave të pluhurit dhe ndotja e ujërave nëntokësore.

Lloje të ndryshme mbeturinash po gjenerohen në punishte ndërtimi komunale dhe private, si: (i) dheu nga gërmimi; (ii) mbeturinat e ndërtimit (mbeturinat minerale, tulla, dru); dhe (iii) mbeturinat nga rrënimi (tulla, beton, mobilieri, qelq i sheshtë, plastikë, asfalt).

MNRr ka potencialin për t'u ricikluar si material dytësor. Llojet kryesore të MNRr që duhet të synohen për riciklim janë:

- Betoni dhe betoni i armuar;
- Asfaltobetoni;
- Qeramika për ndërtim (tulla, etj);
- Materiale shkëmbore të thyera; dhe
- Mbeturinat minerale (inerte).

Të dhënat tregojnë se këto pesë lloje përbëjnë 80-85% të sasisë totale të MNRr-ve të gjeneruara. Pjesa mbizotëruese në mbeturinat e ndërtimit, si betoni dhe tulla, pas imtësimit, është i përshtatshëm për t'u përdorur në ndërtimin e rrugëve në vend të burimeve parësore si zhavorri dhe rëra. Në varësi të cilësisë fillestare të betonit, ai mund të ripërdoret edhe për të njëjtat qëllime ndërtimi. Më shpesh, betoni i ricikluar mund të përdoret për përforcimin e dheut, barrierat mbrojtëse nga zhurma, argjinaturat, materialet kulluese, rrugët e përkohshme, objektet sportive etj.

Zhvillimi i sistemit të integruar të menaxhimit të mbeturinave në rajonin e Dukagjinit duhet të përfshijë një sistem për menaxhimin e mbeturinave të ndërtimit, në përputhje me dispozitat e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbeturinave nga Ndërtimi dhe Rrënimi (PKMMNRr.

Sasitë e MNRr-ve në Rajonin e Dukagjinit
Tabela e mëposhtme paraqet sasitë e MNRr -ve të vlerësuara të gjeneruara nga rajoni dhe nga secila komunë në periudhën 2026 dhe 2030.

Tabela 66Sasitë e MNRr-ve në Rajonin e Dukagjinit

Komuna	2026	2030
Pejë	22,387	27,008
Istog	13,309	16,077
Klinë	10,832	13,076
Deçan	2,010	2,384
Junik	390	465

Komuna	2026	2030
Totali	**48,928**	**59,010**

Burimi: PKMMNRr

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbeturinave të Ndërtimit dhe Rrënimit (PKMMNRr) vlerëson se sasitë e MNRr-ve të gjeneruara në Rajonin e Dukagjinit prej 59,010 tonë në vitin 2030, ose 71,045 m³.

Pajisjet për grumbullim dhe transport
Tabela më poshtë paraqet pajisjet e nevojshme për rajonin për grumbullimin dhe transportin e MNRr-ve.

Tabela 67Pajisjet për grumbullim dhe transport të MNRr-ve

Lloji i pajisjeve	Rajoni i Dukagjinit
Kontejnerë skip (7 m³)	7
Kamionë të llojit skip ngarkues	2
Kamionë për transportimin dhe shkarkimin e mbeturinave të vëllimshme	1

Burimi: PKMMNRr

Pikat e hedhjes (PeH)
Duhet të krijohet një rrjet i pikave të hedhjes, ku MNRr do të mblidhet dhe ruhet, përpara se të transportohet në objektet qendrore të trajtimit dhe deponimit. PeH parashikohet të ketë një sipërfaqe prej 2000 ~ 4000 m². Grumbulluesit e MNRr-ve do t'i hedhin mbeturinat në kontejnerët e hapur përkatës. Vlen të theksohet se PKMMNRr parasheh ngritjen e pikave të hedhjes në territorin e komunës së Pejës, Istogut dhe Klinës. Megjithatë, një PeH e tillë nevojitet edhe për komunën e Deçanit. PeH e Deçanit mund t'i shërbejë edhe komunës së Junikut.

Nevoja për PeH paraqitet në tabelën më poshtë.

Tabela 68Rrjeti i pikave të hedhjes

Komunat	Numri i PeH	Kapaciteti (m³/vit)	Numri i kontejnerëve të nevojshëm
Pejë (duke shërbyer edhe Deçanin dhe Junikun)	1 (e mesme)	5,400	6 (20 m³)
Istog	1 (e mesme)	2,900	9 (7 m³)
Klinë	1 (e mesme)	2,400	7 (7 m³)
Deçan	1 (e mesme)	2,400	7 (7 m³)

Çdo pikë e hedhjes do të jetë e pajisur me ngarkuesin me rrëshqitje.

Riciklimi i MNRr-ve
Për rajonin është parashikuar një objekt riciklimi, i pajisur me një dërrmues të lëvizshëm. Kapaciteti i objektit të riciklimit vlerësohet në 12,800 m³/vit. Vendi do të duhet të sigurojë: (i) zonë për thërmimin dhe ndarjen e fraksioneve nga MNRr; dhe (ii) zonë për ruajtjen e fraksioneve të ndara të gatshme për ripërdorim. Sipërfaqja e kërkuar është rreth 3000 m². Të paktën 800 m² e kësaj zone duhet të mbulohet me beton. Pjesa që nuk është e përdorshme mund të transferohet në deponinë rajonale dhe mund të përdoret si material mbulues si nënshtresa.

Vendi(et) duhet të pajiset me një thërrmues mobil (foto në të djathtë). Thërrmuesi i parashikuar është pajisje me kapacitet 50-70 tonë në orë për të përpunuar të gjitha fraksionet e mundshme të MNRr - beton, beton i gazuar, tulla etj. Madhësia grimcave që dalin mund të rregullohet me sitë. Duke qenë i transportueshëm, thërrmuesi mund të transferohet me një rimorkio nëpër vendet\pikat e hudhjes për riciklimin e MNRr-ve. Për më tepër, thërrmuesi mund të transportohet në punishtet aktive të ndërtimit me kërkesë të kompanive private të ndërtimit. Ky është një shërbim i mundshëm që mund të ofrohet nga operatori i objektit të riciklimit.

Figure 26. Thërrmuesi për MNRr

Për të rritur efektivitetin, autoritetet lokale mund të kërkojnë, për projekte më të mëdha ndërtimi, ndarjen e materialeve të ricikluesshme që duhet të kryhen nga kompanitë e ndërtimit në vendpunishte.

Deponimi i MNRr-ve

Sa i përket deponimit, 15% e inputit në objektet e riciklimit pritet të deponohet. Përveç kësaj, 30% e MNRr-ve që nuk mblidhet në sistemin e grumbullimit ndaras pritet të arrijë edhe në objektin e deponimit. Për të gjithë ZMM-në parashikohet një objekt deponimi me kapacitet vjetor prej 19,300 m³.

Menaxhimi i asbestit

Sasi të asbestit të të mbledhur veçmas do të hidhen në një qeli të veçantë për mbeturinat e rrezikshme në deponi. Për të gjithë ZMM-në, llogaritet se sasitë vjetore të asbestit që do të deponohen arrijnë në 500 m³.

Kostot e menaxhimit të MNRr

Kostoja e menaxhimit në të ardhdhmen të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit të shkaktuara në objekt nuk duhet të jetë pjesë e llogaritjes së tarifave shtëpiake. Në vend të kësaj, kostoja duhet të mbulohet/paguhet plotësisht nga përdoruesit e objektit.

Kostot e investimeve të nevojshme për vendosjen e sistemit të menaxhimit të MNRr-ve ndërkomunale në ZMM janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 69Kostot e investimit për menaxhimin e MNRr-ve

Kategoria	Njësia	Kosto për njësi	Nr i njësive	Vlera, EUR
Pajisjet për grumbullimin e mbeturinave				**439,000**
Kontejnerë skip 7 m³	EUR/kontejner	2,000	7	14,000
Kamion për mbeturina me hapje të krahu	EUR/kamion	150,000	2	300,000
Kamionë të hapur	EUR/kamion	125,000	1	125,000
Pikat e hedhjes				**812,000**
PeH mesatare	EUR/PeH	150,000	4	600,000
Kontejnerë skip 7 m³	EUR/kontejner	2,000	16	32,000
Kontejnerë skip 20 m³	EUR/kontejner	10,000	6	60,000
Ngarkues me rrëshqitje	EUR/ngarkues	40,000	3	120,000
Impiantet e trajtimit të MNRr-ve				**1,210,000**
Thërmues mobil	EUR/thërmues	200,000	1	200,000
Objekti i riciklimit	Punime	1,010,000	1	1,010,000
objekti i deponimit të MNRr-ve				**1,500,000**
Objekti për deponim	Punime	1,500,000	1	1,500,000

Kategoria	Njësia	Kosto për njësi	Nr i njësive	Vlera, EUR
Kontingjent	*10% e kostos së investimit (përjashtuar pajisjet mobile)*			*296,000*
Dizajn & Mbikëqyrje	*4.5% e kostos së investimit (përjashtuar kostot e arkëtuara)*			*151,740*
TOTALI				**4,430,490**

6.9.2 Mbeturinat e vëllimshme

Praktika ndërkombëtare tregon se sasia e mbeturinave të vëllimshme është në përpjesëtim me sasinë e mbeturinave komunale të gjeneruara - rreth 5%.

Llojet kryesore të mbeturinave të vëllimshme janë orenditë e vjetra, duke përfshirë dyshekët, pajisjet e mëdha elektrike, mbulesat e dyshemesë dhe të ngjashme. Disa mbeturina të vëllimshme mund të shfaqen gjithashtu si mbeturina ndërtimi dhe demoëimi dhe si mbeturina kopshti.

Mënyrat kryesore për grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme përfshijnë:

- Hedhja e mbeturinave të vëllimshme afër kontejnerëve për mbeturina të përziera pasuar nga grumbullimi i organizuar nga komuna (sistemi aktual). Një grumbullim i tillë mund të bëhet sipas planit të përcaktuar paraprakisht i cili kërkon që familjet të hedhin mbeturinat e vëllimshme në ditët specifike të muajit.
- Hedhja në oborret e riciklimit ose në pika të tjera grumbullimi komunale të përcaktuara për këtë.
- Grumbullimi sipas kërkesës.

Për më tepër se çka u tha më lart, një pjesë e mbeturinave të vëllimshme mund të mblidhet përmes zinxhirëve të shitjes me pakicë kur dyqanet ofrojnë kthimin e mobiljeve ose pajisjeve të vjetra në momentin e shitjes.

Masat fillestare për mbeturinat e vëllimshme do të fokusohen në skemën e shërbimit të grumbullimit të organizuar nga komunat. Përveç kësaj, familjeve do t'ju ofrohet gjithashtu mundësia për të dorëzuar mbeurinat e tyre të vëllimshme në oborret e centralizuara të riciklimit.

Figure 27. Pikë grumbullimi për mbeturinat e vëllimshme

Çmontimi i mbeturinave të vëllimshme dhe largimi i materialeve të riciklueshëm do të organizohet fillimisht në deponinë rajonale dhe më vonë në TMB. Vendi do të pajiset gjithashtu me grirëse për të reduktuar volumin e mbeturinave të vëllimshme të destinuara për rikuperimin dhe deponimin përfundimtar. Disa çmontime paraprakisht mund të organizohen edhe në stacionet e transferit.

Në një periudhë afatgjatë, grumbullimi i mbeturinave të vëllimshme do të shqyrtojë mundësinë e riparimit dhe ripërdorimit të orendive dhe pajisjeve të vjetra të hedhura. Praktikat e mëposhtme do të promovohen:

- dhurimi për qëllime bamirësie i orendive të vjetra dhe pajisjeve elektroshtëpiake të përshtatshme për ripërdorim.
- grumbullim nga/dorëzim tek tregtarët e mallrave të përdorura.
- dhurata ose shitja tek palët e treta si një iniciativë private (p.sh. nëpërmjet faqeve të shitjeve në internet).
- dhënia si dhurata palëve të treta (familje, miq, të njohur).
- themelimi i qendrës rajonale për riparimin e orendive të vjetra dhe pajisjeve elektrike me mbështetjen e mundshme të sektorit joqeveritar dhe përfshirjen e personave nga grupet e cenueshme.

6.9.3 Fraksionet e veçanta të mbeturinave

Pasi që skemat e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (PZP) të funksionalizihet plotësisht në vend, komunat në ZMM do të lidhin kontrata me operatorët PZP për grumbullimin ndaras të fraksioneve specifike të mbeturinave në vijim:

- Mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike
- Vajra të përdorura
- Automjetet e hedhura dhe mbeturinat e tyre
- Bateritë dhe akumulatorët e harxhuar
- Goma të shpenzuara

Oborret e riciklimit do të krijohen në 5 qendrat komunale në ZMM. Amvisëritë do të lejohen të hedhin aty fraksione të ndryshme të mbledhura ndaras si lloje të ndryshme mbeturinash të riciklueshme, mbeturina të gjelbra, mbeturina të vëllimshme, vajra ushqimorë të përdorur, lloje specifike të mbeturinave ndërtimore dhe rrënimit. Oborret e riciklimit do të pajisen gjithashtu për grumbullimin e mbeturinave të rrezikshme shtëpiake.

Figure 28. Oborr tipik riciklimi

Lokacionet e OR në të pesë komunat tashmë janë identifikuar. Sipërfaqet e disponueshme të OR-ve lejojnë krijimin e qendrave për grumbullimin e fraksioneve të veçanta të mbeturinave të synuara.

6.9.4 Mbeturinat bujqësore

Edhe pse bujqësia është një aktivitet i rëndësishëm ekonomik në Rajonin e Dukagjinit, nuk ka informacion se si menaxhohen aktualisht mbeturinat nga aktivitetet bujqësore. Menaxhimi i mbeturinave bujqësore duhet të ndjekë parimin “ndotësi-paguan”, që do të thotë se gjeneruesit e mbeturinave bujqësore duhet të jenë përgjegjës për menaxhimin e tyre dhe duhet të mbulojnë kostot e menaxhimit.

Gjenerohen katër lloje të mbeturinave bujqësore:

- Mbeturinat e indeve bimore
- Nënproduktet e kafshëve
- Pleh organik

- Mbeturinat agrokimike

Mbeturinat e indeve bimore
Mbeturinat e indeve bimore janë në fakt biomasa të cilat janë burim i rinovueshëm dhe që mund të shkaktojë probleme kur nuk përdoret. Rritja e shpejtë e vëllimit dhe e llojeve të mbeturinave të biomasës bujqësore mund të bëhet një problem në rritje, pasi biomasa bujqësore e mbeturinave të kalbura lëshon metan dhe rrjedhje, dhe djegia e hapur nga fermerët për të pastruar tokat gjeneron CO_2 dhe ndotës të tjerë duke përbërë rrezik për pronën rurale. Prandaj, kërkohet menaxhimi i duhur i mbeturinave të biomasës bujqësore për të parandaluar ato të kontribuojnë në ndryshimet klimatike, ndotjen e ujit dhe tokës, dhe ndotjen e ajrit. Për më tepër, këto mbeturina janë me vlerë të lartë për sa i përket rikuperimit të materialit, lëndëve ushqyese dhe energjisë.

Menaxhimi i biomasës bujqësore duhet të ndjekë hierarkinë e menaxhimit të mbetjurinave. Preferenca duhet t'i jepet riciklimit. Kompostimi është një teknologji e përshtatshme për shumicën e mbeturinave të indeve bimore. Është i mundur të bëhet kompostimi bashkë me mbeturinat e gjelbra komunale. Megjithatë, nëse kapacitetet e impianteve të ardhshme të kompostimit në Rajonin e Dukagjinit lejojnë pranimin e mbeturinave bujqësore, gjeneruesit e këtyre të fundit duhet të paguajnë koston e plotë të trajtimit.

Mbeturinat nga bujqësia mund të jenë burim për industrinë përpunuese. Simbioza industriale mund të mbështetet duke krijuar një platformë elektronike me sasitë e disponueshme/të parashikuara të mbeturinave bimore që do të gjenerohen sipas llojit dhe vendndodhjes.

Kur riciklimi dhe përdorimi i biomasës si material për industrinë nuk janë opsione, atëherë duhet të ndiqet rikuperimi i energjisë.

Nënproduktet e kafshëve (NeK)
Në nivel shtetëror, një objekt qendror për trajtimin e mbeturinave të NeK-ve është ndërtuar afër Prishtinës. Megjithatë, objekti i trajtimit nuk është ende funksional. Pasi të jetë në funksion, do të jetë në gjendje të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe trajtimit për të gjithë prodhuesit e NeK-ve në mbarë vendin. Ndërkohë deponimi i NeK-ve është i vetmi opsion, me kusht që të kryhet në venddepontë epërcaktuara nga autoritetet kompetente.

Plehu organik
Përqendrimi total i materialeve inerte të plehut organik është karakteristika kryesore që tregon se si mund të trajtohet materiali. Plehrat e kafshëve mund të klasifikohen si inerte, gjysmë inerte ose të lëngshëm. E para përmban më shumë se 20% lëndë inerte (mund të grumbullohet dhe trajtohet nga çdo pajisje që lëviz materialet e vëllimshme), gjysmë inerte përmban 5 deri në 20% lëndë inerte, prodhohet në sistemet shtëpiake të bagëtive ku ku ofrohet një system i limituar sanitar dhe nuk rrjedh aq lehtë sa plehu i lëngshëm dhe as nuk mund të grumbullohet si plehu organik inert. Plehrat e lëngshme përmbajnë më pak se 5% lëndë inerte – lëngu shtesë vjen nga larja dhe derdhja nga sistemet e ujitjes – dhe, kur trazohet, mund të pompohet ose lëvizet nga rrjedha e gravitetit.

Katër lloje të menaxhimit janë të disponueshme për plehun e kafshëve: magazinimi, aplikimi në tokë, kompostimi dhe tretja anaerobe.

Mbeturinat agrokimike
Disa mbeturina nga aktivitetet bujqësore mund të jenë të rrezikshme, duke përfshirë pesticidet dhe herbicidet e vjetra, si dhe lubrifikantët që mund të jenë përdorur në pajisjet e fermës. Mbeturinat e tilla kërkojnë menaxhim të veçantë. Ekzistojnë opsione për riciklimin e lubrifikantëve të përdorur në lubrifikantë të rinj.

Megjithatë, në të gjitha rastet e tjera, lubrifikantët, pesticidet dhe herbicidet e përdorura duhet të trajtohen në një incenerator të projektuar siç duhet; për këtë qëllim mund të merret parasysh mundësia e përdorimit të një furre ekzistuese të çimentos (siç bëhet në shumë vende të BE-së, ku furra duhet të plotësojë disa kushte teknike dhe të lejohet për këtë përdorim). Nëse trajtimi nuk është i realizueshëm, këto mbeturina duhet të ruhen ose hidhen në

mënyrë të sigurtë në objekte që plotësojnë normat e pranuara ndërkombëtarisht derisa të identifikohen objektet e duhura të trajtimit. Një strukturë shtetërore për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme parashikohet nga SKMIM, e cila do të ofrojë mundësi dhe zgjidhje të sigurtë magazinimi për këto lloj mbeturinash.

6.10 Opsionet për ndritjen institucionale dhe organizative

Tashmë është vendosur që deponia e përmirësuar rajonale në Sferkë të operohet nga Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK). Megjithatë, për aktivitetet e tjera të menaxhimit të mbeturinave janë të disponueshme opsione të ndryshme për aranzhime operacionale.

6.10.1 Grumbullimi i mbeturinave

Tri opsionet e mëposhtme janë në dispozicion të komunave në lidhje me grumbullimin e mbeturinave:

- **Opsioni 1: Ruajtja e situatës aktuale** . Sipas këtij opsioni, KRU Ambienti do të vazhdojë të ofrojë shërbime për grumbullimin e mbeturinave për komunat e Pejës, Istogut dhe Klinës, ndërsa Deçani do të shërbehet nga kompania e saj komunale Higjiena, dhe Juniku do të vazhdojë me aranzhime vetanake.
- **Opsioni 2: Ofrimi i shërbimit nga KRU** . Sipas këtij opsioni, KRU do të ofronte shërbimin për të pesë komunat me qëllim të uljes së kostove të përgjithshme të grumbullimit të mbeturinave duke përfituar nga ekonomia e shkallës.
- **Opsioni 3: Prokurimi i shërbimit tek operator(ët) privat** . Ngjashëm me rajonet e tjera në vend, komunat do të prokuronin shërbimin e grumbullimit të mbeturinave tek për operatorët privatë.

Tabela më poshtë paraqet avantazhet dhe disavantazhet e të 3 opsioneve.

Tabela 70Avantazhet dhe disavantazhet e opsioneve për grumbullimin e mbeturinave

Opsioni	Avantazhet	Disavantazhet
Opsioni 1: Ruajtja e situatës aktuale	Pranueshmëria politike Nuk ka nevojë për ndonjë ndryshim në sistem Kënaqshmëria aktuale me cilësinë e shërbimit të marrë	Pamundësia për të përfituar nga ekonomia e shkallës që rezulton nga përdorimi i pajisjeve të përbashkëta të grumbullimit të mbeturinave dhe optimizimin e itinerarit
Opsioni 2: Ofrimi i shërbimit nga KRU	Komunat mund të përfitojnë nga ekonomia e shkallës që rezulton nga përdorimi i përbashkët i pajisjeve të grumbullimit të mbeturinave dhe optimizimi i itinerarit	Pranueshmëria politike nga komunat Deçan dhe Junik është e vështirë për shkak të kënaqshmërisë me aranzhimet e tyre aktuale
Opsioni 3: Prokurimi i shërbimit tek operator(ët) privat	Mundësi për t'u kontraktuar operatorë privatë me përvojë të dëshmuar në grumbullimin e mbeturinave urbane Në parim, operatorët privatë ka të ngjarë të ofrojnë shërbimin e grumbullimit të mbeturinave në mënyrë më efikase sesa operatorët komunalë.	Pranueshmëria politike nga të gjitha komunat është e vështirë për shkak të kënaqshmërisë me aranzhimet e tyre aktuale

Opsioni	Avantazhet	Disavantazhet
	Komuna e Junikut tashmë punon me një operator privat.	

Siç shihet nga analiza e mësipërme, të tre opsionet kanë avantazhet e tyre. Megjithatë, opsioni i vetëm që mund të kënaqë të gjitha komunat është Opsioni 1. Është i vetmi opsion që mund të pranohet politik kryesisht për dy arsye: së pari nuk çon në ndonjë ndryshim në aranzhimet aktuale; dhe së dyti, të gjitha komunat janë të kënaqura me cilësinë e shërbimit të marrë aktualisht. Prandaj, opsioni 1 është opsioni i preferuar.

6.10.2 Transferimi i mbeturinave

Analiza teknike e opsioneve për transferimin e mbeturinave ka vërtetuar se stacionet e transferit janë të arsyeshme për komunat Istog dhe Deçan (që do t'i shërbente edhe Komunës së Junikut). Lidhur me funksionimin e stacioneve të transferit, dy opsionet e mëposhtme janë në dispozicion të komunave:

- **Opsioni 1: Stacionet e transferit do të menaxhohen nga KMDK** . KMDK u krijua me qëllim të menaxhimit të venddeponive të mbeturinave në vend. Megjithatë, ajo ka fituar përvojë në menaxhimin e stacionit të transferit edhe në Ferizaj .
- **Opsioni 2: Stacionet e transferit të operohen nga komunat** . Sipas këtij opsioni, stacionet e transferit do të menaxhohen nga komunat përkatëse sipas marrëveshjeve që komunat do të arrijnë. Komuna e Istogut mund të vendos të themelojë/caktojë një entitet komunal si operator, ose në mënyrë alternative që të zgjedhë KRU Ambienti të menaxhojë ST. Në mënyrë të ngjashme, Komuna e Deçanit mund të vendosë për transferimin e menaxhimit të ST në kompaninë e saj komunale Higjiena , ose të prokurojë shërbimet e një operatori privat.

Tabela më poshtë paraqet avantazhet dhe disavantazhet e të dy opsioneve.

Tabela 71Avantazhet dhe disavantazhet e opsioneve për transferimin e mbeturinave

Opsioni	Avantazhet	Disavantazhet
Opsioni 1: Stacionet e transferit do të operohen nga KMDK	Eksperiencë e disponueshme në operacionalizimin e stacioneve të transferit dhe objekteve tjera të menaxhimit të mbeturinave (deponi)	Kontribuon në krijimin e një monopoli të shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave. Mungesa e mundshme e transparencës në lidhje me sasitë e mbeturinave të transferuara dhe të deponuara.
Opsioni 2: Stacionet e transferit të operohen nga komunat	Kompanitë e disponueshme të grumbullimit të mbeturinave të cilat mund të ndërmarrin shërbimin e transferit të mbeturinave. Kontribuon në transparencën e sasive të mbeturinave të transferuara dhe të deponuara	Mungesa e përvojës lokale në operacionalizimin e stacioneve të transferit.

Stacionet e transferit nuk do të jenë objekte rajonale dhe ka kuptim që komunat të vendosin vetë se si do të funksionojnë ato. Opsioni 2 lejon transparencë më të madhe në lidhje me sasitë e mbeturinave të transferuara në deponinë rajonal dhe tarifën përkatëse për deponim. Prandaj, opsioni 2 është i preferueshëm.

6.10.3 Kompostimi i mbeturinave të gjelbra të grumbulluara ndaras

Analiza teknike e opsioneve për kompostimin e mbeturinave të gjelbra të grumbulluara ndaras ka vërtetuar se modeli i decentralizuar është modeli i preferuar dhe se objektet e kompostimit janë të arsyeshme për secilën komunë. Lidhur me funksionimin e impianteve të kompostimit, dy opsionet e mëposhtme janë në dispozicion të komunave, të ngjashme me opsionet për ST:

- **Opsioni 1: Objektet e kompostimit të menaxhohen nga KDMK** . KDMK u krijua me qëllim të menaxhimit të venddeponive të mbeturinave në vend dhe fitoi përvojë të konsiderueshme në menaxhimin e objekteve të mbeturinave.
- **Opsioni 2: Objektet e kompostimit të menaxhohen nga komunat** . Sipas këtij opsioni, objektet e kompostimit do të menaxhohen nga komunat përkatëse sipas marrëveshjeve që komunat do të arrijnë. Komunat e Pejës, Istogut dhe Klinës mund të vendosin të zgjedhin KRU Ambienti si operator të objekteve të kompostimit ose të prokurojnë shërbimet e një operatori privat. Në mënyrë të ngjashme, Komuna e Deçanit mund të vendosë për transferimin e menaxhimit të objektit të kompostimit tek kompania e saj komunale Higjiena, ose të prokurojë shërbimet e një operatori privat. Përndryshe, komunat mund të përdorin shërbimet e departamenteve të tyre përgjegjëse për mirëmbajtjen e hapësirave publike.

Tabela më poshtë paraqet avantazhet dhe disavantazhet e dy opsioneve.

Tabela 72Avantazhet dhe disavantazhet e opsioneve për kompostimin e mbeturinave të gjelbra të grumbulluara ndaras

Opsioni	Avantazhet	Disavantazhet
Opsioni 1: Objektet e kompostimit të menaxhohen nga KDMK	Përvojë e disponueshme në funksionimin e objekteve të menaxhimit të mbeturinave (deponitë dhe një stacion transferi) e centralizuar e cila mund të çojë në nivelizimin e kostove të shërbimeve në të gjitha komunat	Mungesa e përvojës në menaxhimin e objekteve të kompostimit Kontribuon në krijimin e një monopoli të shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave
Opsioni 2: Objektet e kompostimit të menaxhohen nga komunat	Kompanitë publike në dispozicion të cilat mund të ofrojnë shërbimin e kompostimit të mbeturinave të gjelbra Marrëveshje më të thjeshta në lidhje me mekanizmat e pagesës kur komunat vendosin të menaxhojnë objektet përmes departamenteve të tyre të mirëmbajtjes së zonave publike Rregullim më i thjeshtë për përdorimin e kompostit të gjeneruar	Mungesa e përvojës lokale në menaxhimin e objekteve të kompostimit ose objekteve tjera të trajtimit të mbeturinave

Objektet e kompostimit nuk do të jenë objekte rajonale dhe ka kuptim që komunat të vendosin vetë se si do të menaxhohen ato. Opsioni 2 lejon fleksibilitet më të madh në lidhje me marrëveshjet e pagesës dhe përdorimin e kompostit të gjeneruar. Prandaj, opsioni 2 është i preferueshëm.

6.10.4 Grumbullimi ndaras dhe klasifikimi i mbeturinave të ambalazhit

Rekomandohet që grumbullimi ndaras dhe klasifikimi i mëpasshëm i mbeturinave të ambalazhit të menaxhohet përmes skemave të ardhshme PZP. Arsyeja për këtë është se grumbullimi ndaras dhe klasifikimi i mbeturinave të ambalazhit do të sjellë një kosto shtesë, e cila do të çojë në rritjen e tarifave të menaxhimit të mbeturinave për amvisëritë. Operatorët aktualë të objektit(eve) të grumbullimit ndaras dhe klasifikimit do të kontraktohen përmes skemës PZP. Ka të ngjarë që ofruesit aktualë të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave në komuna të jenë gjithashtu të kontraktuar përmes skemës PZP për të kryer grumbullimin ndaras të mbeturinave të ambalazhit.

6.10.5 Operacionet e rikuperimit të mbeturinave

Për të arritur synimet e riciklimit dhe rikuperimit në rajon, analiza teknike e opsioneve për rikuperimin e mbeturinave arrin në konkludim se, përveç grumbullimit ndaras dhe klasifikimit të mbeturinave të riciklueshme, objektet e centralizuara TMB dhe DA duhet të krijohen jo më vonë se në vitin 2032. Lokacioni optimal i objekteve për rikuperimin e mbeturinave do të jetë afër Komunës së Pejës, duke qenë gjeneruesi më i madh i mbeturinave në Rajonin e Dukagjinit. Për sa i përket menaxhimit të dy objekteve, opsionet e mëposhtme janë në dispozicion të komunave:

- **Opsioni 1: Objektet e rikuperimit të mbeturinave të menaxhohen nga KDMK**. KDMK u krijua me qëllim të menaxhimit të venddeponive të mbeturinave në vend dhe fitoi përvojë të konsiderueshme në menaxhimin e objekteve të mbeturinave.
- **Opsioni 2: Objektet për rikuperimin e mbeturinave të menaxhohen nga Komuna e Pejës** . Sipas këtij opsioni, Komuna e Pejës do të jetë përgjegjëse për menaxhimin e objekteve për rikuperimin e mbeturinave. Komuna e Pejës mund të bëjë përzgjedhjen e KRU Ambienti si operator të objekteve të rikuperimit të mbeturinave ose të prokurojnë shërbimet e një operatori privat.

Tabela më poshtë paraqet avantazhet dhe disavantazhet e dy opsioneve.

Tabela 73Avantazhet dhe disavantazhet e opsioneve për rikuperimin e mbeturinave

Opsioni	Avantazhet	Disavantazhet
Opsioni 1: Objektet e rikuperimit të mbeturinave të menaxhohen nga KDMK	Përvojë e disponueshme në menaxhimin e objekteve të menaxhimit të mbeturinave (deponitë dhe një stacion transferi) Wasje e centralizuar e cila do të çonte në nivelizimin e kostove të shërbimeve në të gjitha komunat Më e lehtë për të ndërtuar kapacitetet e nevojshme për funksionimin e objekteve të tilla	Mungesa e përvojës në menaxhimin e objekteve të rikuperimit të mbeturinave Kontribuon në krijimin e një monopoli të shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave
Opsioni 2: Objektet për rikuperimin e mbeturinave të menaxhohen nga Komuna e Pejës	Kompanitë publike të disponueshme të cilat mund të ofrojnë shërbimet e rikuperimit të mbeturinave	Mungesa e përvojës lokale në menaxhimin e objekteve të trajtimit të mbeturinave Modeli i “komunës lider” mund të krijojë mungesë transparence në procedurat e funksionimit dhe tarifimit për komunat e tjera

Opsioni	Avantazhet	Disavantazhet
		Mund të mos jetë e lehtë të ndërtohet kapaciteti i KRU-së, nëse ky model zgjidhet nga Komuna e Pejës

Objektet e rikuperimit të mbeturinave do të jenë objekte rajonale dhe kjo ka kuptim që një kompani mbirajonale të ketë të drejtë të menaxhojë objekte të tilla,ngjashëm me modelin e menaxhimit të deponive rajonale. Përveç kësaj, SKMIM 2024-2035 rekomandon që KMDK-së t'i besohet menaxhimi i objekteve të rikuperimit të mbeturinave në nivel vendi. Do të ishte shumë më e lehtë të forcohej kapaciteti i KMDK-së për të menaxhuar të gjitha objektet e rikuperimit të mbeturinave në zona të ndryshme të menaxhimit të mbeturinave në vend. Prandaj, opsioni 1 është i preferuari.

6.11 Qëndrueshmëria financiare dhe përballueshmëria e shërbimeve

Sipas nenit 59 të Ligjit për Mbeturina, financimi i shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave sigurohet nga tarifat e mbeturinave për gjeneruesit e mbeturinave, si dhe nga burime të tjera si buxhetet komunale, buxheti qendror, grantet.

Financimi i grantit të BE-së sigurohet për (një pjesë) investimet që nuk mund të mbulohen nga tarifat e mbeturinave, duke rritur vazhdimisht pragun e përballueshmërisë. Granti i financuar nga BE kërkon që të hyrat nga tarifat e mbeturinave, të vendosura sipas parimit 'Ndotësi paguan' dhe që janë të përballueshme, të mbulojnë të paktën koston operacionale dhe ato të zëvendësimit në të ardhmen. Përballueshmëria lidhet me tarifat vetëm për amvisërinë, derisa entitetet juridike duhet të paguajnë koston e plotë në përpjesëtim me mbeturinat që gjenerojnë.

Përballueshmëria përkufizohet si çmimi që popullsia mund të paguajë pa rrezikuar aftësinë për të përmbushur nevojat e tjera bazë. Përballueshmëria është aftësia për të paguar, e cila vlerësohet nga të dhënat statistikore . Pragjet ei përballueshmërisë zakonisht përcaktohen në lidhje me të ardhurat monetare të disponueshme të familjes[33] (pas taksave dhe pagesave sociale). Në përgjithësi, për ekonomitë me të ardhura mesatare, siç është Kosova ,1% e të ardhurave familjare njihet si një prag i përballueshëm për tarifat e shërbimit të MKI.

ASK bën anketa për shpenzimet e ekonomive familjare, jo për të ardhurat e ekonomive familjare. Duke qenë se të ardhurat shpenzohen ose kursehen, ato janë më të larta se shpenzimet. Kështu, shpenzimet për tarifat e mbeturinave deri në 1% të shpenzimeve të familjeve janë të përballueshme. Anketa e shpenzimeve të ekonomive familjare të ASK-së[34] ka përcaktuar këtë nivel të shpenzimeve në vitin 2022:

Tabela 74Shpenzimet mesatare vjetore të familjeve, 2022

Shpenzimet vjetore	Mesatare	Zonë urbane	Zonë rurale
Familje	8,106 €	8,255 €	7,971 €
Për frymë	1,903 €	2,004 €	1,817 €

Për një familje mesatare prej 4.335, tarifa mujore e mbeturinave prej 6.8 € ishte e përballueshme në vitin 2022, që korrespondon me një pagesë mujore prej 1.6 € për person. Përballueshmëria e tarifave të mbeturinave rritet me rritjen e të ardhurave monetare. Mbi bazën e rritjes aktuale të BPV-së për frymë në vitin 2023 (12.3%[36]) dhe

[33] Zbatimi i Parimit 'Ndotësi paguan' në Projektet e Menaxhimit të Mbeturinave, JASPERS, f.6, https://jaspers.eib.org/knowledge/publications/application-of-the-polluter-pays-principle-in-waste-management-projects

[34] Rezultatet e Anketës Buxhetore të Ekonomive Familjare 2022

[35] 8106/1903=4.3 persona në një familje

[36] https://www.macrotrends.net/global-metrics/countries/XKX/kosovo/gdp-per-capita

vlerësimet për vitin 2024 (6%), dhe mbi supozimin se të ardhurat vjetore të BPV-së reale për frymë do të rriten me 3% (mbi inflacionin) deri në vitin 2035, bëhet parashikimi i mëposhtëm për rritjen konstante të çmimeve të përballueshmërisë së tarifave të mbeturinavederi më 2035 në një kondtante me çmimet e vitit 2024:

Tabela 75Parashikimi i përballueshmërisë së tarifave të mbeturinave, çmimet e vitit 2024

Tarifa e mbeturinave	2024	2025	2030	2035
Tarifë mujore e përballueshme për familje	8.0 €	8.5 €	9.6 €	11.1 €
Tarifë mujore e përballueshme për person	1.9 €	2.0 €	2.3 €	2.6 €

Për shkak të tendencës për zvogëlimin e madhësisë së familjes, tarifa për person duhet të jetë ajo kryesore për përcaktimin e përballueshmërisë së shërbimit.

Burimi i financimit të deponisë dhe investimi fillestar i objekteve të rikuperimit të ardhshëm, burimi i financimit të grumbullimit ndaras i materialeve të ricklueshme dhe kostoja neto e klasifikimit (pas shitjes së lëndëve të ricklueshme) kanë ndikimin kryesor në kostot dhe përballueshmërinë e sistemit për menaxhimin e mbeturinave të përziera. Kostot e opsioneve 1 (stacioni i transferit vetëm për Istogun), 1a (3 stacione transferi për të gjitha komunat) dhe opsioni 3 (2 stacione transferi për 3 komuna) janë pothuajse të njëjta, megjithatë opsioni 3 është opsioni me kosto më të ulët për arritjen e objektivave të strategjisë shtetërore për mbeturina.

Tabela e mëposhtme paraqet koston e plotë të opsionit 3, në krahasim me koston e sistemit me investimin fillestar të grantit në objektet rajonale të rikuperimit dhe deponimit, dhe më tej në lidhje me një sistem me PZP në vend. Kostot janë dhënë drejt vitit 2035, kur do të vendoset sistemi i plotë, ,me çmimet e vitit 2024[37], në lidhje me mbeturinat e grumbulluara[38].

Tabela 76Tarifa e kostos mesatare të rikuperimit drejt vitit 2035, çmimet e vitit 2024

Përbërësit e Kostos	Rimëkëmbje e plotë e kostos	Me grantin fillestar	Me grant dhe PZP
Grumbullimi i mbeturinave të përziera me kosto të plotë për ton të mbeturinave të mbledhura	46 €/t	46 €/t	46 €/t
Kostoja neto e grumbullimit ndaras dhe klasifikimit (më pak të hyra nga shitjet)	11 €/t	11 €/t	
Transferimi i mbeturinave të përziera	5 €/t	5 €/t	5 €/t
Kostoja e deponimit për ton të mbeturinave të grumbulluara (grant fillestar i konsideruar)	17 €/t	17 €/t	17 €/t
Kostoja fillestare e investimit për ngritjen e deponisë	18 €/t		
Kostoja operacionale e rikuperimit të mbeturinave për ton të mbeturinave të grumbulluara (neto)	23 €/t	23 €/t	23 €/t
Kostoja fillestare e investimit për objektet e rikuperimit	14 €/t		
Kostoja totale	134 €/t	102 €/t	90 €/t

[37] Parashikimi i inflacionit për 10 vjet nuk është i realizueshëm dhe gjithsesi do të sjellë rritje si të të ardhurave monetare ashtu edhe të kostove.

[38] Jo në lidhje me mbeturinat e krijuara, pasi një pjesë e mbeturinave nuk do të grumbullohet për shkak të kompostimit shtëpiak të mbeturinave të gjelbra.

Përbërësit e Kostos	Rimëkëmbje e plotë e kostos	Me grantin fillestar	Me grant dhe PZP
Mbeturinat vjetore 2035 të grumbulluara për person nga familjet (supozimi 75% e mbeturinave janë nga amvisëritë, 25% nga institucionet dhe entitetet juridikë)	0.284 t	0.284 t	0.284 t
Tarifë mujore për person (përfshirë 8% TVSH), 2035	3.4 €	2.6 €	2.3 €
Pragu i përballueshmërisë për tarifën mujore për person (2035)	2.6 €	2.6 €	2.6 €

Siç shihet nga tabela e mësipërme, sistemi nuk mund të jetë financiarisht i qëndrueshëm dhe i përballueshëm pa financim fillestar nga granti. Investimet e mëtejshme në mbylljen e qelive të deponisë dhe ndërtimin e qelive të reja, zëvendësimi i pajisjeve të amortizuara të sigurohet nga komunat nga rritja e tarifave të mbeturinave në përputhje me rritjen e përballueshmërisë. Pa sistemin PZP, tarifa për popullsinë duhet të vendoset në pragun e përballueshmërisë.

Për krahasim, tarifa mujore e vitit 2022 për person është shumë më e ulët. Të hyrat aktuale nga tarifat e mbeturinave për vitin 2022 janë përcaktuar në të dhënat e Raportit të Menaxhimit të Mbeturinave Komunale të AMMK-së për vitin 2022, Shtojca 3 për pagesat e mbledhura dhe të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë 2024[39] (rezultatet preliminare). Pagesa aktuale për person nga amvisëritë nga të gjitha komunat ishte e njëjtë, siç shihet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 772022, Pagesa aktuale për person

Parametrat	Pejë	Istog	Klinë	Deçan	Junik
Pagesa e arkëtuar për shërbime të amvisërive, 2022	875,587 €	351,352 €	316,528 €	294,457 €	41,100 €
Popullsia, Regjistrimi i vitit 2024	82,661	33,066	30,574	27,758	3,952
Pagesa aktuale mujore për person në vitin 2022	0.9 €	0.9 €	0.9 €	0.9 €	0.9 €

Prandaj, edhe me financimin e granteve dhe sistemin PZP në fuqi, tarifa e mbeturinave për popullatën duhet të rritet mbi 2 herë, mbi inflacionin për të financuar zhvillimin e shërbimit të mbeturinave. Rikuperimi i plotë i kostos duhet të arrihet gradualisht, brenda përballueshmërisë, hapat kryesorë që janë:

- Rikuperimi i plotë i kostos së nivelit aktual të kostove të justifikuara - grumbullimi i mbeturinave (kostot operacionale dhe të investimit) dhe kostot e transferimit dhe ato operacionale dhe mirëmbajtjes së deponisë.
- Rikuperimi i plotë i kostos së grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave (si investimi ashtu edhe operacionale) dhe kostot operacionale të riciklimit/rikuperimit të mbeturinave.
- Rikuperimi i plotë i kostos së grumbullimit, riciklimit/rikuperimit dhe deponimit të mbeturinave.

Tabela më poshtë përmbledh komponentin e kostos së shërbimit të mbeturinave sipas komunave në bazë të supozimit se investimi fillestar në ngritjen e deponisë dhe objekteve të rikuperimit të deponive do të sigurohet si grant dhe grumbullimi dhe klasifikimi i mbeturinave do të financohet përmes skemës PZP. Kështu kostot janë llogaritur në lidhje me mbeturinat e përziera të grumbulluara dhe menaxhuara nga komunat.

Tabela 78Tarifa e rikuperimit të kostos për mbeturinat e përziera, sipas komunave drejt vitit 2034

[39] Vlerësimet e ASK-së për popullsinë ishin më të larta, që do të nënkuptonte edhe të hyra aktuale më të ulëta për person.

Komponenti i Kostos dhe tarifa për amvisëritë	Pejë	Istog	Klinë	Deçan	Junik
Kostoja e plotë e grumbullimit të mbeturinave të përziera, për ton të mbeturinave të përziera të mbledhura	52 €/t	60 €/t	85 €/t	54 €/t	56 €/t
Kostoja e transferimit të mbeturinave të përziera, për ton mbeturina të përziera të mbledhura		19 €/t		22 €/t	23 €/t
Kostoja e deponimit, për ton mbeturina të përziera të mbledhura	20 €/t	22 €/t	21 €/t	20 €/t	22 €/t
Kostoja operacionale e rikuperimit të mbeturinave, për ton mbeturina të përziera të mbledhura	28 €/ton	29 €/t	33 €/t	32 €/t	26 €/t
Kostoja totale, për ton mbeturina të përziera të mbledhura	99 €/t	130 €/t	139 €/t	129 €/t	127 €/t
Mbeturinat e përziera të grumbulluara për person nga amvisërinë (supozimi se 75% e mbeturinave janë nga amvisëritë, 25% nga institucionet dhe entitetet juridike), 2035	0.255 t	0.192t	0.143t	0.145t	0.123t
Tarifa mujore për person (përfshirë 8% TVSH)	2.3 €	2.3 €	1.8 €	1.7 €	1.4 €
Pragu i përballueshëm 2035, tarifë mujore për person	2.6 €	2.6 €	2.6 €	2.6 €	2.6 €

Ndërsa kostoja për ton për Pejën është më e ulëta, pagesa mujore për person është më e larta për shkak të gjenerimit më të madh të mbeturinave. Kostoja për ton në deponi është e njëjtë për të gjitha komunat, megjithatë për shkak të dallimeve në përbërjen e mbeturinave, pjesë të ndryshme të mbeturinave shmangen nga grumbullimi ndaras, klasifikimi, kompostimi i mbeturinave të gjelbra, kështu që kostot për ton mbeturina të përziera ndryshojnë.

Krahasim shtesë është bërë për 3 komunat me transfer mbeturinash për opsionin e stacionit të transferit me ngjeshje dhe është paraqitur në tabelën e mëposhtme. Opsioni për stacionet e transferimit me ngjeshje është 85% më i shtrenjtë si kosto investimi dhe 30% më shumë si kosto operacionale në krahasim me opsionin pa ngjeshje, duke çuar në një kosto shtesë totale prej 50%.

Tabela 79 Kostoja e rikuperimit për mbeturinat e përziera me stacion transferi me ngjeshje, 2035

Përbërësit e kostos	Istog	Deçan	Junik
Kosto shtesë në rast ngjeshjeje në lidhje me mbeturinat e përziera të grumbulluara	10 €/t	11 €/t	11 €/t
Kostoja totale për ton mbeturina të përziera të grumbulluara	140 €/t	140 €/t	138 €/t
Mbeturinat e përziera të grumbulluara për person nga amvisëritë (supozimi se 75% e tyre janë mbeturina nga amvisëritë, 25% nga institucionet dhe entitetet juridikë), 2035	0.192	0.145	0.123
Tarifa mujore për person (përfshirë 8% TVSH)	2.4 €	1.8 €	1.5 €

Prandaj, nëse komunat preferojnë të kenë stacione transferi me ngjeshje, edhepse pak më të shtrenjta, janë të përballueshme. Gjithashtu, transporti i drejtpërdrejtë, megjithëse është pak më i shtrenjtë për transferimin e mbeturinave pa ngjeshje, është ende i përballueshëm.

6.12 Integrimi gjinor dhe përfshirja e grupeve të cenueshme

Menaxhimi i mbeturinave ka një ndikim të rëndësishëm në shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve, si dhe në cilësinë e mjedisit. Një sistem i avancuar i menaxhimit të mbeturinave kërkon kapacitete të fuqizuara profesionale,

njerëzore dhe financiare, një ndryshim në mentalitetin midis individëve, bizneseve dhe institucioneve, si dhe integrimin e një qasjeje transformuese gjinore.

Koncept Dokumenti për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave thekson shkurtimisht se ndikimet gjinore nuk ka gjasa të përfshihen për shkak të ndryshimeve minimale në sistemet ekzistuese. Ai thekson se gjinia është e integruar në mënyrë të pamjaftueshme në ligj dhe se qasja në punësim me pagesë në sektorin e mbeturinave shfaq paragjykime domethënëse gjinore. Një raport i fundit konstatoi se në institucionet e nivelit vendor nga 688 punonjës, 32.5% janë gra dhe 67.5% burra. Në nivel menaxherial, 31% janë gra dhe 69% janë burra[40].

Opsionet e propozuara marrin parasysh gjithashtu aspektet e barazisë gjinore dhe përfshirjen sociale. Situata aktuale tregon se në zonat ekzistuese të deponimit të mbeturinave nuk ka aktivitete informale të grumbullimit apo klasifikimit të mbeturinave. Megjithatë, sipas të dhënave të disponueshme në nivel shtetëror, sektori informal është i angazhuar në grumbullimin e materialeve të ricikluesshme me vlerë. Grumbulluesit joformal të mbeturinave luajnë një rol të rëndësishëm në grumbullimin e materialeve të ricikluesshme në Kosovë. Vlerësohet se rreth 2000 individë mund të jenë të përfshirë në grumbullimin informal të mbeturinave në gjithë vendin, megjithëse nuk ka të dhëna zyrtare për të matur me saktësi shkallën e aktiviteteve të tyre. Këta mbledhës zakonisht vijnë nga komunitete të margjinalizuara dhe të pafavorizuara ekonomikisht dhe fokusohen në grumbullimin e artikujve të tillë si plastika, metalet, letra, kartoni, bateritë dhe mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike (MPEE). Ata shpesh ua shesin këto materiale kompanive të licencuara të vogla dhe të mesme, kryesisht për eksport.

Me kalimin e kohës, sektori informal ka evoluar, duke u zhvendosur nga përpjekjet individuale në operacione grupore më të organizuara. Këto grupe tani mbledhin dhe klasifikojnë mbeturinat sipas llojit përpara se t'ua shesin ato përpunuesve ose tregtarëve. Pavarësisht përpjekjeve të kufizuara për të integruar mbledhësit joformalë të mbeturinave në sistemin formal të menaxhimit të mbeturinave, nisma të tilla kanë qenë kryesisht të pasuksesshme (Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, 2021).

Gjithashtu, shumë familje në rajonin e Pejës përballen me varfëri ose janë të cenueshme ndaj shkundjeve ekonomike, pavarësisht përpjekjeve për të përmirësuar standardin e jetesës. Ekziston një hendek i ndjeshëm midis familjeve me të ardhura të larta dhe atzre me të ardhura të ulëta, duke kontribuar në pabarazinë sociale.

Kështu, megjithëse investimet e propozuara po sjellin ndikime pozitive në shoqëri dhe mjedis, mund të ketë ndikime negative të lidhura me personat e cenueshëm dhe mbledhësit informalë të mbeturinave, si dhe pabarazitë e perceptuara gjinore.

Tabela e mëposhtme paraqet një vlerësim të shkurtër të ndikimeve të mundshme mbi personat e cenueshëm dhe masat specifike për integrimin gjinor dhe përfshirjen sociale.

Tabela 80 Vlerësimi i ndikimeve të mundshme tek personat e cenueshëm dhe masat specifike për integrimin gjinor dhe përfshirjen sociale

Masat e propozuara	Ndikimet e mundshme	Masat e propozuara
Parandalimi i mbeturinave • Të fillohet me grumbullimin ndaras të materialeve të ricikluesshme • Kompostimi shtëpiak	Zvogëlimi i aksesit në burime për mbledhësit informalë të mbeturinave, duke përkeqësuar jetesën e tyre. Rritja e barrës mbi gratë për shkak të aktiviteteve të kompostimit në shtëpi	Mblidhni të dhëna për të përcaktuar nivelin bazë për: ○ aktivitete informale të kryera në shënjestër; ○ vlerësimin e përballueshmërisë së mbeturinave dhe përcaktimin e masave për të mbështetur familjet në nevojë;

[40] Draft Raporti, Agjenda e integrimit gjinor në sektorin e mbeturinave, përgatitur në kuadër të projektit-Komunat e gjelbra dhe të qëndrueshme – Menaxhimi i integruar i mbeturinave dhe ekonomia qarkore (Kosovo4Green), zbatuar nga GIZ Kosova, janar 2025

Masat e propozuara	Ndikimet e mundshme	Masat e propozuara
	Rritja e kostove të familjeve për shërbimet komunale mund të çojë në një barrë më të lartë për familjet vulnerabël.	○ gratë që punojnë në sektorin e menaxhimit të mbeturinave Kryeni konsultime me të gjitha palët e interesuara, përfshirë OJQ-të që përfaqësojnë gratë, para dhe gjatë zhvillimit dhe zbatimit të projekteve. Zhvilloni një program koherent ndërgjegjësimi për mbledhjen ndaras të mbeturinave dhe kompostimin në shtëpi. Fushatat duhet të jenë të ndjeshme ndaj aspekteve gjinore dhe aktivitetet specifike ndërgjegjësuese duhet të synojnë gratë dhe grupet vulnerabël, duke përfshirë mbledhësit informal të mbeturinave.
Stacionet e transferit të mbeturinave	Asnjë ndikim joproporcional mbi grupet vulnerabël	Fushatat e ndërgjegjësimit duhet të përfshijnë gjithashtu informacion në lidhje me stacionet e transferimit dhe mesazhi duhet të përshtatet në mënyrë që të jetë i arritshëm për të gjitha grupet, përfshirë ato vulnerabël. Gjithashtu, mesazhi duhet të integrohet në aspektin gjinor.
Oborret e riciklimit • 1 deponi rajonale në Pejë (përmirësimi i ekzistueses). Aktualisht nuk raportohet për prani joformale atje. • 1 ORM për materiale të pastra në Pejë • 1 TMB në Pejë • Mundësisht sistem i decentralizuar i vendeve të kompostimit – 1 në secilën nga 5 komunat • Objekt riciklimi dhe venddeponimi për mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit	Mundësi të reja pune / mundësi biznesi	Njoftimet për punë duhet të promovohen dhe të bëhen të arritshme për të gjitha grupet, përfshirë ato vulnerabël. Gjithashtu, mundësitë e punës nuk duhet të kufizohen në një kategori të caktuar personash, por duhet të jenë neutrale ndaj gjinisë. Në rast se do të promovohen mundësitë e biznesit, atëherë përpiquni të mbështesni gratë sipërmarrëse që të angazhohen në bizneset e riciklimit.

7 ZHVILLIMI I SISTEMIT TË REKOMANDUAR

7.1 Konfigurimi i sistemit

Tabela e mëposhtme përmbledh në detaje sistemin e preferuar për sistemin e integruar të menaxhimit të mbeturinave inerte.

Tabela 81Prezantimi i sistemit të preferuar

Përbërësit e sistemit	Përshkrimi	Kapaciteti	Viti/periudha
Parandalimi i mbeturinave	Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të kompostimit shtëpiak Miratimi i udhëzimeve për prokurimin e gjelbër publik Mbështetja e bizneseve lokale në zbatimin e masave për parandalimin e mbeturinave ushqimore Pjesëmarrja në nismat kombëtare për reduktimin e plastikës njëpërdorimshe	• n/a	Vazhdimisht
Grumbullimi i mbeturinave të përziera	Shporta individuale plastike 120/240 l për shtëpi familjare Shporta plastike individuale 120/240 l ose kontejnerë 1.1 m³ për ndërtesa shumëkatëshe në zonat urbane	• 54,234 tonë mbeturina të përziera të mbledhura në vitin 2026 • 37,644 ton të mbledhura në vitin 2035	Ndërrimi gradual i kontejnerëve dhe automjeteve grumbulluese
Mbledhja ndaras e mbeturinave	Shporta individuale plastike 120/240 l për grumbullimin e materialeve të ricklueshme, Kontejnerë 1.1 - 1.5 m³ për grumbullimin e veçantë të qelqit	• 100% e banorëve në zonat urbane dhe 80% e banorëve në zonat rurale • 19,000 tonë mbeturina të mbledhura ndaras më 2035	2026 në zonat urbane 2030 për zonat rurale
Oborret e Riciklimit (OR)	Do të krijohen 5 OR, një në secilën komunë	Fraksionet e mbeturinave që do të grumbullohen: • Mbeturinat e vëllimshme • Mbeturinat e rrezikshme shtëpiake • Fraksionet e veçanta të mbeturinave	2025
Transporti dhe transferimi	Stacionet e transferit do të ngriten në Istog dhe Deçan	• Istog – kapacitet prej 9,700 tonë /vit • Deçan – kapacitet prej 6,700 tonë/vit	2026
Klasifikimi i mbeturinave	Një stacion klasifikimi për materialet e grumbulluara ndaras do të ngritet në deponinë rajonale në Sferkë	• Kapaciteti i objektit ORM – 21,000 tonë/vit të lëndëve të ricklueshme të mbledhura ndaras	2026
Kompostimi	Katër objekte kompostimi për mbeturinat e gjelbra të grumbulluara veçmas do të ngriten në komunat Pejë, Istog , Klinë dhe Deçan.	• Objekti i kompostimit në Pejë – kapacitet prej 2,400 tonë/vit • Objekti i kompostimit në Istog – kapacitet 600 tonë/vit	2026

Përbërësit e sistemit	Përshkrimi	Kapaciteti	Viti/periudha
	Kompostimi në Pejë do të organizohet në lokacion të përhershëm, ndërsa në komunat tjera do të zbatohet kompostimi i decentralizuar duke përdorur pajisje mobile.	• Objekti i kompostimit në Klinë – kapacitet 600 tonë/vit • Objekti i kompostimit në Deçan – kapacitet 550 tonë/vit	
	Filiimi me kompostimin shtëpiak në zonat rurale	• n/a	I perhershem
Rikuperimi i mbeturinave	Do të ngritet 1 impiant TMB i cili do të trajtojë mbeturinat e përziera komunale nga të pesë komunat	• Kapaciteti prej 40,000 tonë/ vit • Prodhimi prej 12,000 tonë/vit KDM	2031
	1 impiant kompostimi brenda kontonjerëve të specializuar do të ngritet[41]në hapësirën e impiantit TMB ose në objektin e kompostimit në Pejë	• Kapaciteti prej 3,500 tonë/vit	2031
Deponimi i mbeturinave	Përmirësimi ildeponisë sanitare rajonale ekzistues për të gjithë ZMM	• Kapaciteti i deponisë prej rreth 475 mijë tonë[42]për një periudhë 20-vjeçare	2026 për qelinë e parë dhe infrastrukturën e përbashkët
MNRr	Rrjeti i pikave të hedhjes	• Pejë me kapacitet prej 5,400 m³/vit	2025-2027
		• Istog - kapaciteti 2,900 m³/vit	2025-2027
		• Klinë - kapaciteti 2,400 m³/vit	2025-2027
		• Deçan (që shërben edhe Junikun) me kapacitet 2,400 m³/vit	2025-2027
	Një objekt riciklimi me një thërmues mobil	• Kapaciteti 12,800 m³/vit	2027
	Një objekt deponimi	• Kapaciteti 19,300 m³/vit	2027

Shifrat e mëposhtme paraqesin vendndodhjen e objekteve të parashikuara për menaxhimin e mbeturinave në ZMM.

[41] Përndryshe, mund të ngritet një strukturë e tretjes anaerobe në vendin e impiantit TMB, në varësi të gjetjeve të studimit përkatës të fizibilitetit.

[42] Nuk përfshihen mbeturinat industriale jo të rrezikshme



Figura 29Vendndodhja e objekteve të parashikuara për menaxhimin e mbeturinave në WMZ

7.2 Kostot e investive dhe operacionale

Një përmbledhje e kostove të zbatimit për sistemin e ardhshëm të menaxhimit të mbeturinave është paraqitur në figurat e mëposhtme.

Kostot e investimit gjatë periudhës së planifikimit vlerësohen në 54.6 milionë €, duke përfshirë kostot për zëvendësimin e aseteve.



Figura 30Kostot e investimit për operacionalizimin e menaxhimit të mbeturinave

Kostot vjetore të operacionale pritet të rriten me ndërtimin e deponisë së re dhe me filimin e grumbullimit ndaras të mbeturinave të ricikluesshme dhe kompostimit të mbeturinave të gjelbra, nga 5.3 milionë € në 2026 në 7.8 milionë € në 2031 kur priten të funksionalizohen impianti TMB si dhe grumbullimi ndaras i mbeturinave ushqimore.



Figura 31Kostot vjetore operacionale për operacionet të menaxhimit të mbeturinave

Kostot totale vjetore që përbëhen nga kostot operacionale dhe atë të amortizimi janë paraqitur në dy figurat e mëposhtme.



Figura 32Kostot vjetore për operacione të menaxhimit të mbeturinave



Figura 33Kostot vjetore për llojin e kostos

Kostot vjetore për njësi për ton mbeturina të gjeneruara pritet të rriten nga 116,4 €/ton në vitin 2027 në 157,5 €/ton në vitin 2035.



Figura 34Kostot vjetore për njësi për ton mbeturina të gjeneruara

Kostot mesatare me ulje për njësi gjatë periudhës së planifikimit për ton mbeturina të gjeneruara janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 82Kostot e zbritura për njësi për sistemin e integruar të menaxhimit të mbeturinave për ton mbeturina të gjeneruara, € /ton

Parametri	Pejë	Istog	Klinë	Deçan	Junik	Mesatarja
Klasifikimi ndaras						
Kostot investive	6.89	7.51	11.18	11.05	12.85	8.06
Kostot operacionale	10.00	14.89	12.57	13.46	19.94	11.70
Kostot totale të mbledhjes ndaras	16.88	22.40	23.75	24.50	32.80	19.76
Grumbullimi i përzier						
Kostot investive	8.96	10.33	14.49	11.66	11.13	10.21
Kostot operacionale	22.06	25.05	37.64	23.00	21.44	24.57
Kostot totale të grumbullimit të përzier	31.02	35.38	52.13	34.66	32.57	34.78
Transferimi i mbeturinave të përziera						
Kostot investive	-	2.72	-	4.23	3.97	1.01
Kostot operacionale	-	8.57	-	9.85	9.24	2.75
Kostot totale të transferimit të mbeturinave	-	11.29	-	14.08	13.21	3.75
Kompostimi i mbeturinave të gjelbra						
Kostot investive	1.17	0.94	1.38	1.50	-	1.18
Kostot operacionale	4.08	4.00	5.86	6.22	-	4.46
Kostot totale të kompostimit të mbeturinave të gjelbra	5.25	4.94	7.24	7.71	-	5.64
Programi i kompostimit shtëpiak OPEX	1.80	4.13	5.49	5.72	7.42	3.17
Impianti klasifikues për grumbullimin ndaras						

Parametri	Pejë	Istog	Klinë	Deçan	Junik	Mesatarja
Kostot investive	1.76	1.56	1.53	1.48	1.43	1.66
Kostot operacionale	6.96	6.15	6.05	5.83	5.65	6.56
Kostot totale të impianteve të klasifikimit	8.72	7.71	7.59	7.30	7.08	8.22
Trajtimi i mbeturinave të përziera (TMB)						
Kostot investive	8.09	8.54	8.34	8.41	8.17	8.24
Kostot operacionale	7.80	8.23	8.04	8.11	7.88	7.94
Kostot totale tëT MB	15.89	16.77	16.38	16.52	16.05	16.18
Kompostimi i mbeturinave ushqimore në kontejnerë të specializuar						
Kostot investive	2.29	0.59	0.64	0.42	-	1.55
Kostot operacionale	2.63	0.68	0.74	0.48	-	1.78
Kostot totale të DA	4.92	1.27	1.38	0.91	-	3.33
Impianti RDF/KDM WtE/MpE	1.60	1.69	1.65	1.67	1.62	1.63
Deponia						
Kostot investive	15.83	16.70	16.31	16.46	15.98	16.11
Kostot operacionale	10.54	11.12	10.86	10.95	10.64	10.73
Kostot totale të deponisë	26.36	27.82	27.17	27.41	26.62	26.84
Totalet						
Kostot totale të investimit	44.99	48.89	53.88	55.20	53.54	48.02
Kostot totale operacionale	83.97	101.14	105.18	101.53	100.02	91.76
Kostot totale	128.96	150.03	159.05	156.73	153.55	139.78
Të hyrat totale	13.14	11.85	11.66	11.29	10.94	12.49
Kostot neto	115.82	138.18	147.40	145.44	142.61	127.29

Kostot me ulje për njësi për ton mbeturina të gjeneruara janë më të ulëtat në komunën e Pejës dhe vlerësohen në 115,82 €/ton dhe më e lartat në komunën e Klinës 147,40 €/ton, ndërsa vlera mesatare për rajonin është 127,29 €/ton.

7.3 Rrjedhat e mbeturinave dhe balanca e përgjithshme/masës i sistemit të rekomanduar

Shifrat e mëposhtme tregojnë balancën e përgjithshme/masës së sasive të mbeturinave për periudhën e planifikimit dhe për referencën e vitit të kaluar (2035).



Figura 35Bilanca e përgjithshme/masës e sistemit të propozuar të menaxhimit të mbeturinave gjatë periudhës së planifikimit.



Figura 36Balanca e përgjithshme/masës e sistemit në vitin 2035

Balanca e përgjithshme/masës tregon se në vitin 2035 do të arrihet një shkallë riciklimi 50.1% për peshën e mbeturinave të gjeneruara komunale ndërsa sasia e mbeturinave komunale të deponuara do të reduktohet në 17.8%.

8 PLANI I VEPRIMIT

8.1 Aktivitetet kryesore

8.1.1 Aktivitetet dhe përgjegjësitë kryesore

Plani i Veprimit përmban aktivitete të cilat do të jenë përgjegjësi individuale e komunave dhe si të tilla të ndërlidhen me ngritjen e objekteve rajonale për menaxhimin e mbeturinave dhe rrjedhimisht do të jenë përgjegjësi e të gjitha komunave.

Më poshtë janë renditur aktivitetet kryesore të cilat do të jenë përgjegjësi e komunave individuale :

- Masat për parandalimin e mbeturinave (të 5 komunat)
- Të fillohet me grumbullimin ndaras të mbeturinave të ricikluesshme të thata (të 5 komunat)
- Ngritja e oborreve të riciklimit (të 5 komunat)
- Krijimi i dy stacioneve të transferit (për komunën e Istogut dhe Deçanit)
- Krijimi i një objekti kompostimi për mbeturinat e gjelbra të grumbulluara ndaras (në komunën e Pejës) dhe zbatimi i kompostimit të decentralizuar të mbeturinave të gjelbra duke përdorur pajisje mobile në komunat Istog, Klinë, Deçan dhe Junik.
- Të fillohet me kompostimin shtëpiak në zonat rurale (të 5 komunat)
- Krijimi i katër pikave të hedhjes së mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi (në komunat Pejë, Istog, Klinë dhe Deçan)

Lista e mëposhtme tregon aktivitetet kryesore që do të zbatohen në nivel rajonal :

- Përmirësimi i deponisë sanitare rajonale ekzistuese
- Krijimi i një objekti klasifikimi për mbeturinave të ricikluesshme të grumbulluara ndaras
- Ngritja e një impianti TMB për trajtimin e mbeturinave të përziera komunale
- Ngritja e një impianti për trajtimin e mbeturinave organike (kompostimi në kontenjerë të specializuar ose impiant të tretjes anaerobe)
- Ngritja e një objekti riciklimi për mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit
- Ngritja e një venddeponimi për mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit

8.1.2 Ndërlidhjet ndërmjet detyrave

Transporti dhe transferimi i mbeturinave
Që nga viti 2025 është duke u bërë një studim i financuar nga KfW për ngritjen e stacionit të transferit për komunën e Istogut. Pas identifikimit të vendit të përshtatshëm dhe teknologjisë së transferit, duhej përgatitej një projekt i detajuar i ndjekur nga punimet e ndërtimit. Afati kohor për ngritjen e stacionit të transferit për komunën e Istogut është viti 2026.

Gjithashtu, duhet të krijohet një stacion transferi në komunën e Deçanit. Duhet të parashikohet që kapaciteti i stacionit të transferit të mund të akomodojë sasitë e mbeturinave të përziera nga komuna e Junikut. Aktualisht, ngritjes së stacionit të transferit duhet t'i paraprijë një studim fizibiliteti i cili do të identifikojë vendin e ndërtimit të tij si dhe teknologjinë optimale të transferit si dhe projektimi i detajuar për ndërtimin e tij. Afati kohor për ngritjen e stacionit të transferit në Komunën e Deçanit është 2026-2027.

Grumbullimi ndaras i mbeturinave dhe riciklimi i materialeve të ndara në burimi
Krijimi i një objekti të klasifikimit për materialet e ndara në burimi duhet t'i paraprijë vendosjes së sistemeve të grumbullimit ndaras të mbeturinave në komuna. Rekomandohet që grumbullimi ndaras dhe klasifikimi i

mëpasshëm i mbeturinave të ambalazhit të menaxhohet përmes skemave të ardhshme PZP. Arsyeja për këtë është se grumbullimi ndaras dhe klasifikimi i i mbeturinave të ambalazhit do të rezultojë me një kosto shtesë, e cila do të çojë në rritjen e tarifave të menaxhimit të mbeturinave për familjet.

Pasi të krijohen skemat PZP, gjë e cila pritet të ndodhë në vitin 2026, komunat do të duhet të bashkëpunojnë me Organizatat e Përgjegjësisë së Prodhuesit (OPP) në ngritjen e sistemeve të grumbullimit ndaras të mbeturinave në territoret e tyre. Sistemi i ndarjes në burimi do të bazohet në sistemin ekzistues të grumbullimit të mbeturinave – sistemin e sjelljes së mbeturinave te vendi i caktuar për blloqe banesash dhe shporta individuale për familjet që jetojnë në shtëpi individuale. Sistemi i ndarjes në burimi do të nisë fillimisht në zonat urbane, duke arritur mbulimin 100% në vitin 2030. Kjo do të zgjerohet gradualisht drejt zonave rurale, duke arritur mbulimin 80% në 2033.

Oborret e Riciklimit
Do të krijohen 5 OR, një në secilën komunë. Fraksionet e mbeturinave që do të grumbullohen kryesisht përfshijnë mbeturina të vëllimshme, mbeturinat e rrezikshme shtëpiake, fraksione të veçanta mbeturinash (pajisje elektrike dhe elektronike të përdorura, bateri etj.). Që nga viti 2025, po përgatitet një studim i cili do të identifikojë vendet për oborret e riciklimit dhe do të përgatiten konceptet e planit dhe pajisjeve të nevojshme. Kjo do të pasohet nga projektimi i detajuar i ndërtimit aktual të OR-ve. Parashikohet që OR-të të ndërtohen deri në fund të vitit 2026. Njëkohësisht do të prokurohen punimet e ndërtimit dhe pajisje (kryesisht kontejnerë të mëdhenj dhe të mesëm).

Kompostimi i mbeturinave të gjelbra të grumbulluara ndaras në hapësirat publike
Kompostimi i mbeturinave të gjelbra të grumbulluara veç ne veç nga mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbra do të organizohet në të gjitha komunatë. Kompostimi në Pejë do të organizohet në një vend të përhershëm, ndërsa në komunat tjera do të zbatohet kompostimi i decentralizuar duke përdorur pajisje mobile. Ngritja e impiantit të kompostimit duhet të paraprihet nga një studim fizibiliteti i cili do të identifikojë vendndodhjen e punishtes, teknologjinë që do të përdoret dhe pajisjet e nevojshme për të gjitha komunat. Vendi i kompostimit është planifikuar të jetë i disponueshëm dhe aktivitetet të fillojnë në të gjitha komunat në vitin 2027.

Objektet e rikuperimit të mbeturinave
Për të reduktuar sasinë e mbeturinave komunale që shkojnë në deponi, do të ngrihet një impiant TMB i cili do të trajtojë mbeturinat e përziera komunale nga të pesë komunat. Objekti TMB duhet të ngrihet në vitin 2031, si një fazë e dytë e zhvillimit të infrastrukturës së mbeturinave në rajon. Idealisht, objekti TMB duhet të ndërtohet në vendin e deponisë aktuale. Megjithatë, si detyrë e parë, një studim fizibiliteti do të përcaktojë vendndodhjen e saktë të objektit dhe të gjitha aspektet operacionale bazuar në sasitë e vlerësuara të mbeturinave të përziera nga të 5 komunat.

Për të arritur objektivin për mbeturinat komunale të përgatitura për ripërdorim dhe riciklim (50% deri në vitin 2035), do të duhet të krijohet një objekt shtesë për rikuperimin e mbeturinave organike, si pjesë e fazës së dytë të zhvillimit të infrastrukturës së mbeturinave në rajon. Si hap i parë, një studim fizibiliteti do të përcaktojë se çfarë lloj objekti trajtimi do të jetë më i përshtatshëm. Duhet të analizohen dhe krahasohen disa opsione: (i) një objekt për tretje anaerobe; (ii) impiant kompostimi brenda kontejnerëve të specializuar në vendin e impiantit TMB; ose (iii) impianti i kompostimit brenda kontejnerëve të specializuar në vendin e objektit të kompostimit në Pejë. Me të gjitha mundlësitë, objekti do të projektohet për të trajtuar mbeturinat ushqimore të grumbulluara ndaras si nga bizneset ashtu edhe nga familjet. Në mënyrë që objekti i trajtimit organik të ndërtohet në vitin 2031, studimi i fizibilitetit duhet të fillojë në vitin 2028.

Menaxhimi i mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit
Sistemi për menaxhimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit do të përbëhet nga: (i) 4 pika të hedhjes në komunat Pejë, Istog , Klinë dhe Deçan; (ii) një objekt riciklimi me një thërmues mobil; dhe (iii) një objekt deponimi. Krijimi i sistemit do të paraprihet nga përzgjedhja e vendeve për të gjithë elementët. Pasi të krijohen lokacionet dhe të përcaktohen për menaxhimin e MNRr, mund të prokurohen punimet e ndërtimit. Punimet e ndërtimit do të prokurohen për objektin e riciklimit dhe atë të deponimit. Komunat e veçanta do të jenë përgjegjëse për përcaktimin dhe profilizimin e pikave individuale të hedhjes. Përzgjedhja e lokacionit në të gjitha lokalitetet duhet të fillojë në

vitin 2026, ndërsa punimet e ndërtimit për objektin e riciklimit dhe atë të deponimit mund të prokurohen dhe të finalizohen në vitin 2027.

Menaxhimi i mbeturinave bujqësore
Menaxhimi i mbeturinave bujqësore do të jetë përgjegjësi kryesore e fermerëve lokal dhe gjeneruesve të tjerë të mbeturinave.

Menaxhimi i fraksioneve të veçanta të mbeturinave
Fraksionet e veçanta të mbeturinave përfshijnë:

- Mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike (MPEE)
- Bateritë dhe akumulatorët
- Automjetet e hedhura dhe mbeturinat e tyre (AM)
- Gomat e harxhuara
- Vajrat e përdorura

Ngjashëm me mbeturinat e ambalazhit, këto fraksione të veçanta mbeturinash do të duhet të menaxhohen përmes mekanizmit PZP. Skema të ndryshme PZP do të ngriten për çdo fraksion të veçantë mbeturinash. Prodhuesit dhe importuesit e këtyre produkteve specifike do të duhet të krijojnë Organizata të Përgjegjësisë së Prodhuesit (OPP). Pas miratimit të kërkesave ligjore për zgjerimin e përgjegjësive të prodhuesve dhe themelimin e OPP-ve, komunat do të nënshkruajnë marrëveshje me OPP-të për vendosjen e sistemeve të grumbullimit në vendet e caktuara. Kostot për menaxhimin e këtyre fraksioneve të veçanta të mbeturinave do të mbulohen nga OPP-të. Pritet që legjislacioni për PZP të jetë në i gatshshëm dhe në fuqi në vitin 2026 dhe se skemat e PZP do të ngriten deri në vitin 2027.

8.2 Orari për zbatim

Plani i Veprimit mbulon të gjitha fraksionet prioritare të mbeturinave dhe përfshin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e masave të parashikuara në PNMIM për periudhën 2025-2035. Plani i Veprimit përfshin gjithashtu buxhetin për secilin aktivitet, burimin e financimit, përgjegjësitë për zbatim, shtyllat kryesore dhe treguesin e performancës për secilin aktivitet. Treguesit e performancës, të përfshirë në Planin e Veprimit, synojnë të sigurojnë bazën për monitorimin e zbatimit të PNMIM duke përfshirë treguesit specifik dhe të matshëm.

8.2.1 Aktivitete afatshkurtra për zbatim

Aktivitetet e parashikuara për zbatim deri në vitin 2027 synojnë adresimin e problemeve më urgjente dhe prioriteteve kryesore për sistemin ekzistues të menaxhimit të mbeturinave.

Tabela e mëposhtme paraqet aktivitetet të cilat duhet të jenë me prioritet në **periudhën 2025-2027**.

Tabela 83Transporti dhe transferimi i mbeturinave

Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti, Euro	Burimi i financimit	Përgjegjësia	Treguesi i performancës/shtylla
1.	**Prioritet - Parandalimi i Mbeturinave**					
1.1	Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të kompostimit shtëpiak /shpërndarja e kompostuesve shtëpiak tek amvisëritëe	Çdo vit	Në kuadër të buxheteve të alokuara në planet komunale për menaxhimin e mbeturinave	Buxhetet e komunave	Të gjitha komunat	Numri i familjeve që zbatojnë kompostimin shtëpiak

Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti, Euro	Burimi i financimit	Përgjegjësia	Treguesi i performancës/shtylla
1.2	Aktivitete ndërgjegjësuese lidhur me zhvillimin dhe zbatimin e programeve të kompostimit shtëpiak	Çdo vit	Në kuadër të buxheteve të alokuara në planet komunale për menaxhimin e mbeturinave	Buxhetet e komunave	Të gjitha komunat	Numri i familjeve që zbatojnë kompostimin shtëpiak
1.3	Miratimi i udhëzuesve për prokurimin publik të gjelbër	2026	-	-	Koordinator i MNK-së	Udhëzuesit e përgatitur dhe miratuar nga secila komunë
1.4	Mbështetja e bizneseve lokale në zbatimin e masave për parandalimin e mbeturinave ushqimore	Çdo vit	Çmime për ata që zbatojnë masat sukses	Buxhetet e komunave	Komunat, OJQ-të	Numri i bizneseve që zbatojnë nisma për reduktimin e mbeturinave ushqimore
1.5	Pjesëmarrja në nismat kombëtare për reduktimin e plastikës njëpërdorimshe	Çdo vit	5,000 (në çmime për masat e zbatuara me sukses)	Buxhetet e komunave	Komunat, OJQ-të	Numri i iniciativave që zbatojnë reduktimin e plastikës njëpërdorimshe
2.	**Prioritet - Deponimi i mbeturinave**					
2.1	Përfundimi i projektit të detajuar për përmirësimin e deponisë së Sferkës	2025	-	Granti i asistencës teknike	Komuna e Pejës, (përkrahja e institucionit financiar ndërkombëtar)	Dizajni i detajuar i përfunduar
2.2	Punimet e ndërtimit për përmirësimin e deponisë së Sverkës	2026-2027	10,248,000	Granti kapital	Komuna e Pejës, (përkrahja e institucionit financiar ndërkombëtar)	Qeliat e reja janë autorizuar
3.	**Prioriteti - Transporti dhe transferimi i mbeturinave**					
3.1	Identifikimi i lokacionit dhe dizajni i detajuar për stacionin e transferit për Komunën e Istogut	2025	-	Granti i asistencës teknike	Komuna e Istogut , (përkrahja e institucionit financiar ndërkombëtar)	Dizajni i detajuar i përfunduar

Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti, Euro	Burimi i financimit	Përgjegjësia	Treguesi i performancës/shtylla
3.2	Punimet e ndërtimit të stacionit të transferit për Komunën e Istogut	2026-2027	694,000	Granti kapital	Komuna e Istogut , (përkrahja e institucionit financiar ndërkombëtar)	Stacioni i transferit i ngritur
3.3	Hartimi i studimit të fizibilitetit dhe dokumentacionit të projektimit për ngritjen e stacionit të transferit për Komunën e Deçanit (që shërben edhe për komunën e Junikut)	2025-2026	35,000	Granti i asistencës teknike	Komuna e Deçanit	Studimi i fizibilitetit dhe dizajni i detajuar i përfunduar
3.4	Punimet për ndërtimin e stacionit të transferit për Komunën e Deçanit	2027	726,000	Granti kapital	Komuna e Deçanit	Stacioni i transferit i ngritur
4.	**Prioriteti – Ngritja e sistemeve të riciklimit dhe rikuperimit të mbeturinave**					
4.1	***Detyrë – Krijimi i Oborreve të Riciklimit***					
4.1.1	Zhvillimi dhe dizajnimi i dokumentacionit për ngritjen e Oborreve të Riciklimit	2025		Granti i Asistencës Teknike	Të gjitha komunat	Dizajnet e përgatitura dhe të aprovuara
4.1.2	Punimet e ndërtimit dhe furnizimi me pajisje për OR në Komunën e Pejës	2025-2026	400,000	Buxheti komunal/Granti kapital	Komuna e Pejës	OR i gatshëm për punë
4.1.3	Punimet e ndërtimit dhe furnizimi me pajisje për OR në Komunën e Istogut	2025-2026	344,000	Buxheti komunal/Granti kapital	Komuna e Istogut	OR i gatshëm për punë
4.1.4	Punimet e ndërtimit dhe furnizimi me pajisje për OR në Komunën e Klinës	2026	344,000	Buxheti komunal/Granti kapital	Komuna e Klinës	OR i gatshëm për punë
4.1.5	Punimet e ndërtimit dhe furnizimi me pajisje për OR në Komunën e Deçanit	2026	382,000	Buxheti komunal/Granti kapital	Komuna e Deçanit	OR i gatshëm për punë

Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti, Euro	Burimi i financimit	Përgjegjësia	Treguesi i performancës/shtylla
4.1.6	Punimet e ndërtimit dhe furnizimi me pajisje për OR në Komunën e Junikut	2026	181,000	Buxheti komunal/Granti kapital	Komuna e Deçanit	OR i gatshëm për punë
4.1.7	Aktivitete ndërgjegjësuese lidhur me përdorimin e OR në komuna	Çdo vit nga viti 2026 e në vazhdim	2000 (çdo komunë)	Buxhetet e komunave	Të gjitha komunat	Sasitë e materialeve të mbledhura
4.2	***Detyrë – Menaxhimi i mbeturinave të ambalazhit***					
4.2.1	Nënshkrimi i marrëveshjes ndërmjet komunave dhe OPP-ve për mbeturinat e ambalazhit (pas miratimit të kërkesave ligjore për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit dhe themelimin e OPP-ve)	2026 - 2027 (në varësi të miratimit të legjislacionit kombëtar)	Nuk kërkon financim shtesë	-	OPP, komuna	Marrëveshjet e nënshkruara
4.2.2	Zhvillimi i sistemeve për grumbullimin ndaras të mbeturinave komunale të riciklueshme, duke përfshirë mbeturinat e ambalazhit	2027 – e në vazhdim	Në kuadër të buxhetit të OPP-ve	OPP, ofruesit e shërbimeve	OPP, administratat lokale	Popullata që i ofrohen shërbime të grumbullimit ndaras të mbeturinave (100% e popullsisë urbane në 2030; 80% e zonave rurale në 2033)
4.2.3	Ngritja e objektit të klasifikimit për mbeturinat e riciklueshme të grumbulluara ndaras	2027	1,575,000	OPP, ofruesit e shërbimeve	OPP (sipas kontratave me komunat për grumbullim ndaras)	Objekti funksional i klasifikimit për fraksionet e riciklueshme të mbledhura ndaras

Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti, Euro	Burimi i financimit	Përgjegjësia	Treguesi i performancës/shtylla
4.2.4	Zbatimi i fushatave ndërgjegjësuese të dizajnuara për të rritur pjesëmarrjen e publikut në skemat e grumbullimit ndarasë	2027 – e në vazhdim	1 euro për banor të shërbyer në vit	OPP, ofruesit e shërbimeve	Administratat lokale (koordinim)	Numri i fushatave ndërgjegjësuese të realizuara; numri i banorëve që ju ofrohet informacion
4.3	***Detyrë – Menaxhimi i mbeturinave të gjelbra***					
4.3.1	Zhvillimi i studimit të fizibilitetit dhe dokumentacionit të projektimit për ngritjen e objektit të kompostimit në komunën e Pejës dhe për furnizimin me pajisje për komunën e Istogut , Klinës dhe Deçanit.	2026	60,000	Granti i asistencës teknike	Komunat e Pejës, Istogut , Klinës dhe Deçanit (përkrahja e institucionit financiar ndërkombëtar)	Studimi i Fizibilitetit i përgatitur dhe i miratuar
4.3.2	Ndërtimi i objektit për kompostim në komunën e Pejës	2027	912,000	Granti kapital	Komuna e Pejës, (përkrahja e institucionit financiar ndërkombëtar)	1 impiant kompostimi i vënë në punë
4.3.3	Furnizimi me pajisje mobile për kompostim për komunat Istog, Klinë dhe Deçan	2027	701.505	Granti kapital	Komunat e Istogut , Klinës dhe Deçanit (përkrahja e institucionit financiar ndërkombëtar)	3 komuna pajisen me pajisje për kompostim të decentralizuar
4.4	***Detyrë – Menaxhimi i MNRr-ve***					
4.4.1	Zgjedhja e lokacionit për pikën e hedhjes në Komunën e Pejës	2026	-	-	Komuna e Pejës	Vendi i zgjedhur dhe i përcaktuar
4.4.2	Zgjedhja e lokacionit për pikën e hedhjes në Komunën e Istogut	2026	-	-	Komuna e Istogut	Vendi i zgjedhur dhe i pëcaktuar

Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti, Euro	Burimi i financimit	Përgjegjësia	Treguesi i performancës/shtylla
4.4.3	Zgjedhja e lokacionit për pikën e zbritjes në Komunën e Klinës	2026	-	-	Komuna e Klinës	Vendi i zgjedhur dhe i caktuar
4.4.4	Zgjedhja e lokacionit për pikën e hedhjes në Komunën e Deçanit	2026	-	-	Komuna e Deçanit	Vendi i zgjedhur dhe i përcaktuar
4.4.5	Ndërtimi i pikave të hedhjes	2027	600,000 (150,000 euro secila)	Granti kapital	Të gjitha komunat	Ngritja e pikave të hedhjes
4.4.6	Furnizimi me pajisje të grumbullimit dhe transportit	2027	439,000	Granti kapital	Të gjitha komunat	Pajisjet e furnizuara
4.4.7	Furnizimi me pajisje për pikat e hedhjes	2027	252,000	Granti kapital	Të gjitha komunat	Pajisjet e furnizuara
4.4.8	Punimet e ndërtimit për objektin e riciklimit (me vendndodhje në Komunën e Pejës)	2027	1,010,000	Granti kapital	Komuna e Pejës	Impianti i riciklimit është vënë në punë
4.4.9	Furnizimi me pajisje për objektin e riciklimit	2027	500,000	Granti kapital	Komuna e Pejës	Pajisjet e furnizuara
4.4.10	Punimet ndërtimore për deponimin (me vendndodhje në Komunën e Pejës)	2027	1 000 000	Granti kapital	Komuna e Pejës	Objekti i deponimit është vënë në punë
5	**Prioriteti – Menaxhimi i mbeturinave bujqësore**					
5.1	Zhvillimi dhe shpërndarja e materialeve informative mbi menaxhimin e mbeurinave bujqësore (p.sh. udhëzime për ruajtjen e plehut organik në fermë, kompostimin e mbeturinave bujqësore, rikuperimin e energjisë nga biomasa, etj.)	202 5 – për çdo vit në vazhdim	-	Buxhetet komunale, financimi kombëtar, financimi i donatorëve	Të gjitha komunat	Fushatat informative të zbatuara
5.2	Përmirësimi i kushteve për ruajtjen dhe trajtimin e plehut organik të kafshëve	2025 – për çdo vit në vazhdim	-	Fermerët	Komunat	Numri i fermave që zbatojnë planet e menaxhimit të plehut organik

Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti, Euro	Burimi i financimit	Përgjegjësia	Treguesi i performancës/shtylla
5.3	Masat për parandalimin e djegies së mbeturinave bujqësore në mjedise të hapura, duke përfshirë djegien e fushave, në instalime që nuk janë të pajisura me sisteme të trajtimit të gazrave të rrjedhshme dhe në instalime pa rikuperim të energjisë;	2025 – e çdo vit në vazhdim	-	Brenda buxhetit të autoriteteve të kontrollit	Komunat	Numri i inspektimeve
5.4	Mirëmbajtja dhe përditësimi i rregullt i inventarit të magazinave të agrokimikateve të vjetruara	2025 – e çdo vit në vazhdim	-	Brenda buxhetit të autoriteteve të kontrollit	Komunat	Inventarët e kompletuar
6.	**Prioriteti – Menaxhimi i fraksioeve tjera të mbeturinave**					
6.1	***Detyrë - Menaxhimi i MPEE-ve***					
6.1.1	Nënshkrimi i marrëveshjes me OPP-të për MPEE (pas miratimit të kërkesave ligjore për përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit dhe themelimin e OPP-ve)	2026 - 2027 (në varësi të miratimit të legjislacionit kombëtar)	-	-	OPP-të, komuna	Marrëveshjet e nënshkruara midis 5 komunave dhe PRO-ve
6.1.2	Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit të grumbullimit ndaras të MPEEnë përputhje me marrëveshjet me OPP-të	2027 e në vazhdim	Në kuadër të buxhetit të OPP-ve	OPP, ofruesit e shërbimeve	OPP-të, komunat (për koordinim)	Funksionimi i sistemit të grumbullimit ndaras për MPEE
6.1.3	Zbatimi i fushatave të ndërgjegjësimit të publikut të përcaktuara për modelet e reja të konsumit të qëndrueshëm dhe pjesëmarrja në skemat e grumbullimit ndaras	2027 dhe për çdo vit në vazhdim	-	OPP, ofruesit e shërbimeve	Komunat (për koordinim)	Numri i fushatave ndërgjegjësuese të realizuara; numri i banorëve që marrin informacion

Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti, Euro	Burimi i financimit	Përgjegjësia	Treguesi i performancës/shtylla
6.2	***Detyrë - Menaxhimi i baterive dhe akumulatorëve***					
6.2.1	Nënshkrimi i marrëveshjes me OPP-të për bateritë dhe akumulatorët e përdorur (pas miratimit të kërkesave ligjore për përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit dhe ngritjen e OPP-ve)	2026 - 2027 (në varësi të miratimit të legjislacionit kombëtar)	-	-	PRO-të, komunat	Marrëveshjet e nënshkruara midis 5 komunave dhe PRO-ve
6.2.2	Inventarizimi i dyqaneve për shitjen e baterive të automjeteve dhe baterive portative	2026	-	-	Komunat	Inventarizimi i komunës i kompletuar
6.2.3	Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit të grumbullimit ndaras i baterive dhe akumulatorëve të përdorur në përputhje me marrëveshjet me OPP-të	2027 e në vazhdim	Në kuadër të buxhetit të OPP-ve	OPP-të, ofruesit e shërbimeve	OPPtë, komunat (për koordinim)	Funksionimi i një sistemi të grumbullimit ndaras për bateritë
6.3	***Detyrë - Menaxhimi i automjeteve mbeturinë (AM)***					
6.3.1	Nënshkrimi i marrëveshjeve me OPP-të për AM-të (pas miratimit të kërkesave ligjore për përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit dhe themelimin e OPP-ve)	2026 - 2027 (në varësi të miratimit të legjislacionit kombëtar)	Nuk kërkon financim shtesë	-	OPP-të, komunat	Marrëveshjet e nënshkruara
6.3.2	Përcaktimi i vendeve për magazinimin e përkohshëm (dhe çmontimin) e AM-ve	2027	-	Ofruesit e shërbimeve në bazë të kontratës me OPP	OPP-të, komunat për koordinim	Vende magazinimi të përkohshëm për AM-të e krijuara dhe të licencuara për funksionim
6.3.3	Zhvillimi dhe zbatimi i kërkesave për largimin dhe grumbullimin e AM-ve të braktisura në rrugë publike dhe zona parkimi	2027 dhe në vazhdim deri në vitin 2030	Nuk kërkon financim shtesë	-	Komunat	Kërkesat e përcaktuara në rregulloret lokale dhe dispozitat administrative

Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti, Euro	Burimi i financimit	Përgjegjësia	Treguesi i performancës/shtylla
6.4	***Detyrë - Menaxhimi i gomave të të shpenzuara***					
6.4.1	Nënshkrimi i marrëveshjeve ndërmjet komunave dhe OPP-ve për gomat e përdorura dhe shpenzuara (pas miratimit të kërkesave ligjore për përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit dhe themelimit të OPP-ve)	2026 – 2027 (në varësi të miratimit të legjislacionit kombëtar)	Nuk kërkon financim shtesë	-	OPP-të, komunat	Marrëveshjet e nënshkruara midis 5 komunave dhe PRO-ve
6.4.2	Inventarizimi i vendeve për ndërrimin e gomave të përdorura në territorin e komunave	2026	Nuk kërkon financim shtesë	-	Komunat	Inventarizimi në komuna i kompletuar
6.4.3	Krijimi i infrastrukturës së grumbullimit të gomave të përdorura në oborret e riciklimit për mbeturinat specifike komunale	2027 (në varësi të miratimit të legjislacionit kombëtar)	Nuk kërkon financim shtesë	Në kuadër të shpenzimeve për ngritjen e oborreve të riciklimit për mbeturinat komunale	OPP-të, komunat	Vendet e grumbullimit të përcaktuara
6.5	***Detyrë - Menaxhimi i vajrave të përdorura***					
6.5.1	Nënshkrimi i marrëveshjeve me OPP-të për vajrat e përdorura (pas miratimit të kërkesave ligjore për përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit dhe themelimin e OPP-ve)	2026 – 2027 (në varësi të miratimit të legjislacionit kombëtar)	Nuk kërkon financim shtesë	-	OPP-të, komunat	Marrëveshjet e nënshkruara midis 5 komunave dhe OPP-ve
6.5.2	Inventarizimi i dyqaneve të riparimit të makinave dhe vendeve për zëvendësimin e vajrave motorikë	2026	Nuk kërkon financim shtesë	-	Komunat	Inventarizimi i komunave i kompletuar
6.5.3	Ndalimi i zëvendësimit të vajrave të përdorura motorike në zona publike dhe vende të papajisura për këtë qëllim	2027	Nuk kërkon financim shtesë	-	Komunat	Ndalimi është vendosur dhe zbatuar

Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti, Euro	Burimi i financimit	Përgjegjësia	Treguesi i performancës/shtylla
7.	**Prioriteti - Forcimi i strukturës institucionale**					
7.1	Përgatitja dhe nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërkomunal (MBNK)	2025	-	-	Të gjitha komunat	MBNK-të e nënshkruara
7.2	Emërimi i koordinatorit të BNK-së	2025 – çdo vit e në vazhdim	12,000 (në vit)	Buxhetet komunale, KRM-të	Komunat, KRM-të	Koordinatori i caktuar me funksione të dakorduara
7.3	Takime dy-vjeçare për zbatimin e marrëveshjes së PNMIM-së dhe marrëveshjes për BNK	Çdo vit	-	-	Koordinatori i BNK-së, të gjitha komunat	Zbatimi i monitoruar
7.4	Zhvillimi i një modeli për kontratën e shërbimit publik (KShP) që do të përdoret për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave	2025	5,000	Grant i Asistencës Teknike	Koordinator i BNK-së, komunat	KShP e përgatitur
7.5	Hartimi dhe miratimi i planit të biznesit për KRM 'Ambienti'	2025	-	-	Komunat, KRM	Planet e biznesit të aprovuara
7.6	Miratimi i raporteve vjetore dhe planeve vjetore për operimin e KRM 'Ambienti'	Çdo vit	-	-	Komunat	Raportet vjetore dhe planet vjetore të miratuara

8.2.2 Aktivitete afatmesme dhe afatgjata për zbatim

Aktivitetet e parashikuara për zbatimin afatmesëm synohet të bazohen në veprimet afatshkurtra dhe synojnë vazhdimin e krijimit të një sistemi të integruar rajonal të menaxhimit të mbeturinave, ndërsa aktivitetet për zbatimin afatgjatë synojnë t'i lejojnë komunat të vendosin bazat për arritjen e objektivave gjithëpërfshirëse të vendosura për vitin 2035.

Tabela më poshtë paraqet aktivitetet për zbatim për **periudhën 2028-2035** .

Tabela 84Aktivitetet për zbatimin afatmesëm dhe afatgjatë, 2028-2035

Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti, euro	Burimi i financimit	Përgjegjësia	Treguesi/shtyllat e performancës
1.	**Prioritet - Parandalimi i Mbeturinave**					
1.1	Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të kompostimit shtëpiak / shpërndarja e kompostuesve shtëpiak tek amvisëritë	Çdo vit	Në kuadër të buxheteve të alokuara në planet komunale për menaxhimin e mbeturinave	Buxhetet e komunave	Të gjitha komunat	Numri i familjeve që zbatojnë kompostimin shtëpiak
1.2	Futja e "kritereve të gjelbra" në procedurat e prokurimit publik (blerja e mallrave dhe e punëve nga autoritetet publike)	Çdo vit	-	-	Të gjitha komunat	Numri i procedurave të prokurimit publik duke përfshirë "kriteret e gjelbra"
1.3	Mbështetja e bizneseve lokale në zbatimin e masave për parandalimin e mbeturinave ushqimore	Çdo vit	Çmime për masat e zbatuara me sukses	Buxhetet e komunave	Komunatë, OJQ-të	Numri i bizneseve që zbatojnë nisma për reduktimin e mbeturinave ushqimore
1.4	Pjesëmarrja në nismat kombëtare për reduktimin e plastikës njëpërdorimshe	Çdo vit	Çmime për masat e zbatuara me sukses	Buxhetet e komunave	Komunatë, OJQ-të	Numri i iniciativave që zbatojnë reduktimin e plastikës njëpërdorimshe
2.	**Prioritet – Deponimi i mbeturinave**					
2.1	Deponia rajonale funksionon sipas kërkesave për leje dhe standardeve të fundit	E përhershme	Sipas planit të veprimit	Operatori i deponisë (KMDK) përmes tarifës së portës	Operatori i deponisë (KMDK), komunat	Deponia operon sipas kërkesave për leje

Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti, euro	Burimi i financimit	Përgjegjësia	Treguesi/shtyllat e performancës
	mjedisore	gjatë fazës së funksionimit	dhe buxhetit vjetor			Raportet e monitorimit të mjedisit Kapaciteti i deponisë i mjaftueshëm në dispozicion
2.2	Nuk kriohen deponi ilegale në territorin e komunave	I perhershem	-	-	Komunat	Numri i venddepnimeve të identifikuara
3.	**Prioriteti - Transporti dhe transferimi i mbeturinave**					
3.1	Stacionet e Transferit në Istog dhe Deçan funksionojnë sipas kërkesave për leje	I perhershem	Sipas buxhetit vjetor	Operatorët e shërbimeve në bazë të tarifave për shërbimet komunale të mbeturinave	Operatorët e shërbimeve, komunat	Stacionet e transferit janë operacionale
4.	**Prioriteti – Krijimi i sistemeve të riciklimit dhe rikuperimit të mbeturinave**					
4.1	***Detyrë – Krijimi i Oborreve të Riciklimit (OR)***					
4.1.1	OR funksiononte në përputhje me kërkesat mjedisore	I perhershem	Sipas buxhetit vjetor	Operatorët e shërbimeve në bazë të tarifave për shërbimet komunale të mbeturinave	Operatorët e shërbimeve, komunat	OR-të funksionale Sasitë e mbeturinave të grumbulluara në OR
4.2	***Detyrë – Menaxhimi i mbeturinave të ambalazhit***					
4.2.1	Zhvillimi i sistemeve për grumbullimin ndaras dhe veçimin e mbeturinave komunale, përfshirë mbeturinat nga ambalazhet dhe paketimet	E vazhdueshme	Në kuadër të buxhetit të OPP-ve	OPP-të, ofruesit e shërbimeve	OPP-të, komunat	Popullata e shlrbyer me shërbime të grumbullimit ndaras të mbeturinave (100% e popullsisë urbane në 2030; 80% e zonave rurale në 2033)

Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti, euro	Burimi i financimit	Përgjegjësia	Treguesi/shtyllat e performancës
4.2.2	Zbatimi i fushatave ndërgjegjësuese të përcaktuara për të rritur pjesëmarrjen e publikut në skemat e grumbullimit]ndaras	E vazhdueshme	1 euro për banor të shërbyer në vit	OPP-të, ofruesit e shërbimeve	Komunat (koordinim)	Numri i fushatave ndërgjegjësuese të realizuara; numri i banorëve që marrin informacion
4.3	***Detyrë – Menaxhimi i mbeturinave të gjelbra***					
	Nuk parashikohen aktivitete					
4.4	***Detyrë – Menaxhimi i MNRr-ve***					
4.4.1	Zbatimi i legjislacionit dhe rregulloreve që kontrollojnë deponimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit	I perhershem	Nuk kërkon financim shtesë	Brenda buxhetit të autoriteteve të kontrollit	Komunat	Numri i inspektimeve vjetore
4.5	***Detyrë – Ngritja e objekteve të rikuperimit të mbeturinave***					
4.5.1	Studimi i fizibilitetit për ngritjen e objektit TMB dhe sistemin të menaxhimit të mbeturinave ushqimore[43]	2028	350,000	Granti i asistencës teknike	KMDK në bashkëpunim me komunën që është në pronësi të lokacionit	Studimi i Fizibilitetit është përgatitur dhe miratuar
4.5.2	Projektimi dhe ndërtimi i objektit TMB[44]	2029-2031	15,254,000	Granti kapital	KMDK në bashkëpunim me komunën që është në pronësi të lokacionit	Impianti TMB është vënë në punë
4.5.3	Projektimi dhe ndërtimi i objektit të rikuperimit të mbeturinave ushqimore[44]	2029-2031	3,897,000	Granti kapital	KMDK në bashkëpunim me komunën që është në	Impianti i rikuperimit të mbeturinave ushqimore është vënë në punë

[43] Paraparë me pikën I.2.1 të Planit të Veprimit 2024 – 2026 të Strategjisë së Kosovës për Menaxhim të Integruar të Mbeturinave 2024 – 2035, ku përfshihen dhe studimet e fizibilitetit për objektet e përpunimit të mbeturinave.

[44] Paraparë me pikat I.2.1 dhe I.2.4 të Planit të Veprimit 2024 – 2026 të Strategjisë së Kosovës për Menaxhim të Integruar të Mbeturinave 2024 – 2035, ku përfshihen projektet dhe ndërtimi i infrastrukturës për përpunim të mbeturinave.

Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti, euro	Burimi i financimit	Përgjegjësia	Treguesi/shtyllat e performancës
					pronësi të lokacionit	
5.	**Prioriteti – Menaxhimi i fraksioneve tjera të mbeturinave**					
5.1	***Detyrë - Menaxhimi i MPEE-ve***					
5.1.1	Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit të grumbullimit ndaras të MPEE në përputhje me marrëveshjet me OPP-të	2027 dhe në vazhdim	Në kuadër të buxhetit tëOPP-ve	OPP-të, ofruesit e shërbimeve	OPP-të, komunat (për koordinim)	Funksionimi i sistemit të grumbullimit ndaras për MPEE
5.1.2	Zbatimi i fushatave të ndërgjegjësimit të publikut të përcaktuara për modelet e reja të konsumit të qëndrueshëm dhe pjesëmarrjen në skemat e grumbullimit ndaras	2027 dhe çdo vit në vazhdim	-	OPP-të, ofruesit e shërbimeve	Komunat (për koordinim)	Numri i fushatave ndërgjegjësuese të realizuara; numri i banorëve që marrin informacion
5.2	***Detyrë - Menaxhimi i baterive dhe akumulatorëve***					
5.2.1	Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit të grumbullimit ndaras të baterive dhe akumulatorëve të përdorur në përputhje me marrëveshjet me OPP-të	2027 dhe në vazhdim	Në kuadër të buxhetit të OPP-ve	OPP-të, ofruesit e shërbimeve	OPP-të, komunat (për koordinim)	Funksionimi i siistemit të grumbullimit ndaras për bateritë dhe akumulatorët
5.3	***Detyrë - Menaxhimi i Automjeteve Mbeturinë***					
5.3.1	Zhvillimi dhe zbatimi i kërkesave për heqjen dhe grumbullimin e AM-ve të braktisura nëpër rrugë publike dhe zona parkimi	202 7 e në vazhdim deri në vitin 2030	Nuk kërkon financim shtesë	-	Komunat	Kërkesat e përcaktuara në rregulloret lokale dhe dispozitat administrative
5.4	***Detyrë - Menaxhimi i gomave të shpenzuara***					
5.4.1	Krijimi i infrastrukturës së grumbullimit të	2027 (në	Nuk kërkon	Në kuadër të shpenzimeve për ngritjen	OPP-të, komunat	Vendet e grumbullimit të

Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti, euro	Burimi i financimit	Përgjegjësia	Treguesi/shtyllat e performancës
	gomave të përdorura/shpenzuara në oborret e riciklimit për mbeturinat specifike komunale	varësi të miratimit të legjislacionit kombëtar)	financim shtesë	e oborret e riciklimit për mbeturinat komunale		përcaktuara
5.5	***Detyrë - Menaxhimi i vajrave të përdorura***					
5.5.1	Nuk parashikohen aktivitete					

8.3 Kostot dhe burimet

Që nga viti 2025, të gjitha vlerësimet e kostos dhe të hyrat e sistemit janë me çmime konstante. Në të ardhmen, inflacioni ndikon si në kostot ashtu edhe në të hyra.

8.3.1 Grumbullimi ndaras i materialeve të riciklueshme dhe klasifikimi

Grumbullimi i ndaras i mbeturinave të materialeve të riciklueshme është parakusht për rikuperimin dhe shfrytëzimin e tyre.

Futja në praktikë e dhe rritja graduale e grumbullimit ndaras të mbeturinave për të mbuluar 100% të popullsisë urbane dhe 80% të popullsisë rurale kërkon investime të vazhdueshme dhe riinvestim në kamionë dhe kontejnerë. Kjo nënkupton grumbullimin ndaras të mbeturinave të materialeve të riciklueshme, për sasitë si më poshtë:

Tabela 85Materialet e riciklueshme të graumbulluara ndaras nga komunat, ton, 2027-2035

Komuna	2027	2028	2029	2030	2031	2032	2033	2034	2035
Pejë	5,081 t	6,385 t	7,836 t	8,496 t	9,225 t	10,015 t	10,562 t	11,066 t	11,552 t
Istog	1,705 t	1,890 t	2,101 t	2,341 t	2,612 t	2,910 t	3,068 t	3,213 t	3,352 t
Klinë	1,149 t	1,273 t	1,413 t	1,573 t	1,753 t	1,951 t	2,057 t	2,155 t	2,248 t
Deçan	1,027 t	1,142 t	1,273 t	1,423 t	1,592 t	1,778 t	1,875 t	1,964 t	2,048 t
Junik	154 t	163 t	172 t	181 t	191 t	202 t	213 t	224 t	235 t
Totali	9,116 t	10,853 t	12,796 t	14,014 t	15,375 t	16,857 t	17,776 t	18,622 t	19,435 t
Përfshirë pa-pastërtitë	10,484 t	12,481 t	14,715 t	16,116 t	17,681 t	19,385 t	20,442 t	21,415 t	22,350 t

Kostot e investive të grumbullimit ndaras

Për të përcaktuar pajisjet e nevojshme për grumbullimin ndaras të mbeturinave, përdoren supozimet e mëposhtme:

- Numri dhe kapacitetet e kontejnerëve dhe mjeteve të nevojshme grumbulluese korrespondojnë me sasitë e mbeturinave të grumbulluara, të llogaritura sipas numrit të banorëve të shërbyer dhe normave për frymë të grumbullimit të mbeturinave të riciklueshme në zonat urbane dhe rurale për vitin përkatës;
- Dendësia e materialeve në kontejnerë supozohet të jetë: 0,125 tonë/m³ për letër dhe karton; 0,030 tonë/m³ për plastikë; 0,150 tonë/m³ për metalet; 0,300 tonë/m³ për qelqin dhe 0,240 tonë/m³ për mbeturinat (papastërtitë) që gjenden në mbeturinat grumbulluara ndaras;
- Papastërtitë (mbeturinat) në kontejnerët e grumbullimit ndaras supozohet të jenë 15% e materialeve me vlerë.
- Mbushja mesatare e kontejnerit supozohet të jetë 80%;
- Numri i kontejnerëve është llogaritur duke supozuar 5% rezervë;
- Koha për shkarkimit të një shporte prej 240 l supozohet të jetë 40 sekonda, ndërsa koha e ngritjes së kontejnerët 1.5 m³, për qelq pranohet mesatarisht 4 minuta (përfshirë kohën për rrug;timin deri tek kontejnerin tjetër).
- Shpejtësia e lëvizjes së kamionëve grumbullues deri në objektin e klasifikimit supozohet të jetë 35 km/orë;
- Frekuenca e grumbullimit do të jetë 52 herë në vit për kontejnerët e letrës, kartonit e plastikës (ose kontejnerët e thatë) dhe 12 herë në vit për kontejnerët e qelqit;
- Supozohet që 85% të jetë shfrytëzimi i ngarkesës nominale të automjeteve grumbulluese dhe 85% e disponueshmërisë kur të përcaktohet numri i nevojshëm i automjeteve grumbulluese;
- Jetëgjatësia për kontejnerët dhe shportat pranohet të jetë 7 vjet dhe 10 vjet për automjetet për grumbullimin e mbeturinave (AGM-të);

- Kostot për njësi prej 900 €/pc janë kalkuluar për kontejnerin Igloo 1.5 m³, 80 €/copë përdoren për shporta nga plastika 240 l dhe 140,000 €/copë për automjet grumbullues 16.0 m³. Kostot për sistemin e kontejnerëve nuk merren parasysh;
- Distancat mesatare të udhëtimit ndërmjet komunave individuale dhe objektit të klasifikimit maten në drejtim të qendrës përkatëse të qytetit. Supozohet se objekti i klasifikimit do të jetë në deponinë rajonale;
- Koha mesatare e shpenzuar për shkarkim në vendin e klasifikimit do të jetë gjysmë ore. Koha e ndërmjet udhëtimeve do të jetë gjithashtu gjysmë ore;

Vlerësimi vjetor i investimeve dhe riinvestimit të kërkuar nga komunat është përmbledhur në figurën e mëposhtme:



Figura 37Kostot e investimieve për grumbullimin ndaras të mbeturinave

Për periudhën, shuma totale e investimit dhe riinvestimit në grumbullimin ndaras të mbeturinave është llogaritur të jetë 8,6 milionë euro.

Kostot investive në objektin e klasifikimit

Objekti i klasifikimit duhet të përpunojë nga 10,000 deri në 22,000 t.
Këto sasi janë relativisht të ulëta dhe supozojnë ngritjen e një objekti të centralizuar klasifikimi për të gjithë rajonin. Madhësia minimale e investimit fillestar të kërkuar është 1,575,000 EUR, për të përfshirë:

- Punime civile 671,000 €.
- Mekanike 693.000 €.
- Automjete 168,000 €.
- Të tjera 43,000 €.

Kostot operacionale të grumbullimit ndaras

Grumbullimi ndaras

- Kostot vjetore të mirëmbajtjes për kamionët janë vlerësuar në 5% të kostove investive;
- Kostot vjetore të mirëmbajtjes për kontejnerët janë përcaktuar si 2% e kostove investive;

- Kostot e punëve llogariten për 46 javë pune për person, 5 ditë pune në javë dhe mesatarisht 5% pushim mjekësor;
- Kostot për ndërgjegjësimin e publikut llogariten në masën 10% të kostove vjetore;
- Kostot për administrimin e sistemit parashihet të jenë 10% e kostove direkte operacionale.

Deri në vitin 2035, kostot vjetore toperacionale dhe mirëmbajtjes për grumbullimin ndaras të materialeve të ricikluesshme për gjithë rajonin rriten nga 660,000 në 1,3 milionë EUR.

Kostot operacionale për objektin e klasifikimit

Stafi i punësuar rritet nga 36 në 55 persona dhe kostot e pagave vjetore rriten nga 270 në 400 mijë euro. Kostot vjetore të mirëmbajtjes përkufizohen si 1% e kostos së punëve civile, 6% e kostos mekanike, 15% e automjetit dhe 10% e kostove të tjera investive dhe arrijnë në 78 mijë euro. Kostot vjetore të energjisë elektrike rriten nga 24 në 48 mijë euro, kostot e naftës nga 20 në 43 mijë euro. Kostot administrative, taksat dhe sigurimet përcaktohen si 14% e kostove të tjera operacionale vjetore.
Kështu, kostot totale operacionale dhe mirëmbajtjes rriten nga 455 në 665 mijë euro.

Deponimi i mbeturinave të përziera në deponi

Kostoja vjetore e deponimit të mbeturinave të përziera nga impianti i klasifikimit përcaktohet në bazë të tarifës së portës në deponi dhe sasive të papastërtive të deponuara.

Të hyrat nga shitja e materialeve të ricikluesshme

Të hyrat nga shitja e materialeve të ricikluesshme përcaktohen në bazë të çmimeve të mëposhtme për materialet e ricikluesshme dhe supozimin se të gjitha materialet e ricikluesshme do të shiten:

- letër&karton 75 €/t
- plastikë 180 €/t
- metal 200 €/t
- qelq 10 €/t

Kostot e transportit për blerësit e mundshëm të materialeve të ricikluesshme nuk merren parasysh. Çmimi i plastikës ndryshon ndjeshëm në varësi të llojit të plastikës.

Grafiku i mëposhtëm përmbledh kostot e grumbullimit ndaras, klasifikimit dhe të hyrave nga shitja e materialeve të ricikluesshme.



Figura 38Kostot vjetore për grumbullimin ndaras, klasifikimin e materialeve të riciklueshme të grumbulluara ndaras dhe të hyrat nga shitjet e materialeve të riciklueshme

Siç shihet në grafikon, të hyrat nga shitja e materialeve të riciklueshme nuk mund të mbulojnë as kostot e grumbullimit ndaras.
Grante nuk jepen për pajisjet e grumbullimit të mbeturinave. Nëse investimi fillestar në objektin e klasifikimit ofrohet si grant, kjo do të ketë një ndikim të vogël në kosto.

Financimi

Kostot për grumbullimin ndaras dhe klasifikimin janë të konsiderueshme dhe nuk mund të kompensohen nga të hyrat nga shitja e materialeve të riciklueshme siç është konsideruar më sipër. Ngritja e skemës PZP për mbeturinat e ambalazhit është konsideruar në nivel kombëtar si dhe financimi i grumbullimit ndaras dhe klasifikimi i mbeturinave nga të hyrat e skemës PZP.
Të gjitha kostot për mbeturinat e ambalazhit dhe të hyrat që ndërlidhen me grumbullimin ndaras të materialeve të riciklueshme, klasifikimin dhe transportin e mëtejshëm deri në riciklimin përfundimtar do të financohen nga skema PZP, pas miratimit në nivel kombëtar.

8.3.2 Kompostimi i mbeturinave të gjelbra

Kompostimi i mbeturinave të gjelbra organike (p.sh. mbeturinat e fushave, mbeturinat nga kopshtet etj.) kërkon një minimum përpunimi paraprak qëi do të rezultojë në cilësi të lartë të produktit të kompostimit i cili mund të përdoret si kondicioner i tokës, i përshtatshëm për përdorime bujqësore dhe të tjera.

Kompostimi do të bëhet në të ashtuquajturat palë palë, që mund të kenë kryqëzim trekëndor ose trapezoid të seksioneve, që trazohen ose rrotullohen rregullisht. Procesi është i adaptueshëm ndaj zgjerimit të ardhshëm (rritjes së kapacitetit) ose përditësimit të pajisjeve. Disavantazhi është periudha relativisht e gjatë e nevojshme për maturimin e kompostit.

Figure 39. Impiant tipik kompostimi palë palë

Në varësi të cilësisë së lëndës së parë dhe konsistencës së xhiros dhe modeleve operacionale, kompostimi me palë palë të hapura zakonisht zgjat 5 deri në 6 muaj. Për të prodhuar një produkt cilësor (komposto) që mund të përdoret për qëllime të ndryshme fushore apo bujqësore, do të duhet të kryhen teste të rregullta mbi temperaturën, lagështinë dhe përmbajtjen e lëndëve ushqyese të kompostos.

Objektet e kompostimit të hapur palë palë për mbeturinat e gjelbra nga zonat publike urbane janë planifikuar për secilën komunë, përveç Junikut . Sasitë e mbeturinave të gjelbra në komunën e Junikut janë mjaft të vogla për të justifikuar blerjen e pajisjeve apo apo transportin dhe shfrytëzimin e përbashkët të pajisjeve mobile.

.

Tabela 86Sasitë vjetore të mbeturinave të gjelbra të grumbulluara ndaras

Parametri	Pejë	Istog	Klinë	Deçan	Junik
Sasitë vjetore të mbeturinave të gjelbra të grumbulluara ndaras	2,400 t	600 t	600 t	550 t	65 t

Kostot e investimit dhe burimi i financimit

Kostot e vlerësuara të investimit fillestar janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme, në mijë euro:

Tabela 87Kostot investimit fillestar për kompostimin e mbeturinave të gjelbra

Parametri	Pejë	Istog	Klinë	Deçan
Punime civile	129			
Makineri	370	39	39	39
Automjete	369	184	184	184
Inxhinieri, komisionim, kontigjente	43	11	11	11
Totali, mijë EUR	**912**	**234**	**234**	**234**

Financimi i investimit fillestar në vendin e kompostimit të mbeturinave të gjelbra dhe pajisjet duhet të sigurohen si grant.

Kostot operacionale

Stafi i punësuar në objektin e Pejës është 6 persona dhe 3 persona për secilin nga vendet e kompostimit të komunave tjera. Kostot vjetore të mirëmbajtjes janë përcaktuar si 1% e kostos civile, 6% e kostos mekanike, 10% e kostos së automjetit. Kostot administrative dhe sigurimet përcaktohen si 10% e kostove të tjera.

Kostot e vlerësuara të funksionimit dhe mirëmbajtjes për kompostimin e haour pale palë janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme, në mijë euro:

Tabela 88Kostot e vlerësuara operacionale dhe mirëmbajtjes për kompostimin e hapur palë palë

Parametri	Pejë	Istog	Klinë	Deçan
Mirëmbajtja	60	21	21	21
Pagat	55	24	24	24
Materiale harxhuese (karburant, energji elektrike, etj.)	59	11	11	10
Administrata, taksat, sigurimet	17	6	6	5
Totali i OPEX-it	192	61	61	60

Kostot për grumbullimin ndars të mbeturinave të gjelbra prej 30 €/t merren parasysh krahas kostove të kompostimit të hapur pale palë. Kostoja e grumbullimit është vendosur e ulët, derisa vendet e kompostimit duhet të jenë në afërsi të burimit kryesor publik të mbeturinave të gjelbra.

Të ardhurat nga shitja e plehut organik

0.45 ton kompost gjenerohen nga çdo ton mbeturina të gjelbra për shkak të lagështisë, gazit dhe humbjes së materialeve gjatë procesit të kompostimit. Çmimi më i ulët i i konsideruar për kompostimin nga mbeturinat e gjelbra është 5 €/t.

Tabela 89Të hyrat potenciale nga shitja e kompostit

Parametri	Pejë	Istog	Klinë	Deçan
Prodhimi vjetor i kompostit	1,080 ton	270 ton	270 ton	248 ton
Të hyrat potenciale, mijëra euro	5	1	1	1

Kërkesa për kompost po rritet, çmimet dhe të hyrat (ose kostot e shmangura në rast të blerjeve komunale të tokës ose kompostit) pritet të rriten.

Përmbledhja e të gjitha kostove dhe të hyrave në lidhje me kompostimin e mbeturinave të gjelbra është paraqitur në tabelën e mëposhtme, në mijë euro:

Tabela 90Kostot vjetore që do të mbulohen nga tarifa e mbeturinave, mijë euro

Parametri	Pejë	Istog	Klinë	Deçan
Operacionale/OPEX	192	61	61	60
Grumbullimi ndaras e mbeturinave të gjelbra	69	17	17	15
Të hyrat nga kompostimi	5	1	1	1
Kostot neto vjetore	**256**	**77**	**77**	**75**

Ndërsa mbeturinate gjelbra nga zonat publike kompostohen, kostot vjetore neto për kompostimin e mbeturinave të gjelbra duhet të mbulohen nga tarifat e mbeturinave të grumbulluara nga gjeneruesit e mbeturinave – popullsia, bizneset, institucionet.

8.3.3 Kompostimi shtëpiak

Për vendbanimet rurale është planifkuar kompostimi shtëpiak i mbeturinave e gjelbra dhe që nga viti 2032 edhe nga mbeturinat organike/ushqimore.

Kompostimi shtëpiak redukton sasitë e mbeturinave në deponi. Në mënyrën më të zakonshme, procesi i kompostimit kërkon thjesht grumbullimin e mbeturinave të gjelbra. Procesi i dekompozimit ndihmohet nga copëtimi i bimëve dhe degëve nga pemët. Për të përshpejtuar procesin e dekompozimit duhet të sigurohet ajrosja e duhur duke e rrotulluar rregullisht përzierjen. Mbeturinat e kuzhinës gjithashtu mund të shtohen në proces, por vetëm mbeturinat e zgjedhura ushqimore. Produktet e qumështit dhe mishi duhet të shmangen pasi tërheqin parazitë dhe minjtë.
Kompostimi shtëpiak mund të lehtësohet duke përdorur pajisje speciale. Një njësi kompostimi shtëpiak mund të bëhet nga druri ose materiale të tjera, që mund të jetë shumë e thjeshtë dhe e lirë

Për të mbështetur aktivitetin kërkohen masa aktive dhe kontrolle vjetore.

Tabela e mëposhtme përmbledh synimet për sasitë e mbeturinave të kompostuara në shtëpi, kostot vjetore komunale që ndërlidhen me mbështetjen e kompostimit shtëpiak.

Tabela 91Kostot komunale dhe mbeturinat e gjelbra dhe ushqimore të kompostuara në shtëpi në zonat rurale

Parametri	2027	2028	2029	2030	2031	2032	2033	2034	2035
Mbeturinat e kompostimit shtëpiak, Pejë	177 t	196 t	217 t	240 t	256 t	1,451 t	1,657 t	1,895 t	2,045 t
Kostoja për Pejë, mijë euro	24	26	27	28	30	31	33	34	36
Mbeturinat e kompostimit shtëpiak, Istog	97 t	107 t	119 t	132 t	140 t	795 t	908 t	1,038 t	1,120 t
Kostoja për Istog , mijë euro	17	18	19	20	21	22	23	24	25
Mbeturinat e kompostimit shqëpiak, Klinë	64 t	71 t	78 t	87 t	92 t	523 t	598 t	683 t	738 t
Kostot për Klinë, mijë euro	16	16	17	18	19	20	21	22	23
Mbeturinat e kompostimit shtëpiak, Deçan	62 t	69 t	76 t	84 t	90 t	509 t	581 t	664 t	717 t
Kostot për Deçanint, mijë euro	15	16	17	17	18	19	20	21	22
Mbeturinat e kompostimit shtëpiak, Junik	9 t	10 t	11 t	13 t	13 t	76 t	87 t	100 t	108 t
Kostor për Junik, mijë euro	2	2	3	3	3	3	3	3	3

Duke marrë në konsideratë rritjen e kostos së trajtimit dhe deponimit, kompostimi shtëpiak zvogëlon kostot e të gjithë sistemit për gjeneruesit e mbeturinave.

Kostot vjetore për të mbështetur kompostimin shtëpiak në zonat rurale do të mbulohen nga tarifat e mbeturinave të brumbulluara nga gjeneruesit e mbeturinave – popullata, bizneset, institucionet.

